

Rrëfimet  
më të mira



AMËR ISTREFI

**Redaktor**  
Elhaid Alija

**Faqosja**  
Bledar Xama

**Kontakt**  
+355 67 54 94 055

*Merjemes, Jahjas,  
Ejubit, Is'hakut, Ismailit  
dhe jo veç...*







## Parathënie

Falënderimet pa fund qofshin për Allahun, Krijuesin e Gjithësisë, Bujarin, që i dhuroi dijen dhe i zbriti Kur'anin njerëzisë. Salavatet dhe selamet për zotërinë e njerëzimit, për hz. Muhamedin, përgjigjen e lutjes së Ibrahimit, për familjen e tij, sahabet, burimin e udhëzimit dhe për këdo që i pason deri në Ditën e Gjykimit.

Njerëzit, për nga natyra, janë të dhënë pas rrëfimeve dhe historive. U këndohet burrave të urtë, bujarëve, besnikëve dhe trimave të paepur. Një numër i pafund personazhesh dhe ndodhish epike përcillen ndër mote. Një botë e tërë ndjenjash bëhen burim frymëzimi për brezat, veçanërisht për të rinjtë. Dëgjohen me ëndje, lexohen me dëshirë dhe mbahen në mend me lehtësi. Ndoshta kjo është një ndër arsyet pse një e treta ajeteve të Kur'anit Famëmadh na flasin për histori.

Me shpresën që t'u bëhej i dashur libri dhe leximi, para disa viteve, fillova t'u lexoja fëmijëve të mi libra me tregime. Sapo vinin nga shkolla, u lexoja disa faqe për t'ua flladitur zemrat. Kur lodheshin nga detyrat më kërkonin pjesën e mbetur të tregimit. Para gjumit një tregim të ri... e kështu kush e di sa libra me tregime, novela dhe romane kemi lexuar bashkë. Ndërkohë që fëmijëve u shtohet oreksi, unë orvatesha t'u gjeja ndonjë libër me vlerë sa në njërën librari në tjetrën. Mirëpo, një ditë, miku i im, dr. Bekimi, teksa më tregoi çfarë u lexonte të bijave, më dha një libër të vjetër, vende-vende të grisur nga shfletimi i tepërt. "Rrëfime mbi pejgamberët." titullohej, nga shkrimtari

dhe mendimtari i njohur indian Ebu Hasen Nedevij, Allahu e mëshiroffë. Ishte pikërisht ky libër shkëndija që ndezi tek unë dëshirën për të hedhur dritë mbi historitë e Kur'anit. Fillova t'a shfletoj me ëndje. Stili i këtij libri të vlerë ishte i thjeshtë, i përshtatshëm për natyrën e fëmijëve, i lehtë dhe i kuptueshëm. Teksa ua lexoja, aty-këtu më farfurinin lloj-lloj pyetjesh, por fëmijëve nuk u bëja zë. Më nxiti kureshtja dhe fillova të kërkoj përgjigje për pyetjet që më lindën. U zhyta në thellësitë e librit me të njëjtin titull nga alimi i madh, Ibn Kethir, Allahu e mëshiroffë. Prej tij, nxora perla e margaritarë që kurrë s'i kisha dëgjuar; madje zbulova edhe rrëfime të disa Pejgamberëve, që nuk përmendeshin tek libri i fëmijëve. Lexo vetë në mëngjes - tregojua fëmijëve në mbrëmje. Madje shkova edhe më tej: me zell shfletova tefsirin e Abdurrahman es-Sadit që të mund të përfitoja sa më shumë edhe nga ky thesar. E kështu, dashuria për fëmijët më shtyu t'i shkruaj gjithsa mësova që t'ua lë kujtim. Mirëpo, unë nuk jam shkrimtar. Historitë i tregoj me lehtësi ama, i shkruaj me zor. M'u deshën vite t'i mblidhja rrëfimet e Pejgamberëve për fëmijët e mi të shtrenjtë. Pasi i shkrova, ua lexova disa herë që të brumoseshin me tharmin e moralit të mirë dhe virtyteve të larta peygamberike. Kaq mirë i kanë mësuar saqë, djali i madh Jahja, kur filloj rrëfimet, më thotë: "Na bëj pyetje rreth Pejgamberëve se historitë kush e di sa herë na i ke treguar!" Sot i kanë mësuar dhe, ndoshta, kërkojnë libra të tjerë... por unë besoj se këto histori u përngajnë farave të bekuara, të cilat u përpoqa t'i mbjelli me dashuri në zemrat e tyre duke shpresuar që frutat e pemës t'i shijojnë kur të rriten. E lus Allahun e Lartmadhërishëm t'i bëjë të dobishme këto rrëfime, t'i lexojnë fëmijët e mi dhe fëmijët e vëllezërve të mi për nga besimil!

Rrëfimet i kam shkruar në trajtë porosish që baba i jep fëmijës së vet, me dëshirën e mirë që, përse janë të vegjël,

ʼu lexohen nga prindi, dhe kur të rriten, ʼi lexojnë vetë e ʼu kujtohet prindi tek u lexonte dikur. I kam shkruar me dëshirën që ʼua ndezi dashurinë për të Dërguarit e Allahut, për librin dhe leximin. Brez pas brezi ʼua lexojnë edhe fëmijëve e nipave të tyre dhe ʼi luten Rrahmanit ta mëshirojë shpirtin e atij që i mblodhi rrëfimet për ta.

Burimi i rrëfimeve të shkruara është Kurʼani dhe Suneti i të Dërguarit tonë, alejhis-selam. Herë-herë, për ta bërë historinë më tërheqëse, jam ndihmuar edhe me *israiliate* të përcjella nga Ibn Kethiri, Allahu e mëshiroftë. Siç dihet: *israiliatet* ndahen në tre grupe. Në grupin e parë bëjnë pjesë ato rrëfime që përcillen edhe nga Kurʼani dhe Suneti. Këta janë të saktë, të vërtetë dhe nuk lejohet ʼi mohojmë. Në grupin e dytë bëjnë pjesë rrëfimet që nuk përcillen nga Kurʼani dhe Suneti, por nuk i bien ndesh parimeve islame. Rrëfime të tilla i kam përmendur në përputhje me udhëzimin e Profetit, alejhis-selam: "...tregoni rrëfimet e përcjella nga benu israilët, pa u ndjerë keq (duke mos e konsideruar gjynah)...", por pa i besuar dhe duke mos i mohuar. Këta rrëfime nuk i pohojmë, pasi nuk kanë besueshmëri dhe as zinxhir transmetimi. Ama, as nuk i mohojmë, sepse diçka mund të jetë e vërtetë. Ndërsa grupi i tretë përfshin rrëfimet që nuk përcillen nga Kurʼani dhe Suneti, por që i bien ndesh parimeve islame. Këta të fundit nuk lejohet të tregohen, veç nëse është për qëllim vënia në dukje e gabimeve në shkrimet e ithtarëve të librit. I mbështetur në përzgjedhjen e Ibn Kethirit, shpresoj se ja kam qëlluar të vërtetës duke përcjellë vetëm nga dy grupet e para. Megjithatë, sa herë që e kam bërë këtë, e kam filluar fjalinë me fjalën *Thuhet ose Kam lexuar*.

Në këto histori kam sjellë edhe emrat e disa Pejgamberëve që nuk përmenden në Kurʼan, siç është shembulli i Jusha bin Nun apo Shemulit, gjithmonë i mbështetur në përzgjedhjen e Ibn Kethir-it, Allahu e mëshiroftë.



Rrëfimet më të mira

Emrin *Pejgamber* apo *i Dërguar* i kam shkruar gjithmonë me të madhe, qoftë edhe përgjatë fjalisë, për të nderur në zemrën e lexuesit respekt e nderim për këto burra të mëdhenj.

Në rrëfimin mbi “Thertoren e Madhe” e deri tek pjesa “Vdekja e Isait, alejhis-selam.” kam përdorur folje në kohën e tashme dhe të ardhme, sikur t’i kem parë këto ndodhi me sytë e mi. Këtë e kam bërë me dëshirën që t’i sjelli sa më afër lexuesit ngjarjet që do të ndodhin para Kijametit.

Rrëfimet jam përpjekur t’i stolis edhe me këshilla e porosi, që të shërbejnë si dritë udhëzimi dhe burim mirësie për këdo që i lexon, sidomos për moshat e reja.

## Njeriu i parë

Biri im, dije se të gjithë njerëzit janë pasardhës të Ademit, alejhis-selam. Dije se Ademi është njeriu i parë që ka krijuar Allahu i Lartësuar dhe e ka nderuar mbi krijesat e tjera. Mirëpo a e ke dëgjuar ndonjëherë historinë e Ademit, o djalë? Do mundohem të ta tregoj sa më mirë të jetë e mundur, prandaj bëhu i vëmendshëm dhe dëgjo me kujdes...

Mijëra vite para nesh, kush e di se kur; Allahu i Lartësuar krijoi shtatë qiejt dhe tokën. Pasi e zbukuroi me dete, me burime të kulluar dhe lëndina pafund, pasi vendosi kodra e male në të, e bëri të përshtatshme për jetë. Atëherë Lartmadhëria e Tij lajmëroi banorët e qiellit se do i falte jetë një krijese nga dheu dhe caktoi se vendbanimi i saj do ishte Toka. Që të zbulonin urtësinë e krijimit të njeriut, melekët i thanë Allahut: *"A do t'i falësh jetë një krijesë që sjell ngatërresa dhe derdh gjak?"* Thuhet se banorët e qiellit ishin dëshmitarë të tollovide dhe vrasjeve që ndodhnin në Tokë nga xhindët, të cilët Allahu i kish krijuar qëmot, ndaj mendonin se edhe njeriu i tillë do ishte. *"Nëse do krijesa që të adhurojnë, ne të adhurojmë natë e ditë pa u lodhur, o Mbreti i jonë."* - thanë melekët njëzëri. *"Unë e di atë që ju nuk e dini."* - u tha Allahu. Pas fjalës së të Gjithditurit askush nuk foli më.

Për këtë detyrë, Allahu i Lartësuar dërgoi një melek në Tokë për të marrë dhe nga sipërfaqja e saj. Meleku mori dhe nga vende të ndryshme të Tokës dhe i përziu ato me lejen e Allahut. A nuk i vëren se edhe sot e kësaj dite njerëzit kanë ngjyra të ndryshme?!

Bir i dashur, mos u mbaj me të madh ndaj shokëve të tu, pasi vëllezër jeni, bij të Ademit që të gjithë... Dikush i bardhë e dikush i zi, dikush i kuq e dikush i verdhë, por të gjithë nga dheu.

Kur ia sollën *dhénë*, Allahu urdhëroi që ky *dhe* të lagej në mënyrë që të bëhej baltë. Pasi u bë baltë Krijuesi Fuqplotë, në shenjë nderimi, me Duart e Tij i dha baltës formën e njeriut. Pasi i dha formë, i dhuroi shpirtin e, kur hyri shpirti në brendësinë e saj, balta u bë krijesë e gjallë.

Kështu u krijua Ademi, alejhis-selam, babai i njerëzimit, Profeti i parë, krijesa të cilës do t'i dhurohej dituria. Dëgjo me kujdes, mos të të mashtrojnë ty ata që thonë se majmunët janë stërgjyshërit e tu!

Më pas Allahu i dhuroi njeriut dituri të gjerë përmes së cilës ai filloi të njihnte çdo gjë që i shihnin sytë. Atëherë e ngriti në sferat qiellore, ua paraqiti melekëve e u tha atyre: "*M'i tregoni emrat këtyre sendeve!*" "*Qofsh i Lavdëruar!*", thanë melekët, "*ne nuk dimë më shumë se ç'na ke mësuar Ti, Ti je i Gjithëditur dhe i Urtë!*" Pas kësaj Allahu iu drejtua Ademit, alejhis-selam: "*O Adem! Tregojua melekëve emrat e sendeve!*". Kur Ademi ua tregoi emrat e sendeve, Allahu i urdhëroi melekët t'i përkulen në sexhde atij në shenjë nderimi për diturinë që kishte, pasi sexhdeja si shenjë adhurimi bëhet vetëm për Allahun e Lartësuar.

A e kuptove sa vlerë ka dituria? Mos iu ndaj leximit, o djalosh! Le të jetë libri miku yt, le të jetë dituria qëllimi i jetës tënde, sepse me dituri do ngrihesh lart e do nderohesh nga banorët e qiellit. Lute Allahun të të dhurojë dituri, pasi atij që i dhurohet dituria i është dhuruar mirësi e madhe, por përveç të mençurve këtë nuk e kupton askush.

Menjëherë melekët iu bindën urdhrit dhe të gjithë së bashku u përkulën në sexhde para Ademit, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, me përjashtim të Iblisit, i cili nuk pranoi...

*"O Iblisi!,- tha Allahu, "Pse nuk i bëre sexhde atij që Unë e krijova me duart e Mia? Mos u bëre mendjemadh, apo mendon se je më lart se ai?" "Unë jam më i mirë se ai", tha Iblisi, "mua më ke krijuar nga zjarri, ndërsa atë nga balta." "Atëherë qofsh i mallkuar!", tha Allahu, "Zbrit nga Xheneti! Ty nuk të takon të mbahesh me të madh; dil, me të vërtetë ti do jesh i poshtëruar!"*

Po kush është Iblisi, vallë? Pse nuk iu bind urdhrimit siç bënë melekët e tjerë? A nuk ishte edhe ai banor i qiellit?

Dëgjo me kujdes! Iblisi i përkiste familjes së xhindëve të cilët Allahu i kishte krijuar nga flaka e zjarrit shumë kohë para se të krijohej Ademi, alejhis-selam. Xhindët jetonin në Tokë por, si pasojë e adhurimit të shumtë dhe bindjes së tij ndaj urdhrave të Allahut, Ai e kishte përzgjedhur nga mesi i tyre Iblisin dhe e kishte ngritur mbi xhindët e tjerë. Kështu, Iblisi jetonte në Xhenetet e larta së bashku me melekët fisnikë. Mirëpo në vend që të falënderonte Allahun e Lartësuar për pozitën që i ishte dhënë dhe t'i bindej urdhrave të Tij, Iblisi u mbajti me të madh. Ai e kundërshtoi urdhrin dhe jo vetëm kaq... As që u pendua për çfarë bëri, por këmbënguli në gabim edhe më shumë, tha se zjarri është më i vlefshëm se balta, duke harruar se balta dhe dheu janë burimi i jetës, ndërsa zjarri burim i shkatërrimit. A nuk rrjedhin lumenjtë me ujin e freskët mbi dhe? Ku mbijnë bimët, pa të cilat nuk kanë jetë gjallesat? Po ndërtesat shumëkatëshe - ku mbahen që të mos rrëzohen? A nuk mbahen në dhé? Edhe druri me të cilin ndizet zjarri rritet mbi dhé...

Allahu i Madhërishëm e dënoi Iblisin me largim nga mëshira e Tij dhe e nxori nga kopshtet e Xhenetit. Prandaj kij kujdes, o bir! Bëhu i bindur ndaj urdhrave të Allahut dhe mos u mbaj me të madh se përndryshe do shkatërrohesh siç u shkatërrua Iblisi! Dije se nuk hyn në Xhenet ai që në zemrën e tij fsheh edhe një grimcë mendjemadhësie.

Ndërsa Iblisi u përzu nga Xheneti, Ademit, alejhis-selam, iu dha leje të banonte në të. Atëherë, i mallkuari gati sa nuk plasi nga zilia. Filloi ta urrente edhe më shumë Ademin, megjithëse ai nuk i kishte shkaktuar kurrëfarë dëmi. Kur e pa nderimin që iu bë njeriut, zilia iu ndez edhe më shumë dhe iu drejtua Allahut duke i thënë: *“O Allah! Nëse më jep jetë deri në ditën e Kijametit, do t'i mashtroj pasardhësit e Ademit dhe do t'ua prish moralin, përveç robërve të Tu të singertë.”* Si pasojë e një urtësie madhore, Allahu i dha leje të jetonte deri në ditën e Kijametit, por i tha: *“Dil nga Xheneti dhe vepro si të duash me pasardhësit e Ademit mbasi ti nuk do kesh kurrëfarë fuqie ndaj robërve të Mi. Dije, o Iblis, se ti dhe ata që të pasojnë ty do të hidheni në zjarrin flakëruës njëri mbi tjetrin.”*

Pas kësaj ndodhie Ademi alejhis-selam e kuptoi se Iblisi ishte armiku i tij i përbetuar, por ndihej i sigurt pasi Allahu e mallkoi dhe e përzuri nga Xheneti.

## Hawaja

Koha kalonte pa e kuptuar. Ademi, alejhis-selam, jetonte i qetë në Xhenet duke e adhuruar Allahun dhe duke e falënderuar për mirësitë e panumërta. Lëvizte i qetë në fushat e gjera mes për mes së cilave buronin lumenj me ujë të kulluar, përmes hijeve të pemëve të larta me fruta të lloj-llojshme, nën cicërimat e shpendëve shumëngjyrësh që ia ngazëllenin shpirtin. Ah, ç'mrekulli ishte Xheneti!

I gjithë ky kopsht madhështor vetëm për Ademin. Mund të bridhte i lirë nga të kishte dëshirë. Megjithatë diçka e mundonte. Pse e gjithë kjo plogështi në mesin e mirësive? Ç'ishte kjo ndjenjë që e kaplonte kohë pas kohe? Ademit, alejhis-selam, as që i shkonte ndër mend se pas kësaj mërzie fshihej vetmia.



Nuk kaloi shumë kohë dhe Allahu i Lartësuar krijoi gruan e Ademit nga brinja e tij, për të qenë shoqëruesja e tij e pandarë, për t'i dhuruar atij dashuri dhe për t'ia larguar mërzinë që ia kaplonte zemrën herë pas here.

Një ditë teksa po zgjohej nga gjumi, Ademi, alejhis-selam, ndjeu diçka të pazakontë. E ktheu kokën menjëherë, kur ç'të shihte! Pranë tij qe shtrinë një krijesë tjetër dhe si për çudi, shumë e ngjashme me të.

*"Kush je ti?", e pyeti Ademi, alejhis-selam.*

*"Gruaja e jote.", u përgjigj ajo.*

*"E përse je krijuar vallë?", pyeti i çuditur Ademi, alejhis-selam.*

*"Që të qëndroj pranë e mos të mërzitesh.", ia ktheu gruaja buzagaz.*

Allahu i Lartësuar krijoi dashuri dhe mëshirë midis tyre. Pas këtij takimi e kuptuan se ishin krijuar për të jetuar së bashku, prandaj burrë e grua u nisën të lumtur drejt luginave të gjelbëruara duke falënderuar Allahun dhe duke soditur krojet që gurgullonin mes për mes bukurive të pafund.

## Selami

Sillu mirë me njerëzit dhe folu fjalë të mira, o bir! A dëshiron të ta mësoj një fjalë që, nëse e përhap në mesin e besimtarëve do të fitosh kënaqësinë e Allahut dhe dashurinë e tyre?

*Selamun alejkum! Paqja e Allahut qoftë mbi ju!*

Le ta dish se këtë përshëndetje të bekuar nga melekët e kemi trashëguar. Dëgjo me vëmendje! Pasi Allahu krijoi Ademin dhe e futi shpirtin në trupin e tij, Ademi, alejhis-selam, teshtiu dhe tha: *"Elhamdu lil-lah!"* (Falënderimi i qoftë Allahut!)

*"Të mëshiroftë Zoti yt, o Adem!", ia ktheu Allahu i Lartësuar, "Shko tek melekët dhe përshëndeti me selam."*

E kështu Ademi u nis drejt tyre për t'i përshëndetur. Iu afrua dhe u tha: *"E'sselámu alejkum, o krijesa të nderuara!"*

*"Ue alejke selamun ue rahmetullahi ue beraketuhu!", u përgjigjën njëzëri ata.*

Ademi, alejhis-selam, u kthye i gëzuar nga përgjigjja dhe atëherë Allahu i Lartësuar i tha: *"Adem! Kjo do të jetë përshëndetja e jote dhe e pasardhësve të tu."*

Prandaj Ademi, alejhis-selam, ia mësoi përshëndetjen bijve të tij dhe ata e përcollën brez pas brezi deri në ditët tona, ndaj, o biri im i dashur, përcille edhe ti e përkujtoja të tjerëve këtë përshëndetje të bekuar!

Esselámu alejkum!

## Kurthi

Një ditë prej ditësh, ndërsa Ademi, alejhis-selam, dhe e shoqja shëtisnin nëpër Xhenet, Allahu i Lartmadhërishëm për të parën herë i urdhëroi të mos i afroreshin një peme dhe i ndaloi të hanin nga frutat e saj.

*"O Adem!", tha Allahu, "Ushqehuni me frutat e Xhenetit sa të dëshironi dhe prej nga të dëshironi, por mos iu afroni asaj peme dhe mos i prekni frutat e saj!"*

Ndërkohë, larg nga Ademi, alejhis-selam, shumë larg tij lajmin e mori vesh Iblisi i mallkuar, krijesa prej të cilit Ademi mendonte se kishte shpëtuar njëherë e mirë. Pikërisht këtë urdhër të Allahut e përdori Iblisi dhe filloi të përgatiste planin djallëzor. E thuri më në fund kurthin për ta devijuar Ademin dhe gruan e tij nga rruga e drejtë.

Kohët kalonin dhe Ademi e kishte harruar urdhrin e Allahut për të mos iu afruar pemës. Kjo ishte dobësia e Ademit... Harresa, o bir, këtë shfrytëzoi Iblisi për të përmbushur planin e zi. Dëgjo me kujdes dhe ji i vëmendshëm ndaj kësaj që po të tregoj!

Një ditë Ademi dhe Havaja shëtisnin nëpër fushat e pa-fundme të Xhenetit dhe kaluan afër pemës së ndaluar. Bukuria e frutave të saj ia tërhoqi vëmendjen Ademit dhe Havasë. Ndër-kohë, përtej portave të Xhenetit, Iblisi vështronte me kujdes çdo lëvizje të Ademit. Sapo e kuptoi se Ademi u mahnit nga bukuria e pemës, i mallkuari u hodh në sulm. Filloi t'i pëshpëriste me ëmbëlsi nga larg: *"O Adem! A dëshiron të ta tregoj pemën, frutat e së cilës të japin përjetësinë dhe sundimin pa kufi? Nëse ushqehesh prej saj do jetosh përgjithmonë dhe kurrë nuk do vdesësh."* Ademi, alejhis-selam, sillte kokën, por askënd nuk shihte përreth. Gjithsesi, një zë i brendshëm e pengonte t'i afrohej pemës. Kur e pa se Ademi bëri të largohej, filloi t'i pëshpëriste edhe më shumë dhe jo vetëm kaq... Iu betua me emrin e Allahut duke i thënë: *"Pasha Allahun, o Adem, nëse ushqehesh me frutat e kësaj peme do bëhesh i pavdekshëm! Nuk të gënjej, pasha Allahun! Unë jam këshillues besnik."* Ademi, as që e mendonte se dikush mund të betohej në emrin e Allahut dhe të gënjente, ndaj iu afrua pemës. E zgjati dorën dhe këputi një frut prej frutave të saj. *"Kafshoje, o Adem!",* filloi të pëshpërisë nga larg i mallkuari, *"Kafshoje frutin që ke në dorë!"* Ademi, alejhis-selam, e harroi urdhrin e Allahut dhe së bashku me gruan e tij u ushqyen nga pema e ndaluar.

E çfarë ndodhi pas kësaj? Si për çudi, Ademit dhe të shoqes filluan t'u binin rrobat nga trupi dhe iu zbuluan pjesët e turpshme... Sapo e ndjeu diçka të tillë, Ademi filloi të vraponte nga turpi sa andej këndeje nëpër Xhenet. E ku mund t'i fshihesh Allahut? Askund.

I pikëlluar, nisi të mbulohej me gjethet e pemëve të Xhenetit që askush mos ta shihte të zbuluar. Në këtë moment Allahu iu drejtua Ademit duke i thënë: *“A nuk iu kam ndaluar të ushqeheni nga kjo pemë, o Adem?! A nuk të kam lajmëruar se Iblisin e ke armik të përbetuar?!”*

Biri im, kij kujdes! Le ta dish se Iblisin e ke përherë armik. Ai gjithmonë mundohet t’ia veshë të ligës vellon e mirësive... A e kupton se ç’po të them? Iblisi të keqen e shfaq si të mirë... Dëgjo, me vëmendje! Sado që t’i pëshpëriste Ademit, asnjëherë nuk do të mund ta shtynte në gjynah sikur t’i tregonte të vërtetën. Sikur t’ia kujtonte se fruti është i ndaluar për të, Ademi as që do i afrohej pemës dhe jo më frutit. Ama, çfarë i tha? I tha se pema është e bekuar dhe se kush ushqehet prej saj bëhet i pavdekshëm. A e kuptove tani? E mbështolli veprën e ndaluar me vellon e jetës pa fund. Dhe jo vetëm kaq, por iu betua në Allahun dhe e mashtroi Ademin. Ndaj, kurrë mos i beso tradhtarit edhe nëse të betohet pasi mund të të kushtojë shumë. Për më tepër, mos të të mashtrojë kurrsesi shejtani e të mendosh se zhveshja e trupit është përparim dhe zhvillim! Mos harro se Ademi alejhis-selam e përjetoi zhveshjen si turp dhe ndëshkim. Nuk është e njëjtë e keqja dhe e mira sado që të habitesh nga përhapja e të keqes... Mbulesa e trupit gjithmonë do jetë mirësi dhe virtyt i lartë, ndërsa zbulimi i tij mashttrim i shejtanit dhe paturpësi e madhe.

## Pendimi

Iblisi vështronte gjithçka ndodhte me Ademin përtej dyerve të Xhenetit dhe shijonte arritjen e fitores. I mallkuari mendonte se edhe Ademi, alejhis-selam, do kishte të njëjtin dënim me të. Ai shpresonte se edhe Ademi do të mallkohej dhe do nxirrej nga Xheneti... A nuk ishin njësoj? Iblisi theu urdhrin për të rënë në sexhde, ama edhe Ademi theu urdhrin për të mos u ushqyer nga fruti i ndaluar.

Biri im, kij mendjen dhe dëgjo me kujdes! Ademi, alejhis-selam, dhe Havaja e pranuan menjëherë gabimin dhe iu drejtuan Allahut me përgjërime duke i thënë: *"Allah, o Zoti i jonë, ne i bëmë padrejtësi vetvetes dhe nëse Ti nuk na fal gabimin dhe nuk na mëshiron dobësitë tona, ne me siguri do të jemi të humbur."* U kthyen të penduar dhe të përlulur duke kërkuar ndihmë nga Mëshirëploti. E ç'mund të ndodhte tjetër... Allahu ia pranoi pendimin që të dyve. A nuk është Allahu Falësi i Madh, Mëshiruesi i mëshiruesve?! Ndaj, nëse të ndodh që nga harresa apo nga mashtrimet e shejtanit të thyesh urdhrat e Allahut, mos u mbaj me të madh siç bëri Iblisi dhe as mos u mundo të fshihesh, por kthehu i penduar tek Ai që i pranon pendimet ashtu siç bëri babai i njerëzimit. Dije se, kushdo që ka vepruar në këtë mënyrë nga pasardhësit e Ademit ka arritur fitore në këtë botë dhe shpëtim në tjetrën.

Pas provës, Allahu vendosi që ta zbriste Ademin, alejhis-selam, së bashku me gruan e tij në tokë, pasi për këtë qëllim ishin krijuar. A nuk të kujtohet se: që para se ta krijonte Ademin, Allahu i lajmëroi melekët për një krijesë nga dheu që Tokën do kishte vendbanim...

*"Dilni nga Xheneti!",* tha Allahu i Lartësuar, *"Pasi të zbrisni në Tokë do t'u lajmëroj për udhëzimet e Mia. E kush e pason udhëzimin Tim nuk ka për të humbur dhe nuk ka për të dështuar."* Ndërkohë Iblisi do mbetej armiku i tyre i përbetuar, armiku i tyre dhe i gjithë pasardhësve të tyre. Tashmë Toka do të ishte mejdani i luftës ndërmjet Iblisit dhe Ademit, alejhis-selam, ndërsa pasimi i udhëzimeve të Allahut do ishin e vetmja armë kundra armikut të padukshëm.

Gjithsesi, Allahu Mëshirues ia fali Ademit gabimin, e dërgoi në tokë si Pejgamber për njerëzit e parë dhe i premtoi se, pas vdekjes, do ta rikthente përsëri në Xhenet.

## Toka

Jeta në Tokë ishte e vështirë. Burrë e grua lodheshin e mundoheshin çdo ditë të siguronin ushqimin dhe një vendbanim ku të mund të strehoheshin dhe të mbroheshin nga kafshët e egra. U munduan të thurnin rroba të përshtatshme që të mbulonin trupin dhe të mbroheshin nga i nxehti dhe i ftohti. Megjithatë kalonin jetë të lumtur duke falënderuar Allahun dhe duke e adhuruar Atë...

Në Tokë Ademi, alejhis-selam, dhe Havaja patën shumë fëmijë... Ndërsa babai i tyre dilte në kërkim të ushqimit për të vegjlit, nëna i rrinte pranë duke u kujdesur për ta dhe duke ia mësuar sjelljen e mirë dhe fisnikërinë. Kur rriteshin fëmijët e tyre udhëtonin nga njëri vend në tjetrin dhe në këtë mënyrë u krijuan familje dhe fise të shumta. Edhe pse u larguan drejt viseve të largëta ata mbetën vëllezër. Babai i tyre ishte Ademi alejhis-selam, feja e tyre ishte Islami dhe i adhuruari i tyre ishte Allahu i Lartësuar.

## Idrisi

Biri im! Ndërkohë që njerëzit udhëtonin drejt viseve të pashkelura, Allahu i Lartësuar tek çdo popull dërgonte Pejgamber nga mesi i tyre për t'ua mësuar fenë e drejtë dhe për t'i udhëzuar njerëzit nga e mira tek më e mira. Këta Pejgamberë ishin njerëz si gjithë të tjerët, por Allahu i kishte përzgjedhur nga mesi i robërve të Tij për shkak të zemrës së pastër dhe moralit të lartë. Dije se Allahu i Lartësuar ka dërguar në popuj dhe në kohë të ndryshme shumë të tillë, por në Kur'anin Fisnik përmenden vetëm disa prej tyre. Një ndër ata që përmenden në Kur'anin Famëlartë është Pejgamberi Idris. A ke dëgjuar ndonjëherë për Idrisin, alejhis-selam?

Allahu i Lartmadhërishtëm e ka lavdëruar këtë burrë duke thënë për të, se ka qenë njeri i singertë dhe fe-rrëfytes. Idrisi, alejhis-selam, është ndër pasardhësit e afërt të Ademit. Për të thuhet se ka qenë i pari që ka shkruar me penë. Thuhet se kishte njohuri mbi mjeshtërinë e ndërtimit dhe se e ka njohur edhe rrobaqepsinë. Madje kam lexuar se i pëlqente meditimi dhe se ligjëronte shumë në mesin e njerëzve. Ndoshta për këtë arsye është quajtur Idris. A e di ti, o bir, se prej nga buron emri Idris? Ky emër buron nga fjala *ders* që në gjuhën arabe do të thotë *mësim*...

Idrisi, alejhis-selam, e dashuronte nxënien e dijës dhe mendohej me çdo kusht që diturinë e tij ta ndante me të tjerët. Thuhet se mblidhte shumë nxënës rreth vetes për t'ia përcjellë njohuritë. Ndoshta kjo është arsyeja pse Allahu i Gjithëditur e

ka ngritur këtë Profet në një pozitë të lartë. A nuk e ke dëgjuar se ç'thotë Allahu i Madhëruar për të? *"...Ne e kemi ngritur atë në një pozitë të lartë."*

Prandaj lidhe zemrën tënde me librin dhe me leximin, o djalosh! Dituria fetare e ngjall dhe e pastron zemrën ashtu siç e ngjall shiu tokën pas vdekjes së saj. A nuk e sheh se si Allahu i Madhëruar i lartëson njerëzit e ditur?! A nuk u ngrit lart Ademi alejhis-selam?! A nuk iu përulën në shenjë nderimi melekët një krijese nga balta për shkak të diturisë?!

Ndiqe, pra, diturinë që të ngritesh lart në jetën e kësaj bote dhe të fitosh faljen dhe mëshirën e Mëshiruesit në botën tjetër. Dije se ai njeri që ndjek rrugën e diturisë, Allahu i Lartësuar ia lehtëson rrugën për në Xhenet dhe melekët fisnikë shtrijnë krahët e tyre me nderim ndaj tij. Jo vetëm kaq, por banorët e qiellit dhe të tokës së bashku, madje edhe peshku që zhytet në thellësinë e deteve apo lumenjve kërkon falje për këtë njeri.

Dije, o bir, se vlera e dijetarit ndaj adhuruesit të thjeshtë është si vlera e dritës së hënës së plotë ndaj dritës së yjeve rreth saj. Ndaj të këshilloj të bëhesh edhe ti nga kërkuesit e diturive fetare. Biri im! Të porosis t'i nderosh dhe t'i duash njerëzit e dijes, se ata janë trashëguesit e vërtetë të Profetëve. Profetët nuk kanë lënë pas vetes pasuri, por kanë lënë diturinë dhe ai që nxë këtë dituri ka përfituar një mirësi të madhe. Qëndroji afër njerëzve të tillë që të përfitosh edhe ti nga kjo mirësi!

Paqja, mëshira dhe bekimet e Allahut qofshin mbi Idrisin, mbi Profetin e singertë, të cilin Allahu i Madhëruar e ngriti në pozitë të lartë dhe mbi të gjithë pasuesit tij nga dijetarët dhe nxënësit e diturisë.



## Dhjetë breza pas Ademit

Biri im, për vite me radhë Ademi, alejhis-selam, u mësoi fëmijëve dhe nipërve të tij besimin e dëlirë, fenë e vërtetë, Islamin. Njerëzit jetonin në paqe dhe mirësi duke adhuruar Allahun e Madhërishëm. Për shumë kohë ata ishin një popull i vetëm, Zoti i tyre ishte Allahu, feja e tyre ishte Islami dhe babai i tyre Ademi, alejhi-selam...

Njerëzit me kalimin e viteve e kishin harruar shejtanin e mallkuar dhe premtimin e tij se do të hakmerret ndaj bijve të Ademit. Iblisi kishte kohë që thurte planin e tij. Si të vepronte kur të gjithë njerëzit jetonin në vëllazëri duke adhuruar Allahun e Pashoq?

Dëgjo me kujdes, biri im! Pas Ademit, në mesin e besimdrej-tëve jetonin pesë burra të mirë: Uedi, Suvai, Jeguthi, Jeuka dhe Nesra, të njohur për bujarinë, për diturinë dhe devotshmërinë e tyre. E adhuronin Allahun e Madhërishëm natë e ditë dhe përhapnin dituritë e Islamit në mesin e popullit, prandaj të gjithë i nderonin... Por, si çdo krijesë edhe këta burra të mirë ndërruan jetë. Natyrisht, populli u pikëllua pa masë. Pikërisht këtë priste prej kohësh Iblisi. Me vdekjen e pesë dijetarëve filloi t'i pëshpëriste disa prej bijve të Ademit, ashtu siç kishte bërë me babain e tyre shumë kohë më parë. *"A jeni të pikëlluar për vdekjen e pesë burrave të mirë?"*, u thoshte i mallkuari, *"A keni mall për ta? E pse mos t'i shihni ata çdo ditë. Ndoshta prania e tyre ju nxit për punë të mira?"* Njerëzit mendonin me vete: *"Po si mund t'i shohim, kur ata janë të vdekur tashmë?"*

Iblisi u tha: "Pikturoni fytyrat e tyre." Njerëzit u mashtruan dhe ashtu bënë... Shihnin me përmallim portretet e njerëzve të mirë çdo ditë që të përkujtonin bëmat e tyre. Me kalimin e kohës përveç pikturave, njerëzit filluan të ngrenin edhe përmendore në nder të tyre. Në këtë mënyrë u përhapën përmendoret në mesin e njerëzve, megjithëse vazhdonin të adhuronin Allahun, të Vetmin e Pashoq. Por dhjetë breza pas Ademit, si pasojë e humbjes së diturive të fesë dhe pëshpëritjeve të pandërprera të shejtanit, njerëzit filluan t'i adhuronin statujat prej guri. I luteshin, i uthnin, i përkëdhelnin, përuleshin para tyre dhe thernin kurbane për nder të tyre. Kështu rrëshqitën dalëngadalë nga nderimi në adhurim.

Prandaj dije, o bir, se pikturat, fotografitë dhe statujat janë kurth prej kurtheve të shejtanit. Dije se ato janë porta prej portave të devijimit dhe idhujtarisë. A nuk e dëgjove se si u mashtruan bijtë e Ademit?!

Pas shumë e shumë përpjekjesh shejtani ia arriti edhe një herë qëllimit. Ditë feste do ishte kjo ditë për Iblisin dhe ushtrinë e tij. Tanimë, bijtë e Ademit kishin humbur rrugën. Qëllimi i dëshiruar u arrit...

Biri im, a e ke pyetur veten, pse i nxiti shejtani njerëzit pikërisht drejt idhujtarisë? I mallkuari i nxiti drejt saj, mbasi e dinte fort mirë, se Allahu nuk e fal idhujtarinë dhe përveç saj mund të falë çdo gjynah tjetër sado i madh qoftë. E dinte mirë se ata që adhurojnë të tjerë në vend të Allahut të Madhërisëm përfundojnë në zjarrin e Xhehenemit përjetësisht dhe kurrë nuk dalin prej tij...

## Pejgamberi fisnik

Allahu i Lartësuar, Mëshiruesi i mëshiruesve, nuk dëshironte t'i dënonte bijtë e Ademit për idhujtarinë në të cilën

kishin rënë, por dëshironte udhëzimin për ta, prandaj ia zbriti shpalljen hyjnore një burri fisnik në mesin e tyre. E dërgoi këtë njeri për t'i thirrur në besimin e drejtë dhe për t'i larguar nga idhujtaria. Po kush ishte vallë ky burrë fisnik që Allahu e dalloj nga të tjerët dhe e përzgjodhi Pejgamber? Ky burrë ishte Nuhu, alejhis-selam. Ai njihej që para se t'i shpallej pejgamberia si orator dhe mendjemprehtë. Njihej për moralin e lartë, ama ishte njeri si gjithë të tjerët. Allahu, o bir, ia zbriti shpalljen një njeriu në mënyrë që të tjerët rreth tij ta kuptonin se urdhrat dhe porositë e Allahut janë të lehta për t'u zbatuar nga çdo njeri. Vetë Pejgamberi ishte njeri që hante dhe pinte, kujdesej për fëmijët dhe punonte si gjithë të tjerët që të siguronte të ardhurat e mjaftueshme për familjen e tij. E kaplonte lodhja dhe e mundonin sëmundjet, por të gjitha këto aspak nuk e pengonin të zbatonte porositë e Allahut të Lartësuar.

Biri im, Allahu i Madhërishëm e përzgjodhi Nuhun për të bartur porositë e Tij dhe i shpalli: *"Tërhiqja vëmendjen popullit tënd përpara se t'i godasë dënimi i tmerrshëm!"* Menjëherë Nuhu, alejhis-selam, e zbatoi urdhrin e Zotit të botëve. U ngrit në mesin e popullit të tij duke i thirrur në rrugën e shpëtimit. *"O populli im!",* thërriste ai, *"Adhurojeni Allahun pasi nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë veç Tij. Kijani frikën dënimit të Ditës së Madhe!"*. *"O populli im!",* u drejtohej, *"Unë jam Pejgamber besnik, ndaj kijani frikën Allahut dhe më pasoni mua. Unë nuk kërkoj prej jush kurrfarë shpërblimi, shpërblimin tim e pres nga Zoti i botëve. Pra, edhe një herë iu them: Frikësojuni Allahut dhe më pasoni mua."* *"O populli im! Pse i përnderoni statujat që i jepni formë me duart tuaja? A i përulet krijuesi krijesës? Si mund t'i përulet zotëriu robit të tij? A nuk mendoni?!"*

Nuhu, alejhis-selam, mundohej me mish e me shpirt t'ua bënte të qartë kotësinë e adhurimit të idhujve prej guri dhe druri, pasi dëshironte udhëzimin e tyre për nga e mbara.

Përpiqej të bisedonte me njerëzit natën e ditën. U trokiste në dyert e shtëpive me shpresën se do ta pritnin si mik dhe do i kuptonin porosinë e tij. Mendohej t'i këshillonte në tregje kur mbledheshin për të blerë e për të shitur. Kur shihte ndonjë rrugëtar, e shoqëronte me qëllim që t'ia përcillte mesazhin e tij. Nganjëherë thërriste në mesin e turmës e nganjëherë u fliste në fshehtësi. Ditë pas ditë, javë pas jave dhe vit pas viti: *"O njerëz adhurojeni Allahun pasi nuk meriton të adhurohet askush veç Tij!"*

Pejgamberi Nuh, alejhis-selam, përdori mënyra nga më të ndryshmet për ta thirrur popullin e tij në Islam. Nganjëherë i frikësonte me dënimin e Ditës së Madhe në mënyrë që të ktheheshin tek Allahu me pendim. Nganjëherë i përkujtonte me fuqinë dhe mirësitë e Allahut ndaj tyre me shpresën se do tregoheshin mirënjohës. *"Kërkoni falje nga Zoti juaj, sepse Ai është falës i Madh!",* u thoshte, *"Nëse i kërkoni falje, Ai iu zbret nga qielli shi me bollëk, iu shton pasurinë dhe fëmijët, iu furnizon me kopshte pjellore dhe lumenj me ujë të kulluar. A nuk është Ai krijuesi i juaj? A nuk e shihni se si e ka ngritur qiellin mbi kokat tuaja? A nuk e shihni se si e ka vendosur në qiell diellin si pishtar dhe hënën që ndriçon në errësirën e natës? Allahu ua bëri tokën të sheshtë që lehtësisht të ecni rrugëve të saj. Atëherë, çfarë iu pengon ta madhëroni Allahun vallë?"*

## Populli i Nuhut

Pejgamberi fisnik e thirri popullin e tij në rrugën e shpëtimit. E thirri popullin e tij me çiltërsi në adhurimin e Allahut të Pashoq dhe ia tërhoqi vëmendjen nga idhujtaria. Por çfarë ndodhi? Si e priti populli thirrjen e të Dërguarit? Sa herë që u kalonte pranë ia kthenin shpinën me mosmirënjohje. Kur u fliste shtinin gishtërinjtë në veshë dhe mbuloheshin me rroba duke këmbëngulur në mosbesim. Thirrja e tij edhe më shumë i

largoi nga e vërteta, me përjashtim të disa të varfërve që bënë jetë të thjeshtë. Me përjashtim të atyre që e fitonin bukën e gojës me punë e mundim, Nuhut nuk i besoi askush.

Biri im, asnjëherë mos harro se e vërteta nuk lidhet me numrin dhe pozitën e pasuesve të saj. Dhe kurrë mos harro, se shpallja hyjnore mbetet e vetmja rrugë shpëtimi, sado i vogël të jetë numri i pasuesve të saj, ndaj shtrëngoje të vërtetën me të cilën na ka porositur Pejgamberi Nuh, alejhis-selam, edhe nëse mbetesh vetëm.

...Paria e popullit e kundërshtuan të Dërguarin dhe thanë: *"Mos i braktisni kurrsesi zotat tuaj! Mos e braktisni Uedin, as Suvain, as Jeguthin, as Jeukën dhe as Nesran!"* Pasanikët nga populli i tij iu drejtuan Nuhut me mendjemadhësi duke i thënë: *"Ti nuk je tjetër veçse njëri nga ne që dëshiron të fitosh pozitë të lartë në mesin e njerëzve. Sikur të donte Allahu do të dërgonte melekë dhe jo një njeri si gjithë të tjerët. Me të vërtetë ne mendojmë se ti je i çmendur."* Sa herë e shihnin në rrugë talleshin me të. E quanin gënjeshtar, të çmendur dhe të magjepsur. *"Po si mund të të besojmë ty kur ty të besojnë më të ulëtit nga mesi i jonë?"*, i drejtoheshin me nënçmim. I kërkonin Nuhut, alejhis-selam, t'i largonte besimtarët e varfër që e besuan. Nëse kështu do vepronte, kryetarët e popullit do të tuboheshin për ta dëgjuar... Me të vërtetë, pasanikët nga populli i Nuhut nuk mendonin tjetër veçse për shtimin e pasurisë dhe për jetën luksoze. As që ju binte ndër mend ndonjëherë Ahireti. Mirëpo Nuhu nuk pranoi t'i largonte besimtarët mbasi tek Allahu njerëzit nuk vlerësohen për nga fama dhe pasuria, por për nga besimi dhe mirëbërja, për nga çiltërsia dhe zemra e pastër.

Ndaj, o bir, pasoje Pejgamberin Nuh, alejhis-selam!. Qëndro me njerëzit e thjeshtë, me ata që i luten Allahut në mëngjes e mbrëmje, duke shpresuar kënaqësinë e Tij dhe mos i hiq sytë e tu prej tyre duke dëshiruar famë e pasuri.

*"A nuk po besoni?"; i drejtohej Nuhu alejhis-selam, "A nuk kuptoni?" Ndërkaq populli i tij e kërcënoi duke i thënë: "Nëse nuk tërhiqesh nga kjo thirrje, o Nuh, ne do të të vrasim... do të të gurëzojmë." E si mund të kuptojë mendjemadhi? Si të kuptojë kur nuk dëgjon? Si të dëgjojë ndërkohë që, kur këshillohet, vendos gishtërinjtë në veshë? "O populli im", tha Nuhu me trimëri, "nëse nuk ju pëlqen prania ime dhe e urreni këshillën që iu jap, veproni kundër meje ç'të dëshironi! Unë i jam mbështetur Allahut dhe nuk druhem aspak nga ju dhe nga idhujt tuaj!"*

O bir, mundimet e njerëzve sado të rënda qofshin, as nuk krahasohen me dënimin e Allahut të Madhërishëm, prandaj bëj durim ashtu siç bëri Nuhu duke shpresuar shpërblimin e Allahut. Djalosh, dije se kush i mbështetet Allahut, Allahu i mjafton atij. Kush e ndihmon fenë e Allahut, Allahu e ndihmon atë. Thuaje të vërtetën e mos kij frikë!

Nuhu, alejhis-selam, e thirri popullin e tij në rrugën e drejtë pa u lodhur, duke i duruar të gjitha mundimet që i shkaktonin. Ua përkujtoi mirësitë e Allahut ndaj tyre dhe i frikësoi me dënimin e botës tjetër. Megjithë përpjekjet e tij, ata e kundërshtuan në mënyra nga më të ndryshmet derisa iu drejtuan duke i thënë: *"O Nuh, tashmë e teprove me këshillat tuaja! Na e sill pra, dënimin e Allahut nëse je vërtetë i Dërguari i Tij?"* Për më tepër, baballarët i porositnin fëmijët e tyre që: për së gjalli, mos t'i besonin Nuhut, të luftojnë kundër tij dhe t'i kundërvihen në çdo mënyrë.

## Lutja

Në këto kushte të vështira Nuhu iu drejtua Allahut të Lartësuar: *"O Allah, unë e thirra popullin tim natë e ditë, por thirrja e ime edhe më tepër i largoi nga e vërteta. Sa herë*

që i thërrisja në rrugën e drejtë, ata shtinin gishtërinjtë në veshë dhe mbuloreshin me rrobat e tyre, duke këmbëngulur në mosbesim. Pastaj i thirra me zë të lartë. I thirra haptazi dhe fshehurazi e u thashë: kërkoni falje nga Zoti i juaj, mbasi Ai është Falës i Madh, në mënyrë që Ai t'ju dërgojë shi nga qielli, t'ju shtojë pasurinë dhe pasardhësit tuaj dhe t'ju dhurojë kopshte dhe lumenj! Pse nuk e madhëroni Allahun ashtu siç i takon Atij, ndërkohë që Ai ju ka krijuar?" Pastaj tha: "O Allah, populli im më mohoi, prandaj, Ti gjyko mes meje dhe atyre dhe më shpëto mua bashkë me besimtarët që më pasojnë!" Atëherë Allahu i Lartësuar i shpalli të Dërguarit të Tij: "Nga populli yt askush nuk do të besojë, përveç atyre që tashmë kanë besuar, ndaj mos u pikëllo për atë që veprojnë ata!" Kështu, Nuhu alejhis-selam, e humbi shpresën. Sa e sa kohë i kishte thirrur në shpëtim, por ata vazhdonin të adhuronin gurët që i skalitnin me duart e tyre. Kaluan ditët, javët, muajt, vitet dhe shekujt duke i thirrur në rrugën e drejtë. Plot një mijë pa pesëdhjetë vite dhe e keqja vazhdonte të përhapej në tokë.

Biri im! Allahu i Lartësuar na lajmëron në Kur'anin Fisnik se Nuhu ka thirrur në mesin e popullit të tij për nëntëqind e pesëdhjetë vite ndaj nuk na lejohet të dyshojmë në këtë. Të përkryera janë fjalët e Zotit tonë, të vërteta dhe të drejta... A nuk është Allahu Krijuesi Fuqiplotë? A nuk është në dorën e Tij jeta dhe vdekja? Ai me urtësinë e Tij dikujt ia zgjat jetën dhe dikujt ia shkurton atë, ndaj mos u çudit! Me të vërtetë Allahu ka fuqi për çdo send.

"Mjaft më! O Allah!", u drejtua Nuhu me lutje, "Mos lër mbi tokë asnjë jobesimtar sepse, nëse Ti i lë të gjallë, ata do t'i devijojnë robërit e Tu dhe do lindin vetëm kriminelë dhe jobesimtarë!"



## Anija

Allahu i Plotfuqishëm ia pranoi duanë atij, të cilit i është bërë padrejtësi. Ndaj ki kujdes! Mbaj anën e drejtë dhe mos i hy në hak askujt!

Allahu e urdhëroi Nuhun të ndërtonte Anijen e Shpëtimit. *"Ndërto anijen me udhëzimin Tonë dhe mos m'u lut më për keqbërësit! Ata me siguri do të fundosen të gjithë."*

Pa humbur kohë Nuhu, alejhis-selam, filloi ndërtimin e Anijes sipas urdhrave të Allahut. Një Anije me dërrasa dhe gozhdë... Një Anije gjigande mbi një luginë prej së cilës nuk shihej as det dhe as liqen. Populli sa herë që kalonte pranë Nuhut talleshin me të. *"Ku do lundrosh, o i mjerë? Mbi lëndinën e mbushur me bar?"* Nuhu, alejhis-selam, me qetësi vazhdonte punën dhe i drejtohej duke i thënë: *"Nëse sot po talleni me ne, nesër do të tallemi ne me ju, ashtu siç jeni tallur ju!"*

E kështu, pas shumë lodhjes e mundimesh, ndërtimi i Anijes përfundoi. Po afrohej koha e premtuar. Me të zbardhur dita, qielli u mbulua me re të zeza dhe të frikshme që shkonin e vinin. Gjëmimet nisën. Tmerr i vërtetë. Frika i kaploi zemrat e njerëzve. Menjëherë Nuhu filloi përgatitjet ashtu siç qe urdhëruar. Allahu e kishte porositur që të merrte në Anije besimtarët dhe prej kafshëve e shpezëve nga një çift, pasi nga përmbytja nuk do të shpëtonte askush, as njerëzit, as kafshët dhe as shpezët...

Pasi hipën të gjithë në Anijen e Shpëtimit, Allahu i Madhërisëm urdhëroi të hapeshin portat e qiellit dhe shiu vërshoi pa pushim. Burimet e tokës shpërthyen si kurrë më parë. Filloi përmbytja. Toka filloi të mbulohej nga uji që sa vinte e zgjerohej dhe lartësohej. Sikur të mos mjaftonte përmbytja, filloi të frynte tufani, që, sa herë godiste ujin, turfullonte dhe egërsohej edhe më shumë. Dallgët e llahtarshme dhe kreshtat me shkumë tek



përplaseshin mbi ujin e turbulluar ushtonin si gjëmat e bu-bullimave...Tmerr! Ku të fshihesh? Si të mbrohesh nga dallgët gjigande? Njerëzit e lemerisur filluan të ngjithnin kodrat përreth me shpresën se do shpëtonin, por më kot...Dallgët e tërbuara nga tufani i gllabëronin grupe-grupe dhe i zhytnin me forcë në ujin që sa vinte dhe shtohet. Ndërkohë Anija e Shpëtimit lundronte mes dallgëve të larta si malet. Nuhu, alejhis-selam, kishte dalë mbi kuvertë dhe hidhte vështrimin i shqetësuar sa andej këndeje. Ç'të kërkonte vallë? Çfarë e shqetësonte kaq shumë Pejgamberin fisnik? Më në fund, sikur u qetësua pak... Nga larg pa djalin e tij, djalin që nuk i kish besuar porosive të të atit, duke u ngjitur mbi kodrën më të lartë. *"O bir i dashur!",* e thirri, *"hip në varkë me ne dhe mos qëndro me jobesimtarët!".* *"Do ngjitem në kodër",* ia ktheu i biri, *"atje do të mbrohem nga uji."* *"O biri im!",* thirri Nuhu, *"Sot askush nuk do të shpëtojë nga dënimi i Allahut, përveç atij që Allahu e mëshiron!"* Por, pas kësaj një dallgë e madhe i ndau dhe e gëlltiti të birin si gjithë të tjerët.

Biri im! Të këshilloj të jesh i bindur ndaj prindërve të tu. Mos paso rrugën e idhujtarisë dhe mosbindjes ndaj prindërve se do kesh një përfundim të hidhur. Dije se jeta e kësaj bote është plot me mundime e vështirësi, plot e përplot me dallgë dhe stuhi prandaj hip në Anijen e besimit Islam. Qëndro gjithmonë në mesin e besimtarëve dhe asnjëherë të mos ndahesh nga ata. Pasoji porositë e Pejgamberit Nuh dhe porositë e Pejgamberëve pas tij, sepse vetëm atje është shpëtimi yt.

## Shpëtimi

Pasi u realizua premtimi i Allahut dhe u përmbytën të gjithë jobesimtarët, shiu nisi të hollohej dhe toka e gëlltiti ujin e saj. U grisën retë dhe doli dielli përsëri. Ndërkohë Anija e

stërmadhe ishte ndalur mbi luginën e një kodre shumë të lartë, mbi luginën e kodrës Xhudij. Allahu Fuqiptotë e shpëtoi Nuhun, alejhis-selam, dhe besimtarët që e pasuan, ndërsa i përmbyti idhujtarët që e përgënjeshtroan të Dërguarin e Tij. Shih si përfunduan ata që i kundërshtuan urdhrat e Zotit pasi u paralajmëruan.

Mos harro kurrë se e ardhmja e lavdishme u përket besimtarëve, qofshin edhe të pakët në numër. Asnjëherë mos e humb shpresën, se kështu e ka kjo botë, as e mira dhe as e keqja nuk janë të përhershme, ndaj tregohu i matur! Mbas errësirës së natës shpërthen drita e agimit. Mbas vështirësive vjen lehtësimi.

Kur shpëtuan nga përmbytja Nuhu, alejhis-selam, iu drejtua me lutje Allahut duke i thënë: *“O Allah! A nuk më pate premtuar se do e shpëtosh familjen time? O Allah, a nuk ishte djali im pjesë e familjes sime?”*

Atëherë Allahu i shpalli të Dërguarit të Tij: *“Ai nuk ishte pjesë e familjes tënde, ai ishte punëkeq, prandaj mos kërko nga Unë atë për të cilën nuk ke njohuri!”* Menjëherë Nuhu alejhis-selam u kthye me pendim dhe iu drejtua Allahut të Lartësuar: *“O Allah, unë mbështetem tek Ti, asnjëherë nuk do kërkoj gjëra për të cilat nuk kam njohuri. Nëse Ti nuk më fal dhe nuk më mëshiron do të jem nga të humburit.”*

Biri im, dije se prejardhja dhe përkatësia fisnore nuk i bën dobi askujt nëse nuk ka besuar. Secili njeri vlerësohet në bazë të veprave të tij. Allahu nuk i vlerëson njerëzit për nga origjina, por për nga çiltërsia dhe punët e tyre. Djali i Nuhut, alejhis-selam, ishte jobesimtar dhe punëkeq, prandaj u përmbyt së bashku me të tjerët dhe nuk u pranua as ndërmjetësimi i Pejgamberit për të. Në këtë mënyrë Allahu i Lartësuar ia bëri

të qartë Nuhut se lidhja e vërtetë është lidhja e besimit dhe se familja e vërtetë e besimtarit janë besimtarët e tjerë edhe nëse janë prej familjeve të varfra e fiseve të largëta.

## Fund

Mbas një jete të stërmbushur me sprova dhe vështirësi Nuhu, alejhis-selam, i lutet Allahut: *“O Allahu im, falmë mua dhe prindërit e mi, si dhe çdo besimtar që kërkon strehim në shtëpinë time! Fali të gjithë besimtarët dhe besimtare, ndërsa keqbërësave shtojua shkatërrimin!”*

Sa njeri i mirë që ishte Nuhu, alejhis-selam! Asnjëherë nuk u ankua dhe as nuk u mbajt me të madh, por kryeulur i lutej Allahut të Lartësuar. Kush e di se para sa shekujsh kishin ndërruar jetë prindërit e tij, ndërkohë ai kurrë nuk i harronte në lutjet e tij.

Pasi u ndal Anija dhe pushoi tufani, Nuhut iu tha: *“Zbrit nga Anija! Zbrit me selame prej Nesh dhe me bekime për ty dhe pasardhësit e atyre që gjenden me ty.”* E kështu, Allahu e ndihmoi Nuhun, alejhis-selam, dhe besimtarët që e pasuan atë, i bekoi pasardhësit e tyre dhe i bëri mëkëmbës në Tokë. Paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi Nuhun, Pejgamberin që me durim e thirri popullin e tij në fenë e vërtetë për qindra vite...

## Pas Nuhut

Pasardhësit e Nuhut dhe të shpëtuarit nga përmytja u përhapën në tokë. Ata u shtuan në fise dhe popuj. Ndërtuan fshatra dhe qytete. Të gjithë njerëzit i bindeshin urdhërave të Allahut Fuqiptotë, të gjithë në një fe të vetme, të gjithë muslimanë. Pas shumë kohe, në mesin e njerëzve u përhap injoranca dhe si pasojë e keqja i kaploi zemrat e tyre. Shejtani ua errësoi të vërtetën dhe i nxiti edhe një herë të adhurojnë idhujt...

Në kodrat Ahkaf në Jemen jetonte në atë kohë një fis me nam e në zë, fisi Ad. Vendbanimet e tyre ishin më të njohurat e asaj kohe për madhësinë dhe për zbukurimet me kolona të larta. Me të vërtetë ata ishin mjeshtër të ndërtimit... Lugina ku jetonin ishte e pasur me pemë të lloj-llojshme, me kopshte të gjelbërta ku kullosnin bagëtitë e panumërta, me puse të kthjellët dhe me pyje të dendura. Ata ishin njerëz shtatlartë dhe shumë të fuqishëm. Askush nuk i mposhte dot dhe të gjithë ua kishin frikën. Mirësi mbi mirësitë... Mirëpo, ky popull jo vetëm që nuk e falënderonte Allahun e Madhëruar për mirësitë me të cilat i kishte nderuar, por adhuronin idhujt siç bënte populli i Nuhut para tyre. E harruan përmytjen e madhe, prandaj gdhendnin idhuj guri, pastaj i luteshin dhe i adhuronin në vend të Allahut. Fuqinë e shfrytëzonin për t'i bërë padrejtësi të tjerëve pasi nuk i frikësoheshin askujt dhe mburreshin duke thënë: *"Kush është më i fortë se ne?"* Mjerë për ta... Kishin harruar se të gjithë fuqinë e kishin dhuratë nga Krijuesi i tyre. Kishin harruar se Allahu ishte më i fuqishëm se ata. Mosbesimi, mendjemadhësia

dhe padrejtësia ishte përhapur në mesin e këtij populli. E kishin tepruar me gjynahe, megjithatë Allahu Mëshirëplotë nuk i dënoi, por ia zbriti shpalljen e Tij një burri të nderuar nga mesi i tyre që t'i udhëzonte drejt punëve të dëlira. Dërgoi në mesin e tyre një Pejgamber, që ishte i njohur për prejardhjen e tij fisnike, për moralin e lartë, për ndershmërinë dhe mendjen e kthjellët. Ia zbriti shpalljen Hudit, paqja dhe mëshira e Allahu qofshin mbi të.

## Pejgamberi

Pasi e mori përsipër misionin e Pejgamberit, Hudi, alejhis-selam, iu përvesh punës për të cilën ishte urdhëruar...T'i thërrasë njerëzit në fenë e vërtete, t'i nxjerrë ata, me lejen e Allahut, nga errësitat e idhujtarisë dhe veseve të ulëta në dritën e besimit dhe moralit të lartë - ky ishte misioni i tij. U ngrit në mesin e popullit dhe filloi t'ia përcillte porositë e Allahut të Lartësuar. Me përzemërsi iu drejtua duke i thënë: *"O populli im, adhuroheni Allahun mbasi nuk meriton të adhurohet askush veç Tij!"* Sikurse Nuhu, ashtu edhe Hudi alejhis-selam, fillimisht e thirri popullin e tij në adhurimin e Allahut të Pashoq, pasi kjo është rruga e vetme e shpëtimit në këtë botë dhe në tjetrën. Ua tërhoqi vërejtjen për adhurimin e idhujve mbasi një vepër e tillë është gjynahu, të cilin Allahu nuk e fal kurrë.

Pas kësaj, Hudi, alejhis-selam, ia bëri me dije popullit të tij se nuk kërkonte pasuri dhe as pozitë në mesin e tyre. Ua bëri të ditur se ua do të mirën dhe se është këshillues besnik. *"Unë ua përcjelli porositë e Zotit dhe jam këshillues besnik!"*, u thoshte, *"O populli im! Unë nuk kërkoj nga ju asnjë shpërblim. Mua më shpërblen Ai që më ka krijuar! A nuk kuptoni?!"*

O bir! Thirrja e njerëzve për në fenë e Allahut nuk është zanat dhe as profesion, por mision i rëndë, ndaj mos syno të

pasurohesh nëpërmjet fesë. Këshilloji njerëzit me çiltërsi, vetëm e vetëm që të arrish kënaqësinë e Allahut të Lartmadhërishëm. Mos jep këshilla për t'u shpërblyer nga ata që këshillon dhe as për të arritur famë në mesin e tyre.

*"O populli im!", u thoshte, "përkujtoni se Allahu ju bëri më-këmbës pas popullit të Nuhut dhe se Ai iu dhuroi shtatlartësi dhe fuqi si askujt më parë. Përkujtoni mirësitë e Allahut ndaj jush, në mënyrë që të keni sukses!" "Kijani frikën Allahut dhe më pasoni mua! Kini frikë Allahun, i Cili iu dhuroi mirësi pa fund: iu dhuroi bagëti dhe fëmijë iu dhuroi kopshte të gjelbëruara dhe burime të kthjellët. Unë i trembem për ju dënimit të Ditës së Madhe." "Vetëm Allahun të adhuroni, mbasi çdo gjë është nën pushtetin e Tij. O populli im, braktisni adhurimin e idhujve që nuk ju sjellin kurrfarë dëmi dhe dobie." Mirëpo fisi i tij, jo vetëm që nuk e besoi, por shfaqti armiqësi ndaj Hudit, alejhis-selam, dhe e munduan të Dërguarin e Allahut, me përjashtim të disa njerëzve të thjeshtë që i besuan fjalëve të tij dhe pasuan rrugën e Pejgamberit.*

## Fisi Ad

Megjithë fjalët e urta dhe sjelljen e mirë të të Dërguarit të Allahut, populli Ad nuk e braktisi adhurimin e idhujve dhe as tiraninë. Ishin këmbëngulës në të liga dhe fuqinë trupore vazhdonin ta përdornin për padrejtësi ndaj të tjerëve. Ia kthyen shpinën porosive të Pejgamberit dhe i thonin atij: *"A erdhe të na detyrosh të adhurojmë Allahun të vetëm dhe të braktisim zotat e baballarëve tanë? Ti nuk na solle asnjë mrekulli, ndaj ne nuk i braktisim ata për hir të fjalëve të tua dhe as që të besojmë ty, o Hud." "O populli im!", ia kthente Hudi alejhis-selam, "Nëse kështu mendoni, përgatitni ndonjë kurth ndaj meje, ju së bashku me idhujt tuaj, dhe mos më jepni aspak afat mbasi nuk jua kam frikën! Unë i mbështetem Allahut, Zotit*

*tim dhe tuajit! Çdo gjallesë është nën pushtetin e Allahut dhe asgjë nuk ndodh pa lejen e Tij.” Por, edhe pas kësaj, fisi i tij nuk mundi t’i shkaktonte kurrfarë të keqeje Hudit, pasi atë që kërkon strehim tek Allahu askush nuk mund ta dëmtojë. Atë, që e mbështet Allahu, askush nuk mund ta frikësojë. A ia vlen pra të adhurohet guri që shkelet me këmbë? A ia vlen t’i lutesh atij që nuk sheh dhe as dëgjon, nuk sjell dëm dhe as dobi? Ndërkohë që Pejgamberi e thërriste fisin Ad në shpëtim, kryetarët e fisit, ata të cilëve Allahu i Madhërishëm u kishte dhënë mirësi pa fund, i drejtoheshin popullit të tyre duke i thënë: “A nuk e shihni se ky është një njeri sikurse ju! Pi nga ajo që pini ju dhe ushqehet me ushqim si i juaji! Nëse pasoni një njeri si ju, vërtetë, jeni të humbur dhe të mashtruar.”*

Njerëzit kryelartë që jetojnë në mes të rehatisë, e mohojnë Pejgamberin nga frika se do u venitej fama dhe autoriteti dhe shikimet do ktheheshin për nga Pejgamberi... Kërkonin që si Pejgamber t’u zbrisnin melekët. Allahu ia zbriti shpalljen një burri në mesin e tyre në mënyrë që të tjerët rreth tij ta kuptonin se urdhrat dhe porositë e Allahut janë të lehta për t’u zbatuar nga çdo njeri. Vetë Pejgamberi ishte njeri që hante dhe pinte, punonte si gjithë të tjerët, e kaplonte lodhja dhe e mundonin vështirësitë e jetës. Por të gjitha këta aspak nuk e pengonin të zbatonte porositë e Allahut të Lartësuar... A ka më të humbur se mendjemëdhenjtë? Ata e mohojnë ringjalljen dhe vazhdonin rrugën e gabuar duke i mashtruar edhe të tjerët. “Mos vallë Hudi iu premtonte se pasi që të vdisni dhe të bëheni eshtra, do të ringjallen përsëri?”, i drejtoheshin popullit, “Sa premtim qesharak që është ky? Nuk ka tjetër veç jetës së kësaj bote. Ne jetojmë e vdesim, por kurrë nuk do të ringjallemi.”

Biri im! Të jesh i bindur se Allahu Fuqiptotë nuk e ka të vështirë aspak t’i ringjall njerëzit pasi kanë vdekur. Kjo gjë as që e mundon ndopak Allahun e Madhërishëm dhe Ai as që lodhet për diçka të tillë, mjafton të japë një urdher dhe çdo gjë



që dëshiron bëhet menjëherë. Por njerëzit e krahasojnë fuqinë dhe mundësitë e tyre me atë të Zotit Fuqiplotë e si pasojë i duken të pamundura shumë gjëra që për Allahun mjafton një urdhër... Ta kam përmendur edhe më parë se njerëzit me pozitë vështirë se i pranojnë këshillat. Ata shpresat i kanë të lidhura me këtë jetë, prandaj edhe e kundërshtojnë ringjalljen... Ata e urrejnë faktin se një ditë do të përgjigjen përpara Zotit të botëve për veprat e tyre të ulëta. Por e kanë të kotë, mbasi ringjalljes dhe llogarisë nuk mund t'i shpëtojnë askush. Edhe pse u paralajmëruan me dënimin e Allahut, fisi Ad nuk i kushtoi vëmendje porosive të Pejgamberit, por e kundërshtuan të Dërguarin e Allahut dhe iu drejtuan duke i thënë me përçmim: *"Njëllaj për ne: Na këshillove ose nuk na këshillove. Këto që na premtan ti janë vetëm përrallat e popujve të lashtë. Ne nuk frikësohemi aspak mbasi asnjëherë nuk do të dënohemi."*

Atëherë Allahu i Lartmadhërishëm i goditi me dënim të lehtë në këtë jetë përpara dënimin të madh në botën tjetër, me qëllim që të kthehen me përukje në rrugën e drejtë dhe të tërhiqeshin nga të këqijat. Kështu, thatësira pllakosi anë e mbanë. U thanë pemët dhe u shkretuan kopshtet me fruta plot. Nga qielli nuk zbriste as edhe një pikë shiu. Ushqimi u pakësua dhe sofrat u varfëruan. Hudi, alejhis-selam, e dinte se nuk i kishte goditur thatësira për tjetër, por vetëm që njerëzit të heqin dorë nga idhujtaria dhe padrejtësitë dhe të pasojnë rrugën e udhëzimit.

Në këto kushte të vështira u ngrit edhe një herë në mesin e popullit të tij duke i thënë: *"O populli im! Kërkoni falje nga Allahu dhe kthehuni nga Ai të penduar, se kështu Allahu do t'ju sjellë shi me bollëk dhe fuqisë suaj do i shtojë fuqi, e mos kundërshtoni duke qenë keqbërës!"* Nëse fisi Ad do të pendoheshin dhe do kërkonin falje, Allahu i Lartësuar do t'ua largonte dënimin dhe do i përfshinte me mëshirën e Tij, por ata edhe në vështirësi u treguan të pabindur dhe kryelartë.



*"A po na urdhëron të adhurojmë vetëm Allahun, e ta braktisim besimin e të parëve tanë?"*, iu drejtuan Hudit alejhis-selam, *"Na e sill, pra, dënimin e Allahut, nëse je i singertë në atë çka thua! Ne nuk i besojmë fjalëve të tua. Ti nuk je tjetër veçse një gënjeshtar."* Hudi, alejhis-selam, i thirri në rrugën e shpëtimit me mish e me shpirt, por fisi i tij këmbëngulnin të adhuronin gurët që skalitnin me duart e tyre, mbaheshin me të madh dhe vazhdonin t'u bënëin padrejtësi të tjerëve. Atëherë Hudi, alejhis-selam, e humbi shpresën se fisi i tij do përmirësohej ndonjëherë, ndaj i ngriti duart nga qielli duke thënë: *"O Zoti im, më ndihmo se ata po më përgënjeshtrojnë."*

## Stuhia

Kohët kalonin, thatësira vazhdonte. Shpresa e vetme për mbijetesë ishte shiu. Mëngjes e mbrëmje shikimet drejtoheshin nga qielli. Varfëria dhe pikëllimi sa vinin e shtoheshin. Kur, ja! Një ditë prej ditëve në horizont u shfaq një re e stërmadhe që sa vinte e afrohej pranë tokave të tyre. Gëzimi nuk përshkruhej dot me fjalë. Banorët e krahinës Ahkaf dolën nga shtëpitë e tyre për të festuar zbritjen e shiut. *"Më në fund!"*, thërrisnin nga gëzimi, *"Re në horizont, re që lajmërojnë për shi të bollshëm! Më në fund! Do shpëtojmë nga kjo thatësi e tmerrshme!"* Sapo pa renë gjigande, Hudi, alejhis-selam, e kuptoi se dënimi i Allahut po afrohej. *"O populli im! Kjo nuk është re që bart shi, por është ajo që e kërkuat me mendjemadhësi: pas saj do vijë fortuna që bart dënim të dhembshëm dhe që shkatërron çdo gjë me urdhërin e Allahut."* - iu drejtua për të fundit here Pejgamberi. Megjithatë ia kthyen shpinën me mendjemadhësi dhe nuk i besuan. Atëherë Hudi, alejhis-selam, ia përcolli lajmin atyre pak besimtarëve që e kishin përkrahur dhe së bashku u strehuan në një vend të sigurt, përpara se tmerri të përfshinte luginën... Drita e diellit sikur u shua. Krejt lugina u

errësua. Stuhia filloi të frynte pa u ndalur. Ajo ngrinte re prej rëre të imët sa nuk shikoje dot ç'fshihej pas saj. Degët e pemëve filluan të fërshëllenin dhe të kërcasin nga era e cila sa vinte e bëhej më e fortë. Papritmas ushtoi një zë i tmerrshëm dhe frika kaploi zemrat e njerëzve shtatlartë, që dikur mbaheshin si të pamposhtur. Filloi një stuhi e tillë që nuk ishte parë kurrë më parë. I shkulte pemët nga toka dhe rrëronte gjithçka që i dilte përpara. Nga tmerrri njerëzit u futën në shtëpitë e gurta dhe në pallatet madhështore duke shpresuar se do i mbronin nga dënimi, por tashmë ishte e kotë. Kjo stuhi e rrëmbyeshme fryu pareshtur për shtatë netë dhe tetë ditë duke i përcjellë idhujtarët ngado të shkonin. U shkatërrua çdo gjë dhe asnjë nuk shpëtoi.

Ah, sikur t'i shihje trupat e tyre të fuqishëm, qenë të përmbysur dhe pa jetë nën gërmadhat e pallateve madhështore, sikurse trungjet e palmave kur i thyen stuhia. Të gjitha fushat e tyre, burimet dhe banesat me të cilat krenoheshin dikur, u mbuluan nga rëra dhe i gjithë qyteti së bashku me banorët e tij u varrosen nën rërë. Pas shkatërrimit të fisit Ad, shkretëtira e pushtoi vendin dhe mbuloi çdo gjë pa lënë asnjë gjurmë jete...

Ja, ky ishte fisi Ad. Ai i mohoi mirësitë e Zotit, e kundërshtoi të Dërguarin e Tij dhe pasoi porositë e keqbërësve dhe kokëfortëve. Ata i përcollli mallkimi në jetën e kësaj bote dhe në Ditën e Kijametit do të jenë prej të humburve. Me të vërtetë, fisi Ad e mohoi Zotin e tij. Qoffë larguar nga mëshira e Allahut fisi Ad, populli i Hudit alejhis-selam!

Prandaj, o bir! Mos harro asnjëherë se më i madhi dhe më i fuqishmi është Allahu dhe dije se kush këmbëngul në mosbesim dhe padrejtësi, veçse ka hedhur hapin e parë drejt shkatërrimit të tij. Të jesh i bindur se e ardhmja, fitorja dhe lavdia i përket pasuesve të denjë të Pejgamberëve, ndaj bëhu prej tyre! Ndërkaq Hudi, alejhis-selam, dhe besimtarët ishin



*Rrëfimet më të mira*

strehuar në një vend të sigurt drejt të cilit Allahu i kishte drejtuar. Allahu i Lartësuar i mbrojti nga dënimi si pasojë e besimit që u ndriçonte zemrat e tyre. Thuhet se pasi pushoi stuhia dhe retë e zeza u larguan të gjithë së bashku shkuan në një qytet të quajtur Hadrameut, ku jetuan të lumtur duke adhuruar Allahun për sa patën jetë.

## Krahina Hixhr

Biri im! Shumë kohë më parë, në një krahinë të largët në Gadishullin e Arabik, në një zonë të quajtur Hixhër jetonte fisi i Themudit. Allahu i Lartësuar ia kishte hapur portat e mirësisë dhe të begative pa fund. Shiu zbriste me bollëk mbi luginë dhe burimet me ujë të kthjellët nuk numëroheshin. Zona ku jetonin ishte e pasur me pemë nga më të ndryshmet, ku të binin në sy palmat e stërmbushura me hurma. Banorët e kësaj krahine lëvronin tokën, mbillnin fushat, shtronin rrugët dhe ndërtonin godina madhështore, saqë vendbanimi i tyre u bë një nga më të dalluarit në Gadishull. Jo vetëm kaq... Allahu i Lartësuar i kishte nderuar me një dhunti të veçantë: mjeshtërinë e skalitjes së gurit.

Herë pas here të parët e fisit përkujtonin stuhinë e fuqishme Debur, që pati shkatërruar fisin Ad, ndaj i nxitnin fëmijët e tyre të gërmonin kodrat shkëmbore dhe në brendësi të tyre të skalitnin shtëpi madhështore për vendbanim, duke qenë të bindur se këto vendbanime do t'i mbronin nga fortunat shkatërruese. Ndiheshin të sigurt në brendësi të banesave madhështore dhe mendonin se vdekja nuk mund të futej në thellësinë e kodrave. Allahu i bëri mbizotërues të gurit dhe shkëmbit, ndërsa ata i përkuleshin dhe e adhuronin gurin që e skalitnin me duart e tyre... Atëherë kur e harruan Allahun, shejtani ua zbukuroi veprat e shëmtuara dhe i shmangu nga rruga e drejtë, edhe pse ishin largpamës.

## Salihu

Allahu i Lartësuar nuk e do mosbesimin dhe nuk është i kënaqur me mosmirënjohjen e robërve të Tij. Ai dëshiron të jenë të udhëzuar në rrugën e drejtë, në rrugën e shpëtimit, ndaj në çdo popull ka dërguar Pejgamber si bartës të porosive hyjnore, si mësues dhe udhërrëfyes të njerëzimit.

A ke dëgjuar për Pejgamberin e dërguar tek fisi Themud? Çfarë di ti rreth historisë së këtij njeriu fisnik? Nëse ke dëshirë të njihesh me të dhe me historinë e tij, bëhu i durueshëm dhe mos iu ndaj leximit pasi unë do të ta tregoj sa më mirë të mundem.

Dëgjo, o djalë! Ndërkohë që fisi Themud e kishte humbur rrugën, Allahu i Lartësuar përzgjedhi një burrë fisnik nga mesi i tyre si të Dërguarin e Tij. Ia zbriti shpalljen Salihut, alejhis-selam, në mënyrë që nëpërmjet saj t'i nxirrte njerëzit nga errësitat e idhujtarisë në dritën e besimit. Ky burrë vinte nga një familje me emër të mirë. Që në rininë e tij Salihu, alejhis-selam, njihej për zgjuarsin dhe urtësin. I gjithë populli ishte i bindur se një ditë ai do bëhej më i shquari dhe më fisniku i fisit Themud. Të afërmit e tij i drejtonin sytë nga ai dhe fjala e tij kishte peshë në mesin e tyre. Kush e mendonte se një ditë Salihu, alejhis-selam, do të dërgohej në mesin e tyre si Pejgamber dhe do të bënte ç'është e mundur t'i largonte njerëzit nga adhurimi i idhujve. Ndërkohë, i Dërguari fisnik iu përvesh punës për udhëzimin e fisit të tij. Salihu u përpoq shumë për ta drejtuar popullin e tij nga e mbara. Çështja e parë me të cilën e porositi fisin e tij ishte adhurimi i Allahut të Vetëm dhe të Pashoq dhe braktisja e idhujtarisë. Me butësi i drejtohej duke i thënë: "O populli im! Adhurojeni Allahun mbasi askush nuk vlen të adhurohet veç Tij."

Herë pas here ia përkujtonte mirësinë e Allahut ndaj tyre në mënyrë që të ktheheshin të turpëruar, të ktheheshin me

pendim tek Mirëbërësi i tyre. *“O populli im! Adhurojeni Allahun të vetëm dhe braktisni idhujt! Ai ju ka krijuar nga toka dhe ju ka dhënë jetë të mirë mbi të! Ndaj kërkoni falje prej Tij dhe pendohuni për gjynahet tuaja, sepse Allahu dëgjon çdo gjë dhe i përgjigjet lutjes.” “O vëllezërit e mi! Perkujtoni mirësitë e Allahut ndaj jush! Mos harroni se si Allahu ju bëri trashëgimtarë pas fisit Ad, ju bëri mëkëmbës në tokë dhe mbi luginat e saj ngrini pallate, ndërsa në brendësi të kodrave gdhendni shtëpi! Përkujtoni mirësitë e Allahut dhe mos bëni çrregullime në tokë!” Herë pas here ia tërhiqte vërejtjen duke i thënë: “A mendoni vallë se do të liheni të sigurt në mes të kopshteve me fruta shumë dhe burimeve të kulluar? A mendoni se shtëpitë në kodra, banesat që i gdhendni me aq mjeshtëri do ju mbrojnë nga vdekja? Kini frikë Allahun dhe më pasoni mua!”*

Biri im, Zoti na ka krijuar që ta njohim Atë, ta adhurojmë për sa të jemi gjallë dhe t'i bindemi udhëzimeve të Tij. Pikërisht pas adhurimit të Zotit tonë fshihet edhe lumturia e zemrave në këtë botë dhe shpëtimi në botën tjetër. Dije se kjo jetë mbaron sa hap e mbyll sytë, ndaj shpejto për të arritur faljen dhe kënaqësinë e Allahut të Madhërishëm duke zbatuar urdhrat e Tij. Mos të të mashtrojnë bukuritë e kësaj bote e të ndjekësh hapat e Themudit, sepse mund ta pësosh ashtu siç e pësoi ky popull.

Salihu, alejhis-selam, ua donte të mirën të afërmeve të tij, prandaj nuk pushoi së këshilluari, duke i thirrur për nga e mbara, për nga rruga e udhëzimit dhe e moralit të lartë. *“O vëllezër, pse largoheni nga unë kur unë nuk kërkoh nga ju kurrëfarë shpërblimi? Përse nuk më dëgjoni, ndonëse jam një njeri besnik nga mesi i juaj? Përse pasoni ata që u bëjnë padrejtësi të tjerëve, që bëjnë rrëmuja e nuk përmirësojnë?”* Populli i tij mbeti pa fjalë, por nga kryelartësia nuk e pasuan të Dërguarin përveç një pakice. Po kush ishin vallë ata që e pasuan Salihun, alejhis-selam? Ata ishin njerëzit e thjeshtë. Ata

që lodheshin për të fituar bukën e fëmijëve, ata që jetonin me nder, ata që nuk gënjenin, nuk vidhnin dhe as mashtronin. Pasesit e Pejgamberit ishin njerëzit e çiltër, njerëzit me zemër të pastër, ata që nuk e mbanin veten lart ndaj të tjerëve dhe nuk krenoheshin me pasuri. Mirëpo shumica e popullit mbeti në mosbesim dhe nga inati i dhanë përparësi idhujtarisë kundrejt besimit të drejtë.

### Fisi Themud

Megjithëse Salihu e thirri fisin e tij në rrugën e shpëtimit me butësi dhe maturi, duke ia bërë të qartë kotësinë e adhurimit të statujave, ata i thanë: *"O Salih! Para kësaj, ti ke qenë i nderuar në mesin tonë. Ndërkohë sot, ti na thërret t'i braktisim zotat tanë, ta braktisim fenë e të parëve tanë. Vërtetë ne dyshojmë në atë që na thërret ti. Ne nuk mund t'i nënçojmë zotat e të parëve vetëm se ti na e kërkon diçka të tillë."*

Themudasit thanë mes tyre: *"A të pasojmë një njeri nga mesi i jonë? Vallë, vetëm atij mes nesh t'i dërgohet shpallja? Sikur ta pasonim atë do t'na pandehin për të çmendur. Jo, jo! Ai nuk është tjetër veçse një gënjeshtar mendjemadh!"*

Krerët e fisit me mendjemadhësi u drejtoheshin të varfërve, që kishin besuar, duke i thënë: *"Vërtetë mendoni se Salihu na qenka i Dërguar i Allahut?" "Ne jemi të bindur se është i tillë!",* ia kthenin të varfërit plot trimëri, *"Dhe besojmë në çdo gjë që i shpallet atij."* Pasanikët gati sa nuk plasnin nga inati dhe me fytyra të vrerosura i drejtoheshin duke i thënë: *"Ne e mohojmë atë që besoni ju dhe kurrën e kurrës nuk e pasojmë të Dërguarin tuaj!"*

Sa herë që përmendej Allahu zemrat e jobesimtarëve neveriteshin dhe në fytyrat e tyre vlonte zjarri i urrejtjes. Gati sa nuk i vërsuleshin Pejgamberit dhe besimtarëve kur i këshillonin.

## Deveja

*"O Salih!",* thanë themudasit një ditë, *"Ti je njeri i xhindosur! Ti je vetëm një njeri si ne, ndaj na sill ndonjë mrekulli, nëse ajo që thua është e vërtetë!"* Salihu i tha: *"E çfarë mrekullie kërkoni?"* Ata thanë: *"Na e nxirr nga ky shkëmb një deve mbarsë. Nëse e bën diçka të tillë, ne të besojmë dhe e pasojmë rrugën tënde."* Themudasit e dinin se devja nuk lind prej gurit, por vetëm prej deve, prandaj ishin të bindur se do të korrin sukses. Sipas tyre diçka e tillë është e pamundur të realizohet, mirëpo për Allahun çdo gjë është fare e lehtë. Mjafton një urdhër dhe çdo gjë bëhet. Salihu kishte besim të patundur në fuqinë e Allahut të Lartësuar. U ngrit. Vajti menjëherë tek mihrabi i tij dhe filloi të falte namaz. Pastaj e luti Allahun që t'ia realizonte kërkesën e tyre. Atëherë Allahu urdhëroi shkëmbin të çahet dhe nga e çara doli një deve e madhe mbarsë. Njerëzit fërkonin sytë të shastisur. I hidhnin shikimet njëri-tjetrit të habitur dhe lëshonin lloj-lloj pashirmash. Me sytë e tyre panë një mrekulli të stërmadhe! Sikur ishin gozhduar në vend, askush nuk fliste. Heshtjen e theu zëri kumbues i Salihut, i cili qëndronte në mesin e turmës.

*"Kjo është deveja e Allahut!",* u tha i Dërguari, *"Kjo është mrekullia që kërkuat, ndaj lëreni të qetë të kullosë mbi tokën e Allahut, dhe mos e lëndoni, e t'ju godasë dënim i tmerrshëm!"*

Disa prej të pranishmëve besuan, mirëpo edhe pas kësaj mrekullie shumica e popullit nuk pranuan ta ndjekin të vërtetën, por këmbëngulën me inat në mosbesim dhe lajthitje. Atëherë Allahu i Lartësuar i shpalli të Dërguarit të Tij: *"O Salih! Lajmëroji themudasit se uji do ndahet midis tyre dhe deveve, e cila do të pijë në një ditë të caktuar, kurse ju në të tjerat të njohura për ju!"*



## Krimi

Deveja e Allahut kulloste mbi tokë, vinte dhe shkonte. Askush nuk kishte nevojë të merrej me ushqimin e saj dhe një herë në dy ditë deveja e kishte radhën të pinte tek pusi i themudasve. Një ditë përpara se të pinte deveja, populli merrte nga pusi sasinë e nevojshme të ujit të cilin e ruanin nëpër calikë. Kur e kishte radhën deveja thuhet se ata pinin qumështin e saj, derisa ngopeshin. Meqë krerët e fisit e shihnin devenë mëngjes dhe mbrëmje, si dëshmi e sinqeritetit të Salihut dhe si argument i vërtetësisë së tij, vendosën ta therin. Gjoja, që të kenë ujë të mjaftueshëm për vete. Paria e fisit kishin frikë prej saj. *“Disa nga të afërmit tanë e pranuan Islamin sapo doli nga shkëmbi.”*, mendonin, *“Kush e di sa të tjerë do t’i pasojnë tek e shohin ditë për ditë mrekullinë e Allahut. Nëse pasojnë Salihun, nuk do na bëhen më krah në punë të liga, ndaj sot o kurrë.”*

Salihu ua kishte tërhequr vërejtjen që mos ta shqetësonin devenë, por ata nuk i morën parasysh porosinë e tij. *“Kush e mbyt devenë?”*- thanë. U ngrit njëfarë Masre bin Mehrexh dhe tha: *“Unë!”* Menjëherë pas tij u ngrit edhe një faqezi me emrin Kadër bin Salif dhe tha: *“Unë!”*

Këta dy të rinj u përgatitën ta therin devenë dhe atyre iu bashkëngjitën edhe shtatë veta, kështu gjithësej u bënë nëntë. E përcollën devenë, derisa ajo shkoi tek burimi për të pirë ujë. Kur ajo po kthehej, Masre e goditi me shigjetë në këmbë. Me të shpejtë erdhi Kadër bin Salifi, i cili iu vërsul me shpatë në dorë dhe ia preu këmbët. Deveja u rrëzua përdhe dhe filloi të pëlliste me sa fuqi kishte, në mënyrë që t’ia tërhiqte vëmendjen të voglit të saj. Por faqeziu e preu në qafë dhe e mbyti. Pas tij nxituan të tjerët dhe e copëtuan me shpatat e tyre. Thuhet se i vogli i saj, të cilin posa e kishin ndarë nga gjiri, u ngrit në kodër dhe pëlliti tre herë. Pastaj hyri në një shkëmb dhe u zhduk.

## Dënimi

Menjëherë lajmi mori dhenë. I gjithë fisi u grumbullua dhe u nisën për tek i Dërguari i Allahut. Sapo e takuan, iu drejtuan me kryelartësi duke i thënë: *“O Salih! Ne e mbytëm devenë për të cilën ti na thoje se është mrekulli e Allahut dhe na kërcënoje se, nëse e dëmtojmë, do na godasë dënimi i dhembshëm!”* Jo vetëm kaq, por nga inati e sfiduan dhe i thanë: *“Nëse me të vërtetë je i Dërguar i Allahut, na e sill, pra, dënimin me të cilin na kërcënoje!”* Salihu u trondit nga lajmi që mori... Hidhërimi për vrasjen e devesë shihej qartë në fytyrën e tij. Gjithsesi, e përmbajti veten. Më pas iu drejtua të pranishmëve dhe u tha: *“Atëherë, jetoni në banesat tuaja edhe tre ditë e pas tyre do t’ju godasë dënimi i dhembshëm! Ky është premtim i vërtetë!”* Mirëpo ata nuk besonin në këtë kërcënim të sigurt dhe në vend që t’i kërkonin falje Allahut, u tallën me Salihun. Madje, kur ra terri i natës, të nëntë fajtorët që mbytën devenë, përgatitën një plan për ta vvarë edhe vëllanë e tyre, Salihun dhe të gjithë ata që e pasonin nga të afërmit e tij. Vrasësit thanë ndërmjet tyre: *“Betohuni se natën do ta vrasim Salihun dhe gjithë familjen e tij. E nëse na pyesin, do t’u themi të afërmit të tij se ne nuk kemi qenë të pranishëm në zhdukjen e familjes së tij dhe se po themi të vërtetën.”* Mirëpo Allahu i Madhërishëm nuk ua lejoi ta bënin këtë. Ata kurdisën një kurth për vëllanë e tyre, prandaj edhe Allahu u ngriti një kurth, pa e kuptuar themudasit aspak. Allahu dërgoi dënimin mbi ata që u mbledhën për të mbytur Salihun, para se të shkatërronte njerëzit e tjerë.

Thuhet se, kur u gdhinë themudasit ditën e parë të pritjes, që i binte e enjte, fytyrat u ishin zverdhur. Megjithatë, kur ra nata, ata i thërrisnin njëri-tjetrit: *“Ja! Kaloi një ditë nga afati i caktuar.”*

Ditën e dytë, të premtën, gdhinë me fytyra të skuqura. Megjithatë nuk i ndërprejnë thëniet e mosbesimit. Nga mosbindja e tyre nuk i ktheu as paralajmërimi, as frikësimi dhe as sjellja e mirë dhe fjalët e buta. Kur ra nata, i drejtoheshin njëri-tjetrit: *“Kaluan dy ditë, apo jo?”*

Të shtunën, ditën e tretë të afatit të caktuar gdhinë me fytyra të nxira. Kur ra terri, thanë: *“Ja! E shihni?! Kaloi edhe afati i caktuar.”*

Ama, kur agoi e diela, askush nga themudasit nuk priste ndonjë dënim, por premtimi i Pejgamberëve është i vërtetë... Lavdia dhe triumfi u takon të Dërguarve dhe atyre që pasuan rrugën e tyre, ndërsa mohuesit nuk i pret veçse shkatërrimi dhe nënçmimi! Sapo u zbardh horizonti, nga qielli shkrepëtiu një rrufe e tmerrshme dhe një zë i llahtarshëm ushtoi. Ndërkohë toka filloi të dridhej. Tmerri kaploi zemrat. Njerëzit u shtangën në vend si të paralizuar. U erdhi vdekja andej nga s’e prisnin. Nga fuqia e tërmetit filluan të shembeshin mbi kokat e tyre kodrat ku kishin gdhendur banesat. Shpirtrat filluan të braktisin trupat e tyre dhe zemrat u pëlcisnin në gjokse nga tmerri i ushtimës. Për një moment jeta e qytetit u shua, thua se në të as që kishte banuar ndokush më parë. Nuk dëgjohej as pëshpëritja më e vogël. Çdo gjë u shkretua. Të gjithë themudasit të ngrirë dhe të vdekur në vend... Pallatet madhështore prej guri, që i mendonin si strehë e sigurt nga dënimi, nuk u sollën kurrfarë dobie. Kështu pra, fisi Themud e mohoi Zotin dhe u dënua rëndë. Allahu i Lartësuar u dërgoi Pejgamberin nga mesi i tyre dhe u shpalosi mrekulli si askujt më parë, por ata pasuan humbjen në vend të udhëzimit, verbimin në vend të shikimit dhe errësirën në vend të dritës. Ç’të kërkosh do gjesh! Iu larguan të mbarës e nuk gjetën veçse humbje, verbim dhe errësi.

## Shpëtimi

Allahu i Lartmadhërishëm e shpëtoi Salihun, alejhis-selam, dhe pasuesit e tij nga tërmeti dhe rrufeja. Allahu i mbrojti ata nga vdekja e sigurt si pasojë e besimit që ndriçonte në gjokset e tyre... Pasi përfundoi dënimi mbi mosbesimtarët dhe çdo gjë mbaroi, i Dërguari së bashku me besimtarët u nisën për udhëtim. Rugës, teksa shihte shtëpitë e rrënuara dhe trupat pa jetë të themudasve, Salihu iu drejtua duke i thënë: *“O populli im! Unë ua përcolla porositë dhe këshillat, u përpoqa t’ju tregoj rrugën e shpëtimit, porse ju nuk i donit këshilluesit ndaj pësuar dënimin e dhembshëm, në të cilin do të mbeteni përgjithmonë.”* Thuhet se besimtarët bashkë me të Dërguarin u shpërngulën në krahinë e bekuar të Mekes, ku kanë jetuar të lumtur duke adhuruar Allahun e Lartësuar.

## Në Babiloni

Heroi i radhës ka lindur shumë shekuj më parë në qytetin e famshëm të Babilonisë. Ka lindur atëherë kur banorët e këtij qyteti të lashtë kishin arritur kulmin e zhvillimit. Babilonasit ishin mjeshtër të ndërtimit të pallateve të mrekullueshme prej qerpiçi. Qyteti rrethohej nga një mur gjigand për t'u mbrojtur nga armiqtë, rrugët e qytetit i kishin shtruar me pllaka blu dhe anash qëndronin statuja të llojllojshme. Kudo kundërmonte aroma e trëndafilave që mbulonin parqet e gjelbëruara dhe ballkonet e pallateve të fisnikëve. Jo larg qytetit rridhte lumi Euftrat, ujin e të cilit e shfrytëzonin për bujqësi dhe blegtori. Shiu zbriste nga qielli me bollëk në çdo stinë të vitit. Mirësi mbi mirësitë. Por një zhvillim i tillë nuk i solli kurrfarë dobie. Si pasojë e arritjeve dhe diturive që zotëronin, filluan të mburrshin e të mbaheshin me të madh. E harruan Allahun dhe iu dhanë mosbesimit dhe shfrenimit. Nuk mendonin për tjetër veçse për jetën e kësaj bote dhe për bukuritë e saj. Shejtani ia zbukuroi veprat e tyre dhe i largoi nga rruga e vërtetë për t'i humbur në errësiat e idhujtarisë. Në mesin e tyre kishte të tillë që adhuronin yjet dhe trupat qiellorë, disa të tjerë adhuronin statujat dhe shumë prej banorëve të këtij qyteti adhuronin njëfarë mbreti që hiqej si zot. Krenoheshin me idhujt e të parëve, me adhurimin e diellit dhe hënës, me zhvillimin dhe mirësitë e qytetit. Sa i mbrapshtë qe gjykimi i tyre!

## Familja e Azerit

Ndër familjet më të njohura të qytetit ishte familja e Azerit, skulptorit të famshëm. Sa e sa idhuj i kishte gdhendur me duart e tij; sa e sa statuja prej guri me lloj lloj formash adhuroheshin në qytet si pasojë e punës së tij. Njerëzit e nderonin kudo që kalonte. I përmendej emri ngado që shkonte, ndërsa ai mburrej dhe ecte me krenari në mesin e babilonasve. Azeri besonte në shumë zota ashtu siç e kishin zakon babilonasit, adhuronte statujat, që i formësonte me duart e tij. Pasonte me përkushtim fenë e baballarëve. Për më tepër, Azeri kishte edhe një dyqan të njohur në qytet ku tregtonte statuja që ishin burim jetese për të dhe familjen e tij.

## Ibrahimi

Kaluan kohët dhe gruaja e Azerit lindi një djalë të bukur dhe të shëndetshëm, të cilin e quajtën Ibrahim. Që në moshë të re djaloshi dallohej për mendjemprehtësi, për urtësi dhe trimëri. I pëlqente të vetmohej dhe të meditonte. Zhytej në mendime teksa vështronte qiellin e stërmbushur me yje, teksa vështronte diellin rrezeartë dhe hënën e ndritshme në terrin e natës, kodrat e larta rreth qytetit dhe fushat e gjelbëruara me lloj lloj lulësh. Mahnitej tek vështronte lumin sesi lëvizte pa pushim për t'i sjellë jetë tokës së vdekur. Kush i kishte krijuar vallë këto krijesa madhështore? Mos ishin krijuar vetvetiu? Kudo që hidhte shikimin i shfaqeshin shenja pas të cilave fshihej Krijuesi pa të meta. I bekuar qoftë Allahu më i miri krijues! Kur rendeje rrugëve të qytetit, habitej me sjelljen e njerëzve, të cilët i shihte duke iu përlurur në shenjë respekti dhe duke iu lutur disa gurëve që i kishin skalitur me duart e tyre. Sa çudi!

Si mund ta adhurojë krijuesi krijesën? Çfarë mund t'i kërkosh një guri që s'mund ta pastrojë as pluhurin nga koka dhe supet e tij? A meriton të adhurohet statuja, e cila as mizën trazovaçe s'mund ta largojë kur i fluturon mbi fytyrë?

Bir i dashur, ky është heroi i tregimit tonë. Ky është i riu trim dhe me mendje të kthjellët, i riu të cilin Allahu i Lartësuar e kishte frymëzuar të meditonte rreth krijimit të qiejve dhe të tokës, i riu që kundërshtonte adhurimin e idhujve, njeriu të cilin Allahu e zgjodhi për mik dhe i dhuroi pejgamberinë. *"Ne i dhamë Ibrahimit që herët të mbarën, sepse Ne e kemi njohur mirë atë."*

## Me prindin

Biri im! Kur Ibrahim i arriti pjekurinë, Allahu i Lartësuar i dhuroi atij dituri të gjerë, mbasi në këtë mënyrë shpërblehen mirëbërësit. Allahu i Madhëruar i dhuroi pejgamberinë. I shpalli se nuk meriton të adhurohet askush përveç Allahut, se nuk ka Zot tjetër veç Tij dhe se nuk ka asgjë të ngjashëm me Të. Pastaj e urdhëroi t'ia përcillte këtë lajm njerëzve që e rrethonin. Njeriu i parë, të cilin e thirri Ibrahim në rrugën e shpëtimit ishte babai i tij, Azeri. I dhimbsej teksa e shihte duke ju lutur gurëve që i gdhendte me duart e tij, gurëve pa jetë që nuk sillnin dëm dhe as dobi. Për më tepër, frikësohej për fundin e hidhur të babait. A nuk është zjarri vendbanimi i idhujtarëve? Një ditë iu afrua babës dhe me butësi i tha:

*"O babushi im, pse adhuron atë që nuk dëgjon, që nuk sheh e as që mund të sjellë kurrfarë të mire?"*

*"O babush, mua më është dhënë dituria, e cila nuk të është dhënë ty, prandaj më paso mua, se unë do të udhëzoj në rrugën e drejtë."*

*"O babush, dije se shejtani është ai që po të shtyn të adhurosh gurët dhe kam frikë se do të godasë Mëshirëploti me dënim, nëse vazhdon t'i lutesh këtyre statujave pa jetë."*

Bir i dashur! Ibrahimin, alejhis-selam, Allahu i Madhëri-shëm e ka përzgjedhur në mesin e të gjitha krijesave për mik të ngushtë si pasojë e zemrës së pastër dhe moralit të lartë që kishte ai. Nëse pason besimin e tij dhe stolisesh me moralin e tij, do të bëhesh nga të dashurit e Allahut, o bir. Ndaj, le të jetë Ibrahim shembull për ty nëse kërkon të arrish sukses.

Si pasojë e moralit të lartë, Ibrahim, alejhis-selam, asnjëherë nuk e thirri të atin në emër. Për më tepër, e këshilloi babain e tij urtë e butë. I shpjegoi kotësinë e adhurimit të idhujve, i tregoi rrugën e drejtë. Ia bëri të qartë se pas idhujtarisë fshihet padituria dhe se e vetmja rrugë shpëtimi është pasimi i njerëzve të ditur. I tregoi të atit se Allahu i kishte dhuruar dituri të gjerë dhe e kishte përzgjedhur si Pejgamber. Ia bëri me dije se ai që nuk e pason Pejgamberin është pasues i shejtanit, prandaj mund ta godasë dënimi i Allahut. Megjithatë Azeri në vend që të ndikohej nga fjalët e të birit dhe të pasonte rrugën e tij, shfaqti mosbesimin e fshehur thellë në zemër. Jo vetëm kaq, por e kërcënoi Ibrahimin, alejhis-selam, dhe u përpoq ta frikësonte atë.

*"O Ibrahim!", iu drejtua me inat të birit, "A i urren ti zotat e mi? Nëse dëgjoj se tallesh dhe i fyen ata, do të mbys me gurë, prandaj largohu prej meje dhe më lër të qetë."*

Por Ibrahim, përkundër inatit dhe zemërimit të të atit, iu drejtua përsëri me dhembshuri dhe fjalë të ëmbla.

*"Paqja qoftë mbi ty!", i tha djaloshi, "Do ta lus Allahun, Zotin tim të t'i fali gabimet."*

A nuk e dëgjove se si komunikonte me të atin?! Ndërkohë që babai i tij ishte mosbesimtar që u lutej idhujve, Ibrahim,



alejhis-selam, e përkëdhel me fjalë të buta. Po ty, o bir, a të ka hije të sillësh ashpër me prindërit e tu, ndërkohë që janë besimdrejtë e mundohen veçse për mirë?!

## Dielli, hëna dhe yjet

Pas ngjarjes me të atin Ibrahim, alejhis-selam, nuk e braktisi detyrën me të cilën e kishte ngarkuar Allahu Fuqplotë, por me trimëri filloi t'i thërrasë banorët e qytetit të tij në fenë e drejtë. Dilte në mesin e tyre dhe me mendjemprehtësi dialogonte me ta. Ibrahim ishte i Dërguar i Allahut dhe asnjëherë nuk dyshonte në ekzistencën e Krijuesit të vërtetë. Një natë, ndërsa ishte në mesin e adhuruesve të yjeve, ngriti shikimin nga qielli dhe iu drejtua të pranishmëve: *"Sa madhështor ky yll që shkëlqen në errësirën e natës! Ky duhet të jetë zoti im!"*

Djalosh! Ibrahim ishte i bindur se Zoti i tij është Allahu i Madhërishëm, por synonte që nëpërmjet dialogut t'i bindte të pranishmit për besimin e tyre të gabuar... Prandaj sapo zbardhi agimi, atëherë kur yjet e humbën ndriçimin dhe u venitën në qiell, iu drejtua atyre që kishte përreth dhe u tha: *"Unë nuk e dua një Zot të tillë. Si mund t'i lutem një Zoti që humb dhe zhduket?"* Ibrahim, alejhis-selam, kishte për qëllim që nëpërmjet fjalëve të tij njerëzit ta kuptonin se yjet nuk janë Zot dhe se adhurimi i tyre është i kotë. Sa i zgjuar ishte Ibrahim, alejhis-selam!

Një natë tjetër, ndërsa adhuruesit e hënës pritnin me padurim shfaqjen e saj, doli në mesin e tyre. Sapo filloi hëna të ndriçonte në qiellin pa fund, Ibrahim, alejhis-selam, thirri me të madhe: *"Ky duhet të jetë Zoti im!"* Kur i tha këto fjalë, njerëzit rreth tij buzëqeshnin të gëzuar. Një adhurues më shumë në mesin e tyre! Por sapo mbërriti mëngjesi Ibrahim, alejhis-selam, iu drejtua dhe u tha: *"A një Zot që zhduket të*

*adhuroj? Një Zot që nuk i bën ballë as dritës së mëngjesit? Jo, jo. Ky nuk është Zoti im.” Në ato moment adhuruesit e hënës u hutuan. Si t’i përgjigjeshin vallë? Të dëshpëruar u larguan, pa mundur të thonin qoftë edhe një fjalë të vetme. Ibrahim i në këtë mënyrë synonte t’ua bënte të qartë njerëzve se yjet dhe hëna janë thjesht trupa qiellorë që shfaqen dhe zhduken me urdhrin e Zotit të tyre dhe jo Zota për t’u adhuruar. Një ditë shkoi tek vendi ku mblidheshin adhuruesit e diellit dhe thirri me të madhe: “Dielli duhet të jetë Zoti im, mbasi dielli është më i madhi!” Nerëzit rreth tij u gëzuan. Një adhurues më shumë në mesin e tyre! Por në momentin kur dielli perëndoi, iu drejtua njerëzve duke i thënë: “A një Zot që perëndon dhe zhduket të adhuroj? Një zot që e mposht errësira e natës?” Të gjithë të pranishmit u hutuan. Sa shumë u dëshpëruan! Atëherë Ibrahim i zemërtrim u tha: “O populli im ! Unë nuk adhuroj atë që adhuroni ju. Unë adhuroj vetëm Allahun që krijoi qiejt dhe tokën, jam larg besimeve të kota dhe nuk jam prej idhujtarëve!”*

Biri im, ku ta gjesh yllin apo hënën nëse ke nevojë për ndihmën e tyre gjatë ditës? Ku do ta gjesh diellin nëse i frikësohesh natës? Kujt mund t’i lutesh në errësi? Askujt veç Allahut, Zotit të yjeve, hënës dhe diellit, sepse Allahu është i përhershëm dhe nuk zhduket asnjëherë. Lutju Allahut që është i Gjallë, i Përhershëm dhe nuk vdes kurrë! Kërko ndihmë nga Allahu, sepse Ai është i Plotfuqishëm për çdo send! Allahun nuk e mposht as dita dhe as nata. Prandaj vetëm Atij t’i lutesh sepse vetëm Ai mund të të ndihmojë. Mirëpo shumicës së babilonasve nuk i bënë dobi faktet që u solli Pejgamberi i nderuar. Vazhdonin adhurimin e trupave qiellorë natën dhe ditën. Nuk i përfillën argumentet logjike që u shpalosi i riu fisnik. Megjithatë Ibrahim i nuk u ligështua aspak. Përkundër inatit dhe mendjemadhësisë së tyre thërriste pa ndërprerë në fenë e vërtetë, i thërriste natë e ditë në adhurimin e Allahut të Lartësuar, të Vetëm dhe të Pashoq.

## Nemrudi

Lajmi për djaloshin besimdrejtë filloi të përhapej me të shpejtë në qytet. Kudo përmendej emri i tij... Djaloshi që adhuron Allahun... Djaloshi, që nuk i përkulet askujt, përveç Allahut... Asokohe Babilonia sundohej nga njëfarë mbreti që e mbante veten me të madhe. Nemrud i thonin... Pushteti dhe pasuria ia rriti mendjen aq shumë, saqë, në vend që të falënderonte Allahun për këto mirësi, u mbajt me të madh dhe e quajti veten zot. Prandaj, me të dëgjuar tregimin për djalin që nuk i përkulej askujt veç Allahut, u hidhërua dhe urdhëroi që t'ia sillnin. Kur e lajmëruan se Nemrudi dëshiron të takohet me të, djali u nis menjëherë drejt pallatit mbretëror. Ai nuk i frikësohej takimit me mbretin aspak. E si mund t'i frikësohet mbretit ai, që ka me vete ndihmën e Allahut, Mbretit të tokës dhe qiejve? Sapo mbërriti para pallatit mbretëror, rojet ia hapën portat e larta prej druri dhe e shoqëruan në sallën e madhe ku e priste mbreti, i cili nuk i uroi as mirëseardhjen Ibrahimit alejhis-selam, por me inat dhe përçmim ju drejtua: *"Kush na qenka ky Zoti yt, o djalosh? A nuk e di ti se unë jam sunduesi i Babilonisë? A nuk e di ti se un jam zoti dhe bëj ç'të dua? Pse nuk më përulesh edhe ti siç bëjnë babilonasit?"* Plot guxim dhe trimëri, Ibrahim, alejhis-selam, e ngriti kokën dhe, duke e vështruar në sy, i tha mbretit: *"Zoti im është Allahu, Ai, i cili jep jetën dhe vdekjen, ndërsa ti je njeri si gjithë të tjerët, prandaj nuk meriton të adhurohesh."* Nemrudi u habit me guximin e djalit dhe filloi të shtirej si i plotfuqishëm në sytë e të pranishmëve. *"Posi, posi... Edhe unë jap jetë dhe vdekje."* - tha ai. Dhe menjëherë urdhëroi që t'i sillleshin dy të burgosur... Sapo ia sollën, urdhëroi të vritej njëri dhe ashtu u bë, ndërsa për tjetrin urdhëroi që të lirohej nga burgu dhe e liruan. *"A nuk e sheh o djalosh?"* - tha mbreti. *"A nuk e kuptove se edhe unë ja jap jetën dhe vdekjen kujt të dëshiroj?"*

Bir i dashur! Në të vërtetë Nemrudi nuk solli as jetë dhe as vdekje, por thjesht një babilonasi të burgosur, në saje të pushtetit si mbret, i dha lirinë, ndërsa tjetrit, në saje të mendjemadhësisë, urdhëroi t'i pritej koka. Në atë moment Ibrahimiu iu drejtua Nemrudit duke i thënë: *"Meqë ti bën ç'të duash o mbret dhe askush nuk mund të të pengojë dhe as t'i thyej urdhërat e tua, meqë jep jetën dhe vdekjen, atëherë sille diellin nga perëndimi pasi Allahu e sjell atë nga lindja! A nuk të nënshtrohet ty çdo gjë? A nuk je ti sunduesi i vërtetë?"* Heshtja mbuloi sallën e madhe mbretërore... Po tani? Mbreti u hutua. Si t'i përgjigjej djalit? Askush nuk fliste. ...Nemrudi u turpërua përpara të gjithëve. Ra heshtje e rëndë si plumbi. Tashmë nuk mund të gjente fjalë që t'i kundërvihej Ibrahimit. Të gjithëve ju bë e qartë se mbreti i tyre nuk është veçse një krijesë e dobët dhe jo një Zot madhështor siç mendonin për të dikur. Kështu djaloshi u largua me krenari duke e lënë sundimtarin me kokën ulur në mesin e njerëzve. Mbreti jobesimtar mbeti i hutuar.

## Idhujt

Pasi ia kishte bërë të qartë babilonasve kotësinë e adhurimit të yjeve, hënës, diellit dhe kotësinë e adhurimit të mbretit, Ibrahimiu, alejhis-selam, mezi priste të bënte diçka të tillë edhe me idhujt. Për këtë qëllim u ngrit një ditë në mesin e idhujtarëve dhe për t'ia nënçmuar idhujt iu drejtua duke i thënë: *"Çfarë adhuroni me kaq përulje vallë?"* "Adhurojmë idhujt", iu përgjigjën njëzëri: *"dhe u jemi besnikë atyre."* "A ju dëgjojnë idhujt kur i luteni?", i tha Ibrahimiu, *"Apo ndoshta ju sjellin dëm ose dobi?"* "Jo, jo", ia kthyen të habitur, *"por ky është zakoni i prindërve tanë."* Arsyetimi i tyre i vetëm ishte se kështu kishin vepruar të parët e tyre dhe asgjë më tepër. E pranuan se idhujt nuk e dëgjonin lutjen dhe se nuk sillnin dëm apo dobi, por me këtë veprim idhujtarët thjesht imitonin të parët e tyre të paditur.

Biri im! Le të jenë Kur'ani dhe Pejgamberi Muhamed, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, udhërrëfyesit tuaj për sa të jesh gjallë. Mos u shko pas fjalëve, tregimeve apo zakoneve të të tjerëve, qofshin ata edhe të parët e tu, nëse diçka e tillë është në kundërshtim me atë që na mëson Kur'ani dhe Pejgamberi. Nëse u jep të tjerëve përparësi ndaj udhëzimeve të Pejgamberit, do ta humbësh rrugën e drejtë. A nuk e dëgjove se ç'u ndodhi popullit të Nuhut, Hudit dhe Salihut?! Po pse vallë e gjithë kjo fatkeqësi? E gjitha kjo u erdhi atëherë kur i dhanë përparësi zakoneve të të parëve të tyre ndaj porosive dhe këshillave të Pejgamberit. Ndaj kij kujdes!

Kur e dëgjoi përgjigjen që i dhanë, Ibrahim i tha: *"A nuk e shihni se çfarë adhuroni ju dhe baballarët tuaj?"* *"Dijeni mirë pra, se këta idhuj që adhurohen janë armiqtë e mi"*, ngriti zërin djalosht me guxim: *"përveç Zotit të botërave, pasi Ai më krijoi dhe më udhëzoi. Ai më furnizon me ushqim dhe pije nga qielli dhe toka. Ai më shëron kur sëmurëm. Në dorën e Tij është jeta dhe vdekja ime. Zoti im ka fuqi t'më ringjallë pasi të kem vdekur... Flisni! Flisni, pra! A ka të ngjashëm me Zotin tim?"* Në këtë mënyrë djalosht besimdrejtë i shpalosi popullit të tij fuqinë e Allahut dhe kotësinë e idhujve, që sikur të kishin mundësi të sillnin ndonjë dëm apo të bënin diçka, me siguri do ia bënin Ibrahimit, alejhis-selam. Megjithatë idhujtarët ia kthyen me inat: *"A mos po talleh me ne? Kush je ti që fyen të parët tanë duke i nënçmuar zotat e tyre?"* Mjerë për ta! Rruga e shpëtimit ndriçohet me argument dhe jo me emra. A mos është udhëzimi në rrugën e drejtë pronë e të parëve?! Kur e pa djalosht kokëfortësinë dhe inatin e tyre u zotua në vetvete se një ditë do t'i thërmonte të gjitha statujat e adhuruara me të padrejtë nga populli i tij. Me këtë veprim do të shpalosej njëherë e mirë kotësia dhe paaftësia e idhujve.

Babilonasit vit për vit mblidheshin përreth brigjeve të Euf-ratit dhe festonin për nder të idhujve. Me të mbërritur dita e

shumëpritur e festës, Azeri e ftoi të birin që të merrte pjesë, mirëpo Ibrahim, alejhis-selam, i tha se ishte i sëmurë. Kjo ishte dita që priste ai. Sapo u larguan babilonasit nga qyteti, djaloshi mori një sëpatë me të djathtën e tij dhe u nis drejt tempullit ku rreshtoheshin idhujt. Kur arriti pranë tempullit u habit pa masë. Ç'të shihte! Lloj-lloj ushqimesh të vendosura nga idhujtarët përpara statujave prej guri, si flijim për ta. Mendonin se në këtë mënyrë idhujt do t'ia shtonin pasurinë. Djaloshi iu afrua statujave dhe me nënçmim i tha: *"Pse nuk po hani? Ç'keni? Pse nuk flisni?"* Pasi nuk mori asnjë përgjigje nga idhujt filloi t'i godasë njërin pas tjetrit duke i thërmuar që të gjithë, me përjashtim të idhullit më të madh në dorën e ngurtë të të cilit e vari sëpatën e hekurt. Pas këtij veprimi djaloshi u largua me të shpejtë që të mos shihej nga askush... Nuk kaloi shumë dhe banorët e qytetit u kthyen. Sipas zakonit, pas festës, të gjithë së bashku mblidheshin rreth tempullit për t'iu lutur idhujve dhe për t'i adhuruar ata. Por ç'të shihnin! Ngelën të shtangur. Nuk u besonin syve. Të gjithë zotat e thërmuar me përjashtim të njërit. Sikur të ishin zota, a mund t'i dëmtonte ndokush? Edhe sikur të donte t'i thërmonte, a nuk mund të mbroheshin vallë? Ah, sikur të kuptonin! Pikëllimi dallohej qartë në fytyra. Shumë prej tyre qanin, të tjerë u binin fytyrave me shuplaka dhe një grup nga mesi i tyre klithnin me inat: *"Kush veproi kështu me zotat tanë? Me të vërtetë ai është kriminel!"* Disa nga të pranishmit u kujtuan se vetëm Ibrahim mund ta bënte diçka të tillë dhe thanë: *"A nuk e keni dëgjuar se si i fyente idhujt djaloshi i Azerit?"* *"Silleni atë në mesin tonë menjëherë"*, tha një grup, *"që ta pyesim për ngjarjen."* Pikërisht këtë synonte djaloshi, të mblidheshin të gjithë njerëzit dhe t'ua bënte të qartë një herë e mirë kotësinë e statujave pa jetë që i adhuronin në vend të Allahut. Çdo gjë shkoi siç e kishte planifikuar Ibrahim, alejhis-selam. Pasi e sollën përpara turmës së njerëzve iu drejtuan duke i thënë: *"A mos je ti ai që i ka thyer zotat tanë?"* *"Jo,"* tha Ibrahim alejhis-selam, *"por me sa shoh, i paska thyer ky*



idhulli i madh, i cili paska sëpatën në dorë. Gjithsesi, pyesni idhujt se mbase jua tregojnë ata fajtorin?” Të pranishmit u befasuan nga fjalët e djalit. E dinin se idhujt e thyer janë gurë që as nuk flasin dhe as nuk dëgjojnë dhe i tillë është edhe idhulli i madh. U zhytën në mendime dhe filluan të dyshojnë në besimin tek idhujt. E kuptuan se besimi në idhuj është i kotë, por nga inati dhe mendjemadhësia nuk e pranuan të vërtetën dhe i thanë Ibrahimit: “Si kërkon vallë t’i pyesim kur idhujt nuk flasin?” Në atë moment Ibrahim i ia ktheu: “Atëherë si mund të adhuroni këto statuja që nuk mund t’ju sjellin dëm dhe as dobi? Si mund ta adhuroni gurin e gdhendur nga duart tuaja? Si i luteni idhujve kur ata s’e dëgjojnë kërkesën tuaj? Përse nuk logjikoni?” Heshtja dhe hutia kaploi turmën... Nuk u mbeti tjetër veç të përdornin forcën për të mbrojtur besimin e tyre të gabuar. “Përgatitni një zjarr,” thanë të pranishmit, “dhe kur të ndizet flakë, hidheni djalin në të.” Me të shpejtë filluan të mbidhnin drurë, të cilët i vendosën brenda një grope të thellë, me qëllim që kur të hidhej Ibrahim, mos të kishte asnjë mundësi shpëtimi. E sollën edhe një katapultë që e vendosën larg zjarrit, i cili tashmë kishte filluar të ndizej fort dhe të nxirrte shkëndija. Një zjarr i tillë nuk ishte parë ndonjëherë. E lidhën djalin besimdrejtë dhe e vendosën mbi katapultë me qëllim që ta hidhnin nga larg në zjarr dhe të digjej për së gjalli. Ndërkohë Ibrahim përmendte Allahun pa pushim dhe kur e vendosën mbi katapultë, tha: “Më mjafton Allahu, se Ai është mbrojtësi më i mirë.” Ishte i bindur se Allahu i Plotfuqishëm do ta ndihmonte. A nuk e ndihmon Allahu atë njeri që e ndihmon fenë e Tij?! Dhe me të vërtetë ashtu ndodhi. Në momentin kur e hodhën, Allahu i Lartësuar e urdhëroi zjarrin dhe i tha: “O zjarr! Bëhu i ftohtë dhe shpëtim për Ibrahimin!” Sapo ra në zjarr, flaka e tij nuk e dogji aspak... E pamundur! Babilonasit u mahnitën. Askush nuk i besonte syve... Ibrahim, alejhisselam, qëndronte i qetë në mesin e prushit dhe gacave të zjarrit sikur të ishte mbi barin e një kopshti të gjelbëruar. Ndërkaq ata e ndjenin

nxehhtësinë e zjarrit mbi lëkurën e fytyrave të tyre që nga larg. Allahu është më i Madhi! Idhujtarët dëshiruan të lartësohen, por Allahu i rrëzoi; dëshiruan të ngadhënjejnë, por Allahu i poshtëroi.

Biri im! Ruaje fenë e Allahut! Ruaje fenë e vërtetë! Ruaje Islamin, se Allahu i Lartësuar do të të ruajë ty! Ndhimjoje fenë me mish e me shpirt, sepse Allahu do të të ndihmojë ty në momentet e vështirësive! Lute Allahun e Madhërishëm dhe përmende sa më shumë Atë, sepse do ta kesh përherë pranë ndihmën dhe përkrahjen e Tij! Dhe dije se askush nuk mund të të ndihmojë dhe as të të dëmtojë veçse nëse dëshiron Allahu, ndaj përmirësoji marrëdhëniet e tua me Allahun duke u kujdesur për pesë namazet dhe për leximin e vazhdueshëm të Kur'anit Fisnik...

Megjithatë, përkundër mrekullisë që e dëshmuar me sytë e tyre, askush nuk i besoi Ibrahimit, përveç një grupi të vogël në mesin e të cilëve ishte një i ri që quhej Lut, të cilit Allahu do i dhuronte pejgamberinë dhe një vashë me emrin Sara. Pas kësaj mrekullie ata besuan në Allahun, u bindën se Ibrahim, alejhis-selam, ishte i Dërguari i Tij dhe u bënë pasues të djalit besimdrejtë.

## Hixhreti

Për shumë kohë Ibrahim, alejhis-selam, e thirri popullin e tij në adhurimin e Allahut të Lartësuar dhe në braktisjen e idhujve, por ata nuk iu përgjigjën. Në këto kushte Allahu i Lartësuar e urdhëroi Ibrahimin, alejhis-selam, të udhëtonte drejt tokave të shenjta, drejt Palestinës. Nisi shpërngulja e Ibrahimit nga Babilonia drejt Palestinës. Braktisi vendlindjen, të afërmit, pasurinë dhe çdo gjë që kishte për t'u larguar drejt një toke ku mund të adhuronte Allahun i lirë. Tashmë nuk ishte i vetëm.



Bashkë me të udhëtonin edhe një grup i vogël që i kishin besuar, në mesin e të cilëve ishte edhe Sara, që i ish bërë bashkëshorte dhe Luti. Rruga drejt tokës së shenjtë ishte e gjatë dhe e mundimshme. Ibrahim, alejhis-selam, dhe besimtarët shpërnguleshin nga një qytet në tjetrin, derisa pas shumë e shumë kohësh mbërritën në tokën e premtuar. Më në fund! Mbërritën në Palestinën aq shumë të ëndërruar, mbërritën në tokën e bekuar, të cilën fise të panjohur për ta e kishin trashëguar brez pas brezi. Me të mbërritur në tokën e shenjtë kërkuan leje të jetonin aty dhe të ndërtonin një shtëpi banimi në mesin e shtëpive të thjeshta prej guri dhe qerpiçi. Pasi iu dha leje, ia filluan punës për ndërtimin e saj. Nga Babilonia në Palestinë, nga shtëpitë e stolisura dhe rrugët me kalldrëm në fqinjësi me fisin zemërgjerë nën çatinë e një banese të thjeshtë...

Bir i dashur! Është shumë e rëndësishme për ty të dish se toka ku shkel nuk e fisnikëron njeriun. Në Palestinë jetofsh apo kudo qoftë, të jesh i bindur se njeriun e fisnikërojnë punët e mira. Ndaj të jesh punëmirë kudo që të shkosh, o biri im i dashur, në mënyrë që të të lavdërojnë banorët e qiellit e të jesh i nderuar në tokë.

## Në Egjipt

I Dërguari i Allahut qëndroi në Palestinë për një kohë të gjatë, deri kur tokën e goditi thatësira dhe u përhap varfëria, kështu që banorët e vendit u detyruan të emigrojnë drejt viseve të largëta. Ndër ata që u larguan nga Palestina ishin edhe Ibrahim me bashkëshorten e tij. Së bashku me Sarën u shpërngulën në tokat pjellore të Egjiptit. Pasi u vendosën atje, morën vesh se mbreti egjiptian ishte një njeri mendjemadh dhe i padrejtë, sa herë ndonjë vashë e re dhe e hijshme kalonte pranë pallatit mbretëror ai urdhëronte që të merrej me forcë si skllave dhe jo vetëm kaq, por jepte urdhër të ekzekutohej

edhe bashkëshorti i saj. Burrë e grua u munduan të ishin mjaft të kujdesshëm në mënyrë që të mos binin në sy, por një ditë i vuri re një roje e pallatit, i cili nxitoi ta lajmëronte mbretin për bukurinë dhe hijeshinë e Sarës. Sapo mori vesh për lajmin, mbreti dha urdhër që t'i sillej shoqëruesi i saj, Ibrahimimi. U zbatua urdhri i tij menjëherë. Ushtarët e mbretit zbuluan shtëpinë e Ibrahimimit dhe pasi u takuan me të e urdhëruan t'i ndiqte pas deri në pallatin mbretëror. Kur ia sollën përpara syve dhe bisedoi për njëfarë kohe me të, mbreti e pyeti: *"Kush është vasha me të cilën shoqërohesh?"* *"Ajo është motra,"* ia ktheu Ibrahimimi, *"është motra ime."* Në atë rast mbreti i padrejtë ja nguli sytë Ibrahimimit, alejhis-selam. E shihte në sy me kujdes në mënyrë që ta friksonte dhe pasi nuk vuri re asgjë të dyshimtë tek sytë e Ibrahimimit, dha urdhër që të lihej i lirë dhe ashtu u bë. Me të dalë nga pallati i sundimtarit, Ibrahimimi shpejtoi drejt banesës së tij. Sapo mbërriti ja tregoi ngjarjen të shoqes. Iu drejtua asaj dhe i tha me një frymë: *"O Sarë! Mbreti më pyeti për ty dhe unë i thashë se je ime motër. Me të vërtetë ti më je motër në besim, o gruaja ime, prandaj mos ia moho këtë fakt nëse të pyet edhe ty."* Kështu mbreti urdhëroi që t'ia sillnin Sarën. Pasi e sollën në pallat e lanë të priste krejt e vetmuar në dhomën e mbretit që nuk vonoi shumë. Me ta shikuar gruan, u mahnit me bukurinë e saj dhe u afrua që t'ia hiqte mbulesën që mbante në kokë dhe të prekte trupin e saj, por dora nuk iu bind. Mbreti u frikësua pa masë dhe iu drejtua Sarës: *"Lute Zotin tënd të ma shërojë dorën mbasi nuk do të bëj asgjë."* Ajo u lut dhe Allahu e shëroi. Mirëpo ai tentoi ta prekte përsëri, por dora përsëri nuk iu bind, prandaj përsëri i tha: *"Lute Zotin tënd të më shërojë mbasi nuk të bëj asgjë."* Ajo përsëri u lut dhe Allahu e shëroi, por përsëri iu afrua Sarës duke e thyer premtimin që i dha. Kur iu ndal dora për të tretën herë, mbreti e kuptoi se është e pamundur t'i afrohej gruas, ndaj iu drejtua shërbëtorëve: *"Nuk më paskeni sjellë tjetër veçse një shejtan. Kthejeni mbrapsht dhe dhurojani shërbëtoren time,*

*Haxheren.*” Kur e kthyen Sarën në shtëpi, Ibrahimin e gjeti në namaz. Pasi e përfundoi namazin, e përqafoi gruan e tij dhe i tha: “Si shkoi? Çfarë ndodhi? “Allahu e mposhti kurthin e mbretit o burri im”, tha ajo, “Prandaj ma dhuroi edhe Haxheren për shërbëtore.” Sapo i dëgjoi fjalët e të shoqes, Ibrahim, alejhis-selam, e lavdëroi dhe e falënderoi Allahun e Lartësuar për mirësinë dhe nderin që i kishte dhënë duke ja kthyer gruan e tij të pastër dhe të nderuar.

O bir! Kush tjetër veç Allahut i përgjigjet nevojtarit duke ja larguar të keqen dhe duke e bërë ngadhënjimtar në mesin e të padrejtëve? A ka ndihmëtar të tjerë që krahasohen me Të? Nuk ka, por njerëzit nuk logjikojnë... Prandaj vare vath në vesh këtë që po të ta them: “Ruaje fenë e Allahut në mënyrë që Allahu të të ruaj ty atëherë kur të kesh nevojë!” Përkujtoje Allahun në rehati në mënyrë që Allahu të të ndihmojë në vështirësi, ashtu siç i ndihmoi Sarën dhe Ibrahimin alejhis-selam!

## Toka e Ken'anëve

Gjatë qëndrimit në Egjipt, Ibrahim, alejhis-selam, i ftonte vendasit në fenë e drejtë dhe punonte pa u lodhur që të mbante familjen e tij. Kur i siguroi të ardhura të mjaftueshme, u përgatit edhe një herë për udhëtim. I kishin ardhur lajme se në Palestinë thatësira ishte larguar dhe gjendja e tokës ishte përmirësuar... Më në fund! Pas shumë kohësh u nis edhe një herë drejt tokave të Ken'anëve në Palestinë. U nis drejt tokës së shenjtë, që shumë e donte. Këtë radhë nuk ishte vetëm me Sarën, por me vete mori edhe shërbëtoren egjiptiane, e cila kishte pranuar islamin dhe do ishte bashkëshortja e tij në të ardhmen.

## Ismaili

Pas një udhëtimi të gjatë e të lodhshëm Ibrahimimi së bashku me familjen e tij mbërritën në tokat e bekuara të Ken'anëve. Gëzimi shihej qartë në fytyrën e tij. Më në fund në Palestinë! Pasi ju dha leje nga vendasit, Ibrahimimi, me të ardhurat që kishte, bleu një tokë edhe më të madhe dhe iu përkushtua punës për furnizimin e familjes së tij. Pas kthimit nga Egjipti, Allahu i dhuroi mikut të Tij një jetë të qetë dhe të sigurt. Kohët kalonin. Pleqëria afrohej gjithnjë e më shumë dhe bashkëshortja e Ibrahimit, Sara, i kishte humbur shpresat se mund të lindte fëmijë. Kjo gjë e mundonte shumë gruan fisnike, prandaj i propozoi burrit të saj të martohej me Haxherën, e cila ishte besimtare e sigurtë dhe e përkushtuar, për më tepër ishte e re dhe e shëndetshme e, ndoshta, prej saj Allahu do i dhuronte atij pasardhës që do e lumturonin dhe do ia zbukuronin pleqërinë. Iu afrua një ditë bashkëshortit dhe i tha: *"Meqë unë jam e thyer në moshë dhe Zoti nuk më fali pasardhës, atëherë ti martohu me robëreshën time, o Ibrahim, se ndoshta Allahu do të dhurojë fëmijë nga ajo!"* Ibrahimimi, alejhis-selam, u pajtua me mendimin e gruas së tij dhe u martua me Haxherën. Me lejen e Allahut, Haxherja pas disa muajsh lindi një djalë të bekuar, një fëmijë të butë, që e quajtën Ismail. Sa u gëzua Ibrahimimi! Një fëmijë pas shumë e shumë vitesh... Sapo kthehej në shtëpi, pyeste për Ismailin, e vendoste në prehër, luante me të ashtu siç luan prindi me fëmijën kur e takon pas një ndarjeje të gjatë. Gëzimi dhe lumturia nuk përshkruhej dot. Mirëpo lumturia në këtë botë kalon shpejt. Ditët pasonin njëra tjetrën. Sara, teksa shihte përkujdesjen e të shoqit për Haxheren dhe për Ismailin e vogël, filloi të xhelozonte aq shumë saqë i kërkoi të shoqit t'i largonte nënë e bir nga banesa e saj.

## Për në Mekë

Megjithëse kjo e rëndoi Ibrahimin alejhis-selam, ai e pranoi kërkesën e së shoqes. A nuk ishte Sara ajo që i kishte besuar thirrjes së tij atëherë kur askush nga babilonasit nuk e kishte bërë diçka të tillë? A nuk ishte Sara ajo që e kishte shoqëruar Ibrahimin kur ishte larguar nga vendlindja? A nuk e kishte braktisur familjen dhe pasurinë e saj për të pasuar të Dërguarin e Allahut? A nuk ishte Sara ajo që e ndihmonte për vite me radhë të shoqin teksa përballej me dallgët e jetës? Për mbarëvajtjen familjare Ibrahim vendosi ta largonte Haxheren bashkë me të voglin e saj drejt një vendbanimi tjetër. Për më tepër, Ibrahim alejhis-selam ishte i bindur se Allahu do e ndihmonte ashtu siç e kishte ndihmuar për tejkalimin e pengesave të shumta gjatë jetës së tij. Kështu, iu drejtua Allahut me lutje ta ndihmonte. Kush i përkushtohet Allahut, Allahu e ndihmon atë dhe e furnizon nga nuk e pret.

Biri im, le të jetë qëllimi i yt në jetë përkushtimi ndaj fesë së Allahut të Lartësuar! Mos kij frikë! Të jesh i bindur se kush i përkushtohet Allahut të Madhërishëm, Allahu e ndihmon atë. Kush i frikësohet Allahut, atij Allahu ja lehtëson punët. Kush i mbështetet Allahut, Allahu i mjafton atij.

Nuk kaloi shumë dhe Ibrahimit i zbriti shpallja. *"Të udhëtosh së bashku me familjen tënde drejt një lugine pa bimë, drejt shtëpisë së shenjtë!"* Me t'i zbritur shpallja u përgatit për udhëtim. Rruga për tek lugina e premtuar ishte e gjatë, prandaj, pasi mori ushqimet dhe pijet e nevojshme, shaloi kafshën bartëse dhe u nis për udhëtim. Së bashku me Haxheren dhe Ismailin e vogël ecnin pa u ndalur drejt viseve të panjohura për ta. Rruga ishte e gjatë dhe e mundimshme. Me kalimin e ditëve burri e grua u detyruan të përballen me nxehtësinë e madhe të shkretëtirës si e si të arrinin sa më shpejt në luginën pa ujë e pa bimësi. Pas disa ditësh udhëtim, kur arritën në një

luginë të shkretë, Ibrahimit i erdhi shpallja se mu në këtë vend duhet ta linte bashkëshorten dhe djalin e tij... I zbriti nga kafsha nënë e bir. Pastaj zbriti edhe ato pak ushqime dhe pije që kishin mbetur, e përqafoi të birin me dhembshuri, e përshëndeti gruan e tij me përzemërsi dhe u nis për tek kafsha e udhëtimit. Kur Ibrahim, alejhis-selam, i ktheu shpinën bashkëshortes, Haxherja e pikëlluar e ndoqi nga pas dhe i tha: *"Ku po shkon, o Ibrahim? Si mund të na braktisësh në këtë luginë ku nuk ka njeri të gjallë, nuk ka ujë dhe as ushqim?"* Këto fjalë Haxherja i përsëriti disa herë, por, meqë i shoqi nuk e kthente kokën pas, atëherë iu drejtua atij duke i thënë: *"A të ka urdhëruar Allahu të veprosh në këtë mënyrë, o Ibrahim?"* "Po", ia ktheu ai, duke u munduar të fshehte fytyrën e tij. *"Atëherë pra"*, tha gruaja fisnike, *"Allahu i Lartësuar do na ndihmojë dhe nuk do jemi të humbur."* Kur u kuptoi Haxherja se Allahu i Lartësuar e kishte udhëzuar burrin e saj të ndërmernte një veprim të tillë, iu nënshtroa urdhrit dhe e la të shoqin të largohej. Ishte e bindur se Allahu nuk i humb dhe nuk i braktis robërit e Tij sado e pashpresë të dukej situata.

Biri im i dashur! Mundohu që me çdo kusht t'i zbatosh urdhrat e Allahut të Lartmadhërishtëm! Të jesh i bindur se pas urdhrave të Tij fshihet urtësi dhe mirësi e madhe. Sa Mbrojtës i mirë dhe sa Ndihmëtar madhështor është Allahu. Kush ia përforcon zemrat besimtarëve në momentet e vështirësive veç Tij? Prandaj vetëm Allahut le t'i mbështeten besimtarët.

Pikërisht në këtë tokë pa jetë fshihej *shtëpia e Allahut*, të cilën e kishte ndërtuar për të parën herë babai i njerëzimit, Ademi, për ta adhuruar Allahun pranë saj. Por me kalimin e kohëve kjo ndërtesë ishte dëmtuar aq sa nuk kishin mbetur veçse pak gjurmë nga themelet e vjetra të saj. Kjo ishte toka mbi të cilën u vendos Haxherja me foshnjën e saj... Ndërkaq Ibrahim, alejhis-selam, u largua nga Haxherja dhe i biri. Kur arriti në një kthesë nga nuk mund ta shihte gruaja e tij, u kthye nga Qabja i përmalluar. I ngriti duart për nga qielli dhe filloi të

lutej: "O Zoti i jonë! Unë një pjesë të familjes sime i vendosa në një luginë, ku nuk ka bimë, pranë Shtëpisë Tënde të Shenjtë. O Zoti i jonë! I vendosa në këtë vend që ta falin namazin, prandaj bëje të mundur që zemrat e njerëzve të mallëngjehen për ta dhe furnizoj me fruta, që të jenë mirënjohës."

## Safa dhe Merva

Ditët kalonin në të nxehtin përvëlues të shkretëtirës... Haxherja pinte atë pak ujë të mbetur në mënyrë që të ushqente më gji foshnjën e saj. Ushqim nuk kishte mjaftueshëm, po ashtu edhe uji u mbarua... Diellin përvëlues e kishin mbi koka, prandaj nuk kaloi shumë kohë dhe Ismailin e kaploi etja. Kur e pa të birin se si përpëlitej, Haxherja brofi me të shpejtë drejt një kodre që ndodhej pranë saj me shpresën se mund të shihte ndonjë udhëtar andej pari, por më kot. Askush nuk shihej në horizont. Zbriti me nxitim nga kodra dhe kur mbërriti në mesin e luginës, e ngriti rrobën e saj dhe filloi të vraponte, deri sa arriti tek një kodër tjetër jo larg të parës. U ngjit mbi të ashtu siç u ngjit mbi kodrën përpara saj, por askush nuk shihej. Shtatë herë e përshkoi Haxherja këtë rrugë duke kërkuar ujë për foshnjën e saj.

Bir i dashur! Edhe sot e kësaj dite njerëzit vrapojnë pikërisht ndërmjet këtyre dy kodrave Safa dhe Merva, tek plotësojnë ritet e haxhit në shenjë nderimi për nënën fisnike, e cila asnjëherë nuk i humbi shpresat se Allahu i Lartësuar do e ndihmonte.

## Burimi Zem-Zem

E rraskapitur nga lodhja u ngjit për të fundit herë mbi kodrën Merve prej nga dëgjoi një zë të largët... Pasi e ndali hapin, veshtoi zërin edhe një herë dhe tha: "Të dëgjova, të dë-



*gjova, a mund t'më ndihmosh?" Kur e ktheu kokën andej nga dëgjohej zëri, ç'të shihte! Një melek madhështor në mesin e dy kodrave duke gërmuar rërën e shkretëtirës me krahun e tij fisnik. Gërmonte rërën pa pushim derisa nga thellësia e tokës filloi të gufonte ujë i kthjellët dhe i ftohtë. E mahnitur, kishte shtangur në vend. Nuk i besonte syve. Burim jete në mesin e luginës së shkretë! Burim i kthjellët uji për nënën dhe djalin e saj. Ndërkaq, uji filloi të rridhte mes përmes luginës pa jetë. Menjëherë gruaja fisnike mblodhi disa gurë atypari dhe filloi ta rrethonte burimin. I vendoste gurët me të shpejtë duke thënë me zë të lehtë: "Zem... Zem, Zem... Zem. Mblidhu këtu, o ujë i kthjellët." Sa herë që merrte ujë, burimi gufonte edhe më shumë. Kur e shoi etjen dhe e ushqeu me gji foshnjën e saj, thuhet se meleku iu drejtua për ta përgëzuar dhe i tha: "Mos ki frikë se nuk do të jeni te humbur. Në këtë vend do të jetë Shtëpia e Allahut. Në këtë vend do të jetë Qabja e Bekuar." E mallëngjyer, Haxherja falënderonte Allahun e Lartësuar për mirësitë e mëdha që i kishte dhuruar asaj dhe të birit. Madhëronte Allahun për mbrojtjen dhe kujdesin që kishte treguar ndaj tyre. A nuk i mbrojti nga kafshët grabitqare dhe nga plaçkitësit që endeshin nëpër shkretëtirë? A nuk i mbrojti nga i nxehti përvëlues? A nuk i furnizoi me ujë të bollshëm prej nga nuk e pritnin? A nuk e dërgoi melekun madhështor ta ngushëllonte nënën fisnike? A nuk i mjafton pra, Allahu robërve të Tij në momentet e pikëllimit? Kush tjetër veç Allahut i përgjigjet nevojtarit kur ai thërret i pashpresë? Kush ia largon vështirësitë kur e rrethojnë nga çdo anë? A meriton të adhurohet kush tjetër veç Tij? Jo, por njerëzit shumë pak përkujtojnë.*

## *Fisi Xhurhum*

Rreth ujit që buronte me bollëk filluan të mblidheshin lloj lloj shpendësh për të shuar etjen që i kaplonte nga fluturimi



i gjatë nëpër shkretëtirën e nxehtë. Ndërkohë, në afërsi të luginës kishin ardhur një grup kalorësish nga fisi Xhurhum. Pasi u vendosën rrëzë malit për të përfitur paksa nga freskia e hijes së tij që sikur derdhej mbi rrëzë, panë një zog duke fluturuar atypari. *“Ky zog me siguri sillet rreth një burimi uji”*, tha njëri nga kalorësit, *“por ne e njohim mirë këtë luginë dhe në të nuk ka ujë.”* Gjithsesi, i dërguan dy trima nga mesi i tyre për të kontrolluar zonën përreth. Haxherja, e lodhur nga i nxehti përvëlues, as që e kishte vënë re se në drejtim të saj po afroreshin kalorës. Ndërsa kujdesej për të birin, papritmas ajo dëgjoi disa zëra të mbytur që vinin nga larg. Kush mund të ishte vallë? A mos ishin kafshë të egra? Apo disa plaçkitës që enden nëpër shkretëtirën pa fund?. Nuk kaloi shumë dhe ç’të shihte! Dy kalorës që afroreshin gjithnjë e më pranë saj. Haxherja duke shtrënguar birin e saj në gjoks ju afrua burimit. Nuk frikësohej aspak. Ishte e sigurt se pas vështirësive Allahu i Lartësuar do sillte lehtësimin për të dhe djalin e saj. Dhe me të vërtetë ashtu ndodhi. Sapo erdhën pranë saj kalorësit ndjenë dhembshuri për të dhe të habitur e pyetën se për ç’arsye ajo dhe djali i saj jetonin të vetmuar në këtë vend të shkretë. Më pas i treguan nënës fisnike se ishin dy nga kalorësit e fisit Xhurhum dhe i kërkuan leje të ngrinin çadrat e tyre përreth burimit të ndodhur përbri saj. Ndërkohë që i rrëfeu historinë e saj dhe i uroi mirëseardhjen, Haxherja i lejoi kalorësit të vendoseshin rreth burimit meqë nuk e donte vetminë në këtë tokë të largët. Pasi hapën çadrat, ata i sollën pranë burimit edhe familjet e tyre.

Biri im, që nga ajo ditë pjestarët e fisit Xhurhum asnjëherë nuk e braktisën Haxheren dhe Ismailin. Përkundrazi, i ndihmuan dhe u përkujdesën për ta ashtu siç përkujdeset nëna për foshnjën e gjirit, si përgjigje e lutjes së Ibrahimit për gruan dhe djalin e tij. Që nga ajo ditë nënë e bir jetuan të lumtur në mesin e fisit arab prej të cilëve Ismaili do mësonte gjuhën e

kulluar, moralin e lartë, trimërinë dhe gjuetinë. Pikërisht prej pasardhësve të këtij djaloshi do ishte edhe më i miri i Pejgamberëve, Profeti Muhamed, i biri i Allahut. Që nga ajo kohë lugina e Mekes filloi të banohej. Dita-ditës fise të tjera filluan të vendoseshin rreth saj, derisa shumë prej tyre filluan të ndërtonin edhe shtëpitë e para prej guri dhe balte.

## Ëndërra

Ndërsa nënë e bir jetonin të qetë në mesin e arabëve, Ibrahim, alejhis-selam, udhëtonte herë pas here nga Palestina për t'i vizituar. Lumturohej kur e shihte Ismailin tek bëlbëzonte fjalët e para, tek lëshonte shtatin, tek luante me moshatarët e tij dhe tek vraponte pas bagëtive. E falënderonte Allahun e Lartësuar që i kishte përfshirë nënë e bir me mëshirën e Tij të pafund. Kohët kalonin. Djaloshi e rriti shtatin, e mësoi arabishten e kulluar, sjellen e mirë dhe moralin e lartë, por sapo iu bë krah babait në punë u hasën me një sprovë nga e cila do mbeteshin të dalluar, të nderuar e të lavdëruar përgjithmonë. Por ç'ndodhi vallë? Një nga netët që, Ibrahim ishte për vizitë tek Haxherja, pa një ëndërr të çuditshme për të cilën nuk foli me askënd. Çudi edhe më e madhe për të ishte fakti se, sa herë që flinte, kjo ëndërr i shfaqej vazhdimisht babait të përkushtuar. Ibrahim ishte Pejgamber i Allahut, ishte miku i Tij, prandaj ajo që shihte ishte ëndërr e çiltër. A nuk janë ëndrrat e Pejgamberëve shpallje nga Allahu? U zgjua një natë nga gjumi dhe e kuptoi se kjo qe sprovë e rradhës për të. Pasi qe urdhëruar që të shoqen dhe djalin e vetëm t'i linte në shkretëtirën pa jetë, tanimë po urdhërohej ta flijonte të birin që aq shumë e donte. E kështu Ibrahim iu nënshtrua urdhrit të Allahut të Lartësuar dhe vendosi të bënte kurban të birin e vetëm ashtu siç urdhërohej në ëndërr. Sa njeri i mirë që ishte

Ibrahimi! Nuk e mashtroi të birin dhe as që e mori me dhunë për tek vendi ku ishte urdhëruar, por me dhembshuri iu drejtua atij dhe i tha: *“O biri im i dashur, kam parë në ëndërr se më duhet të të pres fytin, çfarë mendon ti, o djalë?”* Ismaili e uli kokën pastaj hodhi shikimin në sytë e përmalluar të të atit. *“O babush”,* ia ktheu me butësi, për t’ia lehtësuar të atit dhimbjen dhe për t’ia qetësuar zemrën që i rrihte fort në kraharor: *“vepro ashtu siç je urdhëruar; do të shohësh se, në dashtë Allahu, do të bëj sabër.”*

Pasi mbërritën në vendin e caktuar duke iu nënshtruar urdhrit hyjnor, Ibrahimi e shtriu të birin ashtu siç shtrihet kurban i duke ia mbështetur ballin fisnik në tokë në mënyrë që të mos e shihte të birin në sy dhe ta pushtonte dashuria prindërore. Urdhri i Allahut duhet të kryhej medoemos. I përlur nxori thikën dhe ia vendosi të birit në fyt për ta flijuar, por për çudi, tehu i mprehtë nuk priste. Sikur ndërmjet saj dhe qafës së Ismailit të ndodhej një pengesë e papërshekueshme. Ibrahimi, alejhis-selam, i mëshonte thikës për të zbatuar atë me të cilin urdhërohej, por as edhe një pikë gjaku nuk rrodhi nga qafa fisnike e të birit. Megjithatë qëllimi u arrit. U vërtetua edhe një herë përlësia e Ibrahimit, alejhis-selam. Me të vërtetë ai gjithnjë i plotësoi obligimet. Ishte i gatshëm të flijonte djalë të vetëm, ashtu siç ishte i gatshëm të flijonte vetveten duke pranuar të hidhej në zjarr, vetëm e vetëm që të arrinte kënaqësinë e Allahut të Madhërishëm... Në ato momente të vështira Ibrahimi dëgjoi blegërimën e një bagëtie që vinte nga kodra pranë tij. Hodhi shikimin anej nga vinte zëri dhe ç’të shihte! Një dash i madh, leshbardhë, me sy të zinj dhe me brirë të mëdhenj e të përdredhur duke zbritur nga kodra. *“O Ibrahim”,* iu tha: *“ti e realizove ëndrrën. Ne, me të vërtetë, kështu i shpërblejmë punëmirët. Kjo me të vërtetë ishte një sprovë e qartë.”* Sa shumë u mallëngjye Ibrahim! E falënderoi Allahun e Lartësuar

ndërkohë që kokën e të birit e shtrëngonte fort në gjoksin e tij dhe nuk e lëshonte nga gëzimi. Si pasojë e nënshtrimit dhe e durimit për t'i plotësuar me sukses urdhrat hyjnore, Allahu e dërgoi këtë dash madhështor si shpagim për Ismailin.

Biri im, tek Allahu nuk mbërrin as mishi dhe as gjaku i kurbanit, por mbërrin vepra e singertë dhe bindja e jonë ndaj Tij. Tregohu i çiltër me Allahun, o djalë, dhe mundohu me mish e me shpirt të kryesh porosinë e Tij, se do të të ndihmojë edhe atëherë kur ti mendon se nuk ka më shpresë. A nuk e dëgjove se me urdhrin e Allahut, thika nuk priste?! Dije se edhe thikat që shpesh na drejtohen ne dhe ditëve tona me lejen e Allahut, nuk do na shkaktojnë kurrfarë të keqeje përderisa të zbatojmë me kujdes ato që Zoti kërkon prej nesh. Dije, se Allahu i Lartësuar nuk ka aspak nevojë për ne dhe as për adhurimet tona, por jemi ne nevojtarë për ndihmën dhe mëshirën e Tij. Allahu s'ka nevojë për askënd ndërkohë që të gjitha krijesat pa përjashtim kanë nevojë për Të. Gjithashtu, dije se Allahu sheh në brendësi të zemrave të robërve të Tij dhe e ndihmon këdo që fsheh në gjoksin e tij bujarinë dhe çiltërsinë, ashtu siç bëri me Ibrahimin alejhis-selam... U vërtetua edhe një herë dashuria e madhe e Ibrahimit, për Krijuesin e tij. Ai e theri kurbanin me po atë thikë që u përpoq të flijonte të birin, për ta lënë këtë ngjarje përkujtim për brezat e mëvonshëm. Me të vërtetë edhe sot e kësaj dite muslimanët anë e mbanë botës therin kurban në ditën Bajramit të madh si vepër me të cilën synojnë afrimin tek Allahu i Lartësuar dhe si përkujtim për sakrificën e Ibrahimit, alejhis-selam.

## Pragu i derës

Pasi Ismaili arriti moshën madhore Allahu i Lartësuar i dhuroi atij urtësi dhe dituri. Megjithëse emri i tij përmendej anë e mbanë viseve arabe, atij nuk i interesonte aspak. E vetmja

gjë për të cilën përpiquej ishte devotshmëria nëpërmjet të cilës arrihet kënaqësia e Allahut.... Kur u rrit dhe filloi të siguronte jetesën për familje, u martua me një vashë nga fisi Xhurhum.

Ndërkohë Ibrahim, alejhis-selam, nuk i ndërpriste lidhjet me të birin. Udhëtonte nga Palestina në Meke për t'i qëndruar në krah Ismailit, edhe pse udhëtimi për tek i biri ishte i gjatë dhe i mundimshëm. E kishte zakon të qëndronte me Ismailin disa ditë dhe më pas kthehej përsëri në Palestinë. Një herë Ibrahim, alejhis-selam, erdhi ta takojë të birin, por nuk e gjeti në shtëpi. Portën e shtëpisë ia hapi bashkëshortja e Ismailit, e cila nuk e njihte plakun. As Ibrahim nuk e njihte vashën e re. I kërkoi leje të pushonte paksa në oborrin e shtëpisë së saj sapo e kuptoi se ishte gruaja e të birit. Plaku i panjohur e pyeti vashën e re për Ismailin dhe për jetesën në luginën e Mekes. Duke mos e njohur vjehrrin e saj vasha filloi të ankohej për vështirësitë e jetës në luginë. *"Dobët jemi"*, i tha vasha, *"në skamje dhe në hall të madh."* Ibrahim, alejhis-selam, e kuptoi se ajo nuk ishte gruaja e duhur për të birin. E kuptoi se ajo nuk do të mund të bënte sabër përballë vështirësive të jetës, prandaj pasi u bë gati të largohej, i tha vashës: *"Kur të kthehet burri përcillja selamin dhe thuaj atij që ta ndërrojë pragun e derës!"* Sapo u kthye nga puna Ismaili, sikur parandjeu diçka dhe e pyeti të shoqen: *"Mos na ka vizituar kush sot?"* *"Po"*, tha ajo, *"erdhi një plak, i cili më pyeti për ty. Më pyeti se si jetojmë e shumë të tjera."* *"A të la ndonjë porosi?"* *"Po"*, iu përgjigj e shoqja, *"më tha që ta përcjell selamin dhe të la porosi ta ndërrosh pragun e derës."* *"Paska qenë babai im"*, ia ktheu Ismaili, *"dhe më paska urdhëruar që të ndahem nga ti, prandaj duhet të të kthej tek të afërmit e tu."* Më pas Ismaili u martua për të dytën herë me një vashë tjetër nga fisi Xhurhum. Kaluan shumë kohë qëkur Ibrahim, alejhis-selam, nuk kishte ardhur tek i biri, i cili e priste me padurim. Një ditë, ndërsa Ismaili kishte dalur për gjueti, një plak me pamje fisnike trokiti lehtë në portën shtëpisë së tij. Ishte Ibrahim. Portën përsëri ia hapi gruaja e

të birit, e cila nuk e njohu mikun, megjithatë i uroi mirëseardhjen dhe i dha leje të hynte. Ibrahim, alejhis-selam, e kuptoi se ishte bashkëshortja e Ismailit prandaj e pyeti vashën si janë, si jetojnë e si e kanë gjendjen. *“Jetojmë në mesin e mirësive dhe begatëve”,* ia ktheu vasha. Sa shumë u gëzua Ibrahim me përgjigjen që mori. E kuptoi se Allahu i kishte dhuruar të birit një grua që do t'i bartë me fisnikëri problemet e jetës, prandaj me një shikim që ia ndriçonte fytyrën, e vështroi vashën dhe para se të largohej i tha: *“Kur të kthehet bashkëshorti, përcillja selamin dhe porosite të hapi mirë sytë e mos ta ndërrojë pragun e dytë.”* Me t'u kthyer Ismaili, e pyeti të shoqen: *“A na ka vizituar kush sot?”* *“Po”,* tha e shoqja, *“erdhi një plak me pamje fisnike, i cili më pyeti për ty dhe i tregova se ku je. Pastaj më pyeti se si jetojmë dhe i tregova se jetojmë mirë.”* *“Mos të porositi diçka?”*, e pyeti me kureshtje Ismaili. *“Po”,* tha vasha. Më pas i rrëfeu të shoqit gjithçka bisedoi me plakun. I gëzuar nga lajmi që mori, Ismaili i tha të shoqes: *“Ai ka qenë babai im. Ndësa ti je pragu i derës, o vashë. Ti je pragu për të cilin më ka urdhëruar ta mbaj dhe të kujdesem për të.”*

Biri im, udhëtimi për tek Allahu është i gjatë dhe i mundimshëm, ndaj kij kujdes me kë shoqërohesh. Zgjidhe mikun më të mirë se veten, në mënyrë që të të ndihmojë në udhëtimin tënd dhe jo të bëhet pengesë për ty. Shoqërohu me njeriun bujar, me atë që nuk i pëlqen të ankohet... Nëse kështu vepron, dije se udhëtimin do ta kesh të lehtë, sepse kur lodhesh njeriu fisnik do ta bartë mbi supet e tij ngarkesën tënde pa kërkuar nga ti kurrfarë shpërblimi.

## Qabja

Atje larg në shkretëtirën e arabe, ndërsa Ismaili po përgatiste shigjeta nën një hije në afërsi të pusit Zem-zem dëgjoi nga larg hapat e një deveje të lodhur nga rruga e gjatë që

kishte përshkuar. Megjithatë nuk i kushtoi shumë rëndësi përderisa ajo iu afrua krejt pranë tij. E ngriti shikimin kur ç'të shihte! Pas shumë e shumë kohësh Ibrahim i kishte ardhur ta takonte. Sapo e pa plakun, u ngrit në këmbë dhe e përshëndeti me respekt. E ndihmoi të zbriste nga kafsha e udhëtimit dhe e përqafoi të atin që shumë i kishte munguar. Pasi u çmallën, Ibrahim i, alejhis-selam, iu drejtua të birit dhe i tha: *"O Ismail, Allahu më ka urdhëruar diçka."* *"Atëherë pra"*, ia ktheu i biri me zë të ëmbël, *"vepro siç je urdhëruar, o babë!"* *"A mund t'më ndihmosh?"*, pyeti plaku fisnik. *"Po, o babë"*, iu përgjigj i biri, *"do të ndihmoj!"* *"Dije pra, o bir"*, tha Ibrahim i, alejhis-selam, *"se Allahu më ka urdhëruar që këtu të ndërtoj një xhami për nder të Tij"*, duke ia treguar me gisht bregoren midis kodrave prej guri. Këtë vend Allahu e ka bërë të shenjtë, që kur ka krijuar qiejt dhe tokën dhe i tillë do mbetet deri në ditën e Kijametit.

Allahu i Lartësuar e kishte urdhëruar mikun e Tij, Ibrahimin, alejhis-selam, ta rindërtonte këtë xhami mbi gjurmët e asaj që kishte ndërtuar shumë kohë para tij Ademi. Sa u gëzua Ismaili kur e mori vesh lajmin. Sa lumturi! Allahu i Lartësuar i kishte urdhëruar të ndërtonin me duart e tyre xhaminë më fisnike, Shtëpinë e Shenjtë, që do ishte vendkthimi dhe vendsigurie për mbarë njerëzit. Me të shpejtë iu përveshën punës. Pasi hapën themelet, babë e bir filluan të grumbullonin gurë të mëdhenj nga kodrat përreth me të cilët do ndërtonin muret e xhamisë. Ditë pas dite muri filloi të ngrihej. Për ta ngritur sa më lartë Ismaili i solli të atit një shkëmb të madh, në mënyrë që Ibrahim i të hipte mbi të dhe të vinte përfund gurët e skalitur që kishin mbetur. Megjithëse Ibrahim i ishte plak, punonte pa u ndalur i hipur mbi shkëmbin e madh që muri të ngrihej sa më lart.

Ndoshta për këtë arsye, o bir i dashur, Allahu i Lartësuar caktoi që edhe sot e kësaj dite gjurma e shputës së këmbës së Ibrahimit të mbesë mbi këtë shkëmb si dëshmi për punën e palodhur të mikut të Tij. Thuhet se kur i hodhën themelet dhe filluan të ngrenin këndin në të cilin sot gjendet Guri i Zi,



Ibrahimi i tha të birit: *“O bir, ma sill një gur sa më të bukur ta vendos në këtë vend.”* Ndërsa Ismaili, i lodhur nga puna, kërkonte gurin, Xhibrili ia solli Ibrahimit, alejhis-selam, një gur nga Xheneti, të cilin Ademi e pat marrë me vete kur kishte zbritur në tokë. Kështu babë e bir e murosën gurin. Teksa punonin i luteshin Allahut të nënshtruar: *“O Zoti i jonë! Pranoje nga ne këtë vepër! Me të vërtetë Ti dëgjon çdo gjë dhe i di të gjitha!”* A nuk të befason kjo lutje, o bir? Ndale pak leximin dhe mendo... Ibrahim, miku i Allahut, imami i besimdrejtëve, zemërtrimi, që u mundua me mish e me shpirt në përhapjen e besimit të drejtë kudo që shkoi, djaloshi që ishte gati të hidhej në zjarr dhe të digjej për hir të besimit tek Allahu, burri që braktisi familjen dhe që u nis të sakrifikonte të birin vetëm e vetëm që të arrinte kënaqësinë e Allahut Fuqiplotë, bart gurë të rëndë nën diellin përvëlues të shkretëtirës për të ndërtuar Shtëpinë e Shenjtë. Ama, e gjithë kjo punë nuk i duket asgjë përballë mirësive të panumërta me të cilat është begatuar nga Zoti i Tij... I lutet Allahut me përgjërime t'ja pranojë këtë punë dhe të jetë i kënaqur me të dhe të birin.

Ndaj edhe ti, o djalë, sado ta adhurosh Allahun dhe sado të mundohesh, mendo për ata burra që dhanë jetën për këtë fe, mendo për gjakun e dëshmorëve, për dijetarët që e harruan rehatinë e trupit dhe ëmbëlsinë e gjumit vetëm e vetëm që kjo fe të mbërrinte tek ti. Mendo se sa e sa djem si ti e adhurojnë Allahun në qytetin tënd, mendo se shumë djem të tillë ka në të gjitha vendet e botës, miliona e miliona njerëz adhurojnë Allahun. Përfytyro këtë mizëri pa fund burrash e grash, të rinjsh dhe të rejash dhe mos u mbaj me të madh... Dije pra, se nuk je tjetër veçse një ushtar i vogël dhe i dobët i kësaj ushtrie të madhe! Për më tepër, asnjëherë mos harro se sa mangësi kanë adhurimet e tua. Ndaj, a je i sigurtë se do të të pranohen? Nëse Ibrahimin, mikun e Allahut e ka brengosur ky fakt, po ty sa duhet të të brengosë? Kur i ngriti muret e



Xhamisë, Allahu i shpalli Ibrahimit, alejhis-selam: *"O Ibrahim! Mos më shoqëro askënd në adhurim dhe pastroje Shtëpinë Time për ata që bëjnë tavaf dhe për ata që rrinë në këmbë, përkulen dhe bien në sexhde duke u falur."* *"O Ibrahim! Thirri njerëzit për të bërë haxhin, se ata do të të vijnë në këmbë dhe mbi deve të rraskapitura nga viset e largëta, për ta përmendur dhe falënderuar Allahun duke dhënë tekbiere dhe duke bërë kurban."* Pas këtij urdhri, thuhet se u ngrit Ibrahim i mbi kodrën Safa dhe filloi të thërrasë me sa fuqi që kishte njerëzit për të bërë haxhin. Kështu u bë miku i Allahut muezini i parë i Qabes, imami i saj dhe gjithashtu shërbëtori i Shtëpisë së Shenjtë. Të jesh imam i njerëzve është vlerë, por mos harro se Ibrahim i, miku i Allahut, megjithëse ishte imam i besimdrejtëve nuk ngurroi asnjëherë të ishte edhe një pastrues i thjeshtë i Xhamisë së Shenjtë, një shërbëtor kokulur në shërbim të udhëtarëve të ardhur nga viset e largëta për të kryer haxhin. Ndaj, kurrë mos u krekos në mesin e të tjerëve, por të jesh i matur, se mendjemadhësia është e urryer nga Allahu dhe nga njerëzit. Nderoji besimtarët e thjeshtë. Mos kalo kurrë përpara një punëtori apo një punëtoreje pa i buzëqeshur dhe pa i falënderuar për punën që bëjnë... Mos i nënvlerëso punët e vogla, mbasi, nëse grumbullohen të gjitha së bashku, peshojnë rëndë në Ditën e Gjykimit.

Pas një jete plot bëma dhe lavdi, Ibrahim i dhe i biri i ngritën duart nga qielli duke u lutur: *"O Zoti i jonë! Dërgoje në mesin e këtij populli një Pejgamber, që t'u lexojë shpalljet e Tua, t'ua mësojë Librin dhe rregullat e fesë dhe t'i pastrojë nga gjynahet! Vërtet Ti je i Plotfuqishëm dhe i Urtë!"* Allahu i Lartësuar e pranoi lutjen e tyre. Si përgjigje ndaj lutjes, Allahu e bekoji Qaben. Shih edhe sot e kësaj dite! A nuk drejtohen muslimanët për nga Qabja në çdo namaz? A nuk bëjnë tavaf rreth saj në çdo kohë, ditën dhe natën? A nuk udhëtojnë drejt saj çdo vit me miliona njerëz për të bërë haxhin? Po ashtu si

*Rrëfimet më të mira*

përgjigje ndaj lutjes së tyre Allahu i Lartësuar dërgoi në mesin e arabëve Profetin Muhamed si mëshirë për mbarë njerëzimin. I shpalli atij Kur'anin Fisnik dhe e bëri fe-rrëfyes për të gjithë popujt.

Prandaj qoftë i madhëruar Allahu dhe bekimet e Tij qofshin përgjithmonë mbi Ibrahimin, Ismailin dhe për vulën e Profetëve, Muhamedin, alejhis-selam.

## Shuajbi

Biri im, një ditë njëri nga shokët e dalluar të Profetit Muhamed, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, i quajtur Ebu Dherr, Allahu qoftë i kënaqur prej tij, nga fisi Giffar, e pyeti Profetin (alejhis-selam) për të Dërguarit e Allahut me origjinë arabe. Profeti Muhamed, alejhis-selam, iu përgjigj: *“Katër prej tyre janë me origjinë arabe: Hudi, Salihu, Shuajbi dhe Pejgamberi yt, o Ebu Dherr.”*

Të kam rrëfyer më parë për historinë e Hudit dhe Salihut, siç të kujtohet, e tani e ka radhën Profeti Shuajb, alejhi selam ... Kush është ky burrë i nderuar? Në mesin e cilit popull u dërgua? Ku jetoi? Për këto dhe shumë të tjera do të të rrëfej në vazhdim, ndaj dëgjo me vëmendje, Allahu të mëshiroftë!

## Qyteti Medjen

Kohë më parë, në krahinat e bekuara të Shamit, afër Detit të Vdekur, jetonte fisi arab Medjen. Lugina ku jetonin ishte plot e përplot me pemë, me fusha të gjelbërta ku kullosnin bagëtitë, me puse të kulluar dhe me bimë të shumta. Allahu i Lartësuar ua hapi portat e mirësive duke i furnizuar nga qielli dhe nga toka, mirëpo ata, në vend që të falënderonin Zotin e tyre, falënderonin dhe adhuronin drurin e një peme të quajtur Ejkeh. Për më tepër, ata njiheshin për hajdutëri rrugësh. Meqë qyteti i tyre ishte vendkalimi për udhëtarët dhe karvanet e tregtisë,

ata shfrytëzonin rastin dhe u ngrinin pusi. Sulmonin karvanet, frikësonin kalimtarët dhe plaçkitnin udhëtarët. Jo vetëm kaq! Njiheshin si mjeshtra të mashtrimit dhe të dredhive në hesape dhe në peshore. Kur blinin diç nga të tjerët, kërkonin që të mbahej drejtësi, ama, kur ata u shisnin diç të tjerëve, peshonin në mënyrë të padrejtë duke e pakësuar peshën me hile.

Biri im! Dije se çdo vepër e keqe dhe sjellje e shëmtuar buron nga mosbesimi. Prandaj besimi se Allahu sheh dhe dëgjon çdo gjë, se çdo vepër do të llogaritet në Ditën e Gjykimit e shtyn njeriun drejt të mbarës dhe sjelljes së mirë. Pikërisht ky besim është ilaçi me të cilin shërohet sëmundja e padrejtësisë, dredhisë dhe e mashtrimit.

## Shuajbi

Allahu i Lartësuar, Mëshiruesi i mëshiruesve, nuk dëshironte t'i dënonte banorët e Medjenit për idhujtarinë dhe për zakonet e pahijshme në të cilat kishin rënë, por dëshironte udhëzimin për ta, prandaj ia zbriti shpalljen hyjnore një burri fisnik në mesin e tyre. E dërgoi këtë njeri për t'i thirrur në besimin e drejtë, në rrugën e shpëtimit dhe për t'i larguar nga idhujtaria dhe padrejtësia ndaj të tjerëve. Ky burrë ishte Shuajbi, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të. Ai kishte prejardhje fisnike dhe ishte pjesëtar i një familjeje me emër. Njihej në mesin e popullit si ligjërues i paarritshëm dhe si gojëtar i shkëlqyer. Njihej për zgjuarsin, urtësin, ndershmërin dhe moralin të lartë, prandaj të gjithë e nderonin.

Menjëherë sapo i zbriti shpallja, Shuajbi, alejhis-selam, u ngrit në mesin e popullit dhe filloi t'ia përcillte porosinë e Allahut të Lartësuar. Me fjalë të përzgjedhura e thirri popullin t'ia besonin porosive me të cilat u kishte ardhur. Me përzemërsi iu drejtua duke i thënë: *"O populli im, adhurojeni Allahun mbasi*

*nuk meriton të adhurohet askush veç Tij!*" Sikurse pejgamberët e mëparshëm, sikurse Nuhu, Hudi dhe Salihu, ashtu edhe Shuajbi fillimisht e thirri popullin në adhurimin e Allahut të Lartësuar, pasi kjo është rruga e vetme e shpëtimit në këtë botë dhe në tjetrën. Me urtësi ua tërhoqi vërejtjen për kotësinë e adhurimit të idhujve, qofshin ata prej guri apo prej druri. Me të vërtetë ai dëshironte udhëzimin e fisit të tij për nga e mbara dhe dëshironte shpëtimin e tyre nga ndëshkimi i Allahut të Lartmadhërishëm.

*"O populli im!", u thoshte, "Peshoni me drejtësi dhe mos bëni hile! Silluni mirë me udhëtarin e mos u zini pusinë karvaneve! Dijeni se pasuria e fituar me djersë dhe mund është më e mirë për ju sesa ajo që e merrni padrejtësisht dhe me dredhi!"*

Bir i dashur! Pasuria hallall e fituar me punë e mundim është e bekuar edhe nëse është pak. Ndërsa pasuria e fituar me dredhi, hile dhe padrejtësi është e mallkuar dhe fundin e ka të hidhur. Ndaj puno me ndershmëri, o djalë, kënaqu me atë që të ka caktuar Allahu i Lartësuar, qoftë edhe pak. Kjo është pasuria e dobishme për ty, pasuria për të cilën Shuajbi, alejhis-selam, e ka porositur fisin e tij.

Shuajbi alejhis-selam nuk ishte prej atyre që flasin për ato gjëra që vetë nuk i veprojnë, nuk ua ndalonte diçka të tjerëve e ta bënte vetë dhe as nuk i largonte nga diçka e të cilës vetë i afrohej. Mundohej të ishte shembull i mirë në mesin e tyre, mbasi vepra e mirë e një njeriu është më e vlerë sesa 1000 fjalë të tij. Fjalë i merr era- thonë të moçmit. *"O populli im!", u drejtohej, "Unë nuk po iu kundërshtoj e të punoj vetë atë vepër nga e cila ua tërheq vërejtjen. Unë dëshiroj që ta përmirësoj gjendjen tuaj aq sa mundem."*

Dije se Pejgamberët, ulematë dhe punëmirët i frikësohen Allahut kur janë në mesin e njerëzve, por edhe kur janë vetëm. Nuk mbahen me të madh e as që dëshirojnë të jenë më lart

se të tjerët... Përmirësimi i shoqërisë: ky është misioni i tyre. Ata nuk kërkojnë asgjë në këmbim, as pasuri dhe as pozitë të lartë. Ashtu edhe Shuajbi, alejhis-selam, mendohej ta ndihmonte fenë e Allahu të Lartësuar me dijen dhe pasurinë e tij dhe nuk kishte qëllim të pasurohej nëpërmjet fesë. I këshillonte të tjerët me çiltërsi e nuk jepte këshilla për t'u shpërblyer nga ata që këshilloheshin dhe as për të arritur famë në mesin e tyre. "Nuk kërkoj nga ju kurrfarë shpërblimi.", u thoshte Shuajbi alejhis-selam, "Mua do më shpërblejë vetëm Zoti i botëve."

Pejgamberi fisnik përdori mënyra nga më të ndryshmet për ta thirrur popullin e tij në Islam. Herë-herë ua përkujtonte mirësitë e Allahut të Lartësuar ndaj tyre me shpresën se do të tregoheshin falënderues dhe do t'i ktheheshin së mbarës dhe herë-herë i frikësonte me dënimin e Allahut në mënyrë që të ktheheshin me pendim. "O populli im! Më pasoni mua dhe bindjuni Allahut!", u thoshte, "A nuk frikësoheni se mund t'ju godasë edhe juve ajo që e goditi popullin e Nuhut, popullin e Hudit apo edhe popullin e Salihut? Mos harroni se edhe populli i Lutit nuk është larg nga ju."

Në rrëfimet e popujve të hershëm ka mësim dhe dobi të shumta. Këto histori nuk përcillen nga njëri brez në tjetrin sa për të kaluar kohën dhe për dëfrim, por në mënyrë që njerëzit të marrin shembull dhe të udhëzohen nga e mbara. Të mos harrojnë dënimet që përjetuan njerëzia kur ia kthyen shpinën besimit dhe i kundërshtuan të Dërguarit e Allahut. Mos harro, o djalë, se i mençuri është ai që zë mend nga përvoja e të tjerëve...

"O populli im! Këkoni falje nga Zoti i juaj, e pastaj pendohuni për gjithëçfarë keni bërë! Me të vërtetë Zoti im është Mëshirues dhe shumë i dashur." Kështu i drejtohej Shuajbi fisit të tij, në mënyrë që të pendoheshin dhe të braktisnin idhujtarinë dhe zakonet e ulëta.

Dije se Allahu i Lartësuar nuk i mbyll asnjëherë dyert e pendimit. Ai dëshiron që njerëzit të pendohen dhe t'i kthehen besimit të drejtë, dëshiron t'i përkushtohen veprave të mira. E me të vërtetë kushdo që kështu vepron, Zoti pendimin ia pranon, gabimin ia fal dhe mirësi të panumërta i dhuron. Profeti, paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, na ka lajmëruar se Allahu i Lartësuar është më i mëshirshëm me robërit e tij sesa nëna me foshnjën e saj. Tregohu i kujdesshëm, dhe ruaju nga gjynahet, por, nëse pa dashur rrëshket, mos u mundo të fshihesh dhe as mos e humb shpresën, por kthehu tek Allahu i Lartësuar me pendim, sepse Ai është Falës dhe Mëshirues. Mos harro asnjëherë se të gjithë bijtë e Ademit bien në gjynahë, por më i miri në mesin e tyre është ai që më së shumti pendohet.

## Populli Medjenit

Megjithëse Pejgamberi e thirri popullin për nga rruga e shpëtimit si mos më mirë, pasanikët mendjemëdhenj ia kthyen shpinën porosive. Shuajbin, alejhis-selam, e besuan vetëm të varfërit. Ata e pasuan rrugën e tij dhe e braktisën fenë e prishur të stërgjyshërve.

Sapo e morën vesh se të varfrit i kishin besuar Shuajbit, krerët e fisit filluan t'i nënçmojnë dhe të tallen me ta. "Mjerë për ju!", i thonin, "Nëse e pasoni Shuajbin, me siguri do jeni të humbur." Por në të vërtetë, ata ishin të humburit.

Njerëzit me pozitë vështirë se i pranojnë këshillat. Ata i kanë shpresat e lidhura me këtë jetë, prandaj e kundërshtojnë ringjalljen... Ata e urrejnë faktin se një ditë do të përgjigjen përpara Zotit të botëve për veprat e tyre të ulëta ndaj mundohen me çdo kusht ta shuajnë thirrjen e Pejgamberit. "O Shuajb!", i drejtoheshin me inat vëllasë së tyre, "Kthehuni në fenë tonë

ose do t'ju dëbojmë nga qyteti ty me të gjithë ndjekësit e tu." Shuajbi i dilte në mbrojtje pasuesve të tij, ashtu siç i ka hije fisnikut. "A po na detyroni me forcë ta braktisim fenë tonë edhe pse ne nuk e dëshirojmë diçka të tillë?", u thoshte, "Sikur të ktheheshim në idhujtari, pasi Allahu na shpëtoi prej saj, kjo do ishte tradhti dhe gënjeshtër ndaj Allahut."

"Ti je i magjepsur!", i thanë, "Ti nuk je tjetër veçse një njeri, ashtu si ne. Në të vërtetë ti nuk je tjetër veçse një gënjeshtar." Pasanikët e popullit të tij e kaluan çdo kufi. Ata kërkonin që t'u dërgoheshin melekët si lajmëtarë të Allahut dhe jo një njeri i thjeshtë nga mesi i tyre. Jo vetëm kaq! Megjithëse Shuajbi alejhis-selam ishte ligjërues i paarritshëm dhe gojëtar i shkëlqyer, krerët e popullit të tij u shtirën se gjoja nuk kuptonin dhe e kërcënuan Profetin: "Ne nuk i kuptojmë këto që po thua ti dhe të shohim si të dobët midis nesh. Sikur mos të ishte farefisi yt, do të të kishim mbytur me gurë. Ti nuk ke më kurrfarë vlere në mesin tonë." Shuajbi ua ktheu me guxim dhe krenari duke i thënë: "O populli im! A mos vallë vlerësoni dhe e respektoni fisin tim më shumë sesa Allahun Fuqplotë? O populli im! Mundohuni sa të doni kundër meje, pasi unë aspak nuk ju frikësohem!"

Ata nuk e vlerësuan siç duhet fuqinë e Allahut. Në ditën e Kijametit e tërë toka do të jetë në Grushtin e Tij, ndërsa qiejt do t'i palosë ashtu siç palosen faqet e librit. Ai është i Gjalli që nuk vdes kurrë. Ai nuk lodhet asnjëherë dhe as që e kaplon gjumi. Atij i përket çdo send që gjendet në qiej e në tokë. Ai është Sunduesi i universit. Çdo gjë ndodh me urdhrin dhe lejen e Tij. Allahu kur dëshiron diçka mjafton t'i thotë: "Bëhu!" dhe ajo menjëherë bëhet, ndërkohë që kjo për Allahun është shumë e lehtë. Allahu është i Lartësuar dhe larg çdo të mete. Ne nuk jemi tjetër veçse krijesa të dobëta, ndaj sado fuqi të kemi Allahu ngadhnjen mbi çdo fuqi tonën dhe mbi të gjitha fuqitë e qiejve dhe të tokës së bashku, sepse Ai është i Plotfuqishëm,



Ai e ka krijuar fuqinë, gjithësinë dhe gjithçka në të. Kush i mbështetet Atij, Ai i mjafton. Kush i frikësohet Atij, Ai e nderon. Kush kërkon ndihmë prej Tij, Ai e ndihmon dhe vështirësitë ia lehtëson. Ky është Zoti i jonë, o bir, ndaj të jesh i bindur dhe të tregosh respekt ndaj Tij, e mos të jesh nga ata që kanë frikë dhe i turpërohen njerëzve më shumë sesa Zotit.

Sa herë që e kaplonte lodhja dhe mërzia nga fjalët e rënda me të cilat i drejtoheshin, Shuajbi, alejhis-selam, falte namaz dhe i lutej Allahut të Lartësuar, pasi namazi e ndihmonte të përmbahej dhe t'i tejkalonte telashet. Ndërkohë banorët e Medjenit e vështronin me ëndje Pejgamberin tek falej dhe e kuptuan se kjo vepër është një ndër adhurimet më të rëndësishme që kryente vëllai i tyre. E kuptuan se pikërisht nëpërmjet këtij adhurimi tejkalohehin vështirësitë. Tek shihnin butësinë e Shuajbit përkundër fjalëve fyese dhe mundimeve që i shkaktonin, e kuptuan se ky namaz ishte çelësi i sjelljes së mirë. Prandaj shpesh herë i drejtoheshin Pejgamberit duke i thënë: *"O Shuajb, a mos vallë namazi yt urdhëron që ne t'i braktisim ata që kanë adhuruar të parët tanë? Apo mos vallë ky namaz na nxit t'a fitojmë pasurinë vetëm me djersë dhe mund?"*

Bir i dashur! Namazi është adhurimi më i rëndësishëm. Ai është shtylla e fesë Islame. Nëse kjo shtyllë është e fortë dhe e qëndrueshme, ashtu do jetë edhe feja. Namazi të përkujton Allahun e Lartësuar, mëshirën dhe pushtetin e Tij. Ky adhurim është burimi i fuqisë së besimtarit. Ai të nxit për braktisjen e veprave të shëmtuara dhe të shtyn drejt moralit të lartë. Për shkak të dobisë që sjell dhe ndikimit që ka në jetën e besimtarit, Allahu i Lartësuar na e bëri obligim faljen e tij gjatë ditës dhe natës.

Megjithëse i thirri drejt shpëtimit dhe i paralajmëroi për dënimin e dhembshëm, populli i Medjenit nuk i kushtoi rëndësi fjalëve të Pejgamberit. Jo vetëm kaq! Ata filluan të tallëshin me Shuajbin, alejhis-selam, duke i thënë: *"O Shuajb, ne nuk*

*kemi frikë aspak nga dënimi për të cilin na flet ti. Nëse je vërtet i Dërguar i Allahut, lëshoje mbi ne ndonjë copë nga qielli!” Shuajbi i tha: “A mos po talleni me atë që po u them? O populli im! Allahu e di mirë se ç’punoni, prandaj, nëse nuk e braktisni idhujtarinë dhe padrejtësinë, do t’ju kaplojë dënimi poshtërues.”*

## Dënimi

Banorët e Medjenit e mohuan Pejgamberin. Me përkushtim vazhdonin adhurimin e idhujve dhe asgjë nuk i pengonte nga padrejtësia dhe dredhitë. Nuk pendoheshin për ç’kishin bërë në të shkuarën, as nuk brengoseshin se ç’ishin duke bërë dhe as që e kishin ndër mend të përmirësoheshin. Shuajbi, alejhis-selam, bëri aq sa mundi për ta shpëtuar popullin e tij nga mosbesimi, nga padrejtësia, mashtrimi dhe hilet, por ata u tallën me Pejgamberin dhe si pasojë Allahu Fuqiplotë ua zbriti dënimin. Përmendet se i ka goditur një vapë e fuqishme. Allahu Fuqiplotë kishte caktuar që për shtatë ditë të mos frynte as edhe një puhizë e lehtë. Në këto kushte banorët e qytetit u detyruan të braktisnin shtëpitë në kërkim të ndonjë strehe të freskët. Ia mësynë maleve, por atje nxehtësia ishte edhe më e madhe. U fshehën nëpër shpella, por më kot. Si të shpëtonin nga kjo vapë që të përcëllonte lëkurën sikur zjarri i ndezur fort? Gjithçka ishte e thatë, e nxehtë si prushi. Duke qenë në këtë gjendje të vështirë, ata panë se mbi qytet ishin grumbulluar re të shumta dhe shpresuan se këto re bartnin me vete shpëtimin e tyre. Mendonin se do t’i mbronin nga i nxehti përvëlues, ndaj nxituan të strehoheshin nën hijen e reve, përveç besimtarëve. Ata u larguan nga qyteti ashtu siç i kishte porositur Shuajbi, alejhis-selam. Kur u grumbulluan të gjithë idhujtarët nën re, Allahu urdhëroi që nga retë të binin copa përvëluese, për t’i poshtëruar ata. A nuk kishin kërkuar diç të tillë nga Pejga-

mberi?! Jo vetëm kaq. Toka filloi të dridhej nën këmbët e tyre dhe nga qielli ushtoi një klithmë e tmerrshme. Tmerri kaploi zemrat e tyre nga ushtimi e llahtarshme, ndërkohë banesat filluan t'u shembeshin mbi kokat si pasojë e tërmetit. Ata, që arritën të dalin nga banesat, u dogjën për së gjalli nga zjarri që zbriste pa pushim nga qielli. U shkatërrua çdo gjë dhe asnjë nuk shpëtoi. Disa mbetën pa jetë nën gërmadha, të tjerët të shtrirë në rrugët e qytetit sikur të ishin qymyr.

Ja pra! Kështu u dënua populli i Shuajbit, alejhis-selam. Ata e mohuan adhurimin e Zotit, e kundërshtuan të Dërguarin dhe i bënë padrejtësi të tjerëve duke bërë hile në matje dhe peshore ndaj dhe e merituan dënimin që në jetën e kësaj bote.

## Shpëtimi

Pas dënimit të popullit të tij dhe shkatërrimit të tyre, Shuajbi, alejhis-selam, u kthye nga qyteti i pajetë i Medjenit duke thënë: *"O populli im, unë u përpoqa që në çdo mënyrë t'ju udhëzoja për nga e mbara, por kjo nuk ju bëri dobi. E tani unë nuk pikëllohem për ju, meqë nuk i pranuat porositë e mia dhe as që u frikësuat nga dënimi për të cilin iu paralajmërova."*

Pas shkatërrimit të Medjenit thuhet se Shuajbi së bashku me besimtarët që e pasuan, emigruan drejt viseve të largëta, ku jetuan të lumtur për sa patën jetë.

Allahu i Lartësuar thotë në Kur'anin Fisnik: *"Ne po t'i tregojmë historitë e të Dërguarve, për të ta përforcuar zemrën."* Këto tregime janë përplot mësim dhe dobi. Në to ka këshilla dhe përkujtim për besimtarët.

## Luti

Besoj se e mban mend emrin e Lutit apo jo? Të kujtohet djaloshi, i cili besoi në Allahun e Lartësuar kur e pa se si shpëtoi Ibrahimimi, alejhis-selam, nga zjarri i llahtarshëm, nga zjarri i përflakur që nxirrte shkëndija verbuese?! Të kujtohet djaloshi që pasoi rrugën e mikut të Allahut, Ibrahimit, apo jo?!

Luti, alejhis-selam, ishte djali i Haranit, vëllasë së Ibrahimit. Ai besoi në Allahun e Lartësuar dhe së bashku me xhaxhain e tij, Ibrahimin, emigruan drejt tokave të bekuara të Palestinës. Luti, alejhis-selam, braktisi vendlindjen, të afërmit e çdo gjë që kishte, duke pasuar mikun e Allahut në udhëtimin drejt trojeve ku mund ta adhuronin Zotin e botërave të lirë.

Që në rininë e tij Luti njihej për mendjemprehtësi, fisnikëri, ndershmëri dhe moral të lartë... Kur zemra e djaloshit u ndriçua me dritën e besimit, Allahu i Lartësuar i dhuroi atij pejgamberinë, i dhuroi urtësi dhe dituri të gjërë. Ndërkohë Luti nuk i ndahej Ibrahimit. Gjithnjë pranë tij, e shoqëronte nëpër udhëtime siç bën miku me mikun. Diskutonte me të sa herë që përballlej me ndonjë vështirësi.

Një ditë prej ditëve Lutit, alejhis-selam, iu shpall se duhet të udhëtonte drejt një qyteti të panjohur për të, me qëllim që t'i udhëzonte banorët e atij qyteti nga e mbara. Ashtu siç e kishte zakon, menjëherë sapo i zbriti shpallja, Luti, alejhis-selam, shpejtoi për tek xhaxhai i ndershëm, Ibrahimimi. Pasi u këshillua me Ibrahimin, alejhis-selam, e përqafoi atë ashtu siç i ka hije

nipit, i dha selam dhe u nis andej nga ishte urdhëruar: drejt qytetit të Sodomës...

Biri im, Allahu i Lartësuar ka premtuar se nuk e dënon një popull derisa në mesin e tyre të dërgojë Pejgamberë që t'ua tregojnë rrugën e shpëtimit. Dije se Pejgamberët u ngjajnë prindërve të kujdesshëm dhe mësuesve të urtë që përpiqen me mish e me shpirt të rrënjosin fisnikërinë në zemrat e njerëzve dhe të përhapin diturinë në mesin e të paditurve. Pejgamberët janë burim mirësie dhe dritë udhëzimi. Ata u përngjajnë yjeve që mbulojnë qiellin, u përngjajnë yjeve nëpërmjet të cilëve orientohen udhëtarët kur bie nata. A nuk e sheh se si i dërgon Allahu i Lartësuar Pejgamberët nga njëri vend në tjetrin për ta përhapur dritën e udhëzimit sapo bie errësira? Ismaili në Mekë, Ibrahim i në Palestinë dhe Luti diku më larg. Të tre me një qëllim të vetëm: të ndihmojnë të vërtetën ndaj të pavërtetës, diturinë ndaj paditurisë, moralin e lartë ndaj veseve të ulëta dhe të dobëtin ndaj të padrejtitit...

## Sodoma

A ke dëgjuar ndonjëherë për qytetin e Sodomës? Ku ndodhej ky qytet? E ç'di ti për banorët e këtij qyteti? Përse të dërgohej një Pejgamber në mesin e tyre vallë?

Qyteti i Sodomës shtrihej në Jordaninë lindore, jo larg Palestinës. Ky qytet dallohej aso kohe për bukurinë e tij, për shtrinjen e madhe dhe për tokat pjellore me pemë nga më të ndryshmet. Vendbanimet e tyre dalloheshin për madhështinë e tyre, për pusët me ujë të kthjellët dhe rrugët e shtruara me kalldrëm. Një jetë mes relative!

Mirëpo ata në vend që të falënderonin Allahun e Madhërishëm për mirësitë e panumërta me të cilat i kishte nderuar, adhuronin idhujt. I përulëshin dhe i nderonin duke

u përkulur para tyre, duke i lutur dhe duke therur kurbane për nder të tyre. Pasi harruan Allahun, shejtani ia zbukuroi punët e shëmtuara dhe i shmangu edhe më tepër nga rruga e drejtë. Banorët e Sodomës u zhytën në detin e bollëkut dhe e mendonin veten të pavdekshëm, ndaj në mesin e tyre u përhap mosbesimi, padrejtësia dhe çoroditja...

Meqë qyteti i tyre dhe fshatrat përreth ishin vende kalimi për udhëtarët dhe karvanet e gjatë me mallra, ata shfrytëzonin rastin dhe u ngrinin pusi. Plaçkitnin me egërsi karvanet e shumta që kalonin pranë qytetit, keqtrajtonin pa mëshirë udhëtarët dhe jo vetëm kaq, banorët e Sodomës praktikonin një sjellje të ulët dhe të ndyrë, një krim të panjohur deri atëherë. Ata ishin me të vërtetë krijesa të neveritshme. Burrat e këtij qyteti parapëlqenin burrat në vend të grave, në kundërshtim me natyrën e njeriut. Kishin kaluar mijëra vite që nga krijimi i Ademit dhe një paturpsi e tillë as nuk ishte parë dhe as nuk ishte dëgjuar...

Biri im! Allahu i Lartësuar e krijoi gruan për t'i qëndruar pranë burrit të saj dhe në zemrat e tyre mbolli dashuri dhe mëshirë për njëri-tjetrin. Allahu i Lartësuar caktoi që burri dhe gruaja të martohen dhe nga kjo martesë të lindin fëmijë, me të cilët gëzohet syri dhe zemra e prindërve si dhe sigurohet jeta e njerëzve në Tokë. Lidhja e burrit me gruan nëpërmjet martesës është e vetmja mënyrë që njerëzit të jetojnë me nder dhe të trashëgohen brezat njëri pas tjetrit.

## Pejgamberi

Thuhet se me të mbërritur në qytetin e Sodomës, Luti, alejhis-salam, u bë i njohur në mesin e tyre. Nuk kaloi shumë kohë dhe u martua me një grua që ishte nga banorët e qytetit dhe si çdo Pejgamber u angazhua me punë për të mbajtur

familjen. Por çdo ditë e më shumë lëndohej kur i shihte njerëzit tek adhuronin idhujt dhe tek keqtrajtonin udhëtarët. Mjaft më! Deri kur do vazhdonin kështu?

Allahu i Lartësuar i shpalli Lutit: *"T'i thërrasësh njerëzit në fenë e vërtetë, t'i paralajmërosh për dënim të rëndë nëse nuk largohen nga gjynahet dhe veset e ulëta!"* U ngrit menjëherë Luti, alejhis-selam, në mesin e popullit dhe filloi t'ia përcillte porosinë e Allahut të Lartësuar. Natë e ditë i thirri banorët në besim, ia bëri të qartë të vërtetën, por ata nuk i kushtuan vëmendje paralajmërimeve të tij. U tallën me porosinë që u solli dhe e mohuan ndëshkimin për të cilin i fliste Pejgamberi. Megjithatë Luti, alejhis-selam, nuk hoqi dorë nga misioni për të cilin ishte dërguar. Me çiltërsi i thirri njerëzit nga e mbara, i thirri drejt ndershmerisë dhe ua tërhoqi vërejtjen për punën e neveritshme që praktikonin. *"Vërtet, ju bëni një punë kaq të shëmtuar saqë askush përpara jush nuk e ka bërë në botë."*, u thoshte Pejgamberi fisnik, *"A nuk e shihni, se ju, ndryshe nga e gjithë bota, shoqëroheni me burrat dhe i lini mënjanë gratë, të cilat Zoti i juaj i ka krijuar bashkëshorte për ju? Me të vërtetë ju e keni kaluar çdo kufi të së keqes."*

Askush nuk iu përgjigj thirrjes së tij me përjashtim të dy bijave të tij fisnike. Me mendjemadhësi vazhdonin rrugën e lajthitjes dhe veseve të ulëta ashtu si më parë. Sa më shumë që i thërriste për nga rruga e shpëtimit, aq më shumë largoheshin prej tij. Sa më shumë që i qortonte, aq më shumë egërsroheshin ashtu siç bëjnë bishat. *"Dëbojeni Lutin dhe familjen e tij prej qytetit tuaj, sepse ata janë njerëz të dëlirë!"*, i drejtoheshin njëri-tjetrit.

Biri im, kushdo që i kthen shpinën adhurimit të Allahut dhe e harron Krijuesin e tij, shejtanin do ta ketë shoqërues. Ai nuk do t'i ndahet derisa ta robërojë njeriun. Dhe a ka më keq sesa njeriu, të cilin e ka robëruar armiku i tij?! Njerëzit e tillë, të vërtetën e marrin si të pavërtetë, të mirën e marrin

për të keqe, e humbin rrugën dhe u shkojnë pas dëshirave duke u poshtëruar në jetën e kësaj bote dhe duke u dënuar rëndë në botën tjetër. A nuk e dëgjove se si u sollën banorët e Sodomës me Lutin dhe të afërmit e tij?! I shihnin si të humbur, ndërkohë që vetë ata ishin të humburit. I shihnin me përçmim, ndërsa vetë ata ishin të përçmuarit. E harruan Allahun dhe u poshtëruan.

Përkujtoje Allahun! Adhuroje Krijuesin tënd, në mënyrë që Allahu të të përkujtojë dhe të të ruajë nga armiku yt i përбетuar, nga humbja dhe devijimi. Dije se adhurimi të nderon dhe të afron tek Allahu Fuqiptotë. Dhe mos harro se sa më afër bariut të qëndrojnë delja, aq më e mbrojtur do të jetë nga ujqërit, dhe sa më larg tij të jetë, aq më afër do ta ketë rrezikun.

## *Gruaja e Lutit*

Megjithëse mundimet i shtoheshin Lutit, alejhis-selam, dita-ditës, brenga e tij më e madhe ishte bashkëshortja e tij. E liga e përgënjeshtroi të shoqin dhe nuk e pranoi thirrjen e tij. Me këmbëngulje adhuronte idhujt, gjithashtu u tregonte respekt dhe i qëndronte besnike popullit të saj. Luti, alejhis-selam, për një kohë të gjatë u përpoq ta bindte të hiqte dorë nga idhujtaria dhe mosbesimi, por më kot. Ajo edhe më shumë e nënçmonte dhe tallej me të shoqin. Ajo e tradhëtoi besimin e Lutit dhe mbeti në errësi të ashtu si populli i saj.

## *Lutja*

Megjithë fjalët e urta dhe sjelljen e mirë të të Dërguarit të Allahut, banorët e Sodomës nuk e braktisën adhurimin e idhujve dhe as tiraninë. Këmbëngulës në mosbesim, ia kthyen shpinën porosive të Pejgamberit dhe e munduan tepër. "Na e



sill, pra, dënimin e Allahut, nëse flet të vërtetën!", i thonin me përtallje. Atëherë kur Luti, alejhis-selam, e humbi çdo shpresë për përmirësimin e tyre, i ngriti duart nga qielli: "O Allah! Më shpëto mua dhe familjen time nga ajo që bëjnë banorët i këtij qyteti!" E kush i vjen në ndihmë nevojtarit, kur i lutet, ia largon të keqen dhe e bën mëkëmbës në tokë? Kush e sjell lehtësimin pas vështirësive? I Lartësuar dhe larg nga çdo e metë është Allahu, Zoti i botërave. Sa Mbrojtës i mirë dhe sa Ndhimëtar i mrekullueshëm që është Ai!

Biri im! Ruhu nga lutja e atij që i është bërë padrejtësi, ngase mes saj dhe Allahut nuk ka asnjë pengesë! Dije se Allahu e ndihmon edhe mosbesimtarin dhe i përgjigjet lutjes së tij kur i bëhet padrejtësi. Kjo nuk do të thotë se Allahu e do mosbesimin, por Ai është i Drejtë dhe e do drejtësinë. Prandaj dëgjo se ç'ndodhi me të padrejtët! Dëgjo se ç'ndodhi me ata që i kthyen shpinën Pejgamberit!

Me të vërtetë Allahu i Lartësuar iu përgjigj lutjes së robit të Tij dhe e dënoi popullin e prishur, por si u dënuan vallë ?

## Mysafirët e panjohur

Një ditë prej ditësh, ndërkohë që Ibrahim, alejhis-selam, ishte kthyer nga Meka dhe qëndronte në Palestinë me gruan e tij, Sarën, tre burra të panjohur i trokitën në derën e oborrit. Sapo hapi derën, u habit me pamjen e tyre. Duhet të kishin ardhur nga larg, pasi askush nuk i njihte, megjithse shenja udhëtimi nuk kishin. Rrobat i kishin të pastra dhe nuk dukeshin të lodhur aspak. Sa çudi! Sapo ia hapi portën e përshëndetën njëzëri me selam. "Paqja e Allahut qoftë mbi ty!" "Edhe mbi ju qoftë paqja e Allahut, o njerëz të panjohur!", ia ktheu Ibrahim. Pasi i uroi mirëseardhjen, i lejoi të hynin. Ibrahim, alejhis-selam, mendoi se janë udhëtarë që vinin nga vise të largëta, prandaj

ndaj tyre veproi ashtu siç vepron fisniku me mikun e tij. Me të shpejtë u solli një viç të pjekur për merak. *"Ndoshta janë të lodhur e të uritur nga udhëtimi!"*, mendonte Ibrahimimi...

Biri im! Të jesh bujar me mysafirin! Mundohu ta nderosh mikun dhe ta ndihmosh udhëtarin mbasi ky është thelbi i fisnikërisë. Dije se mikpritja është moral i lartë, është zakon i njerëzve të mirë, është stoli e Pejgamberëve të Allahut, ndaj zbukurohu edhe ti me stolinë e çmuar të bujarisë dhe mikpritjes, të mëshiroftë Allahu!

Dëgjo me kujdes! Për çudi, kur Ibrahimimi e vendosi ushqimin përpara tyre dhe i ofroi të hanë, ata as që iu afruan ushqimit. *"A nuk po hani?"*, i tha plakuri i çuditur. Kur e vuri re këtë gjë, nuk e pëlqeu aspak dhe ndjeu frikë në vetvete. Mysafirët e hetuan frikën e Ibrahimimit në fytyrën e tij, ndaj i treguan se ishin melekë dhe si të tillë nuk kishin nevojë për ushqim. *"Mos u frikëso"*, i thanë, *"ne po të përgëzojmë me një djalë të ditur!"* Ibrahimimi, alejhisselam, i befasuar dhe i gëzuar nga lajmi iu drejtua melekëve: *"A po më përgëzoni edhe pse jam plakur tashmë?"* *"Ne po të përgëzojmë me të vërtetën"*, ia kthyen njëzëri, *"prandaj, mos e humb shpresën!"* *"E si ta humbi shpresën në mëshirën e Allahut?!"*, ia ktheu Ibrahimimi shend e verë. *"Askush nuk e humb shpresën në mëshirën e Zotit të vet, përveç njerëzve të humbur."* Ndërkohë zonja e shtëpisë, Sara, qëndronte në këmbë për të ndihmuar të shoqin ashtu siç bënin gratë në ato vise. Kur e dëgjoi lajmin e gëzuar gruaja e Ibrahimimit klithi ashtu siç klithin plakat kur befasohen nga ndonjë e papritur. *"E mjera unë"*, tha ajo, *"më thoni vallë, si mund të lind një grua shterpë dhe e thyer në moshë?"* *"Mos po çuditesh me përcaktimin e Allahut?"* - ia kthyen mysafirët. *"Përgëzohuni, pra, o familja e Ibrahimimit"*, thanë melekët, *"me Is'hakun dhe me djalin e tij Jakubin."*

Pasi i dhanë lajmin e mirë, melekët i treguan Ibrahimimit, alejhisselam, se kishin ardhur të shkatërrojnë popullin e Lutit,

të cilët e kishin tepruar me mosbesim dhe gjynahe. “Ne jemi të dërguar tek një popull kriminel!”, i thanë Ibrahimit, “Jemi urdhëruar që mbi ta të zbresim dënim nga qielli për shkak të punëve të tyre të liga.” Ibrahimit, ndërkohë që frika i ishte larguar nga gjoksi, iu drejtua melekëve me një frymë: “Po si mund t’i shkatërroji kur aty është Luti? A nuk e dini se ai është peygamber?” “Ne e dimë mirë se kush është aty, o mik i Allahut!”, ia kthyen, “Lutin dhe familjen e tij do ta shpëtojmë përveç gruas së tij, ajo do të mbetet me të shkatërruarit.” Ibrahimit, alejhis-selam, filloi të ndërmjetsonte edhe për popullin e Lutit me shpresën se ndoshta përmirësohen dhe heqin dorë nga gjynahet, por melekët e njoftuan se urdhri i Allahut nuk kthehet pas, prandaj pasi u përshëndetën me Peygamberin u nisën për tek Luti, ashtu siç qenë urdhëruar.

## Takimi me Lutin

Melekët, pasi u ndanë me Ibrahimin, alejhis-selam, u nisën drejt qytetit të Sodomës. Thuhet se kur mbërritën afër qytetit, takuan një vashëz e cila mbushte ujë nga lumi që rridhte aty pranë... Ishte njëra nga dy bijat e Lutit, alejhis-selam. Ajo qëmoti i kishte besuar Allahut të Lartësuar dhe pasonte me bindje rrugën e të atit. Melekët iu afruan ngadalë dhe e pyetën: “A ka ndonjë vend ku mund ta kalojmë natën këtej pari, o vashëz fisnike?” Vajza solli shikimin. Ç’të shihte? Tre udhëtarë... Fytyra më të bukura nuk kishte parë ndonjëherë. Duhet të jenë nga ndonjë qytet i largët mendoi vasha. U kërkoi që të prisnin aty nga frika se banorët e qytetit do t’u shkaktonin ndonjë të keqe dhe me të shpejtë vrapoi drejt shtëpisë. Pasi hyri në shtëpi dhe u përshëndet me të atin, iu drejtua atij duke i folur me zë të ulët: “O baba, më takuan në hyrje të qytetit tre udhëtarë. Në jetën time kurrë nuk kam parë njerëz me fytyra më të bukura.” “E ç’kërkoni në këto anë o bijë?”, i tha i ati me gjysëm zëri.

*"Kërkonin një strehë për të kaluar natën, o baba.",* ia ktheu e bija. *"Kujdesu për ta dhe mos lejo që banorët e qytetit t'i dëmtojnë, o babë i dashur!"* Luti, alejhis-selam, u nis me nxitim drejt brigjeve të lumit. Pasi i pa nga larg, shpejtoi hapin drejt tyre. Sapo iu afrua, e përshëndetën me selam, gjë që ia gëzoi zemrën Pejgamberit. Ua ktheu përshëndetjen me për-zemërsi, mirëpo brenga se mos të dëmtoheshin nuk e linte të qetë. Banorët e Sodomës qysh më parë ia kishin ndaluar Lutit, alejhis-selam, të pranonte mysafirë në shtëpinë e tij.

Ndërkohë udhëtarët i kërkonin një strehë sa për të kaluar natën. Sa u brengos Pejgamberi nga fjalët e tyre! U mundua t'i bindte me çdo kusht të largoheshin nga qyteti. *"Pasha Allahun, në tërë botën nuk njoh njerëz më të këqinj se banorët e këtij vendi.",* u thoshte herë pas here udhëtarëve në mënyrë që të largoheshin që andej. Mirëpo ata nuk i kthyen asnjë fjalë... Atëherë Luti, alejhis-selam, u turpërua prej tyre dhe i tha: *"A dëshironi ta kaloni natën në shtëpinë time, o udhëtarë të panjohur?"* *"Po! Këtë dëshirojmë.",* u përgjigjën njëzëri udhëtarët me fytyrat që u shkëlqenin nga nuri. Ndërkohë dielli fshihej pas maleve dhe nata po binte pa u ndjerë...

## *Në shtëpinë e pejgamberit*

Pasi u errësua, udhëtarët e panjohur së bashku me Lutin, alejhis-selam, u nisën drejt shtëpisë së tij. Nata kishte mbuluar qytetin e Sodomës anembanë, ndaj nëpër rrugë nuk shihej njeri. Pejgamberi shpejtoi hapat në mënyrë që mos të zbuloheshin nga ndonjëri prej banorëve të qytetit. Rrugë më rrugë e rrugicë pas rrugice mbërriti me një frymë në shtëpi së bashku me udhëtarët e panjohur. Për fat të mirë askush nuk e kishte parë dhe as që e kishin nuhatur se në shtëpinë e Lutit, alejhis-selam, kishin ardhur miq.

Me të mbërritur në shtëpi, e mori mënjanë të shoqen ashtu siç bën fisniku, e porositi që të gatonte darkën dhe mori besën prej saj se askujt nuk do t'i tregonte për mysafirët e panjohur. Pastaj u kthye në mesin e miqve të tij dhe filloi të kuvendonte me ta...

Ndërkaq gruaja e tij, në vend që të përgatiste ushqimin për mysafirët, me të shpejtë njoftoi disa nga banorët më të çoroditur të qytetit për djelmoshat që kishin ardhur për vizitë në shtëpinë e saj. Të prishurit e përhapën lajmin me të shpejtë nëpër qytet. Për pak kohë banorët e Sodomës u mbledhën në errësirën e natës dhe, sikur të ishin një tufë ujqërish të uritur, u nisën drejt shtëpisë së Lutit.

## Melekët

Ndërkohë që Luti, alejhis-selam, kuvendonte me miqtë e panjohur, disa zëra të mbytur ia tërhoqën vëmendjen. E ndali bisedën menjëherë... Vuri vesh dhe ç'të dëgjonte! Zërat e banorëve të qytetit ushtonin në rrugët e qytetit. Atëherë Luti e kuptoi se e shoqja e kishte tradhtuar. Sa u pikëllua i ndershmi Pejgamber! Nuk kishte askënd që ta ndihmonte. Nuk kishte as edhe një mik që ta përkrahte. Megjithatë me të shpejtë doli në oborrin e shtëpisë të përballej me turmën.

Doli në mbrojtje të mysafirëve të tij, ashtu siç bën fisniku me mikun. Ç'të shihte! Një turmë e madhe njerëzish ia kishte rrethuar shtëpinë... "O njerëz!", iu drejtua turmës me zë të lartë, "Siç e keni marrë vesh, në shtëpinë time kanë ardhur për vizitë disa miq të ndershëm, prandaj mos iu afroni atyre dhe mos i shqetësoni." "A nuk ta kemi ndaluar të presësh mysafirë?", i thanë ata. "O njerëz! Kthehuni tek familjet tuaja! Kthehuni dhe na lini të qetël!", u tha Luti, alejhis-selam, "Kini frikë Allahun dhe mos më turpëroni. A nuk ka në mesi tuaj ndonjë njeri

të arsyeshëm?” Në vend që të ktheheshin andej nga kishin ardhur, populli i Sodomës, iu kundërvunë Pejgamberit. Duke mos u frikësuar aspak nga dënimi e kërcënuan të Dërguarin e Allahut dhe më pas i thanë: *“O Lut, ti e di se kthim prapa për ne nuk ka. Ti e di mirë se çfarë dëshirojmë ne.”*

Pasi e pa këmbënguljen e tyre, Luti, alejhis-selam, me të shpejtë nxitoi brenda shtëpisë. I frikësuar e kyçi hyrjen dhe e mbështeti shpinën e tij fisnike mbi derë. Zemra i rrihte fort... Njerëzit nga jashtë iu vërsulën portës së shtëpisë së Lutit, alejhis-selam, me vrull duke synuar të hynin me forcë. Ndërkohë Pejgamberi mundohej t’ua kthente mendjen me fjalë të buta, por ata tregoheshin edhe më këmbëngulës. Sa më tepër i këshillonte aq më shumë egërsoheshin.

I lodhur dhe i munduar Luti, alejhis-selam, i ngriti duart dhe filloi ta lusë Allahun ta ndihmojë dhe t’ia largojë këtë fatkeqësi. Ndërkohë që merrte frymë thellë nga brenga që i kishte kapluar gjoksin, mysafirët u ngritën nga dhoma ku po qëndronin. Iu afruan ngadalë Lutit, i cili qëndronte i mbështetur tek dera sikur të ishte i mbërthyer me gozhdë. Pejgamberi i pikëlluar ktheu shikimin nga miqtë e tij sapo dëgjoi se po afroheshin. Si për çudi, nuk ishin aspak të frikësuar... Me fytyra që u ndriçonin nur iu drejtuan Pejgamberit duke i thënë: *“O Lut! Ne jemi të dërguar nga Allahu, ndaj mos kij frikë. Ata s’mund të na dëmtajnë aspak.”* Lutit nuk i besohej. Sapo dëgjoi se ç’thanë sikur u qetësua pak...

Në këto momente banorët e Sodomës e thyen derën dhe u turrën si egërsirat në brendësi të shtëpisë. Njëri nga melekët u doli përpara dhe me një të ngritur të krahut i goditi të gjithë të çoroditurit në fytyra duke i verbuar pa përjashtim. Askush nuk shihte më. Filluan të përplaseshin me njëri tjetrin. Disa rrëzoheshin, disa mbështeteshin nëpër muret e shtëpisë dhe të tjerët klithnin të tmerruar. Ndërkohë melekët i thanë: *“Nisu me familjen tënde para se të mbarojë nata. Ti ec pas tyre dhe*

*askush nga ju mos të shikojë prapa, por vazhdoni rrugën andej nga jeni urdhëruar!*" Më pas e lajmëruan se mbi banorët e këtij qyteti do të zbresë një dënim i tmerrshëm nga qielli, si pasojë e gjynaheve dhe paturpësisë. E lajmëruan se edhe gruaja e tij do ta shijonte të njëjtin dënim si ata. *"Dënimi i tmerrshëm do të fillojë sapo të zbardhë agimi."*, i thanë melekët, *"A nuk është agimi afër?"*

Kur filloi të lindte dielli mbi ta vërshoi dënimi i furishëm. Ndërkohë Luti, alejhis-selam, nxitonte së bashku me të bijat. Thuhet se me vete e kish marrë edhe gruan e tij megjithëse ishte pikërisht ajo që e kishte tradhtuar. Me të vërtetë Luti ishte i butë dhe i mëshirshëm me të afërmit. Nuk e ndalën hapin derisa gdhui mëngjesi...

Kur filluan të dëgjoheshin ushtrimat e tmerrshme të rrufeve dhe britmat rrënqethëse, Luti alejhis-selam i urdhëroi të afërmit e tij të mos e kthenin shikimin pas, në asnjë mënyrë. Thuhet se gruaja e tij edhe në këto momente nuk iu bind fjalës së Pejgamberit, por e ktheu kokën pas që të shihte se ç'po ndodhte në qytet. Pasi e theu përsëri urdhrin e Allahut një gur i madh i përflakur i ra nga qielli dhe e dogji trupin e saj sa hap e mbyll sytë. E goditi i njëjti dënim që e goditi edhe popullin e saj.

Biri im, të kam mësuar se Allahu nuk i vlerëson njerëzit për nga origjina, por për nga çiltërsia dhe punët e tyre. Megjithëse gruaja e Lutit ishte bashkëshorja e Pejgamberit, kjo nuk i solli kurrfarë dobie. Ajo u ndëshkua ashtu siç u ndëshkuan mosbesimtarët e tjerë dhe në Ditën e Kijametit do hidhet në zjarrin e përflakur, sepse asnjë lidhje tjetër, veç lidhjes së besimit nuk ka vlerë. Të kujtohet besoj edhe djali i Nuhut alejhis-selam?! Të kujtohet se si e gllabëroi dallga dhe u përmyt së bashku me jobesimtarët?! Mos harro pra, se njeriu në jetën e kësaj bote i përngjan bujkut që përkujdeset për tokën e tij. Ç'të mbjellë sot, do të korrë nesër. Nëse mbjell farën e besimit dhe punëve të



mira do të korrë frutin e ëmbël të lumturisë në këtë botë dhe do të shpëtojë në botën tjetër, por nëse mbjell farën e mosbesimit dhe paturpësisë, do të korrë frutin e hidhur të ndëshkimit në këtë botë dhe do të dënohet rëndë në botën tjetër. Në Ditën e Gjykimit secili njeri do të përgjigjet për veprat e tij, dhe askush, as më i afërmi i tij nuk do të mund ta ndihmojë. Ky është ligji i Allahut, ndaj beso në Allahun dhe puno mirë se do jesh kurdoherë i shpëtuar.

## Dënimi

A ke dëgjuar për dënimin e tmerrshëm që goditi Sodomën? Vallë, çfarë i goditi banorët e qytetit në të gdhirë të mëngjesit?

Sapo zbardhi dita ushtoi një zë i llahtarshëm dhe toka filloi të lëkundej... Trishtimi kaploi zemrat. Banesat filluan të shemben njëra pas tjetrës nga fuqia e tërmetit. Njerëzit të verbuar u përpoqën të dalin nga shtëpitë që të shpëtonin kokat, por ku të fshiheshin?! Një rrebesh gurësh u lëshua me furi nga qielli si dënim për ta. Çdo gur kishte të shënuar emrin i atij që do godiste në kokë. Tmerr i vërtetë... Kudo dëgjoreshin britma rrënjëthënëse dhe zëra trishtues. Sikur të mos mjaftonte kjo, thuhet se njëri nga melekët me një fuqi marramendëse e ngriti qytetin e Sodomës së bashku me fshatrat përreth në sferat qiellore. Toka, shtëpitë, banorët, bagëtitë dhe çdo gjë në qytet u ngritën lart në qiell, aq lart sa që banorët e qiellit kanë dëgjuar këngën e gjelave dhe të lehurat e qenve. Pas kësaj, Allahu e urdhëroi melekun ta kthente mbrapsht gjithçka kishte ngritur gjer në qiell dhe ta përplaste me sa fuqi që kishte nga lartësia në brendësi të tokës, si poshtërim për ta... Pasi qyteti u përplas në tokë, nga brendësia e saj shpërtheu uji, i cili gllabëroi çdo gjë. Tokat, arat, shtëpitë dhe çdo gjë u varrosën nën një liqen me ujë të kripur, për të mbetur përherë shembull i gjallë



për ata që e mohojnë Allahun, Pejgamberin dhe ata që bëjnë vepra të neveritshme.

Thuhet se edhe sot e kësaj dite qyteti Sodomës së bashku me banorët e tij gjenden të varrosur në thellësitë e Detit të Vdekur. A ke dëgjuar ndonjëherë për Detin e Vdekur? Ky det shtrihet në lindje të Jordanisë. Kripësia e ujit të këtij deti është kaq e madhe saqë asnjë gjallesë nuk mund të jetojë në thellësitë e tij, ndaj edhe quhet i vdekur. Ujin e ka të nxehtë gjatë gjithë vitit, ndërsa aromën të neveritshme që të shërbejë si shembull për popujt që vijnë pas.

Me të vërtetë në këtë ngjarje ka këshillë për atë që i druhet dënimit. I tillë është dënimi i Allahut kur ndëshkon vendbanimet ku bëhen gjynahe dhe paturpsi. Disa prej tyre qëndrojnë akoma, ndërsa të tjerat janë shkatërruar. Allahu i Lartësuar nuk u bëri atyre padrejtësi, por ata i bënë padrejtësi vetvetes.

## Shpëtimi

Allahu e shpëtoi Pejgamberin së bashku me vajzat e tij besimtare. I mbrojti bijat e tij nga shkatërrimi dhe i nxori nga errësitat në dritën e udhëzimit.

Biri im! Bëj durim ndaj vështirësive, ruaje besimin dhe kujdesu për namazin, sepse përfundimi i lumtur dhe lavdia i takon Islamit dhe muslimanëve. Adhuroje Allahun dhe të jesh bindur se pas vështirësisë vjen lehtësimi, të jesh i bindur se pas natës, sado të zgjasë ajo, zbardh agimi.

Biri im nuk është e njëjtë errësira me dritën, as e mira me të keqen dhe as fisnikëria me paturpsinë sado që të shumohet e keqja dhe paturpsia. Ndaj kij frikë Allahun dhe mos harro se e mira, morali i lartë dhe fisnikëria është e vetmja rrugë shpëtimi, sado i vogël të jetë numri i atyre që pasojnë fisnikërinë dhe

moralin e lartë. Ruaje pra, fisnikërinë dhe tregohu i sjellshëm edhe nëse mbetesh vetëm në mesin e njerëzve të prishur, duke qenë i bindur se Allahu i Lartësuar do të të ndihmojë ashtu siç ndihmoi Lutin dhe vajzat e tij të ndershme.

Luti, alejhis-selam, udhëtoi bashkë me të bijat drejt tokave të bekuara të Palestinës. Mezi priste të takonte mikun e Allahut. Eh, sa mall kishte për Ibrahimin. Më në fund, Allahu i Lartësuar ia mundësoi të bashkohej me xhaxhanë e dashur pas shumë e shumë vitesh. Thuhet se i qëndroi pranë Ibrahimit, alejhis-selam, derisa ndërroi jetë. Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin kurdoherë mbi Lutin.

## Ismaili

Biri im! Kurdo që të shuash etjen me Zemzém, mos harro se pas këtij uji të bekuar fshihet një Pejgamber i nderuar. Mos harro se një melek madhështor zbriti nga sferat qiellore në mesin e dy kodrave pa jetë për nder të këtij Pejgamberi. U urdhërua të godiste rërën e shkretëtirës me krahun e tij fisnik derisa nga thellësia e tokës të gufonte ujë i kthjellët dhe i ftohtë me qëllim që të shuante etjen ky Pejgamber dhe nëna e tij. Besoj se e kuptove se për kë e kam fjalën, apo jo?!

Të gjithë besimdrejtët e përkujtojnë dhe e nderojnë këtë njeri. Biri i bekuar i Ibrahimit, mikut të Allahut. Stërgjyshi i parë i arabëve që jetuan rreth Mekes. Të gjithë e lavdërojnë dhe i shprehin mirënjohje atij sa herë që festojnë Kurban Bajramin. E si të mos e nderojnë vallë?! Si mund të harrohet djaloshi që ishte gati të jepte jetën e tij për të zbatuar urdhrin e Zotit të Lartmadhërishëm?! Me të vërtetë shembulli i këtij të riu mbeti i rrënjosur në historinë e njerëzimit, ndaj emri i tij përmendet edhe pas mijëra vitesh. Ismaili – djali i bekuar i Ibrahimit.

Biri im, ndalu pak dhe mendo! Ndërkohë që Ismaili, alejhis-selam, ishte i gatshëm të dhuronte shpirtin e tij për të arritur dashurinë e Allahut të Lartësuar dhe kënaqësinë e Tij, po ti, a nuk e dhuron pak nga koha e jote për të kryer me kujdes pesë namazet me të cilat je urdhëruar? A nuk je gati të flijosh pak nga koha e jote për leximin dhe mësimin e Kur'anit Fisnik, duke e ditur se aty fshihet Kënaqësia e Allahut të Lartësuar?

Siç të kam rrëfyer më parë, Ismaili alejhis-selam u rrit në prehrin e një nëne besimtare, nën përkujdesin e një babai Pejgamber. Burrë e grua mbollën në gjoksin e Ismailit farën e besimit të drejtë, moralit të lartë dhe fisnikërisë, farën, e cila u rrënjos thellë në zemrën e djaloshit. Ç'të mbjellësh do të korrësh. Kur u rrit, Ismaili u bë shembull i besimtarit të vendosur. Gjithnjë në shërbim të nënës së tij, gjithnjë i dobishëm, si pema që jep frutat e saj në çdo stinë.

Bir i dashur, familja është e shenjtë dhe e rëndësishme, ndaj edhe prindi tregon kujdes të veçantë për edukimin e pasardhësve të tij. Kush e di sa e sa herë udhëtoi Ibrahim, alejhis-selam, nga Palestina deri në Meke për t'i qëndruar pranë të shoqes dhe të birit që rritej dita-ditës! Kush mund ta përshkruajë lodhjen e plakut ndërkohë që kalonte viseve të panjohura vetëm për t'i dhuruar të birit një këshillë. Askush nuk e di se sa i vështirë ishte udhëtimi i gjatë nën diellin përvëlues të shkretëtirës pa fund...

Bir im! Prindi mundohet natë e ditë me shpirt ndër dhëmbë për të mirën e fëmijëve, ashtu siç mundohet bariu me kopenë e tij në errësinën e natës me stuhi... Tregohu mirënjohës pra, mos e shkel të mirën me këmbë, se prindit i lëndohet shpirti. Me të vërtetë prindi nganjëherë e humbet durimin, por mos harro se ai lodhet shumë gjatë ditës dhe mos harro se edhe fëmijët e tij jo rrallëherë e hidhërojnë. Biri im! Nderoje prindin edhe kur të përkëdhel edhe kur të qorton, edhe kur është i drejtë edhe kur të duket i padrejtë pasi porosinë dhe këshillat e tij janë si farët e bekuara që mbolli baba Ibrahim në zemrën e Ismailit.

A nuk mahnitesh tek sheh Qaben e ndershme kur muslimanët grupe-grupe sillen rreth saj duke bërë tavaf? A nuk i sheh si mblidhen të gjithë tok, sikur të ishin një trup i vetëm, megjithëse kanë ngjyra të ndryshme dhe flasin gjuhë që nuk përngjajnë njëra me tjetrën? A nuk mallëngjehesh me turmën

ku nuk ka dallim mes të bardhit dhe të ziut, mes të pasurit dhe të varfërit, mes shërbëtorit dhe zotërisë? Për sa e sa shekuj njerëzit nga mbarë bota e vizitojnë Qaben dhe bëjnë tavaf rreth saj në çdo kohë, nën rrezet përvëluese të diellit dhe në errësirën e natës kur dielli perëndon... A nuk e di ti se miliona njerëz drejtohen me nderim drejt saj teksa rreshtohen për çdo namaz?

Mijëra ndërtesa shumëkatëshe janë harruar dhe janë braktisur me kalimin e viteve, mijëra ndërtime madhështore kanë mbetur të shkreta ngase askujt nuk i interesojnë, sa e sa të tjera të skalitura si mos më mirë janë rrënuar dhe as që i përmendet më emri; ndërsa një ndërtesë e thjeshtë prej guri, e pa stolitur dhe pa dritare pret dhe përcjell mysafirë ditën e natën... Nuk numërohen, kaq shumë janë. Burra e gra, të rinj e të reja, pleq e fëmijë nga çdo skaj i globit e vizitojnë çdo moment. A nuk e pyet veten: "Çfarë fshihet vallë pas mureve të saj që e bën këtë ndërtim të thjeshtë prej guri ndërtesën më të dashur për zemrat e miliona njerëzve?"

Bir i dashur, dije se pas mureve të Qabes fshihet çiltërsia dhe puna e palodhur e një plaku të nderuar dhe një të riu fisnik. Pas çdo guri në murin e saj fshihet dashuria dhe bashkëpunimi i babait me të birin. Ky është sekreti i Qabes së ndershme. Ndaj mos harro se çfarëdo të ndërtosh për të arritur kënaqësinë e Allahut mbetet e nuk rrënohet kollaj. Edhe nëse rrënohet ndërtesa, emri i atij që i ngriti muret e saj mbetet ndër mote ashtu siç mbeti emri i Ismailit, alejhis-selam, dhe babait të tij.

Ismaili e nderonte të atin dhe pasonte rrugën e tij, mbështetej tek Ibrahimit ashtu siç mbështetet miku tek miku. Është e pamundur ta ndash historinë e tij nga ajo e atit të tij, Ibrahimit, alejhis-selam. Ndaj edhe unë rrëfimin mbi jetën e Ismailit ia kam bashkangjitur historisë së Ibrahimit, siç e kujton. Të kujtohet, besoj, se Ismaili jetoi së bashku me nënën nën përkujdesjen e fisit Xhurhum në luginën e Mekes. Prej tyre mësoi

arabishten e kulluar, virtytet e larta dhe gjuetinë. Besoj se të kujtohet edhe historia e martesës së tij.

Allahu i Lartësuar e ka përmendur emrin e këtij peygamberi disa herë në Kur'anin Famëlartë dhe e ka lavdëruar atë duke thënë: *"Ismaili i ka plotësuar premtimet e dhëna dhe ka qenë Pejgamber. Ai e urdhëronte familjen të kryente namazin dhe të jepte zekatin, dhe Zoti i tij ishte i kënaqur me të."* Allahu i Lartësuar na bën me dije se është i kënaqur me Ismailin për shkak të disa cilësive fisnike. Dije pra, se cilitdo besimtar që i janë dhuruar këto cilësi, i është dhuruar mirësi e madhe. Besnikëria në përmbushjen e betimeve, kujdesi ndaj namazit dhe përkujdesi ndaj familjes.

Besnikëria është një ndër cilësitë e lëvduara të Ismailit dhe pasardhësve të tij. Dije bir, se besniku do jetë gjithmonë i respektuar në mesin e njerëzve, qofshin edhe armiqtë e tij. Besnikëria është shpëtim, kurse tradhëtia shkatërrim. Besnikëria është fisnikëri ndërsa tradhtia është dobësi në këtë botë dhe poshtërim në botën tjetër. A nuk e di ti se tradhtia është cilësi e dyfyturëshit? Atij kur i besohet diçka, tradhëton...

Në Ditën e Gjykimit, kur t'i tubojë Allahu të parët dhe të mbramët, çdo tradhtari do t'i ngrihet një flamur me të cilin do të dallohet në mesin e njerëzve dhe do të poshtërohet për tradhtinë e tij në mes të turmës. Ndaj tregojë të vërtetën dhe ruaje besnikërinë kudo që të jesh, mos mendo se gënjeshtria dhe tradhtia është zgjuarsi siç mendojnë shumë njerëz sot. Biri im, dije se besnikëria është stolia e besimtarit, është shenjë dalluese e burrërisë dhe fisnikërisë. Prandaj profeti Muhamed, pasardhësi i Ismailit thotë: *"Plotësoja amanetin atij që ta ka besuar, dhe mos e tradhëto atë që të ka tradhëtuar."* Kush e di sa e sa burra e kanë dhënë jetën për hir të besnikërisë. Besnikëri ndaj fesë, besnikëri ndaj familjes, ndaj shokut, besnikëri në përmbushjen e premtimit, besnikëri në fjalë... Islami na nxit të jemi njerëz të besës. Të gjithë Pejgamberët dhe pasuesit e tyre

kanë qenë të tillë. A nuk të kujtohet Ismaili? I premtoi të atit se do jetë i durueshëm dhe u tregua vërtetë i durueshëm.

Thuhet se Ismaili, alejhis-selam, është i pari që ka zbutur dhe ka shaluar kalin e egër. Kuajt e famshëm arabë kanë qenë të egër dikur, por thuhet se Ismaili e ka lutur Allahun të nënshtohen e të zbuten dhe ashtu ka ndodhur. Ai ka qenë Pejgamberi i banorëve të Mekes dhe krahinave rreth saj. Ismaili është stërgjyshi i fisit Kurejsh dhe stërgjyshi i profetit Muhamed, alejhis-selam. Ka qenë gjuetar i shkëlqyer dhe shigjetar me nam. Emri i tij ishte shumë i njohur në mesin e arabëve, megjithëse atij nuk i interesonte aspak nami. Kaloi një jetë të thjeshtë. Jetoj me devotshmëri ashtu siç i takon një Pejgamberi.

Thuhet për të se ka vdekur në moshën 137 vjeçare dhe është varrosur afër Qabes. Thuhet se Allahu Mëshirëplotë i ka shpallur para se të vdiste Ismaili, alejhis-selam, këto fjalë: *“O Ismail! Unë do t’i hap për ty dyert e Xhenetit në mënyrë që flladi i tij të të freskojë kudo që të varrosesh, deri në Ditën e Kijametit.”*

## Fisniku – i biri i fisnikut

Biri im, Allahu i Lartësuar e ka përzgjedhur Ibrahimin alejhis-selam në mesin e të gjithë të Dërguarve dhe i ka dalluar pasardhësit e tij duke ia dhuruar pejgamberinë dhe librat qiejllorë. Për shkak të vlerës së këtij burri fisnik, Allahu i Lartësuar na e ka obliguar përshëndetjen ndaj tij dhe familjes së tij ashtu siç na ka obliguar ta përshëndesim të Dërguarin tonë, profetin Muhamed, alejhis-selam, në çdo namaz. A nuk themi në çdo teshehud: Allahu-me Sali ale Muhamed ue ale eli Muhamed, keme salejte ale Ibrahim ue ale eli Ibrahim?! *"O Allah nderoje dhe dërgo bekimet e tua mbi Muhamedin dhe familjen e tij ashtu siç bëre me Ibrahimin dhe familjen e tij!"* Po cilët janë këta pjestarë të familjes së Ibrahimit ndaj të cilëve lutemi në përfundim të çdo namazi?

Le ta dish se ata janë Pejgamberët e nderuar që pasuan rrugën e mikut të Allahut. Ndër më të nderuarit në mesin e të nderuarve janë dy bijt e tij: Ismaili dhe Is'haku alejhis-selam. Meqë rrëfimin e Ismailit, alejhis-selam, e mësove, tashmë rradhën e ka vëllai i tij. A ke dëgjuar diç për këtë Pejgamber të nderuar? Ky burrë është fisniku, i biri i fisnikut. Në këtë mënyrë e ka quajtur Pejgamberi Muhamed, alejhis-selam, djalin e bekuar të Ibrahimit, alejhis-selam.

Thuhet se Is'haku ka lindur katërmbydhjetë vite pas vëllait të tij, Ismailit. Me të vërtetë lindja e tij ishte një mrekulli. Besoj se e mban në mend rrëfimin e mysafirëve të Ibrahimit, apo jo? Besoj të kujtohet se si e përgëzuan me lindjen e një djali të ditur me emrin Is'hak?



Ibrahimi, alejhis-selam, asokohe ishte i shtyrë në moshë, po ashtu edhe e shoqja, Sara. Për më tepër ajo ishte një grua që nuk lindte fëmijë. Megjithatë në kohën e caktuar ajo me të vërtetë e lindi djalin me të cilin e përgëzuan melekët. Burrë e grua u gëzuan shumë me lindjen e tij. E si mund të mos gëzoheshin?! Kush e di për sa kohë e kishin pritur një fëmijë. Foshnjen e porsalindur e quajtën Is'hak ashtu siç ishin porositur më parë...

Is'haku u rrit në prehrin e Ibrahimit, i cili u përkujdes për edukimin e tij për sa pati jetë. Kur e hodhi shtatin dhe arriti të kuptojë, Allahu i Lartësuar i dhuroi zgjuarsin dhe e bëri të dashur ndaj prindërve. Is'haku dallohej nga bashkëmoshatarët e tij për diturinë e madhe, për moralin e lartë dhe virtytet fisnike. Adhuronte Allahun e Lartësuar me përkushtim ditën dhe natën, ndihmonte prindërit e tij dhe përkujdesej për ta në mënyrën më të mirë. Pasonte hapat e të atit dhe së bashku me të i ftonin njerëzit në fenë e vërtetë. Is'haku u bë i njohur në qytet për urtësinë e tij dhe diturinë e thellë, ndaj të gjithë i drejtonin shikimet nga ai kur gjykonte në mesin e tyre. Is'haku, djali i Ibrahimit. Fisniku, i biri i fisnikut.

Emri i tij përmendej gjithandej, mirëpo ai nuk mbahej me të madh. Lavdet nuk i interesonin aspak, ndaj kalonte jetë të thjeshtë duke adhuruar Allahun dhe duke i shërbyer njerëzve me përkushtim dhe çiltërsi. Kur Is'haku arriti pjekurinë, Allahu e bëri Pejgamber dhe ia zbriti shpalljen.

## *Një fe e vetme*

Ibrahimi, alejhis-selam, është stërgjyshi i të gjithë Pejgamberëve që vijnë pas tij. Të gjithë e kanë prejardhjen nga dy bijt e tij: Ismaili dhe Is'haku. Dije se të gjithë Pejgamberët paskan rrugën e Ibrahimit, alejhis-selam. Të gjithë, pa përjashtim ndoqën fenë që Ibrahimi, alejhis-selam, ua la porosi bijve të

tij: Ismailit dhe Is'hakut... Bëhu i vëmendshëm dhe mbaje mirë në mend këtë që po të tregoj! Përpara se të ndërronte jetë, Ibrahim, alejhis-selam, iu drejtua bijve të tij duke u thënë: *"O bijt e mi, Allahu i Lartësuar ka zgjedhur për ju fenë e vërtetë, prandaj përmbahuni kësaj feje dhe mos vdisni ndryshe veçse duke qenë muslimanë të nënshtruar ndaj Tij."*

O bir, Ibrahim nuk ka qenë as hebre dhe as i krishterë, por ka qenë musliman, besimdrejtë dhe larg besimeve të kota. Të tillë kanë qenë edhe Pejgamberët pas tij, vëllezër të një feje, megjithëse të lindur nga nëna të ndryshme. Ibrahim, alejhis-selam, i porositi djemtë e tij t'i përmbahen fesë islame, fesë që Zoti e përzgjedhi për ta. Ashtu vepruan edhe djemtë e tij me pasardhësit e tyre, i porositen t'i përmbahen fesë islame, fesë së vërtetë, fesë së Ibrahimit, paqja e Allahut qoftë mbi të. Ndaj mos harro se të gjithë Pejgamberët kanë qenë muslimanë. Mos harro se feja e vetme e pranuar në mbretërinë e qiejve është Islami: besimi se nuk meriton të adhurohet askush me të drejtë përveç Allahut dhe nënshtrimi ndaj Tij me dashuri dhe madhërim. Çdo fe tjetër është devijim i të vërtetës së shpallur nga Zoti i botëve. Cilido që kërkon fe tjetër veç Islamit, atij kurrseksi nuk i pranohet dhe në botën tjetër do të jetë nga të humburit. A ka kuptim që nga një Zot i vetëm të burojnë disa fe?! Atëherë ruaje me besnikëri këtë fe me të cilën na ka nderuar Zoti i jonë, o bir, ashtu siç bëri Ibrahim, alejhis-selam, dhe pasardhësit e tij. E kush ka fe më të mirë se ai që më çiltërsi i bindet Allahut duke qenë mirëbërës dhe pason fenë e drejtë të Ibrahimit?! A nuk e zgjedhi Allahu Ibrahimin për mik të ngushtë?! Is'haku pra, ishte musliman ashtu si i ati, Ibrahim. Ai është paraardhësi i shumicës së Pejgamberëve duke filluar me Jakubin, Jusufin, Musën, Harunin, Davudin, Sulejmanin, Zekerijanë, Jahjanë e deri tek Isai, i biri i Merjemes. Këta janë burrat që Allahu i ka udhëzuar në rrugën e drejtë, ndaj edhe ti, o biri im, paso rrugën e tyre. Dhe thuaj: *"Unë besoj në Allahun,*

*Rrëfimet më të mira*

*besoj në Kur'anin Fisnik, besoj në atë që iu shpall Ibrahimit, Ismailit, Is'hakut, Jakubit dhe pasardhësve të tij. Besoj në librin që iu shpall Musait, Isait dhe në librat që Allahu ia shpalli të gjithë Pejgamberëve. Unë nuk bëj kurrfarë dallimi midis tyre dhe vetëm Allahut i përulem."*

## Jakubi

Biri im! Të kam rrëfyer për mysafirët e Ibrahimit, alejhis-selam, për melekët që e përgëzuan mikun e Allahut me lindjen e Is'hakut dhe me lindjen e Jakubit. Të kam rrëfyer tashmë diç nga historia e Is'hakut: për lindjen e tij të jashtëzakonshme, nga një baba i thyer në moshë dhe nga një nënë shterpë, për diturinë e gjerë që i kishte dhuruar Allahu i Lartësuar dhe për disa nga virtytet e këtij Pejgamberi. Në vazhdim do të hedh dritë mbi historinë e djalit të tij, mbi historinë e Jakubit, pagja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të. Kjo është historia e Pejgamberit për lindjen e të cilit melekët e përgëzuan gjyshin e tij, Ibrahimin, shumë vite para se kjo të ndodhte...

Me të vërtetë ato që thuhet për historinë e tij në dorëshkrimet e të krishterëve dhe hebrejve janë të shumta, por unë do përpiqem të të përcjellë vetëm pak nga ajo që përmendet, me qëllim që t'i lë vend ngjarjes më të bukur e më me vlerë që tregohet për këtë Pejgamber fisnik. Cila është kjo ngjarje? Përse bën fjalë, vallë? Kush e përcjell atë? Do të të tregoj në vazhdim, ndaj bëhu i durueshëm dhe më ndiq me vëmendje...

### *Në dorëshkrimet e hershme*

Thuhet se kur Is'haku, alejhis-selam, babai i këtij Pejgamberi fisnik, ishte dyzet vjeç u martua me një vashë që quhej Rebeka. Ajo nuk lindte fëmijë, por Is'haku iu lut Allahut të

Lartësuar për të dhe, për çudi, në kohën e caktuar ajo lindi dy binjakë: Esaun dhe Jakubin, alejhis-selam.

Thuhet se kur u rritën dy binjakët, Is'haku, alejhis-selam, iu lut Allahut të Lartësuar që ta bënte të dalluar Jakubin mbi mbarë pasardhësit e tij, iu lut t'i dhuronte pasuri dhe fëmijë të shumtë dhe ta bënte të nderuar në mesin e njerëzve. Përmendet gjithashtu se, si pasojë e një zënke me të vëllanë, ai u detyrua të udhëtonte nga Palestina drejt një qyteti në Irak, të quajtur Haran, derisa Esaut, vëllait të tij, t'i kalonte hidhërimi.

Thuhet se kur ra nata, Jakubi, alejhis-selam, u shtri në një vend dhe fjeti. Pasi e zuri gjumi, filloi të ëndërronte disa shkallë të ndritshme që zbrisnin nga qielli në Tokë, nëpër të cilat uleshin melekët një pas një. Në ëndërr dëgjoji t'i thuhej se Zoti i Madhërishëm do ta bekonte, do t'i jepte pasardhës të shumtë dhe tokën mbi të cilën ndodhej do t'ia dhuronte atij dhe pasardhësve të tij. Kur u zgjua, gati sa nuk fluturonte nga gëzimi. Me të shpejtë iu afrua një guri dhe e leu me vaj, në mënyrë që ta njihte në të ardhmen dhe u betua se, nëse do të kthehej ndonjëherë nga Iraku, mu afër këtij guri, do ta ndërtonte një faltore për adhurimin e Allahut. Thuhet se ky vend është Jeruzalemi i sotëm...

Përmendet se pas një udhëtimi të gjatë e të mundimshëm ka mbërritur në Haran ku ka punuar si bari dhensh për katërmbëdhjetë vite. Ndërkohë që martuar me dy vasha: me Lean dhe Rahelën. Thuhet se Lea i dhuroi Jakubit, alejhis-selam, shumë fëmijë ndërsa Rahela nuk lindte. Ajo e luti Allahun Fuqplotë t'i dhuronte një djalë me Jakubin dhe me të vërtetë Allahu ia pranoi lutjen. Ajo i dhuroi Jakubit djalin më të dalluar, Jusufin, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të.

Pas një kohe të gjatë, thuhet se Allahu e urdhëroi Jakubin, alejhis-selam, të kthehej tek të afërmit e tij në Palestinë, duke i premtuar se do ta ndihmonte kurdoherë. Kështu Jakubi u nis

bashkë me familjen e tij të madhe, bagëtitë dhe pasurinë e tij drejt tokave të bekuara të Ken'anëve. Natën udhëtonin dhe ditën pushonin. Përmendet se në natën e tretë të udhëtimit, para se të zbardhëllonte agimi, iu shfaq një melek në pamjen e një burri. Jakubi mendoi se ishte njeri i lig, prandaj iu afrua dhe filloi të përleshej me të panjohurin. Sapo shpresoi se ngadhñjeu mbi të, meleku e goditi fort në kofshë duke e lënë të çalë. Atëherë i panjohuri iu afrua dhe i tha se prej kësaj nate do të quhej Israil. Jakubi e pyeti se kush ishte, por ai u zhduk. Atëherë Jakubi e kuptoi se kishte qenë njëri nga melekët e Zotit.

Pas kësaj ndodhie Jakubi, alejhis-selam, së bashku me gjithçka kishte, udhëtoi edhe disa ditë derisa mbërriti në një vend të quajtur Sair. Thuhet se kur Esau e mori vesh se po vinte Jakubi i doli përpara të vëllait me nijet të keq, por sapo e pa së bashku me gratë dhe fëmijët e tij zemërimi i dikurshëm iu largua. Iu afrua Jakubit, alejhis-selam, e përqafoi ashtu siç bën vëllai me vëllanë, e puthi dhe filloi të qante. Pas kësaj ndodhie, thuhet se Jakubi, alejhis-selam, u nis drejt luginës Sahore dhe mu aty ndërtoi shtëpinë e tij. Më pas bleu nga Shehim bin Xhimuri një livadh të gjërë për të kullotur delet dhe në këtë vend ngriti faltoren e parë në Palestinë për adhurimin e Allahut të Lartësuar. Këtë faltore e ndërtoi afër gurit që e kishte lyer me vaj gjatë udhëtimit të tij drejt Haranit, ashtu siç ta përmenda më parë. Mendohet se kjo ndërtesë është faltorja e famshme e Jeruzalemit, godina që do të rindërtohej nga profeti Sulejman pas shumë e shumë kohësh...

### *Xdër historitë më të bukura*

Gjithsa të rrëfeva për Jakubin gjendet e shkruar në disa libra të vjetër, në dorëshkrime të cilave nuk u dihet vërtetësia. Për këtë arsye nuk të kam përmendur veçse një pjesë nga historia e këtij burri fisnik. Bir i dashur! E kam të pamundur ta

ndaj rrëfimin e Jakubit nga historia e të birit, Jusufit, për shkak të lidhjes së jashtëzakonshme ndërmjet tyre. Për më tepër, të pandarë e ka sjellur edhe Allahu i Lartësuar në Kur'anin Fisnik, në një sure që njihet si njëra ndër suret më të bukura, plot e përplot me dobi dhe mësim. Ndaj edhe unë, rrëfimin mbi jetën e Jakubit do të ta tregoj të bashkëngjitur me tregimin e Jusufit, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të dy, sepse e tillë përmendet në Kur'anin Famëmadh.

## Ëndrra

Allahu i Lartësuar i kishte dhuruar Jakubit, alejhis-selam, dymbëdhjetë djem, në mesin e të cilëve njëri ishte i dalluar për nga pamja dhe morali i tij i lartë. Ky ishte Jusufi, i biri i Rahelës, një djalosh tejmasë i bukur. Jo vetëm kaq! Ai ishte i zgjuar, mendjemprehtë dhe shumë i edukuar me prindërit e tij, ndaj Jakubi, alejhis-selam, e donte si sytë e ballit. E mban-te gjithmonë në gji si pëllumbin e butë. Dashuri, kjo, që se shuante dot as uji i detit. Të gjithë e dinin se Jusufi dhe vëllai i tij për nga nëna, Ben'jamini ishin më të përkëdhelurit dhe të dashurit e Jakubit. Në krahërorin e Jakubit ishte streha e tij. Fjalët e ëmbla dhe këshillat e urta të të atit ishin melhem për të. Përkëdhelia e të atit i sillte pranverën në zemër. Shtati i tij i vogël rritej nën përkujdesjen dhe mbikqyrjen e vazhduar të Pejgamberit të Allahut, Jakubit, alejhis-selam.

Një natë, teksa gjumi e kishte kapluar, Jusufi i vogël, pa një ëndërr të çuditshme: hënën, diellin dhe njëmbëdhjetë yje i pa tek i binin në sexhde. Me t'u zgjuar nga gjumi, vrapoi tek i ati për t'ia treguar ëndrrën. Pasi e përqafoi dhe e përshëndeti, e tërhoqi mënjanë dhe filloi t'ia kallëzonte ëndrrën e habitshme. "O babush!", i tha Jusufi, "Unë pashë në ëndërr njëmbëdhjetë yje, diellin dhe hënën! I pashë të më binin në sexhde." Sapo dëgjoji fjalët e të birit, Jakubi, alejhis-selam, iu drejtua dhe i

tha: *"O djali im! Mos ua trego ëndrrën tënde vëllezërve, pasi kam frikë se i mashtron shejtani dhe kurdisin ndonjë kurth kundër teje."*

Jakubi ishte Pejgamber i Allahut. Ishte shumë i ditur dhe mendjemprehtë. Ai e kishte nuhatur tashmë aromën e xhelozisë dhe zilisë që kishin vëllezërit ndaj Jusufit. Por nga ana tjetër e kuptoi se kjo ëndërr bart me vete përgëzim për dituri dhe pejgamberi, ndaj me fytyrën që i shkëlqente nga nuri, iu drejtua edhe një herë të birit duke i thënë: *"Lum për ty, o bir! Dije se Allahu të ka përzgjedhur dhe do të ta mësojë shpjegimin e ëndërrave. Allahu do ta plotësojë mirësinë e Tij ndaj teje dhe familjes sonë, ashtu siç e ka plotësuar më parë ndaj gjyshërve të tu, Ibrahimit dhe Is'hakut."* E në fund Jakubi i dha një porosi të madhe të birit, një porosi të vlerë të cilën Jusufi nuk do ta harronte kurrë. *"O bir i dashur!",* i tha me përzemërsi babai, *"Jetën e ke përpara. Shumë të papritura mund të të godasin, por asnjëherë mos e humb shpresën. Kurrë mos harro se Allahu është i Gjithëdjishëm dhe i Urtë."*

Po çfarë mesazhi bart porosia e Jakubit vallë? Përcille me vëmendje se ç'po të them dhe vare si vath në vesh! Kjo porosi është formula e tejkalimit të vështirësive dhe të papriturave që me doemos e godasin çdo njeri në jetën e kësaj bote. Allahu i Lartësuar, o bir, ka caktuar se pozita e lartë nuk arrihet me lehtësi, por vjen pas shumë e shumë sprovave me të cilat duhet të përballet njeriu. A nuk e sheh vetë se sa shumë duhet të punosh për të arritur rezultate të larta në shkollë?! A nuk e sheh se sa mund të duhet të dalësh në mesin e nxënësve të dalluar?! Me pak fjalë, sa më lart të synosh aq më shumë mund të sprovohesh. Ama sidoqoftë, nëse je i bindur se këto sprova janë caktuar nga Allahu i Gjithëditur, nga Mirëbërësi, nga i Urti dhe je i bindur se pas tyre fshihet lartësimi i pozitës tënde, duhet që me çdo kusht të durosh, ngaqë pas vështirësive vjen lehtësimi, pas errësirës vjen agimi. Edhe Jakubi, alejhis-selam,



posa dëgjoji ëndrrën e të birit e kuptoi se Jusufi do ngrihej në një pozitë të lartë. Ama ishte i bindur se deri atëherë i dashuri i tij do përballej me lloj-lloj vështirësish, ndaj e porositi të birin të mbështetej në Allahun e Lartësuar dhe asnjëherë të mos harronte se çdo gjë që e godet ndodh me caktimin e Atij që është i Urtë dhe i Gjithëditur. Ai i njeh mirë aftësitë e robërve të Tij ndaj me urtësi u dërgon sprovë në mënyrë që të dalin në shesh vlera dhe pozita e secilit; ashtu siç vepron argjendari kur vendos në zjarrin përcëllues metalet, që të dallohet ari nga bakri apo argjendi nga bronxi.

## Zilia

Përkujdesja dhe dashuria e madhe e Jakubit, alejhis-selam, ndaj Jusufit dhe vëllait të tij ngjalli zili dhe inat në zemrat e vëllezërve të tjerë. Herë pas here mundoheshin të gjenin një mënyrë që babai t'i donte vetëm ata dhe të largohej nga Jusufi... Po, si t'ia arrinin vallë një dite të tillë?

*"Pasha Allahun, Jusufi dhe vëllai i tij i vogël janë më të dashur tek babai se ne, ndër kohë që ne jemi djelmosha të fortë ndërsa ata të dy të dobët dhe të vegjël.",* i thonin njëri-tjetrit, *"Me të vërtetë babai ynë, po gabon ndaj nesh."* Shejtani i mallkuar shfrytëzoi zilinë e vëllezërve për të dëmtuar një herë e mirë Jusufin e vogël dhe për të hidhëruar të atin e tij fisnik, Jakubin. Kur e kuptoi, i mallkuari, se zilia dhe inati ishte ndezur prush në zemrat e vëllezërve, u hodh në sulm. Nëpërmjet pëshpëritjeve dhe mashtrimeve të tij i udhëzoi vëllezërit drejt veprës më të shëmtuar, vrasjes së Jusufit. *"Vriteni Jusufin ose braktiseni në ndonjë vend të largët",* thanë, *"se vetëm kështu babai do të kthehet nga ju, e pas kësaj, do të bëheni njerëz të mirë."* Njëri prej tyre tha: *"Mos e vritni, por hidhjeni në fundin e ndonjë pusi, në mënyrë që ta marrë ndonjë karvan që kalon andejpari."* Të gjithë u pajtuan me këtë mendim, por si t'ia

arrinin vallë? Si mund t'ia bënin atëherë kur Jakubi e mbante djalin fisnik gjithmonë me vete?

Me ndihmën e shejtanit të mallkuar, aty për aty, thurën kurthin djallëzor ndaj vëllait të tyre. Të gjithë së bashku erdhën tek Jakubi, alejhis-selam, dhe i thanë: *"O babai i jonë! Përse për Jusufin nuk ke besim tek ne?! Në të vërtetë ne dëshirojmë çdo të mirë për të. Përse asnjëherë nuk e lejon të kullojë bagëtinë së bashku me ne?"* "Lejaje nesër të vijë me ne që të argëtohet dhe të luajë në lëndinat e gjelbëruara nga bari. E mos kij fare merak për Jusufin, mbasi ne do të kujdesemi për të."

Jakubi u tha: *"Unë brengosem për Jusufin po ta merrni me vete. E kam të vështirë të ndahem prej tij. Për më tepër kam frikë se ju do të habiteni pas lojës dhe atë mund ta hajë ujku, ngaqë është i vogël e nuk mund të mbrohet vetë."* "E si mund ta hajë ujku", thanë njëzëri, "ndërkohë që ne jemi një grup i fortë! O babush, mos u brengos dhe as mos u frikëso për të, se do kthehet shëndosh e mirë." Kaq këmbëngulës u treguan, sa më në fund e bindën Jakubin. Ai u pajtua me kërkesën e tyre dhe e lejoi Jusufin të shkonte me ta...

## Pusi

Me të zbardhur e nesërmja, vëllezërit u nisën tok drejt lëndinave për të kullotur bagëtinë. Ndryshe nga herët e tjera, atë ditë kishin me vete edhe vëllanë e vogël Jusufin, djalin e Rahelës. Me buzën në gaz luanin me njëri-tjetrin ashtu siç e kanë zakon qengjat e vegjël, por me t'u larguar nga vendbanimi i tyre filluan ta tallin dhe ta lëndojnë Jusufin. Nuk iu dhimbsej aspak i gjori dhe as që donin t'ia dinin për besën që i kishin dhënë babës plak. E si vepruan vallë me vëllanë e vogël?

Me të mbërritur tek një kodër afër kullotave e kapën Jusufin ashtu siç bëjnë ujqërit e uritur, ia hoqën këmbëshën që

mbante veshur dhe e hodhën në një pus të thellë dhe të errët që gjendej aty pranë. Nga prehri i ngrohtë i babës, në pusin e ftohtë dhe të errët. Sa e vështirë! Në errësirën e pusit, Jusufi, alejhis-selam, filloi t'i lutej Allahut të Lartmadhërishëm që t'ia largonte brengën dhe ta nxirrte nga thellësitë e tij. E kush tjetër veç Allahut i përgjigjet nevojtarit, kur me çiltërsi lutet, duke ia larguar vështirësinë dhe duke ia lehtësuar brengën?!

Allahu i Lartmadhërishëm ia dërgoi Xhibrilin Fisnik që t'ia qetësonte shpirtin dhe t'ia largonte frikën e vetmisë djaloshit. Jo vetëm kaq! Xhibrili e përgëzoi djaloshin se do të shpëtojë nga kjo vështirësi dhe se do të vijë dita kur vetë Jusufi, alejhis-selam, do t'ia përkujtojë vëllezërve këtë vepër të shëmtuar.

Bir i dashur! Lutja është çelësi i mirësive. Nëse fatkeqësitë që të godasin u përngajnë shigjetave të mprehta, mos harro se lutja i përngjan mburojës së hekurt që të mbron prej tyre,

## Tek Jakubi

Pasi e hodhën Jusufin, alejhis-selam, në pus, vëllezërit u larguan me të shpejtë. U nisën, tashmë pa djaloshin, drejt kullotave për të kurdisur një dredhi që të mashtronin babën plak. Shih se si vepruan! E therën një dele dhe me gjakun e saj e spërkatën këmishën që ia kishin zhveshur vëllasë së vogël, për ta bindur Jakubin se të birin e kishte shqyer ujku. Jo vetëm kaq! Nuk u kthyen tek i ati deri sa ra nata, me shpresën se errësira do ta fshihte djallëzinë që u dallohej qartë në fytyra...

Pasi u errësua, Jakubi, alejhis-selam, priste me padurim djalin e zemrës. Megjithëse nata kishte rënë, gjumi nuk e zinte babën plak. Jusufi, Jusufi, Jusufi... Aty i rrinte mendja Jakubit. Mos vallë t'i ketë ndodhur ndonjë e papritur? I kredhur në mendime vëmendjen ia tërhoqën tringëllimat e zileve që mbanin bagëtitë. Blegërimat e tyre tashmë dëgjoheshin nga larg.

Menjëherë u ngrit. Fytyra e plakut i shkëlqente nga gëzimi. Më në fund erdhën! Më në fund u kthye Jusufi! U ngrit me të shpejtë dhe u doli përpara djemve. Sapo u afruan tek i ati vëllezërit filluan të qajnë. Jakubi, alejhis-selam, e kuptoi menjëherë se diç kishte ndodhur, por u përmbajt dhe nuk foli megjithëse fytyra iu zbeh nga trishtimi. Ç'të kishte ndodhur vallë?

*"O babë", iu drejtuan plakut me gjysëm zëri, "ne filluam të luanim dhe të bënim gara me njëri-tjetrin dhe e lamë Jusufin tek rrobat tona, por atë e hëngri ujku."* Jakubi u vrenjt në fytyrë. Me sytë gjysëm të përлотur u hodhi një vështrim djemve të tij, por përsëri asnjë fjalë nuk foli. Me kokat e ulura dhe me zë të përmalluar, duke shfrytëzuar errësirën e natës, shpresonin se do ta mashtronin Jakubin. Si dëshmi i sollën këmishën e Jusufit të spërkatur me gjak të rrejshëm, por nuk arritën ta mashtrojnë plakun. Vëllezërit e Jusufit nga hutia, kishin harruar ta grisnin këmishën e vëllasë së vogël. Me të vërtetë e kishin spërkatur me gjak, por Jakubi e dinte fort mirë se kur ujku shqyen njeriun, ia shqyen edhe këmishën ndërkaq këmisha e të birit ishte e paprekur. Menjëherë e kuptoi se djemtë e tij po gënjenin. E kuptoi se historia e ujkut ishte sajim, por u përmbajt dhe u tha bijve të tij: *"Këtë histori e sajuat, por unë do të duroj dhe s'do të ankojem. Allahut i kërkoj ndihmë për këto që po thoni."* Pasi i tha këto fjalë, u ktheu shpinën djemve dhe humbi në errësirën e natës me shpirt të helmuar...

Biri im! Kij kujdes nga gjynahet sepse ata tërheqin njëri-tjetrin ashtu siç ndodh me hallkat e çelikut, pastaj të lidhen pas trupi ashtu si zinxhiri e të fundosin në detin e thellë të humbjes dhe poshtërsive. Nëse nuk e kupton këtë që po të them, sill në mendje vëllezërit e Jusufit alejhis-selam: një gjynah i vetëm i shpuri në shumë gjynahe të tjera pas tij. Në fillim dëshiruan të keqen për vëllanë e vogël, kjo i shtyu të gënjenin babain e tyre kur e morën Jusufin në lëndina. E hodhën vëllanë në pus, pa kurrfarë faji. Pas kësaj u përpoqën të mashtronin babën

me këmishën e gjakosur. Për më tepër, erdhën në darkë vonë duke qarë dhe as që nuk u erdhi turp tek mashtonin të atin për të disatën herë radhazi...

## Karvani

Vëllezërit e tij u kthyen në shtëpi, ndërsa Jusufi mbeti i burgosur në pusin e thellë. Ndërkohë që vëllezërit darkuan dhe u shtrinë në shtratin e ngrohtë për të fjetur, ai qëndronte i uritur në fundin e pusit të errët dhe gjumi nuk e zinte. I vetmuar u ul mbi një gur që ngrihej mbi ujë, duke pritur ndihmën e Allahut të Lartmadhërishëm... Nuk kaloi shumë dhe në mëngjes, atypari kaloi një karvan me tregtarë. Gjatë rrugës i kishte pushtuar etja dhe kërkonin sa andej këndeje ndonjë pus, kur ja... Jo larg tyre e panë një të tillë, ndaj menjëherë dërguan njërin prej tyre të mbushte ujë të ftohtë. E ç'ndodhi pastaj? Tregtari lëshoi kovën për të nxjerrë ujë nga pusi, por kur filloi ta ngrinte ajo ishte shumë e rëndë. Ç'të jetë? Me kureshtje zgjati pak kokën të shihte në brendësi të pusit, por ç'të shihte se? Në litarin që e kishin lidhur me kovën mbahej një djalosh. Tregtari i habitur briti me gëzim: *"O lum për ne! Një djalë, një djalë!"* Sapo e nxorën nga pusi Jusufi filloi t'u tregonte ngjarjen se si kishte përfunduar në pus dhe u kërkoi që ta linin të kthehej tek i ati, por ata nuk pranuan. Jo vetëm kaq! E fshehën të lidhur në mesin e mallrave që tregtonin në mënyrë që askush mos ta njihje dhe me të shpejtë u nisën për udhëtim. Po për ku vallë?

## Në Misir

Pasi shuan etjen dhe e morën djaloshin me vete, karvani vazhdoi rrugën për në pazarin e njohur të Misirit... Me të

mbërritur, tregtarët zunë vend dhe filluan të shpalosnin mallin e tyre. E nxorën edhe djaloshin për ta shitur si skllav dhe e detyruan të qëndronte në këmbë në mënyrë që kalimtarët ta shihnin. Të prishurit kishin qëllim ta shisnin sa më shpejt nga frika se mund ta njihte dikush djaloshin dhe mund të lajmëronte të atin e tij, Jakubin, i cili kishte nam në mesin e njerëzve. *“Kush e blen këtë djalosh? Kush e blen për pak dërhëmë?”* Si rrallëherë, veziri i mbretit kaloi andejpari, ndërkohë që nuk e kishte zakon të endej pazareve. Ai dërgonte shërbëtorët e tij të blinin atë që dëshironte, por Allahu i Lartmadhërisëm kishte caktuar që vetë veziri të dilte, të lodhej nën diellin për-vëlues dhe të pluhurosej në rrugët e tregut që gumëzhnin nga njerëzit, vetëm e vetëm që të rehatohej Jusufi. Me të vërtetë ajo që dëshiron Allahu i Lartësuar ndodh patjetër... Ndërkohë që veziri endej në mesin e turmës, ia tërhoqi vëmendjen nuri i Jusufit. Fytyra e djaloshit i la mbresë të thellë. Menjëherë u kthye pas dhe u nis drejt Jusufit, alejhis-selam. Pasi iu afrua dhe e vështroi nga afër, e kuptoi se ky djalë nuk ishte si moshatarët e tij. Në thellësinë e syve të djalit vëreu shenjat e mençurisë dhe fisnikërisë, ndaj nuk ngurroi që ta merrte me vete. Me të shpejtë u dha tregtarëve shumë që kërkonin, e mori djaloshin dhe së bashku u nisën drejt pallatit mbretëror.

### *Në pallatin mbretëror*

Teksa ktheheshin për në pallat, veziri i qëndronte afër shërbëtorit të ri dhe gjatë gjithë kohës fliste me të. Sa më shumë bisedonte me Jusufin, alejhis-selam, aq më shumë bindej se ia kishte qëlluar me blerjen e tij. Djaloshi, i cili ecte pranë tij, shfaqte shenjat e një mençurie të rrallë dhe të një edukate që nuk mund të merrej veçse nga një familje fisnike. U ndikua kaq shumë nga sjellja e djalit, saqë me t'u kthyer, caktoi që Jusufi të kishte të drejta si askush nga shërbëtorët e tjerë të

pallatit. Jo vetëm kaq! Iu drejtua edhe të shoqes duke i thënë: *"Priteni mirë këtë djalë. Bëjani të këndshëm qëndrimin tek ne. Besoj se do na shërbejë si mos më mirë dhe ndoshta do ta birësojmë!"*

Kështu rrodhën ngjarjet. Allahu i Lartësuar caktoi që Jusufi, alejhis-selam, të udhëtonte drejt Misirit duke bërë që zemrat e njerëzve të ndjenin dashamirësi për të dhe ia mundësoi ta kalonte moshën e rinisë në pallatin mbretëror nën përkujdesjen e vezirit të mbretit dhe gruas së tij. Sikur mos të mjaftonte kjo, Allahu i Lartësuar i dhuroi dituri të gjerë, aftësi për të gjykuar dhe e nderoi Jusufin, alejhis-selam, duke ia mësuar shpjegimin e ëndërrave. Ja, kështu i shpërblen Allahu njerëzit e çiltër.

## Gruaja e ministrit

Kohët kalonin dhe Jusufi jetonte i qetë në pallatin e vezirit. Sa më shumë që e lëshonte shtatin aq më shumë zbukurohej. Të gjithë që e njihnin mahniteshin me bukurinë e djaloshit. Thuhet se fytyrën e kishte aq të bukur, saqë shpeshherë kur kalonte pranë tij ndonjë vashë e re, Jusufi detyrohej ta mbulonte fytyrën nga turpi. Të gjithë sytë e botës se ç'e ndiqnin pas. Ndër ata që u magjepsën pas pamjes së tij ishte edhe gruaja e vezirit. Ajo e vështronte djaloshin tek shërbente në pallat dhe mahnitej me bukurinë, mendjemprehtësinë dhe sjelljen e tij fisnike. Me kohë, kjo mahnitje filloi t'ia përvëlonte zemrën. Tashmë ajo mezi e priste rastin kur djaloshi të ishte vetëm që t'ia shprehte ndjenjat e saj. E mbikqyrte gjatë gjithë kohës, kur ja! Një ditë prej ditëve ndërkohë që i shoqi doli nga pallati, ajo shfrytëzoi rastin dhe shpejtoi të vishej me rrobat më të shtrenjta që kishte. U stolis me ar dhe argjend, pastaj papritmas hyri në dhomën e shërbëtorit të saj. E mbylli me të shpejtë derën dhe filloi t'i afrohet djaloshit duke i treguar se sa shumë e donte. Ajo ishte jashtëzakonisht e bukur, e re,



e pasur dhe e fisme, ndaj për Jusufin kjo gjendje nuk ishte e lehtë. Por në ato momente ndjenja se Allahu po e shikonte ia pushtoi zemrën. Ndërkohë që gruaja iu afrua fare pranë dhe dëshiroi të mbështetej në gjoksin e tij, ai e largoi duke i thënë: *"Allahu më ruajt! Unë nuk e tradhtoj zotërinë tim, pasi ai kujdeset dhe sillet mirë me mua. Me të vërtetë tradhtarët kurrë nuk do kenë sukses."*

Bir i dashur! Një ndër betejat më të rëndësishme mbi të cilën njeriu duhet të ngadhënjëjë, është beteja me ndjenjat e brendshme, beteja me inatin, me zilinë, me dëshirat e këqija e kështu me radhë. Dije se askush nuk mund t'i bëjë ballë të tilla nxitjeve veçse besimtari i sinqertë. Një besimtar i tillë i lufton dëshirat e këqija me forcën e imanit. Menjëherë, kur të tilla ndjenja ia pushtojnë gjoksin dhe e shtyjnë atë për keq, përkujton faktin se Allahu i Madhërishëm e mbikqyr kudo të jetë dhe në çdo moment. Sjell ndërmend hidhërimin e Allahut, tmerrin e Ditës së Kijametit dhe dënimin që do përjetojnë në botën tjetër gjynahqarët që e hidhëruan Zotin Fuqiplotë.

Besoj se ke dëgjuar se Ditën e Kijametit malet do thërrmohen e do bëhen pluhur; se detet, lumenjtë e liqenet do shterohen; se bimësia do të thahet dhe se dielli do u afrohet njerëzve fare pranë kokave, aq sa shumica e tyre do të mbuloohen nga djersët... Atë ditë Allahu i Madhërishëm do zbresë dhe nuk do ketë hije tjetër veç hijes së Arshit të Tij... Ama, jo çdokush mund të përfitojë nga freskia dhe mirësia e kësaj hijeje të begatë. Pak njerëz do kenë nderin të strehohen në gjirin e saj, ndërkohë që shumica të zhytur në djersë, do vuajnë të nxehtin përvëlues që ua djeg lëkurat. I Dërguari i jonë, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, na lajmëron se ndër ata që do strehohen në këtë hije të stërmadhe do jetë edhe ai person, të cilin një grua e pasur, e bukur dhe me pozitë të lartë e fton të vetmohet me të, ndërkohë ai i thotë: *"Unë kam frikë Allahun."*



Jusufi, alejhis-selam, e shtyu gruan dhe nxitoi drejt derës, që të dilte nga dhoma, por ajo, e verbuar nga dashuria, e mbërtheu fort pas këmishë dhe u mundua ta tërhiqte drejt saj. Për fat, këmisha u shqye në duart e saj dhe Jusufi arriti të largohej. Megjithatë ajo rendi pas tij ta ndalonte, por sapo mbërritën tek dera, mbetën të dy si të gozhduar në vend. Ç'të shihnin?! Tek pragu i derës qendronte veziri. Për t'i shpëtuar hidhërimit të të shoqit, gruaja e mori fjalën e para. E fajësoi Jusufin me të padrejtë dhe filloi të shpifte për të. *"Çfarë mund të jetë ndëshkimi i atij që ka qëllim të keq ndaj familjes tënde, përveç burgut ose dënimit të dhembshëm?!"*. Jusufi nuk heshti, por u mundua të mbrohej duke iu drejtuar vezirit: *"Ajo m'u afrua mua, o zotëria im! Dije se unë jam i ndershëm e gjithmonë kam qenë besnik ndaj teje."* Fjalët e djaloshit i dëgjoji edhe një burrë i mençur dhe i drejtë, një kushëri i gruas së vezirit, që kish ardhur së bashku me të në pallat. Burri iu drejtua vezirit: *"Në këto kushte nuk mund ta dallojmë të vërtetin nga gënjeshtari, veçse duke parë këmishën e djaloshit. Nëse këmisha e tij është shqyer përpara, atëherë kushërira ime thotë të vërtetën dhe djaloshi gënjen, pasi ai e ka sulmuar dhe ajo ia ka shqyer këmishën duke u mbrojtur prej tij. Por nëse këmisha e tij është e shqyer prapa, atëherë ajo gënjen, ndërsa djaloshi thotë të vërtetën, pasi ai ka ikur me të shpejtë prej saj dhe ajo është munduar ta ndalojë duke e mbërthyer për këmishë."* Menjëherë veziri ktheu shikimin nga djaloshi për të kontrolluar këmishën që mbante të veshur. Ç'të shihte! Këmisha e Jusufit, alejhis-selam, qe shqyer nga prapa...

Pasi e kuptoi të vërtetën iu drejtua të shoqes duke i thënë: *"Kjo qënka një nga dredhitë e tua! Ti i je afruar Jusufit, e pastaj u mundove të gënjeshtë për t'i shpëtuar fajit. Nuk të takon të flasësh më as edhe një fjalë tjetër, por kërko falje, se në të vërtetë ti qënke fajtorja."* Ndërkohë që u shfaq besnikëria e djalit, veziri iu drejtua atij duke i thënë: *"Ti, o Jusuf, harroje këtë"*

*ngjarje dhe mos ia përmend askujt, pasi të tilla gjëra është e udhës të mbahen të fshehta e mos të tregohen.”*

Biri im! Ruaju gjynaheve kudo që të jeshë e mos i zë besë vetes. Ta dua të mirën, ndaj të këshilloj të mos vetmohesh asnjëherë me vashat kushdo qofshin ato, pasi një veçim i tillë mund të të dëmtojë rëndë. Kurrë të mos mendosh se vetmia me një vashë është zotësi apo burrëri ashtu siç mendojnë shumë të rinj sot. Mos harro se nuk është e njëjtë e keqja dhe e mira sado që të habitesh nga përhapja e të keqes...

## Gostia

Ki kujdes për çfarë vepron dhe çfarë flet, o djalë! Dije se kjo jetë është e stërmbushur me sprova e vështirësi. Dije se shpeshherë edhe mund të rrëshkasësh, por kurrë mos harro se Allahun e ke mbikqyrës në çdo çast dhe shikimit të Tij askund nuk mund t'i fshihesh. Sa herë që të gabosh, kthehu me pendim tek Zoti yt dhe kërko, falje se Ai është Falës i Madh dhe Mëshirues. Por, nëse ke diç për ta mbajtur sekret midis teje dhe Allahut të Lartësuar, dije se nuk mund të ruhen sekretet veçse në gjoksin e një njeriu të vetëm. Po ia zbulove sekretin një njeriu tjetër, pa pikë dyshimi prej tij do e marrë vesh edhe një tjetër, prej këtij një tjetër e një tjetër, e kështu sekreti do të bëhet lajm e do përhapet sa andej e këndeje, e ndoshta mund të turpërohesh. Prandaj, ruaje gjuhën se mos t'i zbulon fshehtësitë e zemrës e turpërohesh kur nuk e pret.

Nuk kishte kaluar veçse pak kohë dhe ja: lajmi se gruaja e vezirit dashuronte shërbëtorin e saj kishte marrë dhenë. Gratë më në zë të qytetit, nga smira që ua përvëlonte zemrat, për shkak të bukurisë dhe pasurisë së saj, u munduan që me çdo kusht ta poshtërojnë duke e fajësuar dhe qortuar sa herë që mblidheshin në ndenjat e tyre. Një shërbëtor nuk ishte i de-

një që një grua pasanike. Thashethemet rreth saj u përhapën aq shumë, saqë edhe ajo vetë mori vesh se po e përqeshnin dhe po e përçmonin. Fjalët e përhapura rreth saj e lënduan shumë, ndaj për t'u shfaqësuar urdhëroi të përgatitej një gosti dhe i dërgoi secilës nga një ftesë...Në ditën e caktuar të gjitha pasaniket u mbledhën në pallatin e vezirit, ndërkohë gruaja e tij e kishte zbukuruar dhomën e pritjes si mos më mirë. Për secilën prej të ftuarave kishin lënë një jastëk të butë prej mëndafshi ku mund të mbështeteshin dhe afër çdonjërës kishin vendosur një tabaka me fruta të freskëta, në mesin e të cilave vezullonin thikat e argjendta për copëtimin e tyre.

Pasi u mbledhën të gjitha të ftuarat dhe u rehatuan, me të shpejtë iu dhanë pas bisedave me njëra-tjetrën. Të mbështetura në jastëkët e mëndafshit zgjasnin duart drejt frutave të freskëta që u ishin servirur secilës. Ndërkohë gruaja e vezirit vëzhgonte me kujdes çdo lëvizje të tyre, sikur të fshehte diç në vetvete. Sapo e pa se çdonjëra kishte marrë nga një thikë për të prerë frutat, urdhëroi që të vinte shërbëtori i famshëm, të cilin e kishin stolisur me rrobat më të bukura që kishte. Kur hapi derën dhe hyri në dhomë Jusufi ra heshtja. Gratë u mahnitën nga bukuria e djaloshit, u shastisën nga ajo që panë dhe as që mund ta largonin tashmë shikimin nga fytyra e tij që vezullonte siç vezullon hëna e plotë në natën e errët. Të përhubura dhe të magjepsura, as që e kishin vënë re se me thikat që mbanin për të copëtuar frutat u mëshonin me sa fuqi që kishin pëllëmbëve, pasiqë frutave tashmë thika u kish kaluar tej për tej. I copëtuan duart e veta duke mos e ndjerë aspak dhembjen. *"O Zot, o Zot!", thanë njëzëri, "Ky nuk qenka njeri, por një melek fsnik!"*

Biri im, ruaju nga përgojimi i të tjerëve. Kurrë të mos përmendësh mangësitë a dobësitë e dikujt pas krahëve të tij, sepse herët a vonë mund të të turpërojë Allahu, ashtu siç i turpëroi shoqet e gruas së vezirit. Përgojimi nuk është cilësi e njeriut

fisnik. Njeriu i çiltër nuk poshtëron të tjerët për t'u lartësuar vetë. Kush zbulon të metat e tjerëve, Allahu do ta turpërojë kur nuk e pret, ndërsa kush ua mbulon të metat të tjerëve, Allahu do t'ia mbulojë atij. Të mjaftojnë të metat e tua ndaj ose të flasësh mirë, ose të heshtësh.

Ndërkohë që gjaku u kullonte nga pëllëmbët e copëtua, gruas së vezirit i shkëlqeu fytyra nga gëzimi dhe iu drejtua me përçmim duke u thënë: *"Ja pra, ky është djaloshi për të cilin më qortuat. A e patë bukurinë e tij?"* Pastaj u kthye nga Jusufi, alejhis-selam, dhe tha: *"Është e vërtetë se unë e dua për vete këtë djalosh, ndërkohë që ai më largohet sa herë që gjendem pranë tij. Mirëpo, nëse nuk e zbaton atë që e urdhëroj unë, me siguri do ta burgosi dhe do ta nënçmoj."* Në këto kushte Jusufit, alejhis-selam, nuk i ngeli tjetër, veçse të zgjidhte burgun përballë gjynahut drejt të cilit e ftonin. *"O Zoti im!",* tha djaloshi, *"Burgu është më i dashur për mua sesa ajo gjë drejt të cilës më ftojnë ato, por nëse Ti nuk e largon prej meje dredhinë e tyre, unë mund të rrëshkas dhe të bie në gjynah të madh."*

Biri im! Dije se paturpsitë nuk e kanë nderuar kurrë askënd. Përkundrazi ata i kanë sjellë njeriut përulje, nënçmim dhe përbuzje. Lexo historinë e atyre që i mposhtën dëshirat e këqija dhe iu larguan paturpsive! Ku janë ata?! Të mjafton Jusufi, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, i cili mbeti i përmendur në histori me shekuj të tërë si fisniku, që i mposhti dëshirat e këqija, si djaloshi i dëlirë që nuk pranoi të njollosej me paturpsi. Ta kam thënë se paturpsitë nuk janë zotësi dhe as burrëri siç mendojnë shumë njerëz, por nënçmim dhe robëri. Kurrsesi mos paso ndjenjat e këqija që shpesh mund ta pushtojnë gjoksin e të bëhesh skllav i tyre, ashtu siç bëjnë shtazët a bagëtitë. Mos harro se je njeri. Mos harro se Allahu i Madhërishëm të ka nderuar me arsye dhe logjikë. Dije pra se, nëse arrin që në situata të caktuara t'i mposhtësh dëshirat e këqija me lejen e Allahut të Madhëruar, do të përmendesh

për mirë në këtë botë dhe në tjetrën. Ndoshta shumë njerëz kanë shtrirë dorën e tyre aty ku nuk duhej dhe kanë bërë atë që nuk duhej, duke iu përgjigjur dëshirave të këqija, por të jesh i bindur se ky moment ka mbetur njollë në jetën e tyre që do paguanin kush e di sa për ta shlyer. Nëse mendon rreth kësaj këshille, me lejen e Allahut të Lartësuar, do kesh në dorë një armë e fuqishme, me të cilën nëse godet, nuk do mbetet dëshirë e keqe pa u mposhtur.

## Burgu

Allahu i Lartmadhërishëm iu përgjigj lutjes së tij dhe e mbrojti nga dredhitë e grave të pallatit. Me të vërtetë Ai dëgjon dhe di çdo gjë. Edhe pse të gjithë ishin të bindur për pafajësinë e Jusufit alejhis-selam, vendosën ta burgosin për një farë kohe, në mënyrë që të shuheshin thashethemet e njerëzve në lidhje me gruan e vezirit. Megjithëse u burgos pa kurrëfarë faji, Jusufi asnjëherë nuk u ankua se iu bë padrejtësi, asnjëherë nuk foli për gruan e zotërisë së tij e as për të shoqin e saj, pasi ishte i bindur se çdo gjë ndodhi me caktimin e Allahut të Lartësuar. Ishte i bindur se njeriu mund të urrejë diçka, ndërkohë që ajo është në të mirën e tij, por nga ana tjetër mund ta dojë diçka, e ajo që do është në dëmin e tij. Allahu di, kurse ne nuk dimë. Burgun kish caktuar Allahu i Lartësuar për të në mënyrë që ta shpëtonte djaloshin nga shoqërimi me njerëzit me vese të ulëta.

Kështu pra, përfundoi Jusufi, alejhis-selam, nga pallati i vezirit në burgun e ngushtë dhe të errët. Megjithatë djaloshi ishte i bindur se Zoti i tij, Allahu Fuqiptotë, do t'i bënte zgjidhje; ishte i bindur se Allahu i Lartësuar nuk i braktis ata që u ruhen gjynaheve dhe janë mirëpunues. Ama deri kur do të qëndronte aty? Këtë nuk e dinte... Gjithsesi pas errësirës së natës, sado e gjatë të jetë ajo, vjen përherë drita e agimit.

Mendimi i mirë se Allahu e ndihmonte ia ngrohte zemrën, ndaj nuk u mërzit e as nuk u pikëllua, por iu përkushtua adhurimit. Natë e ditë e kalonte brenda qelisë së ngushtë duke përmendur Allahun, duke u lutur dhe duke falur namaz... Thonë të moçmit se Allahu i Lartësuar e detyron robin e Tij të përballet me sprovë, ashtu siç bën familja e të sëmurit kur e detyrojnë atë të pijë ilaçin duke i thënë: "Pije, se për të mirën tënde e kemi."

Në këtë mënyrë kalonin ditët në burgun e errët, mirëpo sjellja e mirë dhe morali i lartë i djaloshit nuk kaloi pa u vënë re nga të burgosurit e tjerë. Djaloshi nuk ankohej. Kurrë nuk këmbente fjalë me gardianët. Për më tepër, asnjëherë nuk e mbante veten me të madh dhe as nuk mburrej në mesin e të tjerëve... Të gjithë e kuptuan se Jusufi nuk ishte një djalosh dosido, por ishte fisnik e kaluar fisnikut. Emri i tij përmendej vetëm për mirë... U përhap fjala se djaloshi fisnik kishte dituri të gjerë dhe zemër të madhe, ndaj të gjithë të burgosurit e respektonin.

Një ditë prej ditëve dy të burgosur iu afruan. Pasi e përshëndetën me respekt, u ulën pranë tij dhe filluan të diskutonin me të. Lodhja e trishtimi dallohej fare qartë në fytyrat e tyre të zbehta. Flisnin me zë të ulët, aq sa askush veç Jusufit s'mund t'i dëgjonte...

"Dëgjo djaloshi!", i tha njëri, "Unë ëndërroj veten duke shtrydhur rrush për të përgatitur verë." "Ndërsa unë", thoshte tjetri, "ëndërroj se po bart mbi kokë bukë nga e cila hanë shpendët." "A mund të na i komentosh këto dy ëndërra, o shoku i jonë i mirë?", iu drejtuan Jusufit njëzëri sapo mbaruan.

Jusufi iu drejtua me butësi e u tha: "O shokët e mi! Çfarëdo të ëndërroni, unë kam aftësi t'ua komentoj para se të ndodhë ajo, e do të bëhet ashtu siç do t'u them. Kjo është diç nga ajo që ma mësoi Allahu, Zoti im." Me t'i dëgjuar këto fjalë

dy të burgosurit u gëzuan dhe u qetësuan. Në këtë çast Jusufi shfrytëzoi rastin dhe filloi këshillën e tij.

Biri im i dashur! Dije se dituria është dhuratë e shtrenjtë, ndoshta më e shtrenjta që i është dhuruar njeriut. Thuhet se ajo është drita e Allahut e si e tillë nuk u dhurohet gjynahqarëve. Ndaj paso shembullin e Jusufit, alejhis-selam, ki frikë Allahun kudo të jesh se Ai ia dhuron diturinë robërve të Tij të devotshëm, ashtu siç ia dhuroi Jusufit. Allahu është i Gjithdijshtëm për çdo gjë.

### *Këshilla e Jusufit*

Pejgamberët i përngajnë shiut të begatë që i sjell jetën tokës së thatë kudo që zbret. Nuk ka rëndësi se ku ndodhen apo me kë flasin! A nuk e meritonin të burgosurit këshillën? A nuk e meritojnë ata mëshirën? A nuk janë edhe të burgosurit bij të Ademit?

Jusufi dëshironte më të mirën për dy shokët e tij. Dëshironte për ta udhëzimin në rrugën e drejtë, në rrugën e shpëtimit, në rrugën e baballarëve të tij të nderuar, ndaj me përzemërsi u tha: *"O shokët e mi! E gjithë dituria që kam, më është dhuruar nga Allahu, Zoti im. Allahu më dhuroi dituri të gjerë dhe mirësi pa fund ngase unë e braktisa fenë e atyre që nuk besojnë Allahun dhe e mohojnë botën tjetër dhe pasova fenë e vërtetë, fenë e të parëve të mi, fenë e Ibrahimit, Is'hakut dhe Jakubit. Ne nuk na takon të adhurojmë të tjerë veç Allahut. Kjo është mirësia e Allahut ndaj nesh dhe ndaj njerëzve të tjerë, por shumica e tyre nuk janë mirënjohës."*

Bir i shtrenjtë! Asnjëherë të mos harrosh se mirësia më e madhe që të është dhuruar nga Zoti yt është besimi i kthjellët, besimi se askush tjetër përveç Allahut nuk meriton të adhurohet si Zot, as melekët, as njerëzit e mirë, as Pejgamberët e



aq më pak idhujt që as nuk flasin e as dëgjojnë. Nga ky besim njeriu fiton lirinë e vërtetë. Si pasojë e këtij besimi njeriu nuk i robërohet askujt dhe nuk ka frikë nga askush veç Krijuesit të tij, ngase është i bindur se asgjë nuk ndodh veçse me Dëshirën e Tij. Nuk e frikëson idhulli, as i vdekuri, as macja e zezë apo zotat e gënjeshtërt. Kjo është liria e vërtetë. Ama, dije se njeriu i çiltër ua do të mirën të tjerëve, ndaj të mirën që ka, mundohet ta përhapë në mesin e njerëzve. Mos harro se bujarin nuk e varfëron mirësia e të tjerëve, përkundrazi ai lumturohet me të mirën e tyre.

*“O shokët e mi! A është më mirë të adhurohen idhujt, apo Allahu, i Vetmi Zot, i Gjithëfuqishmi?”*, i pyeti Jusufi ndërsa ata po dëgjonin me vëmendje. Pikërisht ky ishte momenti i përshtatshëm t'i shpaloste atë që ishte shumë më e dobishme, sesa ajo që kërkonin prej tij.

*“O shokët e burgut! A nuk e kuptoni se ata që i adhuroni nuk janë tjetër veç statuja, emrat e të cilave i keni shpikur ju dhe etërit tuaj?! A nuk e dini se Allahu ka urdhëruar që të adhuroni vetëm Atë? Kjo është feja e vërtetë, por shumica e njerëzve nuk dinë.”*

Pasi e mbaroi këshillën e tij të çmuar, Jusufi filloi t'u tregonte dy të burgosurve kuptimin e ëndërrave të tyre.

*“Njëri prej jush do t'i japë zotërisë të tij të pijë verë, kurse tjetri do të kryqëzohet dhe shpendët do t'ia çukitin kokën. Endrrat për të cilat më pyetët kështu e kanë përfundimin.”* Megjithëse e dinte mirë se cili nga shokët e tij do të dënohej, ai nuk u tregoi atyre se cili do kryqëzohej e cili jo, në mënyrë që mos dëshpërohej fatkeqi e të jetonte atë që i kish mbetur nga jeta si i vdekur në mesin e të gjallve. Me të vërtetë Jusufi ishte i mëshirshëm, i urtë dhe i matur në të folur..



## Jusufi

Biri im, dëgjo me vëmendje se ç'po të them! Fjalët kanë një ndikim të jashtëzakonshëm kur dalin nga goja, ndaj të jesh i matur në të folur. Fjala e mirë i jep jetë atij që e dëgjon edhe nëse është në prag të vdekjes, ashtu siç ia helmon shpirtin një tjetri fjala e shëmtuar duke e lënë si të vdekur në mesin e të gjallëve. Ki kujdes kur flet edhe nëse po thua të vërtetën! Nuk është urtësi të thuash të vërtetën, por ta thuash të vërtetën në mënyrën më të mirë dhe në kohën e duhur ashtu siç bëri Pejgamberi i Allahut, Jusufi. Ndoshta po zgjatem pak, ama dëshiroj të të tregoj një histori të shkurtër në mënyrë që të bëhet më e qartë kjo që sapo të thashë.

Dëgjo bir! Shumë kohë para teje një mbret shihte herë pas here një ëndërr të çuditshme. Shihte në ëndërr veten përpara një pasqyre, që kur buzëqeshte përpara saj, dhëmbët fillonin dhe i binin një e nga një. Një ditë vendosi të shkonte tek një ndër shpjeguesit e ëndrrave që jetonin në mbretërinë e tij në mënyrë që t'ia mësonte kuptimin. Pasi e takoi dhe u përshëndetën siç ishte zakoni, mbreti ia shpalosi ëndrrën që e shqetësonte herë pas here. Kur dëgjoi gjithçka që i rrëfeu mbreti, njeriu i ditur iu drejtua duke i thënë: *"Mjerë për ty, o zotëria ynë! Me sa kuptoj unë, fatkeqësi të njëpasnjëshme do të të godasin. Të gjithë të afërmit e zemrës do të të vdesin njëri pas tjetrit, ndërsa ju as që do mund ta pengoni diçka të tillë."* Thuhet se mbreti u hidhërua tej mase me atë që dëgjoi, ndaj menjëherë i ktheu shpinën dhe urdhëroi që të burgosej shpjeguesi i ëndrrave. Megjithatë mbreti nuk u dorëzua me kaq, por ndërmoi edhe një udhëtim të dytë drejt vendbanimit të një tjetër shpjeguesi ëndrrash. Thuhet se pasi e takoi dhe e përshëndeti, menjëherë i rrëfeu gjithçka shihte në ëndërr duke pritur me padurim interpretimin e saj. *"Përgëzohu, o zotëria ynë!"*, ia ktheu shpjeguesi i ëndrrave, *"Përgëzohu me jetën e*

*gjatë që do të të dhurohet. Lum për ty, o zotëri! Dije se do jesh më jetëgjati në familjen tënde.*" Kur dëgjoi këto fjalë mbreti gati sa nuk fluturoi nga gëzimi. E përshëndeti ëndërrshpjeguesin me respekt, urdhëroi që t'i dhurohej një qese me flori dhe u largua i lumtur.

Bir i dashur! Besoj se e kuptove tashmë se ç'ndikim ka fjala e mirë në zemrat e njerëzve dhe se ç'ndikim ka urtësia në të folur. Megjithëse të dy shpjeguesit e ëndrrave dhanë të njëjtin mendim, përzgjedhja e fjalëve dhe matura e të dytit dha fryte të ëmbla, ndërkohë fjalët e të parit shkaktuan mlllef dhe hidhërim.

Sapo fatkeqi u largua, Jusufi, alejhis-selam, iu drejtua shokut që do të shpëtonte duke i pëshpëritur lehtë: *"Kur të dalësh, mos harro e përmendëm tek zotëria yt!"* Kur dëgjoi këto fjalë i burgosuri u gëzua pa masë, pasi e kuptoi se ai do të ishte fatlumi. Me sytë që sikur i shkëlqenin nga lumturia duke ia zbukuruar fytyrën e zbehtë, u nda nga Jusufi me shpresën se shpejt do ishte i lirë si dikur... E me të vërtetë ashtu siç e përshkroi Jusufi, alejhis-selam, ndodhi... Nuk kaloi shumë kohë dhe dy të burgosurit dolën nga burgu. I pari u bë nëpunës në pallatin mbretëror dhe i jepte të pijë sundimtarit të Egjiptit, ndërsa i dyti u kryqëzua. Ndërkohë Jusufi, akoma i burgosur, priste ndonjë lajm nga shoku fatlum që kish dalë nga burgu e shërbente në pallat. Shpresonte se shoku i tij nuk do e harronte porosinë që i dha atëherë kur i kishte komentuar ëndërrën. Por ditët ikën, javët kaluan, muajt u bënë vite dhe vitet fluturuan, ama asnjë lajm nuk erdhi nga shoku i burgut.

## Ëndrra e mbretit

Një natë prej netësh mbreti i Egjiptit pa një ëndërr që e habiti shumë dhe e frikësoi pa masë. Me të zbardhur drita e

agimit, mbreti urdhëroi që të mblidheshin të gjithë astrologët e pallatit, magjistarët dhe shërbëtorët e mençur në sallën mbretërore. Kur u mblodhën të gjithë, erdhi mbreti i shoqëruar me shërbëtorët e tij të afërt. Të gjithë iu pëkulën madhërisë së tij dhe me padurim prisnin përpara fronit madhështor, ndërkohë që mbreti akoma s'ishte ulur. *"Përse të na ketë thirrur vallë?"*, mendonte secili në vetvete. Mbreti iu drejtua të pranishmëve me zë kumbues: *"Shërbëtorët e mi të nderuar! O ju që shpjegoni ëndrrat! Sundimtari juaj ka parë një ëndërr të çuditshme. Ka ëndërruar se shtatë lopë të dobëta e të liga përpinin shtatë lopë të majme. Ka ëndërruar edhe shtatë kallinj të gjelbër e shtatë të tjerë të tharë. O shërbëtorë të mençur të pallatit mbretëror, nëse dini të shpjegoni ëndrrat, më tregoni për ëndrrën time!"*

Në sallë për një moment ra heshtja. Shërbëtorët e mençur, magjistarët dhe astrologët u mblodhën tok dhe biseduan me njëri tjetrin, pastaj thanë njëzëri: *"Ëndrra pa vlerë. Nuk mendojmë se ka ndonjë të vërtetë në to."* Mirëpo, njëri nga pijedhënësit e mbretit u ngrit dhe tha: *"Madhëria e juaj! Nëse ma lejoni, unë mund t'ju tregoj shpjegimin e ëndrrës suaj."* Po cili ishte ky njeri që mori fjalën? Ky shërbëtor ishte njëri nga shokët e burgut. Ëndrra e mbretit bëri të mundur që pijedhënësit t'i kujtohej djaloshi fisnik, ndaj, pasi mori lejen e mbretit, u nis me të shpejtë drejt burgut ku mbahej i mbyllur Jusufi. Pasi iu dha leja, pijedhënësi hyri në burg dhe së bashku me gardianin shkuan tek qelia ku mbahej. Sapo e pa, Jusufi, alejhis-selam, e njohu pijedhënësin.

## *J burgosuri bëhet princ*

Pasi u takuan ashtu siç takohen shokët pas shumë vitesh, pijedhënësi i tregoi Jusufit arsyen pse kishte ardhur. Ai i shpalosi Jusufit, alejhis-selam, ëndrrën e mbretit duke qenë i bindur se

kishte aftësi të shpjegonte çdo ëndërr. Jusufi ishte bujar dhe fisnik, nuk mbante mëri ndaj shokëve, prandaj as që ja përme-ndi pijedhënësit porosinë që i kishte dhënë para shumë moti. Për më tepër, kur e kuptoi rëndësinë e ëndërrës, menjëherë iu drejtua shërbëtorit të mbretit duke i thënë: *"Ju këshilloj të mbillni shtatë vite radhazi farë gruri, e çfarëdo që të korrni prej grurit, t'i lini në kallinj, përveç asaj që do të hani, pasi pas viteve të bollëkut do vijë shtatë vite të vështira, vite thatësire në të cilat ju mund të ushqeheni me ato që keni tubuar ndër vite. Gjithsesi, mbas vështirësisë do vijë një vit me reshje të begata që do u sjellë njerëzve të vjela e begati."*

Pasi u përshëndet me Jusufin alejhis-selam, pijedhënësi i sundimtarit të Egjiptit u kthye me një frymë në pallatin mbretëror dhe e lajmëroi zotërinë e tij për kuptimin e ëndërrës. Sapo i dëgjoi mbreti fjalët e shërbëtorit u mahnit. Fytyra sikur iu çel nga një gëzim që nuk përshkruhet. *"Kush e shpjegoi ëndërrën time?"*, iu drejtua pijedhënësit, *"Menjëherë të ma sillni në pallat!"* Ajo që urdhëroi mbreti duhej të realizohej menjëherë. Një i dërguar i posaçëm i mbretit mbërriti me të shpejtë në burg për t'u takuar me Jusufin alejhis-selam. Pasi u takua me të, i dërguari i mbretit e lajmëroi për kërkesën e mbretit. *"Shkëlqësia e tij ju ka dhuruar lirinë"*, i tha, *"me kusht që të shërbeni në pallatin mbretëror."* Sikur ndonjë të burgosuri tjetër t'i jepej ky rast, do pranonte pa një pa dy, mirëpo Jusufi, alejhis-selam, nuk nxitoi. Ai ishte i urtë, fisnik e i mençur. E si mund të shërbente në pallatin mbretëror kur njerëzit e njihnin si djaloshi që tradhëtoi ministrin e mbretit?! Si mund të ecte i qetë ndërsa mbi supe mbante me të padrejtë barrën e tradhtisë?

*"Kthehu pas!"*, i tha plot qetësi Jusufi, alejhis-selam, *"Kthehu tek zotëria yt dhe lajmëroje se shpjeguesi i ëndërrave kërkon të bëhen hulumtime për çështjen e tij."* I dërguari i mbretit, i shastisur nga ajo që i dëgjuan veshët, u kthye në pallat. Sapo mori vesh lajmet që i solli i dërguari, mbreti urdhëroi që të hi-

dhej dritë mbi çështjen e të burgosurit që i komentoj ëndërrën. Kur u informua se si ishte historia e dënimit të tij, urdhëroi që menjëherë gratë e fisme të qytetit të mblidheshin në pallatin e tij. Pasiqë u tubuan ashtu siç kërkoi sundimtari i Egjiptit të gjitha, pa përjashtim, u morën në pyetje për çështjen e Jusufit alejhis-selam.

Kur e kuptuan se përse i kishin mbledhur, të gjitha së bashku, iu drejtuan mbretit duke i thënë: *"Ne nuk dimë për Jusufin kurrfarë të keqeje. Përkundrazi, ai është njeri besnik dhe i pafajshëm."* Sapo dëgjoi këto fjalë, gruaja e ministrit u ngrit e turpëruar e tha: *"Tani doli e vërteta në shesh! Unë u përpoqa ta mashtroj atë. Jusufi nuk është tradhtar, por besnik e plotësisht i pafajshëm. Jam unë që i kam bërë padrejtësi atij dhe për këtë kërkaj falje!"* Sundimtari dhe të gjithë të pranishmit e kuptuan se Jusufi, alejhis-selam, ishte i pastër nga shpifjet dhe i pafajshëm. Pasiqë u njoh me besnikërinë, urtësinë dhe mençurinë e Jusufit, mbreti dërgoi edhe një herë të dërguarit e tij që menjëherë t'ia sillnin komentuesin e ëndërrave në pallat. Kështu doli Jusufi nga burgu. Me nder e me respekt, i Dërguari i Allahut u takua me sundimtarin e Egjiptit, i cili e priti si askënd në mbarë mbretërinë. Pasi biseduan së bashku, sundimtari iu drejtua duke i thënë: *"Që sot e tutje, ti do jesh nga më të afërmit e mi. Jam njohur me besnikërinë dhe urtësinë tënde, ndaj kërkaj t'më ndihmosh në çështjet madhore të mbretërisë!"* "Më lër të kujdesem për hambarët e drithit", ia ktheu Jusufi alejhis-selam, *"se me të vërtetë jam besnik dhe i ditur!"*

Biri im, të jesh i bindur se durimi dhe dituria janë dy armët më të fuqishme që mund të ketë njeriu. Dije se, me ndihmën e Allahut, me durim dhe me dituri do ngadhënjesh kurdoherë. Ndaj bëj durim ndaj vështirësive dhe mëso ditë e natë që ta nxësh diturinë, se kush bëhet i ditur, ka një favor: ai të gjithë njerëzit i kthen në shërbëtorë. A nuk e dëgjove se

ç'ndodhi me sundimtarin e Egjiptit?! A nuk u robërua nga një i burgosur?!

## *Pas shumë vitesh*

Me të dëgjuar fjalët e Jusufit, alejhis-selam, mbreti u pajtua me propozimin e tij dhe e bëri përgjegjës për depot e ushqimit të Egjiptit. E kush mund të planifikonte më mirë sesa besniku dhe i dituri?! Në këtë mënyrë Allahu i Lartësuar e ngriti pozitën e Jusufit, alejhis-selam, lart e më lart. Nga burgu i errët dhe i ngushtë, tani mund të udhëtonte nëpër hapësirat e pafundme të Egjiptit. Kudo që shkonte, pritej me respekt dhe madhështi. Kështu i shpërblen Allahu durimtarët, ndërkohë që shpërblimi i botës tjetër është edhe më i mirë.

Për disa vite me radhë Jusufi, alejhis-selam, u mundua që me çdo kusht të mblidhte gjithçka kishte mundësi nga drithi dhe të korrat e tjera. Pa u lodhur udhëtonte nga njëri hambar në tjetrin, vëzhgonte, numëronte dhe kontrollonte me kujdes. Mblidh e mblidh, gruri erdhi e u bë det...

Ashtu pa vënë re, hyri e doli viti i parë, i dyti, i treti... derisa trokiti në derë i teti. Një thatësi e tillë as nuk ish parë e as nuk ish dëgjuar ndonjëherë. Për më tepër, kjo fatkeqësi nuk kishte kapluar vetëm Egjiptin, por edhe shumë krahina përreth. Në këto kushte të vështira, Jusufi, alejhis-selam, shpërndante drithin dhe ushqimet me dituri dhe me drejtësi. Emri i tij mori dhenë. Kujdestari i hambarëve të drithit! Mirëbërësi i Egjiptit! Veziri bujar! Kudo flitej dhe dëgjohej për të...

Edhe atje larg në Palestinë, në tokat e Ken'anëve, thatësira kishte pllakosur. Uria kaploi vendin. S'kish më drith për gatim. Ushqimet sa vinin e pakësoheshin. Vështirësia e kishte prekur edhe familjen e madhe të Pejgamberit fisnik, familjen e Jakubit të moçëm. Si t'ia bënin vallë? Si mund të kapërcehej kjo kohë e vështirë?

Jakubi, alejhis-selam, kishte dëgjuar se në Egjipt gjendej një njeri bujar dhe besnik, përgjegjës i hambarëve të vendit. Kishte dëgjuar për drejtësinë dhe fisnikërinë e tij, ndaj një ditë, i mblodhi të dhjetë djemtë e tij. Pasi diskutoi me ta, vendosi t'i dërgonte në Egjipt për të blerë drithë dhe ushqim. Vëllezërit e pranuan kërkesën e të atit. Pasi bënë gati devetë për udhëtim, u përshëndetën me të afërmit e tyre, morën bekimet e babës dhe u nisën drejt tokave të largëta. Ditë për ditë në Egjipt vinin karvane nga vendet përreth për t'u ngarkuar me drithë dhe ushqim. Përgjegjësit e hambarit u jepnin drithë në këmbim të monedhave prej ari apo gjësendeve me vlerë.

Një ditë, ndërsa Jusufi, alejhis-selam, po mbikqyrte shpërndarjen e drithit, prej nga larg pa dhjetë burra hijerëndë tek afroreshin tok drejt portave të hambarëve të drithit. Dukeshin të lodhur e të pluhurosur nga rruga e gjatë. Vazhdoi t'i mbikqyrte me kujdes tek vinin së bashku, kur, ja! Dhjetë djemtë e Jakubit, alejhis-selam, dhjetë vëllezërit pas kaq shumë vitesh edhe një herë përballë Jusufit, por tashmë të rritur, princ me pushtet dhe jo fëmijë i pambrojtur si dikur. Menjëherë i njohu. Nuk kishte ndryshuar shumë pamja e tyre, përveç thinjave dhe rrudhave në ballin e mbuluar nga pluhuri. Kush e di se sa kujtime u zgjuan në zemrën e vezirit fisnik. Pusi i thellë! Nata e errët! Babai i dashur!...

Pasi hynë, Jusufi, alejhis-selam, iu afrua dhe vazhdoi t'i vështronte që të gjithë me kërshëri, por për çudi, asnjëri prej tyre nuk i dha të njohur. E si ta njihnin vallë? Nuk kishin përballë vogëlushin e përkëdhelur të babës, me sytë e qeshur, me lëkurën e butë, me trupin e vogël dhe zërin e ëmbël, por të përzgjedhurin e mbretit, një burrë me hije të rëndë, me shikim të mprehtë, me shtat të lartë dhe me zë kumbues. Për më tepër, kush mund ta mendonte Jusufin të gjallë?! Si mund të mbi jetonte një çilimi në një pus të thellë e të errët krejt i vetëm?!



Edhe sikur të kishte mbijetuar, kush e di se ku mund ta kishin përplasur dallgët e jetës?! Ndoshta do ishte skllav ose shërbëtor në derën e ndonjë zotërie, krejt i vetëm e i harruar në ndonjë tokë të largët?! Kush mund ta mendonte se zotëria që kishin përballë, i veshur me rroba fisniku të stolisura me ar dhe gurë të çmuar të ishte i përkëdheluri i Jakubit, alejhis-selam?!

*"Prej nga vini?", i drejtua veziri. "Nga vend i largët zotëri", i thanë njëzëri, "nga tokat e Ken'anëve." "E kush jeni ju?", i pyeti veziri kinse nuk i njihte. "Jemi bijtë e Jakubit, të birit të Is'hakut. Kemi ardhur si gjithë të tjerët, të blejmë pak drithë për familjet tona." "A keni ndonjë vëlla tjetër?", i pyeti përsëri. "Si urdhëron zotëri.", iu përgjigjën, "E kemi edhe një vëlla më të vogël nga babai, Ben'jamin i thonë." "Përse nuk është me ju atëherë?", i tha veziri me zë kumbues. "Epo, babai plak nuk dëshiron të largohet prej tij.", ia kthyen. Kush e di se sa u përmallua Jusufi, alejhis-selam, kur dëgjoi emrin e babës dhe emrin e vëllasë së vogël?! Megjithëse malli ia kish pushtuar zemrën, Jusufi nuk e dha veten aspak, por i urdhëroi nëpunësit e tij t'ia mbushnin trastat dhe së bashku me drithin të futnin edhe gjësendet e tyre, të hollat që i kishin paguar në këmbim të drithit. Pasi u mbushën trastat me drithë dhe u ngarkuan kafshët për udhëtim, veziri iu drejtua dhjetë vëllezërve duke i thënë: "Dëgjoni këtu, o udhëtarë, nëse vini përsëri, dëshiroj të ma sillni edhe vëllanë tjetër!" "Por ne ju treguam se si qëndron puna me babanë tonë zotëri.", ia kthyen vëllezërit. "Nëse nuk veproni siç ju thashë", u tha veziri me zë qortues, "mos iu afroni më Egjiptit pasi nuk do të merrni nga unë as edhe një kokërr drithi për ushqim." "Do të përpiqemi ta sjellim, shkëlqësia e juaj!", thanë me kokën ulur, "Do bëjmë të pamundurën!" Këto ishin fjalët e fundit nga bijtë e Jakubit, alejhis-selam, përpara se të niseshin edhe njëherë drejt tokave të largëta të Ken'anëve...*



## Biseda me Jakubin

Pas një udhëtimi të gjatë dhe të mundimshëm, dhjetë djemtë e Jakubit, alejhis-selam, u kthyen shëndosh e mirë në gjirin e familjeve të tyre. Prej ditësh babai i kishte pritur me padurim, ndaj, me të zbritur nga kafshët, dhjetë vëllezërit shkuan të përshëndeteshin me të atin.

Pasi u çmallën me babën, e lajmëruan plakun për sjelljen fisnike të vezirit egjiptian dhe i treguan atij se ç'i kishte thënë ai në lidhje me vëllanë e vogël. Sapo mori vesh lajmin fytyra e Jakubit alejhis-selam u vrenjt, por nga goja e tij nuk doli asnjë fjalë.

Atëherë djemtë e tij iu drejtuan me përrulje duke i thënë: *"O babai jonë, lejojeni vëllanë e vogël të vijë me ne që të mbushim përsëri trastat me ushqim, se përndryshe asgjë nuk mund të marrim nga veziri."* *"Mos u frikëso për të"*, i thanë, *"ne do ta ruajmë nga çdo e keqe."*

Në këtë moment fytyra e plakut u vrenjt edhe më shumë. *"A t'jua besoj birin tim të vogël ashtu siç ju pata besuar vëllanë e tij më parë?"*- ia ktheu plaku me ton qortues. Kur dëgjuan fjalët e babës, asnjëri nuk foli, por me kokën e ulur filluan të hapnin trastat me drithë. Ç'të shihnin! Përveç drithit dhe ushqimit gjetën edhe të hollat dhe gjësendet e tyre. Fytyrat e vëllezërve shkëlqyen nga gëzimi.

Oh, ç'mirësi! Oh, sa tregti e mbarë! Oh, sa njeri fisnik na paska qenë veziri, menduan në vetvete, ndaj edhe një herë iu drejtuan Jakubit, alejhis-selam, duke i thënë: *"O babë! Ç'mund të dëshironim më tepër! Ja tek është malli ynë, na është kthyer, e veç kësaj edhe ushqim dhe drithë. Siç e sheh edhe vetë, veziri është njeri fisnik, na i mbushi trastat dhe na e ktheu edhe pasurinë tonë. Lëre vëllanë e vogël të vijë me ne që të marri edhe ai pjesën që i takon."*

Plaku u zhyt në mendime. Ç'të bënte vallë? Si mund ta largonte djalin e vogël që i përkujtonte Jusufin? A mund t'ua besonte të dashurin e zemrës atyre që e patën zhgënjyer më parë? Megjithatë në këto kohë zije që po kalonte vendi, drithi ishte shumë i nevojshëm. Në mungesë të tij rrezikonin jetën njerëzit dhe bagëtia... Si t'ia bënte Jakubi vallë? *"Kurrsesi nuk e dërgoj djalin me ju, derisa t'më betoheni në Allahun se do ma ktheni shëndosh e mirë, përveç nëse ju gjen belaja e nuk keni mundësi."*, iu drejtua plaku. Ata i dhanë besën që të gjithë se do mundoheshin me çdo kusht ta kthenin vëllanë shëndosh e mirë, ndërkaq Jakubi, alejhis-selam, sikur u qetësua pak.

Pasi përgatitën kafshët e udhëtimit dhe gjithçka nevojitej, shkuan tek babai i mençur ta përshëndetnin dhe të merrnin bekimet e tij. Me t'u përqaftuar me të gjithë djemtë e tij, i mbloodhi rreth vetes sikur t'i kishte shokë dhe i tha: *"O bijtë e mi, mos hyni të gjithë së bashku nga njëra portë e qytetit, por nëpër porta të ndryshme sepse mund t'ju shohë ndonjë ziliqar e qëllimkeq e mund t'ju dëmtojë nga zilia. Mbështetjuni Allahut, pasi nuk ndodh asgjë në qiej dhe as në tokë veçse me caktimin e Tij!"* Kjo ishte porosia e fundit e Jakubit para se të ndahej edhe një herë nga bijtë e vet.

Biri im, dëgjo me vëmendje se ç'po të them! Shpesh herë zilia dhe inati e mbushin zemrën e njeriut me urrejtje. Një urrejtje e tillë bën që disa inatçi ta dëmtojnë atë që kanë zili duke e goditur me syrin e tyre të keq... Me të drejtë mund të duket qesharake kjo që po të them, por kur të rritesh do mësosh në librat e fizikës se njeriu nëpërmjet shikimit shkarkon energji në formën e rrezeve të dritës që përhapet dhe godet të gjithë trupat që sheh syri. Duke qenë se kjo energji nuk shihet me sy, ajo është e vështirë të shmanget apo të luftohet. Për këtë arsye njeriu duhet t'i mbështetet Allahut dhe të kërkojë mbrojtjen e Tij nga syri i keq, ngase Allahu është i Plotfuqishëm, sheh dhe ka dituri për çdo gjë.

## Vëllai i vogël

U nisën njëmbëdhjetë vëllezër drejt tokës së Egjiptit. Me gjithë rrugën e largët, më në fund mbërritën. Me t'iu afruar mureve madhështore të qytetit, vëllezërit u ndanë në grupe dhe hynë në qytet përmes portave të ndryshme, siç i kishte porositur i ati. Gjithsesi, kjo gjë nuk i shpëtoi vëllezërit nga ajo që Allahu kish caktuar për ta. Me të mbërritur tek veziri u mblodhën sërish së bashku. Sapo i pa, gëzimi i pushtoi zemrën Jusufit, alejhis-selam, aq sa mezi përmbahej. I ftoi në pallatin e tij sikur të ishin miq të vjetër dhe i gostiti siç bën fisniku. Më pas thuhet se i vendosi dy e nga dy në dhomat e stolisura të pallatit. Pasi Ben'jamini mbeti vetëm, Jusufi e mori me vete në dhomën e tij. U rehatuan vëllezërit dy e nga dy në pesë dhoma, ndërkohë Ben'jaminin që kishte mbetur vetëm e urdhëruan të priste në dhomën ku vetë veziri priste miqtë e tij. Sapo u veçua me vëllanë e vogël, Jusufi, alejhis-selam, e mori Ben'jaminin në përqaqim dhe i pëshpëriti në vesh disa fjalë që të mos dëgjonin të tjerët. E lajmëroi për gjithçka i kishte ngjarë dhe e urdhëroi ta fshihte atë që dëgjoji. Eh, sa kohë kishin pa u takuar! Sa mall kishte për vëllanë e vogël, për familjen e madhe dhe për lëndinat ku kullotnin bagëtinë e vraponin me gëzim!

Ndërkohë që bisedonin njëri me tjetrin ashtu siç bëjnë shokët e vjetër kur takohen pas shumë vitesh, Jusufit i lindi dëshira ta mbante vëllanë në pallat që të çmallej me të dhe ta pyeste për babën e dashur e nënën që i kish ndër mend natë e ditë. Mirëpo si ta arrinte këtë? Allahu i Lartësuar e frymëzoi Jusufin me një plan që do mbetej i paharruar. Veziri i urdhëroi nëpunësit t'iu ngarkonin drithin vëllezërve dhe kërkoi që në fshehtësi të vendosnin kupën e çmuar, nëpërmjet të cilës matnin sasinë e drithit, në trastën e Ben'jaminit. Urdhri u zbatua në vend. E teksa u nisën vëllezërit për rrugë, një thirrës bërtiti: *"Ndaluni, se me të vërtetë dikush nga ju ka vjedhur!"* Djemtë e

Jakubit u kthyen pas të habitur dhe pyetën: “Çfarë kërkoni nga ne?” “Ena e vezirit, ena e vezirit ka humbur”, u thanë, “Kushdo që e sjell atë do shpërblehet edhe me një trastë tjetër plot e përplot me drithë.” Ndërkohë vëllezërit filluan të arsyetonin e të mbroheshin nga kjo akuzë e rëndë. Nuk i takonte bijve të një Pejgamberi të vidhnin. Të sigurt në pafajësinë e tyre, ata njëzëri thanë: “Pasha Allahun, ju e dini mirë se ne nuk kemi vjedhur asgjë. Ju e dini se jemi të pafajshëm.” “E ç’të bëjmë me ju nëse gënjeni?”- iu tha atyre. “Dënimimi i atij në trastën e të cilit gjendet kupa që kërkoni, është të robërohet e të burgoset. Në vendin tonë, ne kështu i dënojmë të padrejtët!” Plani po realizohej me sukses. Pas gjithë kësaj fshihej Jusufi, alejhis-selam, ngase sipas ligjit të Egjiptit, hajduti goditej me kamzhik dhe detyrohej të paguante vlerën e asaj që kish vjedhur, por rob nuk mbahej. Ndërsa sipas ligjeve hyjnore, nëpërmjet të cilave gjykonte Jakubi, ligje të cilat Jusufi i njihte fare mirë, hajduti mbetej rob tek pronari i sendit të vjedhur. Me të vërtetë Jusufi, alejhis-selam, ishte i urtë dhe mendjemprehtë.

Në mënyrë që akuza të jetë bindëse dhe qëllimi i tij të ishte i suksesshëm ai filloi të zbrazte një nga një thasët e vëllezërve më të mëdhenj, por asgjë nuk kishte në brendësi të tyre. Pasi i kontrolloi dhjetë trastat një e nga një, në fund ai zgjidhi trastën e Ben’jaminin dhe filloi ta zbrazë me ngadalë... Ndërkohë që kokrrat e drithit shprazeshin, u shfaq në mesin e tyre kupa e çmuar e vezirit, e cila filloi të rrokullisej mbi pllakat e mermerit. Fytyrat e vëllezërve u vrerosën nga ajo që panë. Të gjithë mbetën të shtangur në vend. Djemtë e Jakubit, alejhis-selam, u turpëruan, megjithatë, pa pikë turpi, iu drejtuan vezirit të inatosur duke i thënë: “Në pastë vjedhur ky, ashtu ka bërë para tij edhe vëllau i vet.” Pasi e dëgjoi se ç’tanë për të, Jusufi, alejhis-selam, heshti dhe u përmbajt ashtu siç i takon fisnikut në momente të tilla. Kur ndodhi ajo që ndodhi, vëllezërve menjëherë iu kujtua babai plak dhe besa që i kishin dhënë, ndaj me butësi dhe me kokën ulur iu lutën vezirit duke i thënë: “O

zotëri, ai ka një babë të thyer në moshë që e do shumë dhe s'bën pa të, ndaj në vendin e tij merr njërin prej nesh! Na e bëni këtë mirësi mbasi me të vërtetë ju jeni fisnik dhe mirëbërës!" Atëherë veziri tha: " Në asnjë mënyrë, ne nuk mund ta robërojmë askënd, veç atij që e ka bërë krimin, pasi ne nuk i bëjmë padrejtësi askujt!" Kur dëgjuan se ç'u tha, vëllezërit u brengosën aq sa nuk përshkruhet. Si të ktheheshin në Ken'an pa vëllanë? Si mund t'i dilnin përballë plakut? E çfarë t'i thonin vallë? A thua do u zinte besë?

Teksa shihnin sesi ushtarët ia morën me forcë Ben'jaminin nga mesi i tyre, u larguan me kokat ulur dhe me zemra të helmuara. Të pikëlluar u mblodhën edhe një herë dhe filluan të diskutojnë njëri me tjetrin. Më i madhi e mori fjalën e tha: "A nuk ju kujtohet se i kemi dhënë besën plakut se nuk kthehemi pa Ben'jaminin. A nuk ju kujtohet se ç'padrejtësi i patëm punuar Jusufit?" "O vëllezër", tha, "unë kam turp nga babai, ndaj nuk do largohem nga Egjipti deri sa të ma lejojë ai të kthehem, ose deri sa të ma mundësojë Allahu t'ia kthej Ben'jaminin, se Ai është Ndihmëtari më i mirë." Pas këtyre fjalëve, i përshkoi të nëntë vëllezërit me një shikim të thellë dhe me mallëngjim iu drejtua për të fundit herë duke iu thënë: "Kthehuni tek babai i jonë dhe t'i thoni se Ben'jamini vodhi. Tregoni atij atë që keni parë, mu ashtu siç ka ndodhur. Tregojini atij se kjo ngjarje është e njohur në tërë Egjiptin, madje edhe karvani me të cilin udhëtuam mund ta dëshmojë atë që po themi." Si i dëgjuan këto fjalë nga vëllai më i madh, nëntë vëllezërit u përqaftuan me të për të fundit herë dhe u nisën drejt Palestinës.

## Tek Jakubi

Si të ktheheshin tek babai pa Ben'jaminin dhe pa vëllanë e madh ndërkohë që para disa vitesh gati sa nuk vdiq nga pikëllimi për Jusufin? Takimi me babain! Përballja me Jakubin! Ç'ti thonin vallë atij? Këto pyetje sikur ja helmonin zemrat

vëllezërve, gjithsesi rrugë tjetër s'kishin. Duhet të ktheheshin patjetër tek baba që i priste me padurim. Ditët kaluan dhe pas një udhëtimit të gjatë më në fund mbërritën.

Të lodhur nga rruga dhe të hidhëruar nga lajmi që mbanin në kraharor u kthyen tek Jakubi, alejhis-selam, dhe i treguan për gjithçka që u kishte ndodhur. Sapo dëgjoji atë që thanë plaku ngriti sytë e përlotur dhe i vështroi të nëntë djemtë, sikur donte t'u lexonte mendjen, pastaj tha me zërin që dridhej nga mërzia: *"Sabër të mirë do bëj. Sabër do bëj me shpresën se Allahu do m'i sjellë edhe një herë pranë bijtë e mi."* Pas kësaj u ktheu shpinën i pikëlluar dhe mori të largohej. *"Oh Jusufi im! Oh i dashuri im! Oh dëshpërimi im për Jusufin!"* - tha plaku dhe sytë iu zbardhën nga vaji. Gjendja e babait plak edhe më shumë ua helmoi zemrat nëntë vëllezërve. Të prekur nga dhembshuria që ndjenin për babain iu drejtuan me përdëllim: *"Mjaft më, o babë! Mjaft më, o babush! Pash Allahun, pusho se do sëmuresh e mund të vdesësh!"* *"Ç'keni tani me mua? Unë nuk po u qahem ju dhe askujt nga njerëzit, por i qahem Allahut dhe jam i sigurt se Ai do ma lehtësojë hallin tim dhe do më japë rrugëdalje."* - ua ktheu Jakubi, alejhis-selam.

Jakubi ishte Pejgamber i Allahut. Ai kishte mendim të mirë për Zotin e tij. Ishte pikërisht ky mendim që ia përtërinte herë pas here shpresat plakut të gjorë. Edhe në këto momente të vështira, kur çdokush mund të dorëzohej, plaku i mbledhi forcat dhe i dha kurajo bijve të tij. *"O bijtë e mi"*, tha Jakubi, *"Shkoni dhe kërkoni vëllanë tuaj Jusufin, dhe mos e humbni shpresën në mëshirën e Allahut, sepse shpresën e humbin veç të pafetë."* Ishin këto fjalë të babait të moçëm që i shtynë nëntë vëllezërit të udhëtonin për të tretën herë radhazi drejt Egjiptit.

Jakubi, alejhis-selam, ishte Pejgamber i Allahut dhe si i tillë i njihnte mirë ligjet e Zotit, ndaj edhe nuk e humbi shpresën pasi ishte i bindur se agimi edhe pak do zbardhte për të dhe familjen e tij. Në fillim humbi Jusufin, më pas humbi Ben'jaminin

së bashku me vëllanë e madh, dhe sikur të mos mjaftonte e gjithë kjo, humbi edhe dritën e syve... Ngushtim pas ngushtimi për gjoksin e Pejgamberit plak, errësirë pas errësire për sytë e tij... *"Tanimë lehtësimi është afër"*, mendoi Jakubi, alejhis-selam, ndaj u tha bijve atë që u tha duke lënë një mësim të vyer për brezat që vijnë pas.

O djalë! Mos e humb shpresën në mirësinë e Zotit tënd dhe të jesh i bindur se lumturia e vërtetë vjen pas mundit dhe lodhjes, ndaj nuk mund ta shijojë frutin e lumturisë ai që nuk shikon përtej sprovës, përtej telasheve, përtej vështirësive e kë-shtu me radhë. Ndoshta një muaj agjërim është i vështirë, por ja që kalon shpejt dhe e kurorëzojmë me festën e Bajramit. Ndoshta nganjëherë nuk e kupton një mësim me leximin e parë, nganjëherë as me të dytin, por mos e humb shpresën se me lejen e Allahut do t'ia dalësh... Ndoshta do të të duhet shumë mund dhe shumë durim, por me siguri që do t'ia dalësh.

## Përballë vezirit të panjohur

U nisën bijtë e Jakubit, alejhis-selam, për udhëtim, por këtë herë me më pak të holla dhe me gjësende pa vlerë të madhe. Të lodhur, e të rraskapitur nga i nxehti përvëlues, pas disa ditësh mbërritën në Egjipt. Ashtu tok shkuan tek veziri për të marrë vesh për vëllanë e vogël dhe për të kërkuar lëmoshë. Pasi dha urdhër, u lejuan të hynë në dhomën e vezirit. Me kokën ulur filluan t'i ankohen për varfërinë dhe fatkeqësinë që i kish goditur. *"O zotëri", i thanë, "ne dhe familjet tona i ka goditur fatkeqësia, ndaj të kemi ardhur me gjësende pavlerë me shpresën se do na ndihmosh e drithë do na dhurosh."*

Kur e pa gjendjen e tyre dhe dëgjoi se ç'thanë, veziri u përmallua aq shumë sa nuk mundi të përmbahej. Duke zbuluar fytyrën e tij fisnike para tyre, iu drejtua duke i thënë: *"A ju*



*kujtohet se ç'i punuat Jusufit dhe vëllait të tij nga mendjehetësia?" Krejtësisht të befashuar nëntë burrat shtangën në vend. Ata e dinin se të fshehtë, përveç tyre dhe Jusufit, askush tjetër nuk e dinte. A thua ishte me të vërtetë Jusufi? A thua vallë të jetë Jusufi, veziri i përzgjedhur i mbretit? Të frikësuar hodhën shikimet mbi fytyrën fisnike të vezirit, kur ja... Nuk u mbeti më fije dyshimi se ai, që kishin përballë, ishte Jusufi, i biri i Jakubit alejhis-selam. E jashtëzakonshme? Si mund të jetë e mundur? Nga pusi i errët, princ i princërve... Akoma nuk u besonin syve, ndaj me gjysëm zëri iu drejtuan vezirit duke i thënë: "A me të vërtetë Jusufi jeni, o zotëri i nderuar?" "Po, unë jam Jusufi, e ky është vëllai i im, Allahu na dhuroi mirësi mbi mirësitë", ua ktheu veziri, "pasi ai që u ruhet gjynaheve dhe bën sabër, Allahu e ndihmon në këtë botë dhe nuk ja humb shpërblimin në botën tjetër!" "Pasha Allahun", thanë ata të turpëruar dhe të frikësuar, "me të vërtetë Allahu të ka lartësuar mbi ne, kurse ne kemi qenë fajtorë." Kur e pa frikën në fytyrat e tyre Jusufi i tha: "O vëllezërit e mi! Dijeni se ua kam falur dhe as që do u qortoj për atë që ndodhi mes nesh. Edhe Allahu besoj se do t'ju fali, se Ai është Mëshiruesi i mëshiruesve!" Më tej Jusufi, alejhis-selam, i përmalluar për babain e dashur, kërkoi nga vëllezërit të kthehen me të shpejtë tek Jakubi dhe u tha: "Shkoni me nxitim tek babai me këtë këmishën time, dhe fërkojani fytyrën me të se me lejen e Allahut do t'i kthehet shikimi. Pastaj ejani tek unë së bashku me familjet tuaja."*

Bir i dashur! Të jesh i bindur se njeriu fisnik ua fal të tjerëve atëherë kur ka mundësi për t'i ndëshkuar në mënyrë që të marrë hakun e tij, sepse falja është pjesë e pandarë e sjelljes së tij. Fisniku nuk i fyen dhe as nuk i nënçmon ata që vijnë për t'i kërkuar falje për padrejtësinë që i kanë bërë, por ua falin gabimet dhe nuk ua zënë për të madhe. Ndiq edhe ti, shembullin e Pejgamberit e mos ua merr për të madhe vëllezërve të tu, se do jesh kurdoherë i nderuar në mesin e tyre, ashtu si Jusufi!



Oh, çfarë gëzimi pushtoi zemrat e bijve të Jakubit kur dëgjuan këto fjalë. Të mallëngjyer nga gjithçka ndodhi, u nisën edhe një herë drejt Palestinës, tashmë jo nëntë, por plot njëmbëdhjetë.

## Myzhde

U nisën djemtë e Jakubit, alejhis-selam, shend e verë për tek i ati. Sapo u largua karvani nga qytet, një erë e mbarë fryu andej pari dhe mori diç nga aroma e këmishës së Jusufit duke e bartur larg e larg drejt tokës së Ken'anëve. Ndërkohë atje tej dilnin çdo ditë në skajin më të largët të vendit për të marrë vesh ndonjë lajm nga karvanet që kalonin andejpari. Për çudi të të gjithëve, një ditë prej ditësh, ndërkohë që njëmbëdhjetë bijtë e tij vazhdonin ende udhëtimin, Jakubi, alejhis-selam, se ç'nuhati diç nga aroma që kish sjellë flladi mëngjesor. Për një çast fytyra e tij shkëlqeu, ashtu siç shkëlqen fytyra e atij që përgëzohet me lajme të mira... Menjëherë u ngrit në këmbë. *"Jusufi! Jusufi!"*, thirri plaku papritmas, *"Unë po nuhas aromën e Jusufit tim. E mos më thoni se nuk di se ç'flas."* *"Eh mor i mjerë"*, ia kthyen familjarët që kishte afër, *"nuk na habisin më fjalët e tua, jo. Ti që prej kohësh je matufosur."* Mirëpo Jakubi nuk ua vuri veshin, ndërkohë që zemrën ja kishte pushtuar një ndjenjë gëzimi që as vetë ai nuk e kuptonte pse. Me padurim priste karvanin e radhës. Ishte i bindur se lajme të mira vinin nga larg.

Nuk kaluan shumë ditë, kur ja... Një karvan u pa në horizont. Cilët të ishin vallë? A thua vëllezërit? A thua po kthehen? E ndihmuan plakun të vishej dhe me të shpejtë dolën të gjithë së bashku, duke pritur me padurim karvanin që sa vinte e afrohej më shumë... Në krye të karvanit, mbi një deve të shpejtë, qëndronte vëllai më i madh buzagaz, ashtu siç vjen myzhdexhiu nga udhëtimet e gjata. Posa u afrua, zbriti nga deveja e tij dhe

pa folur as edhe një fjalë u drejtua nga babai dhe i vendosi këmishën e Jusufit, alejhis-selam, mbi fytyrën e tij fisnike. Dhe ndodhi pikërisht ajo që u kishte thënë Jusufi. Me lejen e Allahut, drita u ndez përsëri në sytë e plakut. I mallëngjyer, menjëherë u kthye nga ata që i kishte pranë dhe u tha: *“A nuk ju kam thënë se unë di atë që ju s’e dini. A e kuptuat tash pse nuk e kam humbur shpresën asnjëherë, edhe pas kësaj ndarjeje të stërgjatë? Kjo është urtësia e Allahut, që s’mund ta kuptojnë veçse robërit e Tij të mirë.”*

Të turpëruar nga e kaluara e në të njëjtën kohë të gëzuar nga gjithçka po ndodhte, dhjetë bijtë e mëdhenj u kthyen nga i ati: *“O baba jonë”,* thanë me shpresën se i ati do ua pranonte pendimin, *“lutu për ne të na falen gjynahet tona, se me të vërtetë ne kemi qenë fajtorë!”* *“Do ta lus Zotin tim që t’ju falë”,* tha Jakubi fisnik, *“se me të vërtetë Ai është Falës i madh dhe Mëshirues.”* Mos pyet për gëzimin e familjes së Pejgamberit të Allahut kur të njëmbëdhjetë djemtë u kthyen tok nga Egjipti dhe as mos pyet për lumturinë e plakut kur e lajmëruan se Jusufi është shëndosh e mirë, princ i princërve.

## Ëndrra bëhet realitet

Ashtu siç i kishte porositur Jusufi, familja e madhe e Jakubit, alejhis-selam, u përgatit për udhëtim. Babai, nëna, njëmbëdhjetë vëllezër me gra, fëmijë e gjithçka patën u nisën për në Egjipt. Rruga ishte e gjatë dhe e mundimshme, mirëpo të gjithë këtë lodhje e mposhti ëmbëlsia e takimit me djalin e zemrës. Atje larg, në Egjipt, Jusufi së bashku me një grup të madh shërbëtorësh prisnin me padurim dita ditës. Sa shumë kujtime! Sa shumë mall! Kur ja! Pas sa e sa ditësh udhëtim, më në fund, një karvan i stërmbushur me udhëtarë po u afrohej gjithnjë e më shumë portave të qytetit madhështor. Ishte Jakubi me familjen e tij të madhe. Kjo ditë ishte ditë e shënuar edhe për egjiptianët.

Ata e donin dhe e çmonin Jusufin, alejhis-selam, për bujarinë dhe urtësinë e tij, ndaj edhe të afërmit e tij i pritën me respekt të madh. Më në fund Jakubi dhe bijtë e tij erdhën në Egjipt. Jusufi i përgatiti një pritje madhështore. Gëzimi atë ditë ishte i papërshkrueshëm. Sapo u takua me ta Jusufi fisnik, në shenjë nderimi i mori prindërit, që aq shumë i kishin munguar, pranë tij, mbi një fron madhështor të stolisur e të përgatitur enkas për ta. Në atë moment të dy prindërit së bashku me njëmbëdhjetë vëllezërit iu përkulën atij në shenjë respekti.

Atëherë Jusufi, alejhis-selam, u kthye nga i ati, i përmalluar: *"O babush", i tha Jakubit plak, "Ky është kuptimi i ëndrrës sime kur isha i vogël. Besoj se nuk e ke harruar. Njëmbëdhjetë yje, dielli e hëna, tek më binin në sexhde. Zoti im tashmë e bëri realitet. Allahu është burimi i të gjitha të mirave që kam arritur. Ai që më nxori nga burgu e më bëri mëkëmbës në Egjipt. Ai ju solli nga shkretëtira, pasi shejtani pat mbjellë përçarje ndërmjet meje dhe vëllezërve të mi. Me të vërtetë Ai është i butë me robërit e tij."* "O babush", i tha përsëri të atit, *"asnjëherë nuk e kam harruar porosinë që më pate dhënë në vogëli: Asnjëherë mos e humb shpresën, sepse Allahu është i Gjithëditur dhe i Urtë."* Eh, sa u gëzua plaku kur dëgjoji këto fjalë nga goja e të birit.

Bir i dashur! Nuk ka gëzim më të madh për prindin, sesa të shohë fëmijën e tij tek ecën rrugëve të jetës sipas porosive që i pat dhënë në vogëli. Nuk ka lumturi më të madhe për prindin kur e ndjen se është shembull i mirë për fëmijët e tij, burim mirësie dhe dritë udhëzimi në mesin e tyre. Në mbyllje të kësaj historie, mua nuk më mbetet tjetër veçse të pasoj shembullin e Jakubit, alejhis-selam, duke të ta përkujtuar edhe një herë porosinë që ai i la të birit kur e kishte akoma të vogël, me shpresën se edhe ti do ta mbash mend mirë ashtu siç bëri Jusufi. Kjo porosi i përngjan një anijeje madhështore në kuvertën e së cilës, nëse hipën, me lehtësi do t'i tejkalosh të

gjitha dallgët e jetës sado të larta të jenë ato: *Mendo mirë për Allahun gjithmonë, se nëse kështu vepron, pas vështirësive do të ta sjellë patjetër lehtësimin.*

## Takimi i fundit

Thuhet se Jakubi, alejhis-selam, jetoi në Egjipt rreth njëzet e katër vite me iman dhe devotshmëri. Jetoi i lumtur pranë Jusufit së bashku me të gjithë bijtë e tjerë, me nipër e me mbesa shumë. Të gjithë e nderonin, të gjithë e respektonin. Babai fisnik i vezirit fisnik! Egjipti u bë si atdhe për të.

Por si çdokujt, kur mbërriti pleqërinë e thellë, kur kokën dhe mjekrën ja ndriçonin thinjat, Jakubit, alejhis-selam, iu afrua vdekja. Dhe ja, pas një jete të gjatë e të stërmbushur me sprova plaku fisnik, i shtrirë në shtratin e pleqërisë, pret e përcjell djemtë e tij dita-ditës tek vijnë e çmallen me babën e urtë, me babën pas të cilit ishin strehuar në ditët e vështira. Me butësi dhe urtësi kuvendonte me ta. I jepte këshilla dhe udhëzime bijve, ndërkohë ata dëgjonin me vëmendje rreth kokës së Jakubit urtësitë që buronin nga goja e tij fisnike. Derisa një ditë, kur plaku e kuptoi se tashmë vdekjen e kishte fare pranë, i mblodhi për të fundit herë, ashtu siç bën njeriu i mençur në prag të vdekjes. Pasi u afruan të gjithë, Jakubi, alejhis-selam, iu drejtua duke i pyetur: *“O bijtë e mi! Kë do të adhuroni pas meje?”* Të mallëngjyer nga gjendja e vështirë në të cilën ndodhej i ati, njëzëri u përgjigjën: *“Mos u trazo, o babë! Ne do adhurojmë Zotin tënd dhe Zotin e etërve të tu: të Ibrahimit, Ismailit dhe të Is'hakut, një Zot të vetëm! Ne vetëm Atij i nënshtrohemi dhe askujt tjetër veç Tij!”* Pikërisht këtë dëshironte të dëgjonte Jakubi. Pas kësaj, vdekja iu bë më e lehtë Pejgamberit fisnik. Nuk kaloi shumë dhe plaku i moçëm i

mbylli sytë për të mos i hapur më. Perëndoi dielli që rrezatonte dritën e diturisë dhe urtësisë duke lënë pas dymbëdhjetë yje si udhërrëfyes për njerëzit.

Bir i dashur! Siç e di, besimdrejtët në botën pas vdekjes do të jenë trashëgimtarët e Xhenetit të begatë. Të kënaqur me atë që i shpërbleu Zoti i tyre dhe të gëzuar që i mbrojti nga vuajtjet e Xhehenemit. Hanë e pinë të mbështetur në kolltukë të rehatshëm prej mëndafshi. Njëri tjetrit i zgjasin gotat siç bën miku me mysafirin. Përmes tyre kalojnë shërbëtorë, djelmosha me fytyra që u shkëlqejnë pors margaritar. Qëndrojnë nën hijet e pemëve shumëllojëshe, pranë burimeve që gurgullojnë, ashtu si mbretër. Mirësi mbi mirësitë...Tokë e pasuri shumë. Sikur të mos mjaftonte kjo, prindërve besimdrejtë e të devotshëm Allahu Mirëbërës do ua shtojë edhe më shumë kënaqësinë duke i bashkuar me fëmijët e tyre. Edhe nëse fëmija nuk e meriton atë lartësim në Xhennet, nëse ka vdekur në besimin e drejtë të të parëve të tij, Allahu i bashkon tok, për hir të prindërve të mirë.

Kjo është arsyeja pse Jakubi, alejhis-selam, edhe në momentet e fundit, teksa po ndahej nga kjo botë, porositi djemtë e tij të adhuronin vetëm Allahun, Zotin e tij, Zotin e baballarëve të tij të nderuar, Ibrahimit dhe Is'hakut. Kjo është feja e vërtetë, por shumica e njerëzve nuk e dinë.

### *Lutja e peygamberit*

Thuhet se Jusufi, alejhis-selam, ka jetuar në Egjipt edhe njëzet e tre vite pas Jakubit, si fisnik i nderuar së bashku me të afërmit e tij. Në mesin e begative që gëzonte si vezir, kur e gjithë familja e tij ishin bashkuar, kur çdo mirësi i ishte dhuruar, e kuptoi se jetës në këtë botë po i vinte fundi. Ishte i bindur

se çdo gjë në këtë botë është kalimtare, nga prehri i ngrohtë i babait në errësirën e pusit, nga pusi në pallatin mbretëror, nga pallati në burg dhe nga burgu princ i princërve. Kështu e ka kjo botë: ashtu siç vjen nata pas ditës, ashtu vjen edhe dita pas saj, ashtu siç vjen mirësia pas vështirësisë, ashtu edhe vështirësia e pason mirësinë. Pikërisht në këtë moment Jusufi, pasi e falënderoi Allahun e Lartësuar për mirësitë e panumërta me të cilat e kishte nderuar, iu drejtua me lutje duke i thënë: *“O Zoti im, Ti më ke dhënë pushtet në tokë, Ti më mësove shpjegimin e ëndrrave; o Krijues i qiejve dhe i tokës, Ti je ndihmëtari i im në dynja dhe në Ahiret, ma mundëso të vdes si musliman dhe më bashko me robërit e Tu të mirë!”*

## Ejubi

Biri im! Një ndër rrëfimet më të vlera është edhe historia e Ejubit, të birit të Meusit, stërnipit të Is'hakut, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dy. Thuhet se ka qenë princ i pasur dhe se ka jetuar në krahinë Havran, diku në jug të Damaskut. Allahu i Lartësuar i kishte dhuruar pasuri pafund: fëmijë, toka, bagëti dhe stoli shumë. Mirëpo, kur kishte arritur kulmin e mirëqënies, Allahu e sprovoi në mënyrë që emri i tij të mbetet i paharruar dhe t'i thureshin lavde durimit të tij. E goditi lebra, fëmijët i ndërruan jetë një nga një, pasuria i shkoi dhe shoqëria e braktisi përpos gruas së tij fisnike. Të Allahut jemi dhe tek Ai do të kthehemi. Dije, o bir se ata që goditen nga sprovat më të rënda janë Pejgamberët dhe njerëzit e mirë, që të shfaqet durimi i tyre dhe të shërbejnë si shembull për brezat që u vijnë pas. Një nga këta shembuj të pashoq ishte Ejubi, alejhis-selam. Megjithëse humbi çdo pasuri që kishte, shëndetin dhe familjen, asnjëherë nuk e humbi durimin dhe mendimin e mirë në të Madhin Zot. Dëgjo se ç'rrëfehët për të!

### Bashkëshortja fisnike

Kur iu përkeqësua sëmundja dhe iu venit pasuria, miqtë e braktisën, madje e detyruan të largohej në skaj të qytetit që të mos infektoheshin prej tij. Asokohe lebra nuk kish shërim... Askush nuk e ngushëlloi, askush nuk e ndihmoi, askush nuk

përkujdesej më për të, përveç të shoqes. Fisnikja nuk e braktisi shokun e jetës asnjëherë. Shpenzoi gjithçka kishte në shërbim të Ejubit dhe, kur nuk i kish mbetur as edhe një qindarkë, filloi të punonte si shërbëtoreshë që të fitonte bukën e gojës. Asnjëherë nuk e lëndoi burrin e saj; kurrë nuk i ankua atij, por së bashku me të u bëri ballë vështirësive që e goditën njëra pas tjetrës... Jo një ditë dhe as një javë, jo një muaj dhe as një vit, por për vite me radhë ia mjekonte plagët dhe ia këqyrte sytë Ejubit. Mirëpo, kur u mor vesh se ditë për ditë e vizitonte të shoqin dhe i qëndronte pranë, njerëzit iu larguan edhe asaj. Tashmë as punë nuk i ofronte kush nga frika se mos infektoshin nga lebra. Një ditë, tek i mjekonte trupin, e shoqja i tha: *"O i Dërguar i Allahut, sikur ta lusje të Madhin Zot, Ai me siguri do të të shëronte."* *"Moj grua"*, ia ktheu Ejubi, *"Për shtatëdhjetë vite kam jetuar shëndosh e mirë, e tash kam turp të ankohem. Sabër do bëj se shpejt do kalojnë vështirësitë."* Në këto kushte, gruaja e Ejubit alejhis-selam e preu njërin nga gërshetat e saj në fshehtësi dhe ia dha të bijës së një pasaniku në këmbim të ushqimit. Kur ia solli Ejubit alejhis-selam, ai e pyeti: *"Prej nga vjen gjithë ky ushqim, moj fisnikja e ime?"* *"I fitova duke i shërbyer një pasanikeje, o Ejub."* - ia ktheu me fytyrë të buzëqeshur e shoqja. Mirëpo, për pak ditë ushqimi mbaroi. Po tani si t'ia bënte vallë? Kujt t'i binte në qafë? Kujt t'i trokiste në derë? Uria e madhe e shtyu fisniken ta priste edhe gërshetin tjetër. Ama kësaj radhe Ejubi, alejhis-selam, vërejti trishtim në sytë e të shoqes, ndaj u betua se nuk do ta prekte ushqimin derisa ta merrte vesh të vërtetën. Atëherë e shoqja hoqi mbulesën nga koka dhe e vërteta doli sheshit. Kur i pa flokët e saj, të Dërguarit iu helmua shpirti. *"Veç, në mos u shërofsha!"* - i tha të shoqes. *"Njëqind herë do të të fshikulloj për këtë që po shoh, moj e mjerë."* Por fisnikja s'iu përgjigj. E vuri edhe një herë shaminë mbi kokë dhe iu afrua burrit t'ia mjekonte plagët e ta ngushëllonte.



## Lutja

Një ditë, i lodhur nga sëmundja dhe i pikëlluar nga gjendja e gruas së tij, Ejubi ngriti duart nga qielli dhe po lutet: *"O Allah! Mua më ka goditur vështirësi e madhe, e Ti je Mëshiruesi i mëshiruesve!"* Menjëherë lutja e tij u pranua. *"Mëshoji tokës me këmbë!"*- iu shpall. *"Ujë i ftohtë, shërim për ty do burojë nga thellësia. Laju me të e shuaje etjen, se kështu shpërblehen sabërlitë."* I Dërguari goditi tokën me sa fuqi pat, kur ja... sa hap e mbyll sytë shpërtheu një burim me ujë të bekuar, ilaç për sëmundjet dhe i ëmbël si mjalti. Ejubi, alejhis-selam, filloi të lahet dhe sapo uji ia prekte lëkurën, plaga mbyllej e qelbi largohej. Sikur të mos mjaftonte kjo, Allahu dërgoi një tufë karkalecash floriri në drejtim të tij, që sapo i kapte Pejgamberi, ngrinin e shndërroheshin në stoli. Me të shpejtë i stërmbushi xhepat me flori të kulluar. Shend e verë, tek mundohej të kapte karkalecat që i fluturonin krejt afër, i Lartësuari i shpalli: *"A nuk u ngope, o Ejub?" "E kush ngopet me rahmetin tënd, o Zoti im?!"*- briti Ejubi me gëzim. Pasi mblodhi sa më s'ka, Allahu përsëri i shpalli: *"Tash, këput njëqind fije nga trangu i palmës që ke pranë, godite gruan tënde me ta e mos e shkel premtimin!"*

## Përkujtim

Pasi ia shëroi trupin dhe ia mbushi xhepat, Allahu i Lartësuar e urdhëroi të merrte njëqind fije palme dhe me të t'i binte të shoqes një herë të vetme, si lehtësim për fisniken dhe shpagim për betimin... Kur u kthye nga qyteti, fisnkja nuk e njohu. Me gjysëm zëri i tha: *"O rob i Allahut, mos e pe vallë një lebroz që rrinte këtu pranë?" "E mjera ti moj nusel!"*- i buzëqeshi Pejgamberi. *"Lebroz ishte, por u shërua."* *"O rob i Allahut, mos u tall me mua!"*- ia ktheu gruaja. *"E mjera ti",* ia

*Rrefimet më të mira*

priti burri përsëri, "Ejubi jam, a s'ma njeh zërin?!" Fisnikja nuk u besonte syve. E përlotur iu afrua të shoqit dhe e shtrëngoi fort nga gëzimi. Ejubi, që tashmë e kish pushtuar me krahët e tij, i puthte kokën dhe falënderonte të Lartmadhërismin. Allahu ia ktheu shëndetin, ia shtoi pasurinë. Ndër vite i dhuroi pasardhës të shumtë, dyfishin e atyre që kishin ndërruar jetë, dhe e bëri emrin e Ejubit, alejhis-selam, të paharruar, si përkujtim për sabërlitë.

## Junusi

Biri im! Edhe Junusi ka qenë Pejgamber. Allahu e dërgoi si fe-rrëfyes tek banorët e Ninevës, në rrethinat e Mosulit. Mot pas moti i thirri drejt adhurimit të Allahut të Vetëm e të Pashoq, porse ata nuk iu bindën dhe këmbëngulën në mosbesim. Kur i humbi shpresat se do të përmirësoheshin, Junusi, alejhis-selam, iku i zemëruar nga trojet e tyre pa marrë lejen e Allahut. Ndërkohë që dilte nga portat e qytetit, i lajmëroi se pas tre ditësh do zbriste mbi ta dënimi i tmerrshëm dhe se askush nuk do shpëtonte. Kur dëgjuan paralajmërimin e Junusit, frika ua kaploi zemrat dhe u penduan për gjithçka kishin bërë. Thuhet se me t'u larguar Pejgamberi, dolën të gjithë në një luginë: burra e gra, pleq e plaka, djem e vasha për t'i kërkuar falje të Lartmadhërishmit. Ashtu të leckosur filluan të luteshin me lot në sy. Thuhet se kishin marrë edhe gjënë e gjallë në lëndinë. Devetë e lopët pëllitnin, delet e qengjat blegërinin, të gjitha bagëtitë e trasha e të imëta, të trazuara, kërkonin falje në gjuhën e tyre... Si pasojë e pendimit, Mëshirëploti ua fali gabimet dhe e largoi dënimin. Me të vërtetë Ai i pranon pendimet dhe i fal gabimet.

### Shorti

Ndërkohë, Junusi, alejhis-selam, kishte mbërritur në brigjet e detit. I frikësuar nga dënimi që mund të zbriste mbi ato troje,

u pajtua me kapitenin e një anijeje dhe u nis për udhëtim në det të hapur. Mirëpo, kur anija arriti mesin e detit, qielli u ngrys dhe deti u egërsua. Valët e buta u shndërruan në dallgë të egra që përplasnin me sa fuqi kishin anijen prej druri. Filladi i freskët detar u shndërrua në tufan të furishëm që gati sa nuk i shkuli velat nga direkët. Ekuipazhi lëshoi alarmin. Anija gati sa nuk po fundosej nga pesha që mbante mbi shpinë. Udhëtarët dukeshin si krimba në një copë druri që e hidhnin dallgët sa lart-poshtë. Nga tmerri zemrat u erdhën në fyt. Nuk u mbeti tjetër veçse ta vendosnin me short se kush do hidhet në det në mënyrë që të lehtësohej kuverta e stërmbushur me ujë të ftohtë. Kur hodhën short për të parën herë, ai i ra Junusit, alejhis-selam, mirëpo udhëtarët nuk u pajtuan. I Dërguari u kish hyrë në zemër, ndaj hodhën short edhe një herë. Megjithatë shorti përsëri i ra Junusit, alejhis-selam, i cili filloi të përgatitet. Kur edhe për të tretën herë i ra atij, u bind se po e thërret exheli dhe u hodh me turr nga kuverta e anijes në detin e egër. Dallgët e tërbuara menjëherë e gllabëruan.

Ndërkohë që luftonte me vdekjen, këmbët e tij prekën shpinën e një balene gjigande që i ish afruar krejt pranë. U mundua të largohej, por më kot. Duart i ishin lodhur, ndërsa këmbët i ishin mpirë nga uji i ftohtë. I rraskapitur iu nënshtrua fatit, ndërkohë peshku i frikshëm hapi gojën gjigande dhe Junusi, alejhis-selam, ra në brendësinë e balenës, si të binte në humnerën e vdekjes. Diku thellë në errësitat e barkut të saj u mundua të lëvizë duart e të prekë fytyrën me to. Kur arriti ta ndjente ftohtësinë e pëllëmbës në fytyrë, e kuptoi se ishte akoma gjallë. Allahu e kish frymëzuar peshkun të mos ia prekte mishin dhe të mos ia thyente eshtrat.

### *Lutja në errësi*

Ndërsa nata mbuloi me errësi qiell e det, balena zhytej

thellë e më thellë. Mirëpo Junusi, alejhis-selam, nuk e humbi shpresën. Diku në barkun e balenës, e humbur në thellësitë e detit, i zhytur në terrin e natës, thërret me gjysëm zëri : *“Nuk ka të adhuruar me të drejtë veç Teje, o Allah, i Lavdëruar qofsh! Me të vërtetë unë i kam bërë vetes padrejtësi!”* Thuhet se Allahu i Lartësuar ia mundësoi banorëve të qiellit ta dëgjonin lutjen e Junusit alejhis-selam. *“O Allah”,* thanë melekët, *“nga thellësitë po dëgjojmë një zë të dobët!”* *“Është zëri i robit tim, Junusit.”*, u tha Allahu, *“Ka bërë gabim, ndaj e kam burgosur në barkun e një peshku në det.”* *“O Allah!”*, thanë melekët, *“A nuk është ky njeri, rob i Yt i devotshëm që të lutej natë e ditë me përgjërim?”* *“Po”,* u tha Allahu. *“Atëherë fale dhe mëshiroje, o Zoti jonë!”*- iu drejtuan melekët njëzëri. *“Do ta fal dhe do ta mëshiroj.”*- tha Allahu, dhe e frymëzoi peshkun të nxirrte gjithçka mbante në brendi.

Biri im! Bëhu i njohur në mbretërinë e qiejve përsa kohë që je rehat, që të të përkujtojnë kur të godasë belaja. Sikur Junusi, alejhis-selam, të mos ishte nga ata që e përmendnin Allahun shumë, do të qëndronte i burgosur në barkun e balenës deri Ditën e Ringjalljes. Ruaje fenë e Allahut që Ai të të ruajë ty! Përkujtoje Allahun në mirëqenie, në mënyrë që Ai të të ndihmojë në vështirësi!

## Në breg

Balena iu afrua brigjeve aq sa mundi dhe zbatoi urdhrin e të Madhit Zot. Kur doli në sipërfaqen e detit, i Dërguari i Allahut u dha krahëve me sa fuqi pati drejt bregut. Valët e detit ia lehtësuan udhën dhe për pak kohë mbërriti në një breg të shkretë. I raskapitur për vdekje u shemb mbi rërë dhe e kaploi një gjumë i lehtë. Fytyra i ish nxirë dhe lëkura i ish regjur nga kripa. I sëmurë rënkonte mbi rërë, por askënd nuk kishte pranë ta ndihmonte. Atëherë Allahu bëri që pranë tij të

mbinte me të shpejtë një lloj kungulli gjethemadh. Aroma e gjetheve të tij largonte insektet, ndërsa sipërfaqja e tyre i bënte hije Junusit. Frutin e kishte të shijshëm e të ëmbël. E sikur të mos mjaftonte kjo, Allahu frymëzoi një dhi që kulloste atyre shtigjeve t'i shkonte pranë Pejgamberit, mëngjes e mbrëmje që ta milte e të shuante etjen.

Thuhet se pasi ripërtëriu forcat, Junusi u kthye në tokat e Ninevës. Mos pyet se sa u gëzua kur pa se të gjithë banorët e asaj krahine, njëqind e sa mijë njerëz, adhuronin Krijuesin e Qiejve dhe të Tokës, të Vetëm e të Pashoq. Mbarë populli e mirëpritën Pejgamberin fisnik, i cili jetoi i lumtur në mesin e tyre derisa vdiq.

## Musai

### Pas Jusufit

Biri im! Për shumë vite me radhë, Jusufi, alejhis-selam, i thirri koptasit në rrugën e shpëtimit, udhëhoqi me drejtësi duke përkrahur të shtypurin dhe duke ushqyer të uriturin. Ai i ndihmoi ata në ditët e thatësirës dhe urisë së madhe. Për këtë arsye të gjithë banorët e Egjiptit e nderuan vezirin bujar për sa kohë qëndroi në mesin e tyre dhe u përkujdesën për të afërmit e tij edhe pasi ndërroi jetë. Benu Israil! Bijtë e Israilit! Kështu quheshin bijtë e Jakubit, në përkujtim të babait fisnik. Vit pas viti numri i benu israilëve sa vinte e shtohej. E sikur të mos mjaftonte kjo, bashkë me numrin shtohej pasuria dhe autoriteti i tyre. Me pak fjalë Egjipti u bë shkak i begatisë për ta. Një atdhe i dytë për pasardhësit e Jakubit. Mirëpo shumica e tyre me kalimin e kohës u mashtruan nga bukuritë e kësaj bote. Dashuria për famë dhe pushtet ua gllabëroi zemrat. Një pjesë e madhe u dhanë pas grumbullimit të arit dhe argjendit, i lanë pas dore porositë e baballarëve të tyre të parë dhe braktisën thirrjen në besimin e drejtë. Megjithatë kishte akoma familje që e ruanin fenë e Ibrahimit, alejhis-selam, me kujdes, ashtu siç i ruan argjendari perlat dhe rubinët.

Gjithsesi fisnikëria e shumicës së benu israilëve u venit, morali i tyre u prish dhe gjendja ndryshoi. Koptasit nuk i ndëronin më si dikur, madje shumë prej tyre mendonin se benu

israilët ishin të huaj dhe si të tillë nuk kishin pse të gëzonin kurrfarë të drejte në Egjipt. Shumë prej koptasve e kishin harruar tashmë mirësinë dhe fisnikërinë e Jusufit, alejhis-selam, aq sa u përhap në mesin e tyre ideja se ai nuk kishte qenë tjetër veçse një skllav i blerë nga sundimtari i Egjiptit...

Në këtë mënyrë koptasit filluan t'i nënçmonin pasardhësit e Jakubit, alejhis-selam, të pasurin e kishin zili, ndërsa të varfërin e poshtëronin. Por e zeza e madhe i pushtoi ata kur në fronin e Egjiptit erdhi një mbret tiran dhe kryelartë që nuk shihte askënd mbi vete, një inatçor që krenohej në mesin e të tjerëve me sundimin e tij, pushtetin dhe pallatet madhështore. Ky mbret i padrejtë ishte firaoni i Egjiptit, ai që mohoi Allahun e Lartësuar dhe i urdhëroi njerëzit ta adhuronin si zot.

Biri im! Mos harro se muslimani nuk ka përgjegjësi vetëm ndaj Zotit të tij dhe vetvetes, por edhe karshi shoqërisë që e rrethon. Muslimani urdhëron për të mirën dhe të dobishmen, përndryshe përhapet e keqja, dhe pastaj e ka të vështirë të mbrohet prej saj. Profeti ynë, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, na mëson se ndër veprat më me vlerë në mbretërinë e qiejve është urdhërimi për mirë dhe ndalimi nga e keqja. *"Pasha Atë në dorën e të cilit është shpirti im",* thotë Profeti, alejhis-selam, *"ose do urdhëroni për mirë dhe do ndaloni nga e keqja, ose Allahu do ju dërgojë një dënim mbi ju, pastaj do ta lusni Atë por nuk do u përgjigjet."* Shih se ç'u ndodhi israilitëve!

## Firaoni

Me të marrë pushtetin, firaoni i Egjiptit i skllavëroi benu israilët. Ky kriminel mendonte se koptasit janë krijuar për të sunduar botën, ndërsa benu israilët për të shërbyer. Për këtë arsye ai e ndau popullin në sundues dhe skllavë. Ndaj sklle-



vërve nuk tregonte kurrfarë mëshire, por i shtypte me ashpërsi dhe sillej me ta ashtu siç sillet pronari me kafshën e egër. I ngarkonte me punë të rënda dhe nuk u jepte ushqim veç sa për të mbajtur frymën. Hidhërimi i shtohet edhe më shumë, se benu israilët nuk e madhëronin siç bënin koptasit, nuk i përkuleshin dhe as nuk i bënin sexhde, ngase ata ishin pasardhës peygamberësh që s'aduronin tjetër veç Allahut. E sikur mos të mjaftonte vetëm kjo...

Një natë prej netëve ky zullumqar pa një ëndërr të frikshme që e tmerroi pa masë. Ëndërroi një zjarr që vinte nga tokat e Ken'anëve drejt Egjiptit. Një zjarr të flakëruar që digjte pa mëshirë pallatet mbretërore pastaj shpejtonte drejt tij. Kur u zgjua nga gjumi i tmerruar, menjëherë i mblodhi të gjithë magjistarët, astrologët dhe dijetarët e pallatit mbretëror për ta pleqëruar shpjegimin e ëndrrës që shumë e kish frikësuar. Pasi e dëgjuan me vëmendje ata i thanë: *"O shkëlqesija jonë! Ëndrra juaj lajmëron se shpejt do të lindë një foshnje në mesin e benu israilëve, një foshnje që do jetë shkaku i shkatërrimit tënd dhe i të gjithë koptasve që të pasojnë ty."* Me të dëgjuar fjalët e tyre, mbreti gati sa nuk u çmend nga hidhërimi dhe urdhëroi ushtarët e tij me diç që nuk ishte dëgjuar kurrë më parë. *"Që sot e tutje, të vriten pa mëshirë të gjithë djemtë që do lindin në mesin e benu israilëve, ndërsa vajzat të lihen gjallë!"*- dha urdhër të prerë firaoni. Ditë vaji dhe dëshpërimi erdhën për pasardhësit e Jakubit, alejhis-selam. Firaoni ndërmori të gjitha masat e duhura që të zhdukej foshnja të cilës i frikësohej: organizoi ushtrinë dhe gra të posaçme të cilat vizitonin shtëpiat e benu israilëve dhe informonin për çdo shtatzënë. Sa herë që lindte një djalë kriminelët e firaonit e thernin aty për aty, sikur të ishte bagëti kurhani. Nuk numërohen se sa fëmijë u therën para syve të prindërve, sa e sa të tjerë u morën me dhunë nga gjiri i nënave a prehri i ngrohtë i tyre. Me të vërtetë dita kur linte një fëmijë nga benu israilët, ishte ditë kobi, ditë dhimbjeje dhe ngushëllimi.

Thuhet se kjo gjendje e vështirë vazhdoi për vite me radhë derisa koptasit iu ankuan firaonit se nëse mbyteshin fëmijët e benu israilëve, do vijë dita kur edhe të rriturit në mesin e tyre do vdisnin dhe askush nuk do të mund t'i bënte punët e rënda që i ngarkoheshin atyre. Kush mund t'u shërbente koptasve? Kush mund të transportonte mijëra tulla gjigande prej qerpiçi për ndërtimin e pallateve dhe të piramidave? Kush mund të mbillte tokën vallë? Të ngjitha këto pyetje e të tjera të ngjashme me to e shtynë firaonin të jepte një urdhër të ri. *"Një vit të mbyten të porsalindurit meshkuj, ndërsa vitin që pason të lihen në jetë, në mënyrë që të jetojnë vetëm ata që do punojnë për ne dhe do na shërbejnë të përlulur!"*

Mirëpo tjetër gjë kishte caktuar Allahu i Madhërishëm për pasardhësit e peygamberëve: të dobëtin do ta përforconte, të mundurin do ta bënte ngadhënjyes dhe të poshtëruarin do e lartësonte. Dhe nuk ka dyshim se ajo që cakton Allahu do ndodhë patjetër, deshi apo s'deshi firaoni dhe të ngjashmit me të. Nuk ka dyshim se tokën do ta trashëgojnë robërit e vërtetë të Allahut, njerëzit bujarë dhe të dëlirë, ata që mbjellin mirësinë dhe udhëheqin me drejtësi.

## Lindja e ngadhënjimtarit

Në një familje fisnike, të njohur për përkushtimin ndaj Zotit dhe për bujarinë ndaj njerëzve, lindi në vitin në të cilin nuk mbyteshin fëmijët një foshnje e bekuar. Erdhi në jetë Haruni alejhis-selam, i biri i Imranit, stërnipit të Jakubit. Erdhi në jetë foshnja që në të ardhmen do bëhej dritë udhëzimi dhe burim mirësie për pasardhësit e peygamberëve. Mos fol për lumturinë e prindërve kur e shihnin se si buzëqeshte dhe lëvizte foshnja në prehërin e tyre. Gëzim i madh, gëzim që nuk përshkruhej!

Megjithatë, ky gëzim pas një viti u shndërrua në brengë dhe trishtim për familjen e nderuar. Në vitin kur thereshin

foshnjat, deshi Allahu i Lartësuar të sillte në jetë djalin e dytë të Imranit, djalin që do ishte udhërrëfyesi i paepur i benu israilëve, Pejgamberin që do t'i shpëtonte pasardhësit e Jakubit nga zgjedha e firaonit, fisnikun që do t'i nxirrte njerëzit nga ërrësitat në dritë. Pikërisht në këtë vit lindi Musai, alejhis-selam, biri i Imranit, përkundër asaj që dëshironte firaoni. Erdhi në jetë djali, lindjes së të cilit i ruhej dhe i frikësohej aq shumë sundimtari i Egjiptit. Për fat të mirë, nëna besimtare e kishte mbajtur të fshehtë barrën e saj. Thuhet se ajo nuk dilte shpesh nga shtëpia, por edhe kur dilte, bënte gjithçka që të mos binte në sy derisa lindi. Por kur e lindi foshnjën, ç'të shihte! Një djalë i shëndetshëm, me sy të qeshur dhe me fytyrën që i vezullonte si hëna. Megjithë lumturinë që solli lindja e Musait, brenga dhe frika për të ardhmen e tij ishte e madhe. Thuhet se Musai, alejhis-selam, jetoi rehat dhe i qetë në ngrohtësinë e gjirit të nënës për tre muaj, mirëpo sa më shumë kalonte koha aq më shumë trishtohej nëna e mjerë. E si të mos frikësohej kur armiku ishte në pritë?! Ç'të bënte nëna e gjorë?! Ku ta fshihte djalin që e kish si dritën e syve?! Një zë i brendshëm sikur i pëshpëriste: *"Vendose djalin tënd në një shportë, pastaj hidhe në lum e mos ki frikë se mos fundoset, mos ki frikë..."*

Ditë pas dite ky zë i çuditshëm ia trazonte shpirtin nënës së mjerë. E si mund ta hidhte djalin në lumin Nil, kur rrjedha e tij ishte e fortë dhe e rrëmbyer?! Si mund ta bënte diçka të tillë kur në lumë jetonin krokodilë gjigandë dhe peshq grabitqarë?! Mirëpo ushtria ishte gjithandej. Armiku i fëmijëve rrinte në pritë. Në këto kushte, Allahu i Lartësuar ia përforcoi zemrën, ndaj ajo u qetësua dhe u pajtua me atë që trazonte shpirtin e saj. E mori djalin e bekuar dhe pasi e shtrëngoi fort në gjoks dhe e uthi, e vendosi në një shportë. Pasi e përgatiti me të shpejtë, së bashku me vajzën e saj, në mënyrë që të mos binte në sy, iu afrua bregut të Nilit dhe e hodhi djalin në lumë. Sapo preku sipërfaqen e ujit, shporta nisi udhëtimin pas rrjedhës. Në këtë

moment nëna iu drejtua të bijës duke i thënë: *"Nisu bija ime! Ndiqe pas vëllanë e shih se për ku lundron shporta!"*

## *Xë pallatin mbretëror*

Shporta lundroi mbi Nil. Për çudi, megjithëse lëkundej pa pushim, rrjedha e lumit as nuk e përmbysi dhe as e fundosi. Deshi Allahu që uji ta bartë shportën deri në afërsi të bregut, krejt pranë pallatit mbretëror, kopshti i të cilit shtrihej buzë Nilit. Thuhet se shërbëtorët e firaonit vunë re nga larg një shportë që lundronte qetë e qetë mbi lumë dhe ngarendën me të shpejtë se kush ta merrte i pari. Megjithatë asnjëri nuk guxoi ta këqyrte derisa e sollën përpara gruas së sundimtarit, Asijes. Ç'të kishte në brendësi vallë?

Sapo e mori shportën ajo e hapi me padurim, kur ç'të shihte! Një foshnjë e bukur dhe e buzëqeshur me fytyrën që shkëlqente nur. Me butësi e mori foshnjën në duar dhe dashuria për të ia pushtoi zemrën. Pasi e puthi, e shtrëngoi fort në gjoks dhe me të në duar shkoi tek i shoqi. Kur iu afrua, ai u frikësua nga foshnja dhe pa një pa dy urdhëroi që ta vrisnin. Por pa u afruar mirë rojat e pallatit, Asija e rroku fort fëmijën pas vetes dhe me përgjërime e luti të shoqin që t'ia falte asaj ngaqë nuk kishte asnjë djalë. *"Mos o zotria im! Mos e mbytni se ai do jetë gëzim për mua dhe për ty! Le të rritet në prehrin tonë se ndoshta na sjell dobi."* Kur e pa reagimin e të shoqes, firaoni u pajtua me dëshirën e saj, duke mos kuptuar asgjë.

Kështu e kish caktuar Allahu: fëmija të cilit i frikësohej aq shumë sundimtari i fuqishëm, fëmija si pasojë e të cilit u derdh gjaku i mijëra foshnjeve të pafajshme, të rritej pikërisht në pallatin e tij, të ushqeje me bukën e tij dhe pijen e tij, të flinte në shtratin e tij, të edukohej në prehrin e tij, më pas, të bëhej shkaktar i dënimit të tij në këtë botë dhe në tjetrën. E gjithë

kjo me qëllim që firaoni dhe tërë bota ta marrë vesh se Allahu i Lartmadhërishëm, Zoti i qiejve dhe i Tokës, është i Urtë dhe i Plotfuqishëm dhe se çka të dojë Ai, bëhet me hir a me pahir.

Kështu pra, Musai, alejhis-selam, biri i Imranit, hyri në pallatin e firaonit dhe askush nuk pati mundësi të binte në gjurmët e tij. Për më tepër, kushdo që e shihte e donte. E merrnin në prehër, e shtrëngonin dhe e puthnin. *I dashuri i mbretëreshës! I dashuri i mbretëreshës!* - kumbonin korridoret e pallatit sapo dëgjohej zëri i djalit. Ndërkohë motra e Musait ishte kthyer tek e ëma dhe e kishte lajmëruar se si vëllanë e vogël e kishin gjetur shërbëtorët e sundimtarit dhe se si e kishin marrë me vete në brendësi të pallatit. Sapo dëgjoji fjalët e së bijës zemra e nënës u helmua. Dësh u këput nga hidhërimi nëna e gjorë, por edhe në këto momente Allahu i Lartësuar e përforcoi duke ia mundësuar të jetë e qëndrueshme dhe e pathyer, ashtu siç i takon një besimtareje të vërtetë.

## Tek nëna

Kur e shpunë në pallatin mbretëror, mbretëresha pajtoi disa mëndesha për ushqimin e të dashurit të saj. Secila prej tyre u përpoq ta ushqente foshnjën, por për çudi, vogëlushi refuzonte gjirin e çdo mëndeshe dhe çdo lloj ushqimi. Megjithë përpjekjet e mëndeshave për ta gëzuar mbretëreshën, fëmija veçse qante dhe nuk pranonte gjirin e asnjërës. Koha kalonte dhe ushqimi i fëmijës u bë shqetësimi i oborrit mbretëror. Fjala mori dhenë: kërkohet një mëndeshë për të dashurin e mbretëreshës!

E frikësuar për jetën e foshnjës, Asija dërgoi shërbëtorët e pallatit së bashku me djalin në pazar me shpresën se do të mund të gjenin dikë që të mund t'i jepte gji. Shumë gra u përpoqën ta ushqenin në mënyrë që të përfitonin nga dhuratat e mbretëreshës, por më kot, foshnja nuk pranonte të thithte

gjirin e askujt. Për fat të mirë, ndërkohë që lëviznin me nxitim nëpër treg, shërbëtoret i ndaloi një kalimtare. *"A dëshironi t'ju tregoj unë për një grua që mund ta ushqejë të dashurin e mbretëreshës?"* - iu drejtua vajza. Po kush të ishte vallë kjo vogëlushe? Ishte pikërisht motra e Musait që u kishte dalë përpara shërbëtoreve të pallatit me shpresën se Allahu do ta kthente edhe një herë vëllaqon tek gjiri i ngrohtë i nënës. *"A dëshironi t'ju tregoj për një familje, që do kujdeset për të, dhe do ta ruajë si mos më mirë?"* - i tha përsëri. *"E ku e di ti se do kujdesen për të dhe do ta ruajnë?"* - ia kthyen shërbëtoret. *"Po ja! Ata dëshirojnë të gëzojnë mbretëreshën dhe shpresojnë shpërblimin e saj."* - ia ktheu vajza.

Kur dëgjuan çfarë dëgjuan, iu vunë pas vajzës së vogël dhe së bashku mbërritën në shtëpinë e saj. As mos pyet se sa u lumturua nëna kur iu kthye vogëlushi. Megjithatë, e përmbajti veten në mënyrë që mos të zbulohej sekreti. Sapo e vendosi foshnjën në gj, vogëlushi filloi të thithte pa pushim gjë që i gëzoi pa masë shërbëtoret. Me të shpejtë ata ia përcollën lajmin e mirë Asias, gruas së firaonit.

Pas kësaj ndodhie thuhet se Asia e ftoi nënën e Musait të jetonte në pallatin mbretëror, por ajo nuk pranoi duke u arsyetuar se kishte detyra ndaj burrit dhe fëmijëve të saj. *"Këtë fëmijë nuk mund ta ushqej ndryshe vetëm nëse e dërgon me mua."* - tha nëna e Musait. Asia pranoi ta dërgonte me të, duke i caktuar një rrogë të mirë dhe gjithçka kishte nevojë fëmija: ushqim të përzgjedhur dhe veshmbathje. Kështu pra, nëna u kthye sërish në shtëpi, por tashmë nuk ishte e vetme. Në gjoks shtrëngonte me përmallim foshnjën e saj të dashur. Allahu i Lartësuar pas ndarjes i bashkoi sërish.

U plotësua premtimi i Allahut... Ai e ruajti Musain nga fundosja në Nil, e mbrojti nga grabitqarët e lumit dhe nga duart e kriminelëve, ia ktheu nënës fisnike që ta ushqente pa kurrëfarë frike dhe ta shihte tek rritej në prehrin e saj. Kështu

është shkruar, o bir: kush e ruan fenë në ditët e vështira, Allahu e ruan nga belatë, jo vetëm atë, por edhe të afërmit e tij.

## Përsëri në pallat

Kur Musai, alejhis-selam, u rrit aq sa të ndahej nga qumështi i gjirit, Asia, gruaja e firaonit, urdhëroi që foshnja të sillej edhe një herë në pallat. Urdhri i mbretëreshës nuk kthehej prapa, ndaj djaloshi u kthye përsëri pranë saj që të rritej ashtu siç rriten bijtë e mbretërve. Kështu e kish caktuar Allahu për të: të rritej në mesin e princërve dhe pasanikëve, të rritej pranë firaonit dhe komandantëve të ushtrisë së tij në mënyrë që në të ardhmen t'i njihte mirë dobësitë e tyre dhe të mos ndjente kurrëfarë frike nga ata. Thuhet madje, se një herë kur ishte akoma krejt i vogël, e tërhoqi fort për mjekre firaonin. A mos ishte pikërisht kjo foshnje njeriu që në të ardhmen do t'ia mirrte pushtetin nga duart? Thua të ishte ky zjarri që kish parë në ëndërr? Aq shumë u frikësua makuti saqë urdhëroi që ta vrisnin menjëherë. Sikur të mos ishte Asia, ushtarët u nisën të zbatonin urdhrin, mirëpo gruaja fisnike ndërhyri tek firaoni duke i thënë të mos frikësohej aspak pasi foshnja thjesht po luante. A thua arsyeton një foshnje e tillë? A mos vallë e njëj armikun foshnja që akoma s'di të flasë? Thuhet se fjalët e të shoqes sikur e qetësuan tiranin.

Gjithsesi, ai, për të vërtetuar fjalët e saj dhe për të provuar zgjuarsinë e Musait, i vendosi përpara një frut dhe një gacë. Foshnja zgjati dorën drejt frutit, mirëpo në moment një melek ia shtyu për tek gaca, të cilën pa një pa dy e futi në gojë ashtu siç bëjnë fëmijët e mitur. Sapo e futi në gojë bërtiti me të madhe. Gjuhëza e vogël gati sa s'ju ndez flakë. Qau me ngashërim foshnja e nuk pushoi së rënkuari për gjatë kohë, por teht të mprehtë të thikës i shpëtoi edhe një herë për bukuri. Thuhet se kjo gacë bëri që Musai të bëlbëzonte e të mos mund të fliste rrjedhshëm asnjëherë.



Vitet kaluan dhe Musai, alejhis-selam, hodhi shtat e u rrit bukur e mirë. Që në rini Allahu i Lartësuar mbolli farën e fisnikërisë dhe virtyteve të larta në zemrën e tij, i dhuroi dije të gjerë dhe urtësi. Thuhet se Musai, alejhis-selam, i ruajti marrëdhëniet me familjen e vërtetë, sidomos me të vëllanë, Harunin, prej të cilit e mori vesh se si qëndronte e vërteta e prejardhjes së tij. E kuptoi se në venat e tij rridhte gjaku fisnik i pejgamberëve, gjaku i Ibrahimit, Is'hakut dhe Jakubit. Gjatë kësaj kohe e njohu dhe e përqafoi besimin e vërtetë, besimin se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë veç Allahut, megjithatë një gjë të tillë e mbajti të fshehtë për vite me radhë. Kaluan motet. Musai, alejhis-selam, shihte me sytë e tij se si vuanin benu israilët për t'u kënaqur e për t'u dëfryer familja e firaonit.

## Goditja vdekjeprurëse

Musai e urrente padrejtësinë, i ndihmonte të dobët dhe të shtypurit, megjithatë asgjë nuk mund të ndryshonte për sa kohë që firaoni ishte gjallë. Herë pas here i vetmuar endej nëpër qytet në kërkim të qetësisë që tashmë nuk e gjente dot në pallatin mbretëror. Endej në kërkim të lumturisë, por më kot. Një herë, teksa po ngrysej, Musai, alejhis-selam, kish dalë i vetëm nëpër qytet dhe nga larg vërejti dy burra që grindeshin njëri me tjetrin. U afrua pranë tyre e ç'të shihte: një koptas tek përleshej me një izrailit. Sapo e pa Musanë, izrailiti iu ankua dhe e thirri në ndihmë. Një skenë e tillë e hidhëroi pa masë princin, i cili pa një pa dy iu afrua koptasit dhe e goditi me inat. Për çudi, një goditje e vetme e Musait mjaftoi dhe koptasi ra i vdekur në tokë. Sapo ndodhi ajo që ndodhi, Musai, alejhis-selam, u brengos si kurrë ndonjëherë dhe u pikëllua pa masë. Ai nuk kish pasur qëllim ta vriste koptasin, në asnjë mënyrë, ai donte vetëm ta pengonte dhe ta largonte nga shtypja e një të izrailiti të dobët. U pendua menjëherë për atë që bëri



dhe Allahu ia pranoi pendimin, meqë ai nuk kishte për qëllim marrjen e një jete.

Biri im! Në mbretërinë e qiejve punët vlerësohen në sajë të njetit. Nëse pa qëllim bie në batac, mos u dëshpëro, por kërko faljen e Zotit, se Ai është Bujar dhe fal shumë.

*"Kjo është punë e shejtanit"* - tha Musai alejhis-selam, *"ai, me të vërtetë, është armik i përbetuar!"* Pastaj iu drejtua Allahut me lutje duke thënë: *"O Zoti im! Unë i kam bërë vetes padrejtësi, ndaj më fal! O Allah, të betohem se fuqinë dhe autoritetin tim kurrë nuk do t'i përdor në ndihmë të tiranëve dhe kriminelëve!"* Me të shpejtë u largua nga vendi i ngjarjes. I frikësuar endej nëpër rrugët e qytetit duke pritur momentin kur do prangosej nga ushtarët e pashpirtë të firaonit. Nuk kaloi shumë dhe rojet që hulumtonin qytetin e gjetën koptasin e vdekur, por dorasin nuk e kish parë askush... Lajmi mbërriti me shpejtësinë e erës në pallatin mbretëror. Ndërkohë edhe Musai mbërriti në pallat. *"O princ! Israilitët kanë vrarë një koptas."*, i thanë, *"Nëse kapet vrasësi, gjyko drejt dhe mos mbaj me hatër!"* *"Sigurisht që po."*, ua ktheu Musai, *"Ma sillni vrasësin dhe një dëshmitar që e ka parë me sytë e tij e do e shihni gjykimin tim."* Me frikë në shtat, mezi e shtyu natën. Të nesërmen në agim doli edhe një herë i vetëm nëpër qytet duke përgjuar rreth e rrotull. Teksa rendte nga një rrugë në tjetrën, edhe një herë e pa izrailitin që e ndihmoi një natë më parë. Kur ja, përsëri tek kacafytej si mos më keq, por tashmë me një koptas tjetër. E sikur të mos mjaftonte kjo, ai sapo e pa Musanë, alejhis-selam, sërish e thirri për ndihmë. *"Me të vërtetë ti qenke i humbur e i lajthitur!"* - i thirri Musai. *"A mendon ti se çdo ditë do të të mbroj nga problemet dhe ngatërresat?!"* Pastaj i hidhëruar iu afrua dy burrave. Sapo e pa izrailiti zemërimin në fytyrën e Musait, u frikësua se mos e godet edhe atë siç goditi koptasin një ditë më parë dhe i tha: *"A do më mbytësh edhe mua ashtu siç bërë dje me koptasin? Me të vërtetë ti dëshiron t'i dhunosh"*

të tjerët e nuk dëshiron të përmirësosh e të vendosësh drejtësi.” Sapo dëgjoi këto fjalë, koptasi e kuptoi se si qëndronte puna dhe u largua me të shpejtë. Sa hap e mbyll sytë ai arriti në pallat dhe i lajmëroi për çështjen që i shqetësonte. Kur e dëgjoi lajmin, firaoni u hidhërua shumë. Menjëherë mblodhi këshilltarët e tij e së bashku vendosën ta ekzekutonin Musanë pa kurrfarë gjyqi. Sipas firaonit ai nuk ishte koptas dhe si i tillë nuk meritonte mëshirë aspak. Po çfarë kishin bërë benu israilët që nënçmoheshin dhe keqtrajtoheshin kaq shumë? Apo pse nuk kishin preardhje egjiptiane? Si mund të vritet tjetri pa e ditur se si kanë rrjedhur ngjarjet? Musai nuk kishte pasur aspak qëllim ta mbyste koptasin, por rastësisht vetëm një e rënë i kish sjellë vdekjen... Kështu e kanë zakon tiranët dhe të padrejtët, ata nuk e marrin parasysh arsyetimin e tjetrit, por gjykojnë vetëm sipas dëshirave të liga.

Në mesin e këshilltarëve të firaonit ishte një burrë i drejtë dhe fisnik. Kur dëgjoi urdhrin për vrasjen e Musait alejhis-selam, sapo mbaroi mbledhja e jashtëzakonshme, koptasi me një frymë mori rrugët e qytetit. Po përse vallë me kaq nxitim? Për më tepër, pse fshehtas? Thuhet se ky njeri ishte mik i Musait. Ai e njihte mirë shokun e tij, ndaj as nuk kishte dyshim se Musai, alejhis-selam, është i pafajshëm përballë akuzave që shpifnin për të. I frikësuar për mikun, nxitonte rrugëve të qytetit me shpresën që ta takonte përpara se ta arrinin armiqtë e tij. E me të vërtetë ashtu ndodhi. Allahu dëshironte ta shpëtonte Musanë, alejhis-selam, nga e keqja e firaonit dhe e ushtarëve të ligj. Sapo e pa Musanë, me të shpejtë erdhi drejt tij dhe me zërin që dridhej nga frika dhe lodhja, hiç pa e përsëndetur iu drejtua: *“O Musa! Paria e Egjiptit është mbledhur e po kuvendojnë të të vrasin, ndaj ik, ik, o miku im se kam frikë se mos të të kanoset e zeza!”*

Bir i dashur! Mbage mend e kurrë mos e harro se ç’po të them! Miku i vërtetë është ai që gëzohet me gëzimin tënd

dhe pikëllohet me pikëllimin tënd. A nuk thonë: *Njihe mikun e mirë në ditë të vështirë!* Mos harro se miku i mirë i përngjan diamantit, si i tillë është shumë vështirë të gjendet, ndaj lum për ty nëse të përpjek fati me të.

Me të dëgjuar fjalët e vezirit të mbretit, Musai u frikësua edhe më shumë. Ndoshta armiku ishte fare afër... Ama, ku të fshihej në një qytet që është plotësisht nën pushtetin e firaonit? Për më tepër as nga t'ia mbathte nuk kishte, pasi deri kësaj dite asnjëherë nuk kishte udhëtuar jashtë qytetit. I frikësuar si kurrë më parë, iu drejtua Allahut me lutje: *"O Zoti im, më shpëto nga populli kriminel!"* Me shpresën se Allahu i Lartësuar do ta ndihmonte dhe me nxitim se mos e arrinin ushtarët e firaonit, doli jashtë portave të qytetit. Doli me emrin e Allahut dhe me të vërtetë Allahu e mbrojti nga e keqja e kriminelëve.

## Në Medjen

Allahu e frymëzoi Musanë të shpejtonte drejt Medjenit, drejt një vendbanimi shkretinor arab që të shpëtonte nga dora e firaonit. Thuhet se udhëtimi deri në Medjen e lodhi tejmase Musanë alejhis-selam. E si mos të lodhej, kur për tetë ditë dhe tetë netë u detyrua të shijonte të nxehtin përvëlues shkretinor, ndërkohë që ujë dhe ushqim nuk kish me vete, veçse pak. I rraskapitur ecte në kërkim të fatit duke mos ditur se ku do të përfundonte udhëtimi i tij. Kur lodhja kish arritur kulmin dhe kur këmbët mezi e mbanin, nga larg iu bë sikur dëgjoi disa blegërima dhensh. Mbjajti vesh mirë dhe hodhi shikimin tej, kur ja, atje larg një grup çobanësh që u prinin bagëtive drejt një burimi me ujë. Megjithëse një ndjenjë gëzimi e kish kapluar të tërin, Musai e përmbajti veten dhe duke ecur ngadalë, por me krenari iu afrua burrave. Askënd nuk njihte, njëkohësisht askush nuk e njihte. Teksa burrat mbushnin ujë, dy baresha i mbanin bagëtitë e tyre që të mos i afroreshin burimit. Sapo i

pa, zemrën e Musait e kaploi brenga e prindit të mëshirshëm dhe fisnik. Me ngadalë iu afrua bareshave dhe u tha: *"Përse nuk i afroheni burimit? Përse nuk ia shuani etjen bagëtive?"* *"Ne nuk i afrohem burimit, derisa të mos shkojnë barinjte, ndërsa babën e kemi plak të dobët."* - ia kthyen vashat. Kur dëgjoji fjalët e tyre, Musait alejhis-selam edhe më shumë iu trazuan ndjenjat e fisnikërisë. Thuhet se barinjte, pasi u jepnin ujë bagëtive, e mbyllnin grykën e burimit me një rrasë të madhe guri që të mos ndotej, ndërsa dy vashat i jepnin bagëtive nga uji që kish mbetur në enët dhe calikët që liheshin pranë burimit. Mirëpo, atë ditë Musai e ngriti i vetëm rrasën e madhe, nxori ujë aq sa u mjaftonte bagëtive, pastaj e ktheu gurin në vendin e mëparshëm. Sapo u dha ujë bagëtive, me fisnikëri u largua drejt hijes së një peme aty pranë pa i kërkuar vashave kurrfarë shpërblimi. U ul në hije si të ishte zog i drobitur nga udhëtimi. Gjatë gjithë rrugës, nga Egjipti e deri në Medjen, nuk kishte ngrënë veç gjethe pemësh dhe barishte të egra sa për ta mbajtur shpirtin gjallë. Nga udhëtimi i stërgjatë sandalet prej lëkure i ishin shqyer dhe në këmbët e zbathura dukeshin qartë plagët e shkaktuara nga rëra e nxehtë dhe gurët e zallit. Kur u ul të pushonte, barku i ishte ngjitur për shpine nga uria, ndërsa buzët i kishin marrë ngjyrë të gjëlber nga barishtet dhe gjethet që kish ngrënë. Në këtë moment kishte nevojë të papërballueshme për të ngrënë dicka, qoftë edhe një gjysmë hurmeje. Ama, fisnikërinë e tij nuk e nëpërkëmbte dot dhe dorën nuk i bëhej t'ia shtrinte askujt. Në këtë gjendje të vështirë iu drejtua Allahut të Lartësuar: *"O Zoti im, çfarëdo mirësie të më japësh, unë kam nevojë për të!"*

Biri im! Shih çfarë fisnikërie! Musai, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, megjithëse nuk kish vënë asgjë në bark prej ditësh, megjithëse mezi mbante shpirtin gjallë, nuk ia shtriu dorën askujt, nuk kërkoi lëmoshë nga askush. Besimtari është fisnik. Nuk i takon atij t'i lypë askujt. Besimtarit i mjafton Allahu. Allahu është ndihmëtar i tij në momentet e vështira, ndaj

mos iu përul askujt, o bir, askujt përveç Zotit tënd. Të mjafton ty Allahu i Lartësuar.

## Shpërblimi i merituar

Atë ditë vashat mbërritën në shtëpi më herët se kurrë. Kur dëgjoi blegërimat e bagëtive nga larg, babai i tyre doli me nxitim. I priti me lumturi, por i habitur i pyeti për shkakun e shpejtimit të tyre si kurrë më parë. Menjëherë vajzat i treguan për të huajin që kishin takuar tek burimi dhe për sjelljen e tij fisnike. Kur dëgjoi për djaloshin, plaku urdhëroi njëren nga të bijat të shkonte me të shpejtë pranë burimit të ujit dhe ta ffonte të huajin për bukë. Nuk kaloi shumë, kur ja, njëra nga vajzat erdhi tek Musai, alejhis-selam, dhe iu afrua. Duke u turpëruar prej tij iu drejtua dhe i tha: *"Të thërret babai im, që të të shpërblejë për nderin që na bëtë sot, kur na ndihmuat me bagëtinë!"* Sapo dëgjoi fjalët e saj Musai, alejhis-selam, e kuptoi se Allahu Fuqiplotë iu përgjigj lutjes së tij, ndaj nuk e kundërshtoi vajzën.

U nisën së bashku për tek i ati i saj, ndërkohë Musai kërkoi që të ecte përpara vashës, në mënyrë që shikimi i tij mos ta prekte aspak hirin e saj. Në këtë mënyrë ecën gjatë gjithë rrugës për në shtëpi. Kur mbërritën e u përshëndetën me babën plak, ky i fundit e gostiti Musain siç bën fisniku me mysafirin e çmueshëm. Urdhëroi t'i sillej ushqim dhe ujë i freskët, më pas u ul pranë mikut të panjohur. E pyeti hollë-hollë se kush ishte, prej nga vinte dhe ç'e mirë e kish sjellë nga ato anë, ndërkohë Musai i rrëfente gjithçka për çfarë e pyeste plaku.

I tregoi fillim e mbarim se ç'i kish ngjarë dhe se si e kish braktisur Egjiptin nga frika e firaonit. Teksa miku fliste, plaku i mençur e dëgjonte me durim dhe pa e ndërprerë. Kur e mbaroi rrëfimin ai i tha: *"Mos ki më frikë, tashmë je i sigurt, o njeri i mirë, këto troje nuk janë nën pushtetin e firaonit, ndaj*

*këtu nuk vijnë asnjëherë ushtarët e tij.” Plaku i urtë na ishte gojëmjaltë dhe kish një të folur që ta ngrohte zemrën. Dy burrat kuvenduan gjatë e gjatë, me çiltërsi e përzemërsi, sikur të ishin babë e bir. Ndërsa plaku gostiste mikun, njëra nga vajzat shfrytëzoi rastin dhe i tha të atit: “O babë, merre këtë djalosh si punëtor me mëditje, pasi është njeri besnik dhe i fuqishëm!” “E nga e di ti se është i këtillë moj bijë?”- tha plaku. “Po ja!”, tha vasha, “Ai e largoi rrasën e burimit i vetëm, ndërkohë që për largimin e saj duhen së paku dhjetë burra, ndërsa kur u nisëm për këtu, ai më tha që të eci pas tij dhe gjatë tërë rrugës asnjëherë nuk më ka vështruar.”*

Këto fjalë i lanë mbresa plakut, për më tepër, ai e kuptoi se tashmë djaloshi fisnik i kishte hyrë në zemër edhe të bijës. E ku mund të gjeje njeri si ky?! A mos vallë Allahu e kish sjellë për t’ju bërë evlad dhe krah për punë?! Pasi e pleqëroi çështjen ashtu siç i takon të mençurit, iu drejtua edhe një herë djaloshit me çiltërsi dhe fisnikëri: “O Musa, o mik i çmuar, a do pranoje ti të martoheshe me njërën nga bijat e mija, me kusht që të qëndrosh në Medjen për tetë vite, të më shërbesh si biri im e t’mi kullosësh bagëtitë e mija? Nëse më qëndron afër dhjetë vite kjo do ishte mirësi mbi mirësitë, ama unë nuk dëshiroj të ta vështirësoj punën tënde. Në dashtë Allahu do gjesh kurdoherë tek unë mirëkuptim.” Kur dëgjoi fjalët e përzemërta të plakut Musai, alejhisselam, u mendua një copë herë, pastaj e ngriti shikimin dhe i tha: “E pranoj kërkesën tënde, o plak bujar. Kështu le të jetë mes nesh! Cilindo afat të plotësoj nga këta të dy, nuk do ketë përgjegjësi mbi mua. Për këtë që po them Allahu është dëshmitar.”

## Princi bëhet çoban

Në këtë mënyrë filloi një jetë e re për Musain, alejhisselam. Nga Egjipti në Medjen, nga qyteti madhështor në fshat, nga

pallati mbretëror në tendë me lëkurë të regjur, nga kalldrëmet e shtruara në rërën e shkretëtirës arabe, princi na bëhet çoban.

Me të vërtetë në këto anë mungonte zhvillimi shkencor dhe bollëku i Egjiptit, mungonin pallatet madhështore dhe kolonat e gdhendura, nuk njiheshin rrobat prej mëndafshi, byzylyqet me diamante dhe përkrenaret e arta, mirëpo atje mbizotëronte lumturia, ngase ishin vise të lira, larg zgjedhës së tiranëve. A nuk është më mirë të jetosh në shkretëtirë i lirë sesa në qytet si rob i padrejtësive?! Këtë kish caktuar Allahu i Lartësuar për këtë djalosh fisnik; shkretëtirën dhe kodrat e pabanuara në mënyrë që në të ardhmen të ishte i gatshëm të përballonte vështirësitë, i gatshëm të durojë urinë, etjen dhe lodhjen.

Jeta në pallat, rehatia dhe luksi u harruan tashmë. Tërë ditën e ditës Musai, alejhis-selam, e kalonte jashtë, në kërkim të kullotave që rriteshin andej pari. S'linte shteg dhe lug pa shkelur. Sot këtu, nesër përtej. Megjithë vështirësitë, puna si bari i mundësoi Musait të kënaqej me bukurinë e shkretëtirës si dhe të jetonte i qetë e pa brenga. Natyra e punës së bariut e bëri djaloshin të thjeshtë e të përrulur. Ushqente bagëtitë, mbikqyrte qengjat e vegjël, madje edhe flinte në mesin e tyre kur lodhej nga rrugët e gjata. I ruante nga sulmet e papritura të grabitqarëve dhe u printe drejt kullotave të largëta, gjë që mbolli farën e trimërisë në zemrën e tij. Herë pas here mjekonte bagëtitë që prekeshin nga sëmundjet apo dëmtoheshin kur kërcenin nëpër kodra, e kështu dita-ditës mendjemadhësia e princit venitej për t'i lënë vendin mëshirës e butësisë.

Në të vërtetë Allahu Fuqiptotë, pa asnjë vështirësi mund ta furnizonte Musain alejhis-selam me pasuri dhe rehati në mënyrë që ai të mos kishte nevojë të punonte. Por nuk e bëri diç të tillë në mënyrë që ky djalosh të bindej se pasuria më e mirë është ajo që fitohet me djersë, të bindej se jeta e ndershme arrihet me mund e durim. Ky mësim do kishte rëndësi të



madhe në të ardhmen pasi ky njeri do mbante mbi shpatulla përhapjen e mesazhit hyjnor për popullin e tij. Nuk i takon fisnikut të shtrijë dorën për lëmoshë. Nuk i takon Pejgamberit të pasurohet nëpërmjet fesë, nuk i takon atij të këshillojë të tjerët për t'u shpërblyer, pasi bukën e gojës e fiton me djersën e ballit. Kur njeriu ushqehet nga puna e duarve të tij, ai fiton lirinë për ta folur të vërtetën.

Në një hadith të vërtetë tregohet se i Dërguari ynë, Muhamedi, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, ka thënë: *"Çdo pejgamber që ka dërguar Allahu ka qenë bari në një periudhë të jetës së tij."* E si të jetë ndryshe kur jeta e thjeshtë e bariut mbjell në zemrën e njeriut cilësi të mrekullueshme që të nesërmen do i nevojiten për të udhëhequr umetin. Durimi e thjeshtësia, mëshira e trimëria, krenaria dhe liria skaliten në natyrën e bariut duke e përsosur sjelljen e tij që të jetë nesër shembull në mesin njerëzve.

Biri im, mos mendo se zhvillimi shkencor dhe teknologjia janë burimi i mirësive! Sikur të ishte kështu Allahu i Lartësuar do ia mundësonte Musait të qëndronte në Egjipt, në kryeqendrën e zhvillimit të asaj kohe. Përkundrazi, Zoti i Madhëruar e udhëzoi të Dërguarin e Tij drejt Medjenit, ndonëse nuk ishte shkencërisht i zhvilluar si Egjipti. Mos mendo se shkenca dhe teknologjia është burimi i lumturisë ashtu siç besojnë shumica e njerëzve sot! Me të vërtetë zhvillimi shkencor ua lehtëson përditshmërinë njerëzve, ama lumturia e zemrës fshihet pas sjelljes së mirë dhe moralit të lartë, të cilën nuk mund ta mësosh nga shkenca dhe as nga teknologjia, por vetëm nga pasimi i gjurmëve që kanë lënë të Dërguarit e Zotit. Kush pason udhëzimet e tyre Allahu e bën të lumtur kudo që të jetë, në qytet apo në fshat, në pallate shumëkatëshe a në shtëpi të thjeshta përdhese.



## Kthimi në egjipt

Mirë sot e mirë nesër. Ditët u bënë javë, javët u bënë muaj, muajt u bënë vite dhe vitet i lanë vendin njëri-tjetrit. Kaluan plot dhjetë vite dhe marrëveshjes mes Musait, alejhis-selam, e vjehrrit të tij i erdhi fundi. Thuhet se, i shtyrë nga përballimi, Musai i kërkoi leje plakut që të mund ta merrte familjen e tij e të ktheheshin në Egjipt fshehurazi që të takohej me motër e vëlla. Pasi iu dha leja të udhëtonte, u përshëndet me plakun siç përshëndetet fëmija me prindin kur niset në mërgim, u mbështet në Allahun Fuqiptotë dhe u nis drejt Egjiptit së bashku me gruan, fëmijët dhe disa bagëti.

Rruga drejt Egjiptit ishte e gjatë dhe e mundimshme. Musai, alejhis-selam, dhe të afërmit e tij udhëtonin herë me terr e herë me dritë që të mbërrinin sa më parë. Por një natë, tek ecnin në errësi, e humbën rrugën. E gjitha kjo ndodhi atëherë kur dielli ishte fshehur tashmë diku pas kodrave, hëna ishte mbuluar nga retë dhe errësira sa vinte e bëhej më e thellë. Musai përpiqej të orientohej disi, por më kot. Teksa mendohej të gjente rrugën, papritmas diku larg, andej nga kish përdënuar dielli, në anën e djathtë të tij, në drejtim të kodrës Tur, diktoi një dritë zjarri. Kush të ishte vallë? Mos ishin plaçkitës karvanesh? Apo ndoshta udhëtarë të ndonjë karvani që prisnin të kalonte nata për të vazhduar rrugën?

Në këtë moment Musa alejhis-selam u ndal. "Pritni!" - i tha gruas së tij, "Tani sa pashë një zjarr. Ndoshta prej andej do sjell ndonjë lajm, apo ndonjë copë dru për të ndezur zjarr që të ngroheni pak." Pasi e siguroi familjen, u nis i vetëm andej nga dukej drita. Sa më shumë afrohej, aq më i fortë bëhej vezullimi, ama për çudi, gjurmë njerëzish nuk dalloheshin gjëkund. Kur erdhi fare pranë, nuk i besonte syve: një zjarr që ndizej në një pemë të gjelbër. Sa më shumë flakëronte zjarri aq më shumë gjelbërohej pema. I mahnitur u ndal në vend. Tek shihte i mre-

kulluar dëgjoi një zë: "Qofshin të bekuar ata që gjenden në vendin ku është zjarri dhe ata përreth tij, dhe qoftë lavdëruar Allahu - Zoti i botëve!" I habitur hodhi shikimin përreth, por askush nuk shihej andej pari. "O Musa! Unë jam Zoti yt, ndaj zbathi sandalet, sepse gjendesh në luginën e bekuar Tuva!" - i thirri edhe një herë zëri. "Unë të kam përzgjedhur ty, ndaj dëgjo me vëmendje se ç'po të shpallet: Unë jam Allahu, nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë veç Meje, ndaj vetëm Mua t'më adhurosh dhe të tregosh kujdes ndaj namazit, që përherë të jem në mendimet e tua." Në këto momente Musai e kuptoi se Krijuesi i Gjithësisë e kish përzgjedhur për t'i zbritur shpalljen hyjnore. "Dita e Kijametit do të vijë me siguri, por Unë e mbaj të fshehtë, në mënyrë që secili të shpërblehet apo të ndëshkohet sipas punës së tij. Ndaj kurrsesi mos lejo atë që nuk beson në Ditën e Madhe dhe pason dëshirat e veta të të largojë nga rruga e drejtë, e të jesh i humbur e i shkatërruar!" - i tha Allahu i Lartësuar.

Biri im! Namazi të përkujton Allahun e Lartësuar, mëshirën dhe pushtetin e Tij të pakufishëm. Ky adhurim të nxit për braktisjen e veprave të shëmtuara dhe të shtyn drejt moralit të lartë. Pikërisht kjo është edhe arsyeja pse Allahu i Urtë dhe i Gjithëditur, kur për të parën herë i foli Musait, e urdhëroi me namaz dhe e nxiti të shoqërohet me njerëz të mirë, pasi shoku i mirë të përkujton namazin dhe moralin e lartë. Shoku i mirë të përkrah në punë të mira dhe të largon nga të shëmtuarat. Shoku i mirë të përkujton botën tjetër, mirësitë dhe vështirësitë e saj. A nuk thonë të moçmit: Zgjidhe shokun më të mirë se veten?! A ke dëgjuar se ç'thotë Profeti Muhamed, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, për shokun? Shoku i mirë dhe i përkushtuar në fe i përngjan shitësit të parfumeve, prej të cilit largohesh përherë i parfumosur me lloj-lloj aromash. Nëse nuk blen gjësend, së paku përfiton diç nga dyqani i tij që kundërmon aromë të këndshme. Ndërsa shoku i keq i përngjan farkëtarit që punon hekurin në farkën e tij. Gjatë ndenjes me

të, nëse nuk digjesh, së paku do ndotesh e do kundërmosh erë të rëndë tymi a qymyri...

Ndërkohë që fliste me Allahun, Musai, alejhis-selam, mban-te në dorë bastunin e tij, një shkop të gjatë që e kish pasur që bari. Allahu i Lartësuar e dinte mirë këtë, megjithatë i tha Musait: *"Ç'është ajo që mban në të djathtën tënde, o Musa?"* Menjëherë Musai, alejhis-selam, filloi t'i tregonte Allahut një e nga një dobitë e bastunit, ngase kishte shumë dëshirë të fliste me Zotin e tij dhe biseda të ishte sa më e gjatë. *"Ai është shkopi im",* u përgjigj, *"tek ai mbështetem, me të u shkundi gjethet bagëtime e më shërben edhe për punë të tjera."* Atëherë Allahu Fuqiptotë i tha: *"Hidhe atë, o Musa!"* Sapo dëgjoi urdhërin Musai, alejhis-selam, e hodhi shkopin, kur ç'të shihte! Me lejen e Allahut shkopi u shndërrua në gjarpër e filloi të zvarritej e të lëvizte me të shpejtë. Përmes kësaj mrekullie madhështore Musai u bind se Ai që i fliste kishte fuqi mbi çdo send, e kup-toi, se kur Zoti i tij dëshiron diçka, do bëhet patjetër ashtu siç dëshiron Ai. Megjithatë kur e pa gjarpurin se si zvarritej drejt tij, u frikësua dhe filloi të largohej me të shpejtë, pa e kthyer kokën pas. Në këtë çast Allahu i tha: *"Afrohu, o Musa e mos u frikëso. Kape gjarpurin në dorën tënde se Ne do ta kthejmë edhe një herë në formën e mëparshme."*

Megjithëse akoma i frikësuar, Musai alejhis-selam, e zba-toi urdhrin. U kthye, iu afrua gjarpurit që zvarritej, e zuri nga bishti, kur ja, edhe një herë gjarpri u shndërrua në shkop, ashtu siç kish qenë më parë. Musai, alejhis-selam, i mahnitur nuk u besonte syve. I lavdëruar qoftë Sunduesi, i Plotfuqishmi, i Lartësuari, Madhështori, i Cili, kur urdhëron diçka, ajo bëhet siç e urdhëron Ai.

Pas kësaj Allahu i Madhërishëm e urdhëron Musain: *"Fute dorën tënde në xhepin që ke afër kraharorit e, kur ta nxjerrësh, do të jetë e bardhë pa kurrfarë të mete. Kjo është një mrekulli tjetër që do të të jepet nga ana e Jonë."* Musai, alejhis-selam,

zbaton urdhërin e Allahut, kur ja, dora e tij shkëlqen sikur dielli në mesin e ditës, e bekuar pa kurrfarë të mete. “Këto dy mrekulli”, i tha Allahu Fuqiptotë, “të janë dhënë nga Zoti yt për firaonin dhe parinë e tij. Ata, me të vërtetë janë popull i shthurur!” Firaoni që e mbante veten për zot, dhe populli, që pasonin urdhrat e tij, e kishin mohuar Allahun prej kohësh, mbaheshin me të madh dhe tashmë e kishin kaluar çdo kufi ndaj bijve të Israilit. Mirëpo Allahu i Lartësuar nuk është i kënaqur me mosbesimin dhe mendjemadhësinë e robërve të Tij. Me të vërtetë Ai nuk e do padrejtësinë dhe rrëmujën në tokë, ndaj e urdhëroi Musain duke i thënë: “Shko tek firaoni, sepse ai e ka kaluar çdo kufi, dhe thuaj atij: A dëshiron të përmirësohesh? A dëshiron të të udhëzoj në rrugën e drejtë? A nuk i druhash dënimit të Zotit?” Sapo dëgjoi urdhrin e Allahut Musai, alejhis-selam, u frikësua. E si të mos frikësohej kur ushtarët e tiranit deri dje e kërkonin për vrasjen e koptasit?! Si të ishte i qetë kur të gjithë e njihnin mirë?! A nuk kishte urdhëruar firaoni para pak kohësh vrasjen e tij?! Për më tepër Musai belbëzonte që në vogëli dhe nuk shquhej për gojëtar. Allahu i dinte të gjitha këto, megjithatë e urdhëroi të Dërguarin e Tij prerazi.

“O Allah, o Zoti im, unë kam mbytur një njeri në mesin e tyre, ndaj kam frikë se, nëse shkoj, do hakmerren ndaj meje e do më mbysin.” Megjithatë urdhri i Allahu nuk kthehej pas. Kur e kuptoi se nuk kishte tjetër zgjidhje veç asaj me të cilën urdhërohej, Musai iu drejtua Allahut Fuqiptotë me lutje. “O Allah, o Zoti im, zgjeroma kraharorin, lehtësoma punën, dhe zgjidhma nyjen e gjuhës, që ata të m’i kuptojnë fjalët! Më jep një ndihmë nga familja e ime, Harunin, vëllanë tim! Ma shto fuqinë përmes tij dhe bëma ortak, që të të thurim lavde Ty, o Zot dhe të të përmendim vazhdimisht! Vërtet, Ti je Mbikqyrësi ynë përherë.”

Bir i dashur! A nuk e dëgjove?! I përzgjedhuri i Allahut, ai që me një të rënë e mbyti koptasin, ai që me një të shtyrë largoi pllakën e gurit, që mezi e shtynin dhjetë burra, i lutet Zotit që ta përforcojë me vëllanë e tij. A nuk thonë: bashkimi bën fuqinë?! Sado i ditur, sado i fuqishëm të jesh, gjithmonë do kesh nevojë për mbështetje... Nuk mund t'ia arrish çdo gjëje i vetëm. Ama, ki kujdes e zgjidhe shokun më të mirë se veten, se veç ai të bëhet krah i djathtë...

Atëherë Allahu i shpalli Musait, alejhis-selam: *“Kërkesa e jote u plotësua o Musa! Edhe më parë Unë të kam dhuruar mirësi kur e frymëzova nënën tënde të të hedhi në lumë. Unë të kam përzgjedhur dhe ti je rritur nën kujdesin Tim. Me caktimin Tim je kthyer tek nëna e jote, që ajo të gëzohej dhe të mos pikëllohej e brengosej më. Pastaj ti vrave një njeri, por Unë të shpëtova nga brengat dhe të vura në sprova të shumta. Ti qëndrove me vite të tëra mes banorëve të Medjenit, pastaj erdhe në këtë vend të shenjtë sipas asaj që Unë kam përcaktuar!”*

## Me Harunin

Kështu i foli për të parën herë Musait, alejhis-selam, Allahu i Lartësuar, i dha katër porosi të vyera dhe e urdhëroi që të shkante tek firaoni si i Dërguari i Zotit të botëve. U kthye Musai, alejhis-selam, tek familja e tij, dhe ua solli lajmin, e ç'lajm se?! U solli udhëzim, e ç'udhëzim se?! U solli dritë, e ç'dritë se?! Pasi i tregoi bashkëshortes së tij për gjithçka që i kish ndodhur, së bashku me të vazhdoi rrugën për në Egjipt ashtu siç ishte urdhëruar: të nxjerrësh njerëzit nga errësira në dritë, nga adhurimi i njeriut në adhurimin e Zotit të njerëzve, të çlirosh beniu israilët nga zgjedha e tiranit dhe popullit të tij. Ja pra! Kështu e kish caktuar Allahu Fuqiplotë: të ndodhte pikërisht ajo nga e cila ruhej dhe i frikësohej firaoni. Pas një

udhëtimi të gjatë nëpër shkretëtirë u kthye në Egjipt i biri i Imranit, tashmë jo më si bariu i Medjenit, por si i Dërguari i Zotit të botëve...

Me të mbërritur u takua me të vëllanë, Harunin, alejhis-selam, të cilin Allahu e kish përzgjedhur për të qenë mbështetje për të dhe ia kish ndriçuar kraharorin me dritën e pejgamberisë. Pasi u çmallën ashtu siç bëjnë vëllezërit kur takohen pas shumë e shumë vitesh, Musai i rrëfeu Harunit gjithçka i kishte ngjarë. E lajmëroi të vëllanë se u duhej patjetër të përballëshin me firaonin, megjithëse një përballje e tillë nuk ishte aspak e lehtë. Allahu i Lartësuar e dëgjonte bisedën e dy vëllezërve, madje e dinte mirë edhe atë që fshihnin në kraharor, ndaj në mënyrë që t'ua lehtësonte vështirësitë dhe t'ua largonte drojën nga zemrat, i shpall Musait alejhis-selam: *"O Musa! Unë të kam përzgjedhur ty për Vete. Shkoni, pra, ti dhe vëllai i yt me mrekullitë e Mia dhe mos reshtni së përmenduri Emrin Tim! Shkoni tek firaoni dhe flitini fjalë të buta, se ndoshta i kujtohet feja tek e cila thërriste Jusufi e ndoshta i frikësohet dënimit të Zotit!"*

Bir i dashur! Dije se Allahu i Urtë dhe i Gjithditur e ka bërë fjalën e mirë dhe butësinë çelësa për hapjen e zemrave të mbyllura. Paramendo! Nëse i Lartësuari e mëson Musain se me butësi dhe urtësi mund t'a fitosh zemrën e inatçorit mendjemadh, atëherë ç'mund të themi për të tjerët? ... Sillu me butësi, me vëllezërit e motrën tënde, me shokët e tu, me mësuesin e me ata që të rrethojnë se ti nuk je më i mirë se Musai dhe as ata s'janë si firaoni!

Dy vëllezërit thanë: *"O Allah! O Zoti i jonë! Ne frikësohemi se firaoni do të tregohet i egër ndaj nesh e do të na dënojë menjëherë."* "Mos u frikësoni!", u tha Allahu, "Unë jam me ju, dëgjaj dhe shoh se ç'ndodh. Shkoni tek ai dhe i thoni: Ne jemi të Dërguarit e Zotit tënd, lëshoji bijtë e Israilit që të vijnë me ne dhe mos i mendo! Ne të kemi sjellë mrekulli nga Zoti yt."

*Paqja qoftë mbi atë që pason rrugën e udhëzimit!*" Pas kësaj, të bindur në ndihmën e Zotit Fuqiplotë, sikur të ishin një trup i vetëm, u nisën me trimëri dhe besim të patundur drejt pallatit mbretëror. U nisën tek firaoni që ta thërrisnin në fenë e drejtë, ta thërrisnin në adhurimin e Allahut të Madhërishëm, të Vetëm e të Pashoq, ta thërrisnin t'i lirojë pasardhësit e Jakubit nga prangat e frikës dhe padrejtësisë në mënyrë që të adhurojnë Zotin e tyre dhe vetëm Atij t'i nënshtrohen.

## Tek firaoni

Kur dy vëllezërit mbërritën në pallat dhe iu dhanë leje të hynin, rojet i shoqëruan deri në sallën e madhe të pritjes. Pasi u hapën portat e saj, ç'të shihje: një dhomë e lartë dhe e gjerë, e shtruar me pllaka të gdhendura, e stolitur në të dy anët me kolona të larta prej guri, me mure të zbukuruara me lloj-lloj pikturash, plot me njerëz që qëndronin në këmbë rreth fronit të sundimtarit të Egjiptit, me frikë e respekt ndaj tij.

Sapo hynë dy vëllezërit, në sallën e stërmadhe ra heshtja. Asgjë nuk dëgjohej veç hapave të tyre ndërkohë që i afroreshin fronit ku qëndronte mbreti. Kur i erdhën krejt afër, firaoni i njohu. Fytyra e tij iu nxi nga inati. Hidhërimin ia shtonte guximi i dy burrave të cilët as nuk iu përkulën dhe as nuk iu drejtuan me fjalë përkëdhelëse siç e kishin zakon koptasit. Pasi u ndal përballë tij, Musai, alejhis-selam, e vështroi firaonin drejt e në sy dhe përplot trimëri i tha: *"O mbret! Unë jam i dërguari i Zotit të botëve! E kam detyrë që të them vetëm të vërtetën dhe ju kam ardhur me mrekulli nga Zoti i juaj, ndaj lëri të vijnë me mua bijtë e Israilit!"* Ra heshtja... Askush nga të pranishmit nuk foli derisa vetë sundimtari u ngrit dhe iu drejtua Musait me mendjemadhësi: *"E kush na qenke ti që vjen e më urdhëron në mesin e të afërmve të mi?"* "A mos je vallë foshnja që e patëm gjetur në breg të Nilit?", i tha me nënçmim, "A nuk je ti ai që



*e rritëm në gjirin tonë për vite me radhë? A mos je ti ai që bëri krimin e rëndë, duke qenë mosmirënjohës ndaj mirësive tona?” Musai, alejhis-selam, u përmbajt dhe nuk u hidhërua, as nuk i kundërshtoi fjalët e firaonit dhe as nuk u arsyetua, por u përgjigj me çiltërsi dhe burrëri duke thënë: “Gjithçka thoni e kam bërë, por në atë kohë nuk kam qenë i udhëzuar. Pastaj ika kur u frikësova prej jush, por Zoti im më dhuroi mençuri dhe më bëri një nga të Dërguarit e Tij. E ç’mirësi më paske bërë ti mua ndërkohë që popullin tim e poshtërove, djemtë e tyre i vrave dhe vajzat i skllavërove?” Firaoni mbeti pa fjalë kur dëgjoi Musain, alejhis-selam, dhe nuk pati asnjë mundësi t’i kthente përgjigje. I zënë ngusht, u mundua t’i bënte bisht diskutimit dhe tha: “E kush na qenka ky Zoti i botëve që po të dëgjojmë duke e përmendur?” “Ai është Sunduesi i qiejve, i Tokës dhe i gjithçkaje që gjendet midis tyre.”- ja ktheu Musai, alejhis-selam. Firaoni u mllefos për çfarë dëgjoi, ama dëshironte që të pranishmit të ishin në krahun e tij, ndaj me përtallje iu drejtua atyre që kishte përreth: “A nuk e dëgjoni?!” Musai alejhis-selam nuk u ligështua aspak nga arroganca e firaonit, por përsëri iu drejtua e i tha: “Ai është Zoti i juaj dhe Zoti i paraardhësve tuaj!”*

Fjalët e Musait e mllefosën firaonin edhe më shumë, ndaj për ta përtallur të Dërguarin përsëri iu drejtua të pranishmëve duke thënë: “Me të vërtetë ky i Dërguar që na paska ardhur, qenka i lajthitur.” Musai, alejhis-selam, as që donte t’ia dinte për arrogancën e tij ndaj iu drejtua për së treti: “Ai është Zoti i lindjes dhe i perëndimit dhe ç’ka ndërmjet tyre, nëse keni mend e kuptoni.” Firaoni e ndjeu tashmë se nuk mund t’i bënte ballë fjalëve të Musait, alejhis-selam. E kuptoi se është i paaftë përballë tij, ndaj me dinakëri i drejtoi një pyetje që të mund të bënte për vete të pranishmit. “Po, mirë”, tha firaoni, “meqë Zoti yt të paska dhënë dituri të madhe, ç’mund të na thuash



për brezat përpara nesh?" Sikur Musai, alejhis-selam, të përgjigjej e të thonte se ata kanë qenë të udhëzuar në rrugën e drejtë, firaoni do ta përgënjeshtronte duke thënë se kanë qenë idhujtarë. Nëse Musai do të thonte se ata kanë qenë idhujtarë të humbur në padituri, do të zemëroheshin të pranishmit, ngase po fyhen paraardhësit e tyre dhe kështu do të mund të ngadhënjente sundimtari. Mirëpo Musai, alejhis-selam, ishte më i mençur nga sa e mendonte firaoni. Ai ishte i përzgjedhuri i Allahut. Atë e ndihmonte i Urti, i Gjithëditur.

*"Dituria për ta është tek Zoti im, e shënuar në libër: Zoti im nuk gabon dhe as nuk harron."*- ia ktheu Musai, alejhis-selam. Firaoni mbeti i turpëruar e gojëhapur. Në këtë moment Musai edhe njëherë iu drejtua të pranishmëve me zë kumbues: *"O njerëz! Zoti juaj ua nënshtroi tokën për të mirën tuaj. Ai ka vendosur rrugë nëpër të dhe ju lëshon ujë nga qielli nëpërmjet të cilit rriten lloj-lloj bimësh, prej të cilave ushqeheni ju dhe bagëtitë tuaja. Këto me të vërtetë janë shenja për ata që mendojnë."* A ka të barabartë me Krijuesin Fuqiptotë? A meriton të adhurohet firaoni që s'është tjetër veçse një krijesë e dobët? Kur dëgjoi fjalët e Musait, alejhis-selam, firaoni u xhindos dhe i tha atë që thonë të gjithë mbretërit kur zihen ngushtë e s'mund të përgjigjen. *"Nëse beson në tjetër zot veç meje, do të dënojmë e do të burgosim!"*

### *Mrekullitë e Musait*

Kur dëgjoi fjalët e mbretit dhe vërejti mllefin në fytyrën e tij, i Dërguari i Allahut i tha: *"A do më burgosësh edhe nëse të sjell mrekulli nga Zoti im?"* *"Na i sill mrekullitë pra, nëse thua të vërtetën!"*- ia ktheu me inat firaoni. Atëherë Musai, alejhis-selam, e hodhi shkopin e tij, kur ja, ai u shndërrua në

gjarpër që lëvizte me shpejtësi duke i tmerruar të gjithë. Kjo skenë madhështore i mahniti mendjet e të pranishmëve të cilët tashmë kishin mbetur pa fjalë. Në këtë moment Musai e kapi gjarpurin për bishti, kur ja, ai u kthye edhe një herë në shkop, ashtu siç ishte në fillim. Pas kësaj Musai, alejhis-selam, e futi dorën në gjoks, pastaj e nxori që aty dhe ajo ndrinte sikur hëna. Vezullimi i saj gati sa nuk i verboi të pranishmit, të cilët kishin ngelur të mrekulluar, të shtangur në vend. Mbi-zotëroi heshtja dhe askush nuk mundi të fliste me përjashtim të mbretit kryeneç. Ai jo vetëm që nuk nxori mësim, por edhe më shumë nguli këmbë në mosbesimin e tij. *"Vërtetë, ky qenka magjistar shumë i aftë!"* - iu drejtua të pranishmëve firaoni. *"Po, po, kjo s'mund të jetë tjetër veçse një magji e qartë."* - thanë të afërmit e tij. *"A të vërtetës i thoni magji?"* - ia ktheu Musai, alejhis-selam. *"Po, po"*, thanë paria e mbretit egjiptian, *"Ti dëshiron të na largosh nga feja e të parëve tanë, për të të mbetur ty dhe vëllasë tënd madhështia në tokë. Po ne nuk ju besojmë juve, kurrsesi!"*

Kur dëgjoi fjalët e të afërmeve, firaoni u gëzua dhe u mundua t'i frikësonte edhe më shumë. *"Me të vërtetë, ai me magjinë e tij dëshiron t'ju dëbojë nga toka e juaj"*, u tha, *"ndaj ç'mendonit të bëjmë me të?"* Pasi u menduan, këshilltarët i thanë njëzëri: *"Dërgo nëpër qytet tellallë që të të sjellin magjistarët më në emër. Vetëm kështu mund të ngadhënjesh ndaj tij, o madhëria e jonë."* Atëherë firaoni tha: *"O Musa, a mos na ke ardhur që me magjinë tënde të na nxjerrësh prej tokës tonë? Atëherë edhe ne do të të kundërvihemi me një magji të tillë. Na e cakto një kohë dhe një vend të përshtatshëm ku mund të ndeshemi, e ta shohësh ti se kush do dalë fitimtar?"* *"Koha e përballjes le të jetë dita e festës suaj"*, tha Musai, alejhis-selam, *"në mënyrë që njerëzit të mblidhen paradite, nën dritën e diellit!"*

Më në fund dëshira e Musait, alejhis-selam, po bëhej realitet: fuqinë e pakufishme të Allahut t'ua shfaqte të gjithë

njerëzve nëpërmjet mrekullive madhështore. Për këtë arsye ai caktoi ditën e festës së koptasve si ditën e përballjes. Veç kësaj ai nuk kërkoi që takimi të ndodhte në errësi, siç e kishin zakon koptasit, por paradite, kur drita e diellit është e fortë, në mënyrë që e vërteta të jetë sa më e qartë dhe e dukshme.

## Në shesh

Urdhri i mbretit ishte i qartë: të mblidhen magjistarët më në zë nga mbarë vendi. Ç'të urdhëronte mbreti duhej të realizohej me doemos! U përhapën tellallët anembanë dhe thirrën me sa zë që kishin: *"O milet! O milet! Dëgjoni mirë! Mbreti urdhëron që të gjithë magjistarët të mblidhen tek sheshi i madh në ditën e festës! Të tuboheni edhe ju bashkë me ta, o popull! Të mblidheni e të përkrahni magjistarët, nëse do jenë fitues! Të mblidheni e të përkrahni magjistarët, nëse do jenë fitues!"*

Ditët kalonin, ndërkohë që në Egjipt nuk dëgjohej tjetër veç bisedave rreth magjisë dhe rreth emrave të magjistarëve që do merrnin pjesë në ditën e madhe. Më në fund! Pas shumë e shumë bisedash e diskutimesh zbardhi dita e shumëpritur. Njerëzit dilnin grupe-grupe nga shtëpiat e tyre. Burra e gra, pleq e plaka, të rinj dhe fëmijë shpejtonin drejt sheshit të madh. *"Kush do të fitojë sot?"* - pëshpëriste njëri. *"Magjistarët nuk ka dyshim."* - ia priste tjetri. *"E si mund të fitojë mbi ta Musai?!"* Ai nuk e njehej magjinë. Ai është rritur në pallat e kur u rrit iku atje larg në Medjen. *"Po ndoshta e mësoi atje magjinë?"* *"Jo, jo mos ki merak se atje s'ka magjistarë dhe as nuk njihet magjia..."* U mblodhën koptasit në shesh dhe askush nuk mbeti pa dalë. Megjithëse sheshi ishte tejet i madh dhe i gjerë, ai dukej shumë i vogël dhe i ngushtë për shkak të numrit të madh të të pranishmëve. Erdhi mbreti me ushtarë, i veshur e i stolitur. Erdhën magjistarët me krenari, me shkopinje e litare

ndër duar duke u kapërdisur. Iu afruan sundimtarit tok dhe iu përulën në shenjë respekti. *"A do ketë shpërblim për ne nëse dalim fitues, madhëri?"*- iu drejtuan firaonit njëzëri. *"Posi jo"*, ua ktheu ai, *"atëherë do t'ju bëj prej më të afërmve të mi!"* Eh, sa u gëzuan magjistarët me çfarë dëgjuan! Të afërmit e mbretit! Fisnikët e fisnikëve! Pasuri mbi pasuri!

Ja, me pasuri e me pozitë të lartë u bëjnë lajka të tjerëve mbretërit! Ja, me pasuri e më pozitë mashtrohen njerëzit! Kush e di se sa njerëz ulin kokat para keqbërësve dhe mbyllin sytë para punëve të tyre të liga nga frika e humbjes së pasurisë që ata u ofrojnë. Kujdes bir!

Ndërsa të gjithë ishin tubuar dhe askush nuk mungonte, erdhi Musai me vëllanë e tij, Harunin. Me burrëri dhe duke mos iu dridhur syri aspak çanin turmën siç bën anija me dallgët e detit, derisa arritën në mes të sheshit, mu përballë firaonit dhe magjistarëve. Erdhën bashkë me ta edhe shumë nga benu israilët me shpresë e frikë në zemra. A thua vallë mund të triumfonin dy burra përballë dhjetra magjistarëve? A thua mund të triumfojë mrekullia përballë magjisë?

## Musai dhe magjistarët

Sapo erdhi i Dërguari i Allahut, iu afrua magjistarëve për t'i këshilluar dhe për t'ua tërhequr vëmendjen. *"Mjerë për ju!"*, u tha Musai, alejhis-selam, *"mos i mashtroni njerëzit me magji dhe gënjeshtër, se me siguri, nuk ka sukses gënjeshtari!"* Pastaj i thirri në fenë e vërtetë dhe i përgëzoi me mirësitë dhe shpërblimet e Ahiretit, nëse pasonin rrugën e besimit. Kur dëgjuan fjalët e tij, magjistarët u përçanë mes veti. Disa thonin: *"Këto nuk janë fjalë magjistari."* Të tjerë thonin të kundërtën. Kështu u mblodhën tok dhe diskutuan me njëri-tjetrin, duke pëshpëritur fshehurazi. Njëri prej tyre u hodh e tha: *"Në të vërtetë"*

Musai dhe Haruni, janë dy magjistarë e nëpërmjet magjisë duan t'ju largojnë nga toka e juaj dhe t'ua shkatërrojnë fenë tuaj, që është më e drejta. Ndaj, bashkujini magjitë tuaja dhe rreshtohuni të gjithë! O sot o kurrë!" Në këtë mënyrë u rreshtuan magjistarët dhe e pyetën Musain, alejhis-selam: "A do të hedhësh ti i pari, apo ne?" "Hidhni ju!"- tha Musai.

Atëherë magjistarët hodhën gjithçka kishin në duar, magjepsën sytë e njerëzve, i frikësuan ata dhe shfaqën një magji të madhe. Të sigurt se do fitonin ndaj Musait, thanë: "Pasha madhërinë e firaonit, ne do fitojmë patjetër!" Dhe ja! Me të vërtetë litarët dhe shkopinjt e tyre u ngjanin gjarpërinjve të vërtetë që lëviznin me shpejtësi dhe përpëliteshin rreth njëritjetrit. Përnjëherësh turma u tmerrua. Njerëzit filluan të largoheshin me të shpejtë. "Gjarpërinj!", bërtisnin me të madhe, "Gjarpërinj helmues!"

Edhe Musai, alejhis-selam, pa atë që panë njerëzit. Edhe atij iu duk se litarët dhe shkopinjtë lëviznin si gjarpërinj. Ndjeu frikë në vetvete. A mos vallë magjistarët me magjinë e tyre do t'i mashtronin njerëzit para se ai të hidhte shkopin që mbante në dorë? A mos vallë do ngadhënjente e kota ndaj të vërtetës? A thua do ngadhënjente idhujtaria ndaj fesë së Zotit? A thua do të triumfonin magjistarët ndaj të Dërguarit të Allahut? Gjithsesi, Musai, alejhis-selam, nuk guxonte të ndërmernte kurrfarë veprimi para se t'i vinte urdhri i Zotit të tij. Ja! Në çastin vendimtar Allahu i shpalli të Dërguarit: "Mos u frikëso, se nuk ka dyshim që ti do të fitosh! Hidhe shkopin që mban në të djathtën tënde! Ai do të gëlltisë gjithçka kanë bërë ata, sepse ajo është veçse një mashtrim magjistarësh, e magjistari nuk do ketë sukses çfarëdo që të bëjë."

Atëherë Musai hodhi shkopin që mbante në dorë dhe iu drejtua magjistarëve: "Kjo që sollët ju nuk është tjetër veçse magji. Allahu do ta shkatërrojë atë. Kurrsesi Allahu nuk i jep sukses magjistarëve. Allahu me fjalën e Tij e përforcon të

vërtetën, edhe sikur ta urrejnë keqbërësit këtë!” Me të vërtetë, sapo shkopi i Musait, alejhis-selam, preku tokën, u shndërrua në një gjarpër me pamje të tmerrshme. Ai, pa një pa dy, iu vërsul litarëve dhe shkopinjve dhe i gëlltiti që të gjithë me një shpejtësi të llahtarshme. Të pranishmit u mahnitën, ndërsa magjistarët panë diçka që e tejkalonte mjeshtërinë e tyre. Ç’ ishte kjo? Ata e njihnin mirë magjinë dhe llojet e saj. Po të ishte magji, do ta sulmonin me magji dhe sigurisht që do ngadhënjenin mbi të. Si ishte e mundur që magjia e madhe të tretej si kripa në ujë? Kur panë çfarë panë, magjistarët u bindën se ajo nuk ishte magji, as fantazëm dhe as gënjeshtër, por një e vërtetë që s’ mund ta sjellë askush tjetër veç Atij që e kish dërguar Musain, alejhis-selam, si fe-rrëfytes. Atëherë magjistarët u hodhën në sexhde dhe thanë para të gjithëve: *“Ne i besuam Zotit të Gjithësisë! I besuam Zotit të Musasë dhe Harunit!”* Ndodhi çfarë nuk e priste firaoni. Ai shpresonte ta mposhtë Musain nëpërmjet magjistarëve, por ata u bënë pasuesit e tij.

## Perëndimi i magjistarëve

Biri im! Të kam treguar se njerëzit kryelartë, ata që jetojnë në mes të luksit dhe rehatisë, e mohojnë të vërtetën dhe Pejgamberin nga frika se do u venitet fama dhe autoriteti përballë tij. I tillë ishte edhe firaoni. Kur pa se si magjistarët e pranuan islamin haptazi, u frikësua pa masë dhe ishte i gatshëm të trillonte lloj-lloj intrigash në mënyrë që të mbronte pozitën e tij si zot.

Me inat dhe mendjemadhësi iu drejtua magjistarëve duke i thënë: *“A i besuat atij, para se t’ju lejoja unë?!”* Pastaj i kërcënoi dhe u mundua t’i frikësonte ashtu siç bëjnë mbretërit kur zihen ngusht. *“Ai është i madhi juaj, ai që ua ka mësuar juve magjinë.”* - u tha firaoni nga inati. *“Unë mendoj se kjo është një dredhi, që ju e keni përgatitur për të dëbuar nga tokat e tyre*

*banorët e Egjiptit, po do ta shihni se ç'do ju gjejë!" - tha për së dyti duke gënjyer. Pastaj përplot mllef iu drejtua për së treti magjistarëve: "Do ua pres duart dhe këmbët tërthorazi dhe do t'ju gozhdoj në trungjet e larta të palmave, që të shiheni nga larg dhe të jeni shembull për këdo që pason besimin tuaj!"*

Magjistarët, zemrat e të cilëve ishin ndriçuar me dritën e imanit, i përballuan sulmet e sundimtarit me durim dhe trimëri. "S'ka rëndësi", thanë njëzëri, "ne do të kthehemi tek Zoti ynë. Ne shpresojmë se Ai do na i falë gjynahet tona, meqë jemi të parët që besuam." Përplot trimëri iu drejtuan sundimtarit për së dyti: "Ne kurrë nuk do të të japim ty përparësi ndaj mrekullive që pamë dhe ndaj Atij që na ka krijuar. Prandaj gjyko ç'të duash, ti gjykon vetëm në jetën e kësaj bote! Ne i besuam Zotit tonë në mënyrë që të na i falë gabimet dhe magjitë, për të cilat na ke detyruar ti. Shpërblimi i Tij është më i mirë se shpërblimi yt dhe afërsia me ty. Ai që kthehet tek Zoti i tij si keqbërës, sigurisht që e pret Xhehenemi, ku as nuk do vdesë e as nuk do të jetojë. Ndërsa kush kthehet si besimdrejt e mirëpunues, do të ngrihet lart e më lart në Xhenetet e Adnit, nëpër të cilat rrjedhin lumenj. Aty do të qëndrojnë përjetësisht. Ky është shpërblimi për ata që përmirësohen dhe i largohen mosbesimit."

Firaoni mirë që nuk zuri mend, por u hidhërua edhe më shumë kur dëgjoji atë që dëgjoji. U ngrit nga froni dhe bëri me shenjë që të dënoheshin të gjithë. U zbatua urdhri i tij menjëherë, mirëpo edhe përballë torturave magjistarët nuk hoqën dorë nga besimi, përkundrazi treguan trimëri të rrallë dhe iu lutën Allahut Fuqiptotë t'i dhuronte durim dhe t'i bënte të qëndrueshëm. Fjala e tyre e fundit ishte: "O Zoti ynë, na jep durim të madh dhe na e mundëso të vdesim si muslimanë!" Kjo është historia e vërtetë e magjistarëve të firaonit. Ky është perëndimi i tyre: në mëngjes magjistarë që u interesonte veçse fama e pasuria, ndërsa në mbrëmje shehidë të shquar që nuk u interesonte asgjë veç shpërblimit dhe mirësive të Ahiretit.



Biri im! Sipas përllogaritjeve të historianëve këto magjistarë kanë jetuar qindra vite para Profetit Isa, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, ndoshta njëmijë vite para tij, megjithatë shembulli i tyre përmendet edhe sot e kësaj dite. Dije se për aq sa të ketë caktuar Allahu jetë në këtë botë, përherë do të përmendet shembulli i tyre. Allahu i Lartësuar e ka bërë përmendjen e magjistarëve të firaonit të përhershme në histori. E çfarë bënë këto burra për ta arritur këtë emër?

Përgjigjia është e thjeshtë për t'u thënë, por e vështirë për t'u arritur: ata që luftojnë dhe paguajnë për autoritet, harrohen; ndërsa ata që luftojnë për të arritur kënaqësinë e Allahut të Lartësuar, përmenden gjatë. Lufto pra, me mish e me shpirt të fitosh dashurinë e Zotit Fuqplotë e mos të jetë qëllimi yt pasuria e pozita, pasi, nëse kështu vepron, do të përmendesh për mirë brez pas brezi.

### *Besimtari nga familja e firaonit*

Pasi ndodhi ajo që ndodhi, koptasit u kthyen në shtëpitë e tyre të mahnitur nga mrekullia që u solli i Dërguari i Allahut. Disa prej tyre i besuan Musait alejhis-selam, ashtu siç bënë magjistarët, por besimin e mbajtën të fshehtë në mënyrë që të mos përfundonin siç përfunduan ata. Koptasit i druheshin firaonit pasi ai ishte tiran dhe në të keqe kalonte çdo kufi. I mallkuari, pas ekzekutimit të magjistarëve u kthye në pallat dhe caktoi një takim për të gjithë ministrat dhe të afërmit e tij, me qëllim që të diskutonte me ta për çështjen e Musait. Me të vërtetë ai tmerrohej kur mendonte se njerëzit mund ta braktisnin adhurimin e tij si zot, e kështu t'i venitej sundimi në Egjipt.

Pasi u mblodhën të gjithë ministrat dhe këshilltarët e tij, filluan diskutimet ndërmjet njëri-tjetrit. Ata, në vend që ta udhëzonin firaonin t'i besonte Musait, alejhis-selam, e nxitën edhe

më shumë në mohimin e tij dhe në mosbesim... E nxitën firaonin të mundonte dhe të torturonte benu israilët, pasi sipas tyre, ata ishin burimi i së keqes. *"A mos vallë, do e lësh Musain dhe popullin e tij të bëjnë ngatërresa në tokë dhe të braktisin adhurimin tënd dhe fenë tonë?"*- iu drejtuan firaonit. Ai u vërenjt në fytyrë dhe u përgjigj përplot mllef: *"Meqë jemi sunduesit e tyre, ne do ua vrasim djemtë dhe vajzat do ua lëmë të gjalla që t'i përdorim si skllave e robëresha."* Tirani i Egjiptit frikësohej shumë nga benu israilët ndaj dhe urdhëroi vrasjen e djemve të tyre, në mënyrë që të dobësoheshin, të nënshtroheshin dhe në të ardhmen të mos kishin fuqi t'i kundërviheshin. Gjithsesi ai nuk u mjaftua me kaq, por iu drejtua të pranishmëve duke thënë me krenari dhe përtallje: *"Lërmëni ta vras Musain dhe atëherë le t'i lutet Zotit të vet, mjerani! Unë frikësohem se mos ua ndërron fenë tuaj dhe se mos sjellë trazira në tokë!"*

Sapo dëgjoi këto fjalë një burrë besimtar nga paria e firaonit, një burrë që e fshihte besimin e tij, u ngrit dhe tha: *"Ç'po thoni kështu vallë? A mbytet tjetri se thotë: Zoti im është Allahu! A doni të mbytni atë që ju ka sjellë mrekulli të qarta nga Zoti juaj? Nëse gënjen, vetëm vetveten dëmton, por nëse e thotë të vërtetën, a nuk frikësoheni se mund t'ju godasë diç nga ajo që ju premtton? Allahu nuk udhëzon për kah e mbara atë që gënjen dhe e tepron me të këqija."* *"O populli im!",* tha besimtari zemërtrim, *"Sot pushteti është i juaji dhe me të vërtetë ju jeni ngadhënjimtarë, por kush mund të na mbrojë nga dënimi i Allahut nëse na godet papritmas?"*

Firaoni thellë në brendësinë e tij ishte i bindur se mrekullitë që sillte Musai ishin nga Ai që kishte krijuar qiejt dhe Tokën, megjithatë me gjuhën e tij thoshte të kundërtën. *"Unë nuk kam mendim tjetër veç atij që thashë"*, tha i mallkuari, *"dhe të jeni të bindur se po ju udhëzoj në rrugën e drejtë."* Ndërkaq, ai që kishte besuar u ngrit përsëri dhe tha: *"O populli im, unë frikësohem se mos ju godet dënimi siç pat goditur popujt e*

mëparshëm! A ju kujtohet se ç'ndodhi me popullin e Nuhut, Adit dhe Themudit kur iu kundërvunë Pejgamberëve?" Kur dëgjuan fjalët e tij të gjithë heshtën.

"O populli im!", iu drejtua përsëri besimtari, "unë kam frikë për ju Ditën e Madhe! Ditën kur nga frika do të mundoheni të ikni, por kush mund ta ndalojë dënimin e Allahut? Ai që kërkon humbjen askush s'mund ta udhëzojë." "Edhe Jusufi u pat sjellë dëshmi të qarta e ju gjithmonë ishit në dyshim ndaj fjalëve të tij, derisa edhe kur vdiq ju thatë se: Allahu nuk dërgon më Pejgamber pas tij." Edhe një herë ra heshtja. Me sa shihej fjalët e besimtarit kishin lënë mbresa në zemrat e të pranishmëve, ndaj firaoni u ngrit me të shpejtë dhe me dhelpëri iu drejtua ministrit më të afërt duke i thënë: "O Haman! Ndërtoma një kullë të lartë që të ngjitem në qiell e të mundohem të shoh Zotin e Musait! Unë mendoj se ai është gënjeshtar i madh." Kur dëgjoi se si firaoni mundohej t'i mashtronte të pranishmit me hile dhe dinakëri, u ngrit përsëri besimtari zemërtrim dhe me urtësi iu drejtua atyre që kish përreth: "O populli im! Më pasoni mua që t'ju udhëzoj në rrugën e drejtë! O populli im, jeta e kësaj bote është e shkurtër dhe e përkohshme, ndërsa bota tjetër është e përhershme. Kush bën një të keqe do të ndëshkohet për të keqen e tij, por kush bën mirësi, duke qenë besimtar do të futet në Xhenetin e bekuar ku do shpërblehet pa kufi."

Të mashtruar nga pasuria dhe pushteti, të frikësuar se mos humbisnin famën dhe pozitën e lartë, ministrat e tjerë jo vetëm që nuk ia vunë veshin fjalëve të urta që dilnin nga goja e besimtarit, por me të madhe iu kundërvunë atij. "Kthehu në fenë e të parëve të tu të nderuar dhe lëri marrëzitë" - i thanë. Filluan t'i bërtisnin dhe ta godisnin me lloj-lloj fjalësh, aq sa kur e tepruan besimtari ua ktheu: "O populli im, ç'është kjo sjellje? Unë ju thërras në shpëtim e ju më thërrisni për në zjarr? Më nxitni të mohoj Allahun dhe të adhuroj zota që nuk

*sjellin dëm dhe as dobi, ndërkohë që unë ju thërras për tek i Gjithëfuqishmi që i fal gjynahet? Me të vërtetë ai, drejt të cilit më shtyni t'i nënshtrohëm nuk e meriton adhurimin në këtë botë dhe as në tjetrën." "Të gjithë do kthehemi një ditë tek Allahu", u tha burri i urtë, "por mos harroni se ata, që i largohen rrugës së drejtë, do jenë banorë të zjarrit flakërues." Kur e pa reagimin e tyre, për të fundit herë iu drejtua të pranishmëve: "Do vijë dita kur do t'i kujtoni këto që u thashë, e çështjen time ia besoj Allahut. Ai i mbikëqyr dhe i ndihmon robërit e Tij." Firaoni dhe ministrat e tij u hidhëruan shumë nga fjalët e besimtarit, por Allahu e mbrojti nga të këqijat që i kurdisën, ndërsa ata i goditi dënimi i rëndë.*

## Karuni

Musai, alejhis-selam, nuk kishte armiq vetëm nga koptasit, por edhe nga mesi i kushërinjve të tij. Një ndër ta ishte Karuni. Po kush ishte ky burrë? Karuni ishte nga populli i Musait, alejhis-selam, por i tejkaloi kufijtë: me mendjemadhësi, me shpërdorim të pasurisë, duke përhapur shkatërrim dhe shturje në mesin e israilitëve. Allahu i dha pasuri kaq të madhe sa që disa burra të fuqishëm mezi i mbanin çelësat e depove të thesareve të tij. Thuhet se ka qenë njeri i pasur dhe me "emër". Thuhet se ka qenë i njohur edhe në mesin e koptasve, madje punonte si taksambledhës i firaonit. Allahu e di më së miri...

Ama, kur pas dhjetë vitesh të gjata u kthye edhe një herë Musai në mesin e israilitëve, e tashmë si Pejgamber, ndjenjat e Karunit u trazuan. Në zemër i lindi smirë dhe urrejtje për të Dërguarin e Allahut, pasi tashmë "shikimet" e benu israilëve u kthyen për nga Musai alejhis-selam. Iu zbeh fama e dikurshme dhe "emri" nuk i përmendej shpesh. Për këtë arsye, Karuni bëri të pamundurën që të nënçmonte Musain dhe të lartësonte vet-veten. Nuk linte rast pa u tallur me thjeshtësinë e të Dërguarit

fisnik... E përgënjeshtroi, e quajti magjistar, madje thuhet se u bë palë me firaonin në armiqësinë ndaj Pejgamberit. Në mënyrë që të bënte benu israilët për vete, dilte nëpër qytet duke u krekosur me truprojat vigane dhe duke u mburrur me stolitë prej ari dhe argjendi ndërkohë që israilitët vuanin për bukën e gojës. Shpenzonte nga pasuria e tij si e si t'i largonte israilitët nga rruga e shpëtimit drejt së cilës i ftonte, Musai alejhis-selam...

Aq shumë e teproi saqë populli i tij i tha një ditë: *"Mos u ngazëlle e mos shit mend, sepse Allahu nuk i do mburravecët! Përdore atë që të ka dhënë Allahu i Lartësuar në bindje dhe respekt ndaj Zotit, kërko shpërblimin e Ahiretit, kërko Xhenetin e mos harro edhe hisen e lejuar që të takon nga mirësia e kësaj bote! Bëj mirë ashtu siç të bëri mirë Allahu ty, e mos përhap shkatërrimin në tokë, sepse Allahu nuk i do shkatërrimtarët!"* "Zoti e ka ditur që unë e meritoj këtë pasuri", ua ktheu me krenari Karuni, *"i gjithë ky thesar është falë diturisë, përvojës dhe aftësive të mia. Sikur mos të isha i vlerë tek Allahu, Ai s'do ma kish dhënë kurrë gjithë këtë bollëk."* A nuk e dinte ai se Allahu kishte shkatërruar përpara tij, popuj të tërë që ishin më të fuqishëm dhe kishin më shumë pasuri?! Sikur të ishte e drejtë fjala e tij, Allahu nuk do të kish ndëshkuar askënd që ishte më i pasur sesa ky...

Një ditë Karuni, i pispillosur, me kortezhin që e rrethonte, doli për të shitur mend përpara njerëzve. Thuhet se kish dalë pikërisht në ditën kur Musai, alejhis-selam, po këshillonte njerëzit dhe po u fliste për Ditën e Gjykimit. Kur e panë të stolitur, me shërbëtorë e hamshorë njëri pas tjetrit, ata që lakmonin mirësitë e kësaj bote e humbën fare. Të dehur nga salltanetet e Karunit i harruan porositë e Pejgamberit e thanë: *"Ehhh, sikur të kishim edhe ne si pasuria e Karunit! Me të vërtetë ai është njeri me fat të madh!"* Kur dëgjuan këto fjala, njerëzit e ditur nga të pranishmit u thanë: *"Të mjerët ju! Çfarë thoni?!"*

*Shpërblimi i Allahut është më i mirë sesa pasuria e Karunit.” Por, edhe pasi dëgjuan porosinë e atyre që u ish dhënë dituria, lakmitarët nga mesi i israilitëve tundën kokat dhe ua kthyen shpinën me mendjemadhësi. “Epo, këtë këshillë e pranajnë vetëm durimtarët.”, thanë njerëzit e urtë, “Këtë porosi e kuptojnë vetëm mendarët.”*

Teksa shihte reagimin e njerëzve Musai alejhis-selam iu drejtua Karunit duke i thënë: *“Pse i trazon njerëzit, o Karun? Përse vepron kështu?” “O Musa!”, ia ktheu Karuni, “Nëse, ma ke kaluar me pejgamberi, unë ta kam kaluar me pasuri. Madje unë besoj se jam më i vlerë tek Zoti se sa ti.” E si u krahasoka dituria profetike me arin dhe stolitë?! “Po, po... Unë jam më i vlerë sesa ti.”, tha Karuni, “Nëse dëshiron, dil përpara njerëzve dhe më mallko... Pastaj, po dal unë, e ta shohim se kujt do t’i pranohet lutja! Ta shohin të gjithë se cilin do ta godasë mallkimi!” “Le të bëhet siç dëshiron ti, atëherë!”- i tha Musai, alejhis-selam. I pari u lut Karuni, po mallkimi i tij nuk u pranua. “A të lutem unë tani, o Karun?”- tha i Dërguari i Allahut. “Lutu!”- ia ktheu Karuni. “O Allah!”, tha Musai, “Urdhëroje Tokën të më bindet sot, o Zoti im!” “Ajo veçse po pret urdhrin tënd, o Musa.”- i shpalli Allahu. Atëherë Musai, alejhis-selam, tha: “O Tokë! Të urdhëroj ta përpish Karunin dhe pasurinë e tij!”*

Në çast, toka filloi të dridhet nën këmbët e benu israilëve, aq sa tmerri ua kaploi zemrat në gjokse. Ndërkohë që lëkundej, sipërfaqja e Tokës u thërrmua si rërë dhe papritmas Karuni filloi të zhytet në të. Toka ia gllabëroi menjëherë këmbët në mënyrë që të mos kishte se si të largohej. Kur e kuptoi se e kish kapluar mallkimi i Musait, filloi të përgjërohej e të kërkonte ndihmë, por më kot. Tashmë ishte zhytur gjer në gjunjë... Bërtit e bërtit, por s’kish më shpëtim; gjer në fyt... Ndërkohë që pasurinë ia kish përpirë Toka, u fundos edhe trupi i Karunit në thellësitë e saj. Askush nga truprojat e tij nuk mundi ta mbronte nga dënimi i Allahut dhe as që mund t’i ndihmonte vetvetes...

Kur e panë se ç'i ndodhi Harunit dhe pasurisë së tij, ata që pak më parë dëshiruan të ishin si ai, filluan të flasin nën zë: "A nuk e patë! Me të vërtetë Allahu ia jepka pasurinë atij që do nga robërit e tij, por pasuria nuk qenka shenjë e dashurisë së Allahut. Sikur Allahu të mos na mëshironte me siguri, edhe ne do ishim fundosur! Me të vërtetë, për mohuesit nuk paska shpëtim!"

Me të vërtetë historia e Karunit është e stërm bushur me dobi, ama të mjaftojnë ty tre prej tyre... Së pari, asnjëherë mos harro se zilia ta prish zemrën dhe ta errëson dritën e të kuptuarit, ndaj luftoje zilinë që ndizet herë pas here në gjoksin tënd. A nuk ishte zilia shkëndija e parë e shkatërrimit të Karunit?! Së dyti, pasuria e madhe nuk është shenjë e dashurisë së Allahut, ndaj mos rend pas grumbullimit të saj e të lësh pas dore nxënien e diturive! Mos harro se dituria e dobishme është më e vlefshme se floriri. Profeti na ka lajmëruar se Allahu ia dhuron dijen fetare vetëm të dashurve të Tij, ndaj mos ndalo në nxënien e diturisë e të bëhesh prej të dashurve të Zotit. Dhe së treti: Mos u mbaj me të madh, o bir, se Allahu nuk e do mendjemadhin! A nuk e pe se si e pësoi Karuni?!

## Gruaja e firaonit

A e di ti se kush ishte gruaja e firaonit? Ajo quhej Asja, e bija e Muzahimit. Kjo grua ishte gruaja më e pasur në botë. Zotëronte argjend dhe flori, diamante e margaritarë, pallate mbretërore, rroba mëndafshi të qendisura me ar dhe kurora të praruara, gjë e të mira që nuk numëroheshin. Mendo! Nëse për ndërtimin e varrit të firaonëve në Egjiptin e lashtë kanë marrë pjesë mE mijëra punëtorë, sa mund të ketë qenë numri i atyre që kanë ndërtuar pallatin e Asias? Mendo numrin e shërbëtorëve që kujdeseshin për bashkëshorten e firaonit: me dhjetra, ndoshta me qindra. Dije pra, se kjo është gruaja



fisnike, e cila të gjitha bukuritë e dynjasë, të gjitha mirësitë e privilegjet që kishte në jetën e kësaj bote i braktisi në këmbim të afërsisë me Allahun. "O Allah!", është lutur, "Ma ndërto një shtëpi afër Teje në Xhenet!" Me të drejtë mund të pyesësh se si e pranoi fenë e islame dhe si u bë muslimane gruaja e kriminelit që pretendonte se ishte zot? Kush ia mësoi besimin e vërtetë kësaj fisnikeje?

Bir i dashur! Siç të kam treguar, kjo grua e rriti dhe u përkujdes për Musain, alejhis-selam, që në vogëli. U përkujdes për të siç bën mbretëresha me princin e ardhshëm. Thuhet se e ka dashur të Dërguarin e Allahut ashtu siç e do nëna birin e saj. Thuhet se e ka pranuar fenë e vërtetë atëherë kur Musai, alejhis-selam, u rikthye në pallatin mbretëror për t'i shpalosur firaonit mrekullitë që ia dha Zoti i Madhërishëm. Me sa dihet, fjalët e Musait e goditën zemrën e gruas fisnike dhe mrekullitë që shpalosi i lanë mbresa të thella, por besimin e saj e mbajti të fshehtë. E si ta shfaqte besimin përballë tiranit, kriminelit që për një ëndërr urdhëroi të vriteshin mijëra fëmijë? Jo burra apo djelmosha, po fëmijë të vegjël, foshnje djepi.

Kur Profeti Muhamed, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të, është ngritur në sferat qiellore natën e Israsë dhe Miraxhit, ndërkohë që udhëtonte përmes Xhenetit me Xhebrailin fisnik, nuhati një aromë shumë të këndshme, një aromë që kaq shumë e ngazëlleu saqë nga kureshtja iu drejtua melekut që kish përkrah duke i thënë: "O Xhebrail, nga vjen kjo aromë kaq e këndshme?" "Kjo është aroma e shërbëtorese së vajzës së firaonit." - ia ktheu meleku. Mirëpo, kush është kjo shërbëtore? E ç'lidhje ka kjo shërbëtore me gruan e firaonit mund të thuash ti?

Kjo grua ishte shërbëtore në pallatin e mbretëror. Një ditë teksa i krehte flokët të bijës së firaonit, i rrëshqet krehri nga dora dhe për pak sa pa rënë në tokë shërbëtorja e kap fluturimthi duke thënë: "Bismillah!"... Sapo e dëgjoji vajza e firaonit, e

pyeti: “Çfarë the? Ç’është ky emër? Mos është njëri nga emrat e babait tim?” “Jo, jo!”, ia ktheu gruaja, “Ky është emri i Zotit tim dhe Zotit të babait tënd.” “Çfaaarë?”, tha bija e firaonit, “Ti paske Zot tjetër veç babait tim?” Menjëherë lajmi për besimin e shërbëtores u përhap nëpër pallat.

Sapo dëgjoi për këtë, firaoni u hidhërua pa masë. Në mënyrë që ta bënte shembull, i mallkuari urdhëroi të ndizej një zjarr i madh dhe urdhëroi që t’ia merrnin me forcë katër fëmijët e saj. Pasi e sollën shërbëtoren të lidhur pranë zjarrit, ia sollën edhe fëmijët. “Nëse nuk heq dorë nga besimi yt do të t’i hedhim në zjarr të gjithë fëmijët, maj e shkretë!”, iu drejtuan gruas me përçmim. Ah, sa u pikëllua nëna kur dëgjoi këto fjalë! Ajo e njihte mirë firaonin. E dinte se vrasja e fëmijëve të pafajshëm nuk ishte asgjë e madhe për tiranin, megjithatë bëri durim dhe nuk e shfaqti pikëllimin. E tërhoqën me forcë fëmijën e parë afër zjarrit dhe iu drejtuan gruas: “Shërbëtore! O shërbëtore! A s’na thua se kush është Zoti yt?” “Allahu!”- ua ktheu me trimëri ajo. Sapo dëgjuan përgjigjen e saj, ia hodhën fëmijën në zjarrin përcëllues. Zemra sa nuk iu shqye nënës së gjorë, megjithatë u përmbajt dhe nuk tha asgjë...

Kështu vepruan edhe me dy fëmijët e tjerë, por shërbëtorja nuk u gjunjëzua, derisa para saj ia sollën fëmijën më të vogël... “Kush është zoti yt?” - i thanë. Në këtë moment Allahu Fuqiptotë ia mundësoi kësaj foshnjeje djepi të fliste. “Duro, o nënë”, tha foshnja, “se dënimi i Ahiretit është më i dhembshëm!” Kur dëgjoi fjalët e foshnjes shërbëtorja e kuptoi se kjo ishte një shenjë e drejtpërdrejtë nga Allahu i Lartësuar, ndaj bëri durim dhe nuk u dorëzua megjithëse e hodhën në zjarr së bashku me foshnjën e saj. Thuhet se kur Asja, gruaja e firaonit pa qëndrueshmërinë e shërbëtores, u prekën ndjenjat e saj, iu trimërua zemra dhe me guxim i tha të shoqit: “Dije pra, se edhe unë i kam besuar Allahut, të mohoj ty si zot dhe aspak frikë nuk të kam.”

Bir i dashur! Mundohu të mbjellësh farën e guximit dhe trimërisë në zemrën tënde që të jesh shembull i mirë në mesin e njerëzve që të rrethojnë, ashtu siç bëri shërbëtorja në shtë-

pinë e firaonit. Këshillo për mirë dhe ndalo nga e keqja, ngase Allahu i Lartësuar përmes fjalës së urtë, përmes shembullit të mirë mund të nxjerrë nga shtëpitë e mosbesimit dhe të gjynaheve, njerëz të devotshëm dhe besimtarë, që së bashku me ty udhëtojnë në karvanin e të dalluarve në mirësi. Ama, nëse heq dorë nga këshilla dhe shembulli i mirë, ka mundësi që nga shtëpitë e besimit dhe të devotshmërisë, të dalin njerëz të prishur dhe jobesimtarë.

Kur dëgjoi fjalët e së shoqes firaoni gati sa nuk plasi nga inati. Menjëherë urdhëroi rojet ta merrnin me forcë dhe ta torturonin derisa të hiqte dorë nga besimi i saj. E keqtrajtuat fisniken e aspak nuk patën mëshirë për të, megjithatë Asja qëndronte si shkëmb përballë vështirësive. Thuhet se firaoni e shtrinte në rrëzën e shkretëtirës, kur përcëllonte vapa, të lidhur në katër shtylla - dy për këmbët e dy për duart e saj dhe e torturonte pa pushim, derisa kur e pa vendosmërinë e gruas, urdhëroi që një shkëmb të madh ta rrokullisnin nga një kodër aty afër, me qëllim që ta copëtonte kokën dhe trupin e saj. Në këto momente të vështira Asja iu drejtua Allahut Fuqiptotë me lutje. *"O Allah, më ndërto një shtëpi pranë Teje në Xhenet! O Allah më shpëto nga firaoni dhe dënimi i Tij! Më shpëto, o Zot, nga populli mizor!"*

Mbështetu në Allahun e Lartmadhërishëm sa herë të presësh nga e keqja e vështirësitë pasi në Dorën e Tij është shpëtimi. Kush i mbështetet Allahut, Ai i mjafton atij. Kush i mbështetet Allahut, Ai i dhuron durim nëpërmjet të cilit ëmbëlsohet idhëtija e sprovave.

## Gjashtë shenjat

Pasi ekzekutoi të shoqen që të shërbente si shembull për të gjithë koptasit, firaoni iu kthye edhe një herë beni israilëve. Çdo ditë fshihte me dhjetra e dhjetra vështirësi për ta. Mundim pas mundimi, bela pas belaje, sprovë pas sprovë... Deri kur kë-

shtu?! Toka e begatë e Egjiptit u bë e ngushtë për ta, përkundër gjerësisë së saj. Qyteti i ndritshëm u bë burg i errët...

*"Kërkoni ndihmë nga Allahu dhe bëni durim.", i drejtohej Musai, alejhis-selam, popullit të tij, "Toka është e Allahut dhe Ai ia lë në trashëgim atij që do nga robërit e Tij. E mos harroni se e ardhmja e lumtur është për të devotshmit." "Asgjë e mirë s'na erdhi me ty.", ia kthenin benu israilët të Dërguarit, "Të shtypur e të munduar ishim mot, por të tillë jemi edhe sot. A nuk e sheh se ç'po heqim?!" Megjithë vështirësitë që kalonte së bashku me popullin e tij, Musai qëndronte si shkëmb dhe i jepte kurajo. "Mos e humbni shpresën, o njerëz!", u drejtohej i Dërguari, "Allahu do ta shkatërrojë armikun tuaj dhe shpejt do ju bëjë sundimtarë në tokë, për t'ju sprovuar se si do veproni." "O populli im! Nëse me të vërtetë besoni në Allahun, mbështetuni tek Ai siç u takon muslimanëve!" Kur e panë vendosmërinë e Musait, alejhis-selam, kur u bindën në vërtetësinë e fjalëve të të Dërguarit dhe iu kthyen Zotit Fuqiptotë, duke shpresuar në ndihmën dhe përkrahjen nga ana e Tij, u erdhi ajo që shpresonin. Ndërkohë që belatë dhe mundimet u bënë të papërballueshme (arritën kulmin), Allahu i Lartmadhërishëm i shpalli Musait dhe vëllait të tij: "Shtëpitë tuaja t'i shndërroni në faltore dhe ta falni namazin rregullisht! Përgëzoni besimtarët!" Kur benu israilët iu nënshtruan Allahut Fuqiptotë dhe iu drejtuan Atij me lutjet e nevojtarit dhe të drobiturit, u erdhi ndihma që prej kohësh e pritnin... Allahu i Lartmadhërishëm e urdhëroi Nilin të tërhiqej nën tokë dhe qiellin të mbante mbyllur dyert e tij që të mos zbriste pikë uji mbi Egjipt. Ashtu u bë... Thatësira kaploi paparitmas qytetin e begatë. U harruan të mbjellat e të korrat. Pemët nuk jepnin fruta dhe bagëtitë s'kishin më qumësht. Një kohë e një mot, egjiptianët furnizonin me drithë e ushqim banorët e Shomit dhe udhëtarët e viseve të largëta, ndërsa sot nuk kishin me se të mbanin frymën gjallë. Varfëria mbuloi qytetin. Mjerim dhe zi*

anembanë... Pse nuk u ndihmoi firaoni? A nuk mbahej si zoti i tyre më i lartë?! A nuk ishte nën sundimin e tij Nili?! A nuk rridhte me lejen e tij?!

Në këto kushte të vështira koptasit e kuptuan mirë se furnizimi nuk ishte në dorën e firaonit. U bindën se lumi Nil që gjarpëronte përgjatë qytetit duke njomur tokën nuk ishte pronë e mbretit mendjemadh... Megjithatë, në vend që të zinin mend e t'i ktheheshin së mbarës, u ngritën dhe thanë: *"Këto bela dhe vështirësi na vijnë si pasojë e kobit të Musait dhe popullit të tij."* Përkundrazi, fatkeqësia u vinte si përgjigje e mosbesimit dhe padrejtësisë së tyre. *"Çfarëdo mrekullie të na sjellë Musai, që të na magjepsë"*, thonin me mendjemadhësi, *"ne nuk i besojmë atij!"*

Atëherë, i Plotfuqishmi i provoi me përmytje. U hapën dyert e qiellit dhe shiu vërshoi me furi. Shpërtheu shtrati i Nilit dhe uji gufoi si kurrë më parë. U përmytën arat, drithi e të mbjellat. Shiu i shumëpritur u kthye në tmerr për koptasit. Nili i bekuar u bë armik për ta. Kudo ujë... Kudo ujë... Përballë kësaj fatkeqësie edhe vetë firaoni u gjuhëzua. I mundur dhe i poshtëruar e thirri të Dërguarin e Allahut në pallat dhe kërkoi nga Musai, alejhis-selam, ta luste Zotin e tij që ta largonte këtë bela. Në këmbim të lutjes, i premtoi se do ta besonte si Pejgamber dhe se do i lejonte benu israilët të shkonin me të... Ç'ndodhi më pas? Musai e luti Allahun e Lartmadhërishëm ta ndalonte përmytjen dhe menjëherë shiu ndaloi. Nili u qetësua. Nuk kaloi shumë dhe uji u tërhoq. U rikthyen bollëku dhe mirësia. Njerëzit u ngopën dhe fatkeqësia u largua. Mirëpo firaoni e theu premtimin. Me të vërtetë ai ishte mohues, inatçor dhe i pabesë. Fjala e mirë dhe këshilla nuk i bënë dobi, ndaj Allahu Fuqiplotë dërgoi një ushtri të stërmadhe kundra firaonit dhe koptasve. Një ushtri të atillë që nuk mposhtej dot as me shpatë as me shigjetë. Po kush ishin këta ushtarë që as ushtria e firaonit nuk mund t'i bënte ballë? Karkalecat! Kakaleca të

mëdhenj! Karkaleca jeshil që fluturonin me shpejtësi. Karkaleca që pushtuan horizontin sikur të ishin re shiu. Karkaleca që hanin çdo bimë që u dilte para. U shkatërruan arat me grurë, u shkatërruan pemët me fruta, u shkatërruan të mbjellat, u thanë drurët dhe nuk mbeti gjë prej tyre. Në këto kushte firaoni e thirri të Dërguarin e Allahut përsëri dhe kërkoi nga ai ta luste Zotin e tij që ta largonte këtë ushtri të pamposhtur. Në këmbim të lutjes, i premtoi se do ta besonte si Pejgamber dhe se do i lejonte benu israilët të shkonin me të... Po ç'ndodhi më pas? Musai, alejhis-selam, e luti Allahun e Lartmadhërishëm ta largonte ushtrinë e Tij nga tokat e Egjiptit dhe ashtu u bë. Ushtria u tërhoq dhe qyteti ra në qetësi. U rikthyen bollëku dhe mirësia. U rritën bimët dhe u mbushën arat me grurë e të mbjella shumë. Njerëzit u ngopën dhe fatkeqësia u largua. Mirëpo firaoni e theu përsëri premtimin. Me të vërtetë ai ishte mohues, inatçor dhe i pabesë. Ai nuk përmbushi asgjë nga ajo që kish premtuar, ndaj Allahu dërgoi një tjetër ushtri. Këtë rradhë u përballën me rriqra. Thuhet se Musai u urdhërua të hipte mbi një dunë rëre dhe t'i mëshonte asaj me shkopin e tij. Kur arriti atje dhe e goditi rërën me shkop, përnjëherësh një ushtri e pallogaritshme rriqrash iu vërsulën qytetit. Për pak kohë rriqrat u përhapën anembanë. Ushtarët e fuqishëm të firaonit, megjithë shpatat e mprehta e shigjetat e shumta që mbanin me vete, nuk mundën t'i bënin ballë ushtarëve të Allahut Fuqiplotë. Rriqrat mbushën shtëpiat e koptasve. Rriqra kudo! Rriqra në rroba. Rriqra në shtretër. Rriqra në trup. Rriqra në flokë e rriqra në kokë. Dhjetë rriqra shtypnin, një mijë të tjera vinin. Ditët i kalonin të lodhur e të molisur, ndërsa netët i shtynin pa gjumë duke mallkuar rriqrat. Kur u rraskapitën sa më s'ka e lutën përsëri të Dërguarin e Allahut njësoj si herët e tjera. Musai, alejhis-selam, e luti Zotin e tij dhe Ai ua largoi rriqrat, por ata përsëri nuk e plotësuan marrëveshjen. Atëherë, Allahu u dërgoi bretkosat. Ata u përhapën me të shpejtë kudo nëpër qytet. Sa hap e mbyll sytë, zhabat laramane e bretkosat

e gjelbra zaptuan shtëpitë e koptasve. Një e mbysnin, dhjetë shfaqeshin. Dy i nxirrnin jashtë, njëzet hynin brenda. Bretkosa në shtrat. Bretkosa në raft. Hop-hop ditën. Guak-guak natën. Askush nuk mund të flinte më nga zëri i bretkosave. Koptasit gati sa nuk u çmendën nga kjo bela, ndaj përsëri e lutën Musanë ashtu si herët e tjera. I Dërguari e luti Allahun Fuqiplotë dhe nuk kaloi shumë kur ja... bretkosat filluan të largohen. Ama, koptasit përsëri nuk plotësuan asgjë nga premtimet e dhëna.

Kësaj radhe Allahu i Lartmadhërishëm u dërgoi gjakun që të zinin mend e të hiqnin dorë nga prapësitë. Uji i burimeve u shndërrua në gjak. Thuhet se u gjakos edhe lumi Nil. Sa herë që koptasit bënë në nxirrnin ujë nga lumi, nga burimet, nga pusët apo nga çfarëdo vendi, ai shndërrohej në gjak të freskët. Thuhet se edhe nga hundët filloi t'u rridhte gjaku rrëke. Megjithëse në mjekësi koptasit kishin arritur majat, asnjë mjek nuk arriti t'u jepte ndonjë bar apo ilaç që t'ua ndalonte gjakun. U lodhën banorët e Egjiptit dhe u rraskapitën sa më s'ka. Për çudi, asgjë nga kjo bela nuk i preku benu israilët. A nuk mjaftonte kjo për koptasit, që të zinin mend e t'i ktheheshin së mbarës? A nuk dëshmonte kjo, se Musai është i Dërguari i Zotit Fuqiplotë?

Megjithatë, banorët e Egjiptit edhe më shumë u zhytën në mosbesim dhe pabesi. Sa herë që lodheshin nga sprovat, i betoheshin dhe i premtinin Musait, alejhis-selam, se do t'i besonin dhe do ta lejonin popullin e tij të shkonte me të, nëse Zoti i tij do ua largonte të keqen. Mirëpo, kur u largoheshin sprovat bëheshin edhe më të këqinj. Edhe pse Musai, alejhis-selam, u erdhi me mrekulli madhështore njëra pas tjetrës, koptasit nuk hoqën dorë nga prapësitë. Sapo u largohej belaja, menjëherë e shkelnin premtimin. Sapo largoheshin vështirësitë, firaoni krekosej me sundimin e tij, mburrej me bukurinë e mbretërisë së tij dhe me hijeshinë e lumit Nil që gjarpëronte nëpër qytet. "O populli im!", u ngrit dhe tha, "A nuk më përket mua push-



teti i Egjiptit dhe i këtij lumi të bekuar që rrjedh nën pallatin tim?! A nuk jam unë më i mirë sesa i Dërguari i gjorë i benu israilëve, që mezi flet?! Përse nuk i janë dhënë atij byzylykë të praruar?! Përse nuk na vijnë melekët bashkë me të që t'na e dëshmojnë se është me të vërtetë i Dërguar?" Në këtë mënyrë ai e mashtronte popullin e tij, derisa iu nënshtruan të gjithë duke e besuar për zot. Edhe pse u bindën se Musai është i Dërguari i Allahut, e mohuan dhe u treguan kryelartë ndaj mrekullive që u solli. Allahu i Lartësuar ua tregoi rrugën e drejtë, por ata ndoqën rrugët e humbjes. Dëgjoje, atëherë, si qe fundi i shkatërrimtarëve!

## Shpëtimi

"O Allah, o Zoti ynë!", tha Musai alejhis-selam, "Ti i ke dhënë firaonit dhe parisë së tij stoli dhe pasuri në këtë botë, por ata mundohen të na largojnë më çdo kusht nga rruga e Jote e drejtë! O Zoti ynë, shkatërroja pasurinë dhe vulosi zemrat e tyre, që të mos besojnë derisa të shohin dënimin e tmerrshëm!" Allahu i shpalli: "U pranua lutja e juaj, ndaj përqendrohuni në rrugën e drejtë dhe kurrsesi mos pasoni dëshirat e mendjelehtëve!"

Kur sprovat u shtuan, kur vuajtjet nuk duroheshin dhe kur toka e Egjiptit u bë burg për benu israilët, Allahu i shpalli Musait, alejhis-selam: "Nisu natën me robërit e Mi, por dije se do t'ju ndjekin nga pas!" Me t'i zbritur urdhri hyjnor, i Dërguari lajmëroi popullin e tij dhe i urdhëroi të përgatiteshin për udhë. Megjithë përpjekjen e tyre për të mos rënë në sy, ushtarët e firaonit e nuhatën dredhinë e israilitëve dhe menjëherë lajmëruan mbretin e tyre. Kur e mori lajmin, firaoni u hidhërua, u nxi fytyra e tij dhe gati sa nuk plasi nga inati. Menjëherë dërgoi lajmëtarët nëpër qytet që të tubonin të gjithë ushtarët. "Të bëheni të gjithë gati për marshim!", bërtiti, "Benu israilët na

*ikën fshehurazi në errësirë. Me të vërtetë na hidhëruan sa më s'ka, por do ta paguajnë. Ata janë krejt pak e të pafuqishëm ndaj nesh. Veshni parzmoret dhe ngjeshni armët. Shpeeeejt! Shpeeeejt! T'i kapim sa nuk është vonë!"*

Thuhet se përgatiti një ushtri të stërmadhe e të fuqishme dhe iu vu pas israilitëve. Ndërkohë që, Musai, alejhis-selam, i printe popullit të tij drejt Palestinës thuhet se humbi rrugën në errësirën e natës. Musai dëshiroi diçka, por Allahu dëshiroi diçka tjetër, e kështu u përmbush dëshira e të Lartmadhërishmit. Në vend që të udhëtonin drejt veriut ata kishin marrë drejtimin e lindjes. Pa vënë gjumë në sy, të lodhur e të sflitur, mbërritën në brigjet e Detit të Kuq. "Ku jemi vallë kështu?", thirrën disa, "Kjo nuk është rruga për në Palestinë!" "Të kthehemi pas! Të kthehemi sa nuk është vonë!"- bërtitën të tjerë. Nga të ktheheshin vallë?! Ndërkohë që dielli filloi të lindte, ndjenë tokën poshtë këmbëve të tyre të dridhej. Trokëllima kuajsh u dëgjuan nga larg. Kokat i kthyen prapa, por shikimet u shtangën dhe zemrat gati sa nuk u ndalën nga frika. Ç'të shihnin! Një ushtri e stërmadhe, një ushtri e armatosur gjer në dhëmbë, e cila tërhiqte pas një re pluhuri, kishte mbuluar horizontin. Ku të fshiheshin? Përpara tyre deti, anash male të lartë dhe nga pas armiku. Kur e panë ushtrinë e panumërt dhe armët vdekjeprurëse që vezullonin nga larg e humbën çdo shpresë. Burrat filluan të qortonin të Dërguarin e Allahut. Pleqtë e plakat shtangën në vend. Gratë dhe fëmijët vikatnin nga frika. Musai, alejhis-selam, qëndronte i palëkundur. U ngrit plot trimëri në mesin e pasardhësve të Jakubit, ndërkohë që era detare ia shpupurishte flokët e zinj dhe mjekrrën e dendur. "Qëndroni e mos u lëkundni! Me mua është Zoti im, Ai do t'më udhëzojë!"- kumboi zëri i Pejgamberit. Allahu e urdhëroi të Dërguarin e Tij që me bastunin, të cilin e mbante në duar, t'i mëshonte detit. Musai iu afrua bregut, ndërkohë valët thyheshin në këmbët e tij fisnike. Era u egërsua. Re të zeza mbuluan qiellin. Musai

i ra detit siç qe urdhëruar, kur papritmas, uji i detit u çka dhe çdo anë e tij u bë si të ishte mal i thepisur. I Lartmadhërishti u bëri israilitëve rrugëdalje përmes detit, i cili ngrihej lart e ndërkohë era e perëndimit frynte pa pushim, që të terej balta ku do shkelnin këmbët e tyre. Pikërisht përmes këtij shtegu u urdhërua Musai, alejhis-selam, të kalonte së bashku me popullin e tij. Burra e gra, pleq e plaka, djem e vasha vërshuan pas të Dërguarit. Tek shikonin të mahnitur muret e detit sesi lartësoheshin mbi kokat e tyre, u futën thellë e më thellë në zemër të tij pa e ndalur hapin. Ndërkohë firaoni u trondit me atë që pa nga larg.

Madhështia e detit ia ndali hovin tiranit. Për një moment bëri të kthehej pas e të zbrapset, mirëpo krenaria përballë ushtarëve e shtyu të thotë me gojën e tij të kundërtën e asaj që i pëshpëriste zemra. *"Shikooonii! Shikooonii se si u hap deti për nder timin, që t'i zë robërit e mi, pasi u ngritën kundër mbretërisë sime dhe u larguan prej meje."* - bërtiti inatçori. U vërsul drejt detit e nga pas i vinte ushtria, mirëpo sa më shumë që bënë përpara aq më shumë trishtoheshin zemrat e tyre. Kuajt hingëllonin pa pushim nga frika tek shihnin anash tyre, të notonin me të shpejtë krijesat gjigande të thellësive detare. Musai, alejhis-selam, bashkë me popullin i tij kishin shkelur tashmë në brigjet matanë e vështronin me padurim se ç'do bëhej me shtegun që la pas.

Teksa i pa se si afroheshin me të shpejtë ushtarët, Musai ngriti shkopin e tij që të godiste me të bregun e të mbyllej deti, mirëpo Allahu i shpalli: *"Lëre detin të qetë, se ata gjithsesi do të përmbyen!"* Vetëm kur të gjithë ushtarët iu vërsulën thellësive dhe nuk ngeli asnjë, Allahu i Lartmadhërishtëm e urdhëroi Musain, alejhis-selam, ta godiste bregun. Sapo bastuni i Pejgamberit preku rërën e lagur, uji i detit, i ngritur si mal i thepisur filloi të trazohet. Majat papritmas u lëshuan në dallgë gjigande, ndërkaq muret e tij shkapërderdheshin pak e nga

pak. Nga t'ia mbanin?! Brigjet ishin larg. Shtegu i fund-detit sa vinte e ngushtohej, ndërkaq dallgët gjigande nuk mbaheshin nga tërbimi. Tmerri kaploi zemrat e ushtarëve. Dikush bërtiste, dikush mundohej të bënte përpara, dikush të kthehej pas, dikush kish mbetur si i gozhduar nga llahtaria ndërkohë që kuajt hingëllinin pa pushim nga frika. Por, më kot! Deti filloi të mbyllet mbi ta. Kur e pa se si dallgët e tërbuara gllabëronin ushtrinë e tij grupe grupe, firaoni thirri me sa zë që kishte: *"Besoj se, nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Atij që adhurajnë benu israilët dhe unë jam musliman."*

Mirëpo pendimi në momentet e vdekjes nuk i bën dobi jobesimtarëve. Kështu është e shkruar nga Zoti jonë. Për më tepër, edhe sikur të ktheheshin, njësoj do të vepronin. Deti i ra mbi kokë dhe e mbajti të burgosur në thellësi derisa vdiq. Edhe ushtarët e tij u mbytën deri tek i fundit, dhe asnjë nuk shpëtoi... Nërkohë që Musai, alejhis-salam, qëndronte sypatrembur para detit e vështronte fundin e hidhur të tiranit, disa nga benu israilët dyshonin ende në vdekjen e tij. Madje disa mendonin se është i pavdekshëm, ndaj Allahu Fuqplotë e urdhëroi detin ta nxirrte trupin e tiranit në sipërfaqe. Kur ja... nga larg, mbi valë shkëlqeu parzmorja e praruar që bartte trupin pa jetë të mizorit. Në këtë mënyrë ata u bindën për vdekjen e tij dhe u bindën se për Allahun e Lartmadhërishëm nuk ka rival. I Ploftuqishmi e shpëtoi trupin e firaonit, që të jetë shembull për ata që vijnë pas tij, megjithatë shumica e njerëzve nuk zunë mësim. Biri im, përmytja e firaonit dhe ushtrisë së tij ka ndodhur në ditën e Ashurasë, që përkon me ditën e dhjetë të muajit hënor Muharrem. Kjo ditë ishte ditë feste për benu israilët. Brez pas brezi israilitët e kujtonin ditën e shënuar, ditën kur Musai ngadhënjeu mbi firaonin, kur ngadhënjeu besimi ndaj idhujtarisë dhe drita ndaj errësirës. Pejgamberi i jonë, na ka nxitur ta agjërojmë këtë ditë në shenjë respekti ndaj Allahut, që ndihmoi të Dërguarin e Tij dhe në shenjë përkujtimi për triumfin e besimit dhe të besimtarëve.

## Në bregun e tjetër

Më në fund! Bijtë e Israilit shpëtuan nga skllavëria qind-ravjeçare. Matanë detit, për të parën herë pas shumë motesh thithnin ajrin e lirisë. Nuk kish më firaon apo ushtri që t'i frikësonte. Grupe-grupe ecnin të sigurtë pas Pejgamberit të tyre drejt Palestinës, drejt tokës së premtuar. Mirëpo, tek udhëtonin në një krahinë jo shumë larg brigjeve të detit, ndeshën në një popull idhujtar. Teksa u kalonin pranë, një grup prej israilitëve u mahnitën tek shihnin se si idhujtarët u përkuleshin dhe i nderonin idhujt e tyre që thuhet se kishin formën e lopës. Thuhet se pyetën pse u përkuleshin dhe i nderonin idhujt, ndërkohë ata u përgjigjën se në dorën e idhujve është e mira dhe e keqja, dëmi dhe dobia...

Biri im, koha e gjatë nën prangat e skllavërisë ua kishte prishur zemrat israilitëve. Besimi që kishin trashëguar nga Jakubi u ishte përzier me lloj-lloj bestytnishë egjiptiane. Megjithëse nuk kishte kaluar veçse pak kohë qëkur kishin kapërcyer detin dhe me sytë e tyre kishin parë shenjat e fuqisë së jashtëzakonshme të Allahut, iu drejtuan Musait, alejhis-selam, dhe i thanë: *"O Musa! Na e bëj edhe ti një zot ashtu si zotat e këtij populli!"* Kur dëgjoji këto fjalë, Musai, alejhis-selam, u vreros. Hidhërimi vërehej qartë në fytyrën e tij fisnike. *"Ju jeni me të vërtetë popull pa mend!"*, tha Pejgamberi. *"Vërtet, kushdo që adhuron idhujt është i humbur dhe adhurimi i tyre është i kotë e pa dobi. A nuk kuptoni?"*

Mjerë për ta! Kushdo që besimin e tij e përzien me shirk dhe idhujtari është i humbur. Kështu është shkruar. Kushdo që besimin e tij e përzien me shirk dhe idhujtari ndjen frikë dhe pasiguri. Kjo ndodhi edhe me israilitët: Si pasojë e besimit të tyre të prishur Allahu u futi frikë në zemra. Ngado ku shkelnin ndiheshin të pavlerë e të pasigurtë. Megjithëse, diçka të tillë mundoheshin ta mbanin sekret, shpejt do u dilte në shesh

fshehtësia e tyre. Thuhet se pas shumë ditë udhëtimi iu afruan tokës së shenjtë, tokës që Allahu i kishte premtuar Ibrahimit dhe Musait.

Ndërkohë që edhe pak udhëtim u kish mbetur, u erdhi lajmi se tokën e bekuar e kishin zaptuar hetitët dhe fezarinjtë, fise idhujtare që njiheshin për aftësitë luftarake dhe për padrejtësi. Kur e mori lajmin Pejgamberi nuk u frikësua aspak, por u ngrit në mesin e burrave dhe i nxiti për luftë. Si mund të jetohej në një vend të shenjtë nën zgjedhën e të padrejtëve?! Akoma të jetonin të nënçmuar?! Akoma nën zgjedhën e idhujtarëve?! *"O populli im!",* tha Musai, alejhis-selam, *"Përkujtoni dhuntinë e Allahut ndaj jush, kur disa prej jush i bëri fe-rrëfyes, e disa të tjerë sundimtarë dhe u dha mirësi si asnjë populli më parë. O populli im, hyni në Tokën e Shenjtë, të cilën Allahu ua ka caktuar dhe mos u tërhiqni prapa, e të ktheheni të humbur."* Mirëpo ata thanë: *"O Musa, atje gjendet një popull i pamëshirshëm e ne nuk hyjmë në qytet derisa ata të dalin prej tij. Vetëm nëse dalin ata, do hyjmë ne."* Pejgamberi shtangu në vend. Si ishte e mundur vallë?! Megjithëse me sytë e tyre e panë detin të çahëj, megjithëse ishin vetë dëshmitarë të shkaktërimit të firaonit dhe ushtrisë së tij që ishin më të dhunshëm se këta e më të shumtë në numër, prapëseprapë nuk patën guxim t'i kundërvihen armiqve të tyre. Musai u mllëfos nga fjalët që dëgjoji.

Në këto momente u ngritën dy burra të mirë, dy burra që njiheshin për besimin e patundur dhe për trimëri. *"O populli i jonë!",* buçiti zëri i tyre, *"Mbështetuni në Allah, kërkonin ndihmë prej Tij dhe vërsuluni në luftë. Të jeni të bindur se Allahu do ju ndihmojë dhe me siguri do të fitoni ndaj tyre!"* Mirëpo edhe këto fjalë nuk i trimëruan aspak. Përkundrazi, me paturpësinë më të madhe e lanë në baltë Pejgamberin. *"O Musa",* thanë, *"Ne nuk hyjmë në Tokën e Shenjtë përderisa ata të jenë në të! Shko ti dhe Zoti yt e luftoni, e ne po presim këtu!"*

Thuhet se kur dëgjuan këto fjalë të kobshme, dy burrat e mirë i shqyen këmishat e tyre si pasojë e hidhërimit, ndërsa Musai dhe Haruni, alejhis-selam ranë në sexhde. "O Allah, o Zoti im!", tha Musai, "Unë kam pushtet vetëm mbi veten dhe vëllanë tim, ndaj gjyko ndërmjet nesh dhe popullit tonë!" "Atëherë, Toka e Shenjtë do t'u jetë e ndaluar", tha Allahu, "katërdhjetë vite do bredhin nëpër shkretëtirë, ndërkohë ti mos u pikëlllo për popullin gjynahqar!" Për shkak të besimit të prishur me të cilin ishin brumosur e thyen urdhrin e Pejgamberit dhe kundërshtuan të luftonin. Si pasojë u ndëshkuan me bredhje nëpër shkretëtirë megjithse diçka e tillë ishte e rëndë dhe e vështirë për ta. Për katërdhjetë vite rendën të çoroditur, sa andej-këndej, derisa u shua ky brez. Thuhet se asnjëri prej atyre që kanë hyrë në shkretëtirën e Sinit, nuk ka dalë më prej saj, me përjashtim të Jusha bin Nun-it, Kalib bin Jofn-it (dy burrave të mirë) si dhe grave e fëmijëve. Allahu i Lartësuar thotë në Kur'an: "...Neve ata nuk na bënë kurrëfarë dëmi, ata dëmtuan vetveten."

### *Në shkretëtirë*

Biri im, siç ta përmenda edhe më parë, robëria qindravjeçare ua kish prishur zemrat benu israilëve. Me asgjë nuk kënaqeshin. Asgjë s'i rehatonte. Shumica prej tyre ishin mosmirënjohës dhe për çdo gjë ankoheshin. Shumica ishin ziliqarë, urrenin atë që u jepej dhe lakmonin atë që u s'ju lehohej. Megjithëse, vetë e merituan dënimin e përhumbjes në shkretëtirë, përsëri u ngritën të prishurit nga mesi i tyre dhe i thanë Musait, alejhis-selam: "Ti na nxore nga vendi i mirësive, ti na nxore nga Egjipti! Kush do na ushqejë në shkretëtirë? Ku mund të gjejmë ujë për të shuar etjen? Mjerë për ne! Mjerë për fëmijët e gratë tona!" Kur dëgjoi fjalët e tyre, Pejgamberi iu drejtua me lutje Zotit të tij. E kush mund ta ndihmonte veç Allahut?!



Lutja e Musait u pranua menjëherë dhe Allahu i zbriti "menn" nga qielli, rrëshirë të ëmbël si mjalta e të bardhë si bora, me të cilën gatuanin ushqim të shijshëm. Sapo zgjohe-  
shin në mëngjes e gjenin rrëshirën kudo rreth vendbanimeve të tyre dhe merrnin prej saj aq sa kishin nevojë për atë ditë deri në mëngjesin tjetër. Nëse dikush merrte më tepër sesa e nevojshmja, rrëshira prishej. Por, nëse merrte më pak, ajo i mjaftonte. Jo vetëm kaq! Para se të perëndonte dielli u zbrisnin nga lart "seluaa", zogj shtegtarë me pendë lara-lara, me këmbë të shkurtra e mish të njomë që u ngjanin thëllëzave. U afroheshin kaq shumë, sa që i zinin pa kurrfarë mudi e i gatuanin për darkë. Veç kësaj, Allahu i Lartësuar i shpalli Musait që gjatë udhëtimit israilitët duhet të bartnin me vete një shkëmb e sa herë që të kërkonin ujë, Musai do mjaftonte të godiste me bastun shkëmbin e prej tij do gufonin plot dymbëdhjetë burime uji, për dymbëdhjetë fiset israilite. E me këtë ujë të ftohtë e të kulluar do të mund shuanin etjen e tyre dhe etjen e bagëtive që bartnin me vete. Sikur të mos mjaftonte kjo, Allahu i Lartësuar gjatë ditëve të nxehta zbriste mbi ta një "re" të dendur që i mbronte nga dielli përvëlues i shkretëtirës. Madje kjo "re" udhëtonte me ta kudo nga shkonin, tamam si të ishte tendë mbi kokat e tyre.

Me të vërtetë këto ishin dhurata të çmuara nga ana e Allahut, megjithëse ata nuk u kushtuan rëndësi, nuk u treguan mirënjohës, madje me kalimin e kohës filluan të shfaqnin pakënaqësi. Nuk kaloi shumë dhe i thanë Pejgamberit të tyre: "O Musa, ne nuk mund të ushqehemi çdo ditë me të njëjtin ushqim, boll më! Lute Zotin tënd, në emrin tonë, që të na dhurojë nga ato që jep toka: perime, kastravecë, hudhra, thjerrëza dhe qepë!" Musai, alejhis-selam, u habit nga kjo kërkesë dhe me zë qortues u tha: "Vallë, a dëshironi të ndërroni atë që është më e mirë me atë që është më e keqe?! Këto që i kërkonin mund t'i gjeni kudo: në fshatra e qytete, kërkojini atje nëse doni, se unë nuk ia përcjell më Allahut dëshirat tuaja!"

## Biseda me Allahun

Pas shumë e shumë mundimesh që kaloi në shkretëtirën e Sinait, Allahu i Latësuar i caktoi Musait, alejhis-selam, një ditë të veçantë për të biseduar me të. Vendtakimi do ishte në kodrën Tur. Para se të nisej për udhë, Musai e caktoi si prijës vëllanë e tij Harunin, alejhis-selam, dhe e këshilloi duke i thënë: *“Të kam caktuar prijës të popullit, ndaj trego kujdes. Mbjaj rregull e mos ndiq dëshirat e ngatërresëtarëve!”* Pasi e porositi vëllanë dhe u përshëndet me të, u nis me të shpejtë.

Tridhjetë netë para bisedës me Zotin e tij, obligohej të agjëronte që të dëlirësohej edhe më shumë zemra e tij. Mirëpo, thuhet se pasi e plotësoi një muaj agjërim, Musai, në iftar, përtypi lëvoren e një bime aromatike që të kundërmonte aromë të këndëshme. Pejgamberi nuk kishte njohuri se kundërmimi i gojës së agjëruetit është më i këndshëm për Allahun sesa era e miskut... Thuhet se për këtë shkak dhe për disa urtësi madhore Allahu e urdhëroi që ta vazhdonte agjërimin edhe dhjetë netë të tjera. Thuhet se këto dhjetë netë përkujnë me dhjetë netët e para të muajit Dhul-hixheh, ndërsa biseda e veçantë është zhvilluar ditën e Kurban Bajramit...

Ditën e caktuar, Allahu filloi t'i flasë pas “perdes” dhe ia mundësoi Musait ta dëgjonte Zërin e Tij. I Madhërishmi e afroi të Dërguarin e Tij, bisedoi me të dhe e këshilloi si mos më mirë, i la porosi dhe e nderoi si askënd më parë. Kjo bisedë ia shtoi Musait edhe më shumë dashurinë për Zotin. *“O Allah”,* i tha Musai, alejhis-selam, *“m’u shfaq e të të shoh!”* *“Nuk mund të më shohësh,”* i tha Allahu, *“por shikoje kodrën që ke afër, e nëse ajo mbetet në vendin e saj do të mund t’më shohësh!”* Kur u ngrit pakëz “perdja” prej drite, kodra u thërrmua e tëra. Sikur të ngrihej plotësisht, drita e Fytyrës së Allahut do t’i digjte të gjitha krijesat deri atje ku mbërrin Shikimi i Tij. Në këtë çast Musai u përplas në tokë pa ndjenja. Allahu e di për sa kohë ka

qëndruar i shtirë. Mirëpo, sapo erdhi në vete, iu drejtua Allahut me këto fjalë: *"Qofsh i Lavdëruar o Zot! Pendothem për atë që të kërkova, dhe unë jam i pari që dëshmoj se askush nuk mund të të shohë Ty në këtë botë!"* Atëherë Allahu i tha: *"O Musa! Unë të kam përzgjedhur mbi gjithë njerëzit e kohës tënde, e të kam nderuar me peygamberinë dhe të Folurit Tim. Prano porosinë Time dhe bëhu falënderues për gjithë ç'të dhashë!"* Pasi foli me të në kodrën Tur, Allahu i Lartësuar i zbriti Musait, alejhis-selam, Teuratin, librin e shenjtë, të shkruar në pllaka nga Dora Fisnike e Lartmadhërisë së Tij. Përmes këtij libri qiellor, benu israilëve u zbriti udhëzimi i drejtë dhe drita hyjnore. Sipas këtij libri gjykoi ndërmjet tyre Musai, alejhis-selam, dhe Pejgamberët pas tij. Përmes Teuratit duhej të gjykonin pushtetarët dhe dijetarët israilit, të cilit e kishin detyrë ta ruanin Libri e Allahut dhe ta mbronin atë.

## Diçi i pruar

Po ç'ndodhi me benu israilët gjatë kohës që Musai shkoi në Tur? Thuhet se pasi u largua Pejgamberi, në mesin e israilitëve plasi rrëmuja. Shkak i saj u bë pasuria, stolitë dhe floriri që ua patën besuar një kohë e një mot koptasit. Këtë pasuri israilitët e kishin marrë me vete natën kur kishin dalë nga Egjipti. Mirëpo ç'të bënë me të tani? T'i përdorin për vete apo t'i braktisnin si pasuri e huaj? Duke qenë se Musai, alejhis-selam, nuk u kthye në kohën e caktuar, debati në mesin e tyre u ndez edhe më shumë. Në këtë situatë të vështirë Haruni, alejhis-selam, iu drejtua duke i thënë: *"O populli im! Kur dolët nga Egjipti, i morët me vete stolitë që ua patën besuar njerëzit e firaonit, por mos harroni se edhe atyre u kanë mbetur shtëpitë e gjësendet tuaja. Gjithsesi unë ju këshilloj të mos prekni asgjë nga ajo që u është besuar. Tashmë stolitë nuk mund t'ua kthejmë pas, ama as për vete nuk do i mbajmë."* Pas kësaj thuhet se hapën një

gropë dhe secili që kishte ndonjë stoli të koptasve urdhërohej ta gjuante në brendësi të saj. Më pas në gropë ndezën një zjarr dhe u tha: "As e jona dhe as e tyrja."

Një nga një, kush zotëronte diç nga floriri që nuk i përkiste atij, afrohej tek gropa dhe e hidhte në zjarr. Mirëpo ç'ndodhi? Pasi i hodhën në zjarr gjithë ç'patën, u afrua pranë gropës Samiriu. Thuhet se ky njeri vinte nga një fis idhujtar, por u ishte bashkëngjitur israilitëve kur kishin dalë nga Egjipti dhe hiqej sikur besonte Zotin e tyre. Bir, nuk ka një fakt të prerë për këtë, por thuhet se Samiriu gjithë floririn e shkrirë e përpunoi dhe i dha formë viçi. Kur e panë statujën e praruar, benu israilët u mahnitën. Ajo që ua shtoi habinë ishte fakti se herë pas here statuja filloi të nxirrte zë nga thellësia e trupit të zbrazët. Zërin e krijonte fladi i erës që hynte nga ana e prapme e statujës dhe i dilte nga goja. Të mrekulluar nga ajo që panë, disa mendjelehtë nga mesi i israilitëve iu drejtuan Samiriu duke i thënë: "Na e thuaj ç'është ky viç, o Samiri?" "Ky është zoti i juaj dhe i Musait, po ai e ka harruar." "Me të vërtetë?", thanë të prishurit në mesi e tyre, "A nuk na e premtoi Musai se do të kthehej pas tridhjetë ditësh?! Ja, kanë kaluar katërdhjetë ditë dhe ai akoma nuk është kthyer. Me sa shihet, nuk e ka gjetur Zotin e vet, ndaj ende po e kërkon!"

Ndërkohë, tek i shihte israilitët të humbur në errësitat e idhujtarisë, Haruni, alejhis-selam, iu drejtua duke paralajmëruar: "O populli im, kjo statujë është sprovë për ju. Zoti i juaj është Allahu, i Gjithmëshirshmi, ndaj më pasoni mua dhe dëgjoni atë që po u them!" Megjithatë, mendjelehtët, të helmuar nga fjalët e Samiriut, i thanë: "Ne nuk e braktisim zotin e praruar dhe do ta adhurojmë deri sa të kthehet Musai e të na lajmërojë se viçi nuk është zot." A nuk e vërejtën ata, vallë, se viçi as nuk fliste dhe as që mund t'i udhëzonte në rrugën e drejtë? A nuk e vërejtën se viçi nuk mund t'ua largonte vështirësitë dhe as t'u sillte ndonjë mirësi? Shumica e tyre e adhuruan dhe ranë

në humnerën e idhujtarisë. Megjithatë një grup besimdrejtë u ngritën e thanë: *"Ky është kurth i shejtanit. Ky nuk është zot. Ne kurrsesi nuk i besojmë dhe as nuk e adhurojmë."*

## *Pas katërdhjetë ditësh*

Ndërsa një pjesë e israilitëve adhuronin viçin, atje lart, mbi kodrën e bekuar, Musai, alejhis-selam, bisedonte me Zotin e tij. Ndërsa israilitët me përkushtim madhëronin dhe i thurinin lavde idhullit të praruar, Profeti fisnik pranonte këshillat dhe porositë hyjnore. Por, ndërkohë që Musai, alejhis-selam, shtrëngoi pllakat ku shkruhej Teurati dhe u bë gati të kthehej, Allahu i Madhërishëm e lajmëroi për sprovën që kishte goditur popullin e tij.

Me të marrë lajmin, Profeti shpejtoi hapin. Kur mbërriti dhe i pa israilitët tek madhëronin statujën e praruar, u mbush me hidhërim. U ndal përpara tyre me vetulla të mrrolura dhe u hodhi një vështrim qortues. Fytyra iu ngrys si ana e malit kur vjen shiu me breshër. Sapo e panë nga larg të Dërguarin, u trishtuan të gjithë. Musai ishte hije-rëndë dhe askush nuk kishte zemër t'i fliste. Në mesin e israilitëve ra heshtja... Israilitët mbetën si të gozhduar në vend. Ndërkaq Musai, i mllëfosur sa më s'ka, iu drejtua israilitëve duke u bërtitur: *"Aaaaahh, sa keq paskeni vepruar pasi ju lashë! Përse e nxitët hidhërimin e Zotit tuaj? Përse nuk e mbajtët premtimin që më dhatë mua?"* Të frikësuar, filluan të justifikohen. *"Nuk e thyem premtimin që të dhamë me dëshirën tonë,"* i thanë, *"por ishim të ngarkuar me peshë të rëndë, me stolitë e popullit të firaonit. Pasi i hodhëm dhe morën formë viçi, Samiriu na nxiti ta adhurojmë si Zot."* Kur dëgjoi fjalët e tyre, Musain, alejhis-selam, e përvëloi kaq shumë hidhërimi sa nuk mundi ta përmbante veten. I hodhi pllakat dhe iu vërsul vëllait të tij. E kapi me forcë për flokësh dhe për mjekre duke e tërhequr nga vetja me sa fuqi që kishte.

"Ooo Harun", i bërtiti, "Pse nuk erdhe tek unë t'më njoftoje kur iu dhanë idhujtarisë? Pse nuk e zbatove urdhrin tim? Pseee?" "O vëllai im", ia ktheu Haruni, alejhis-selam, "mos më tërheq për flokësh e për mjekre! Unë pata frikë t'i lë ata ngase ti më pate caktuar udhëheqës. I këshillova, por ata s'ma vunë veshin e gati sa s'më mbytën, ndaj më lësho e mos më llogarit si gjynahqar!" Pas kësaj, Musai alejhis-selam u këndell pak. "O Allah! O Zoti im!", u lut, "Më fal mua dhe vëllanë tim dhe na dhuro Mëshirën Tënde ngase Ti je më i Mëshirshmi i mëshiruesve!" Pastaj iu kthye Samiriut duke e qortuar. "Ç'ke për t'na thënë, o Samirij?" - iu drejtua me vrazhdësi Musai alejhis-selam. "Epo, unë pashë atë që s'e panë të tjerët." - filloi të arsyetohet Samiriu. "E përpunova floririn dhe i hodha një grusht nga dheu që lanë gjurmët e të Dërguarit... atij që ju ndihmoi ndaj firaonit (e kish fjalën për Xhebrailin). Kështu vetvetja ma zbu-kuroi të keqen." "Shporru!", i tha Musai, alejhis-selam, "Gjatë gjithë jetës do të thuash: Askush të mos më prekë!" Pastaj iu drejtua përsëri me përcmim: "Shihe mirë këtë zotin tënd se si do e djegim! Shihe se si do e copëtojmë dhe pluhurin e tij do e përhapim në det!"

Kur Musait, alejhis-selam, i kaloi hidhërimi, i mori pllakat në të cilat ishte i shkruar udhëzimi për rrugën e drejtë dhe mëshira për ata që i frikësohen Zotit. Viçin e dogjën duke mos i lënë as hirin e tij që të shuhej një herë e mirë besimi se idhujt na qënkuan zota. Ndërsa Samiriu u përzu nga populli dhe thuhet se e kaloi tërë jetën i nënçmuar dhe i përbuzur nga kushdo.

## Xë "Tur"

Pasi u shkatërrua idhulli prej ari dhe u përzu Samiriu, Musai, alejhis-selam, përzgjodhi në mesin e israilitëve shtatëdhjetë burra besimdrejtë e të devotshëm. I urdhëroi të laheshin, të

parfumoseshin dhe të agjëronin, pastaj u tha: *“Të përgatiteni për udhë. Do të vini me mua në kodrën Tur dhe do t’i kërkonti falje Allahut për vetvetet tuaja dhe për popullin tuaj.”*

Të gjithë të përzgjedhurit iu bindën urdhrit dhe u nisën për udhë. Kur iu afruan kodrës, filloi një tërmet i tmerrshëm, toka poshtë këmbëve të tyre dridhej me të madhe, ndërsa zemrat në gjokse gati sa nuk plasën nga frika. Në këtë moment Musai, alejhis-selam, iu drejtua Allahut me këto fjalë: *“O Allah! O Zoti im, sikur të doje, mund t’më kishe shkatërruar mua dhe ata që më parë. A do të na shkatërrosh për shkak të asaj që kanë bërë mendjelehtët nga mesi i jonë? Ti je ndihmëtari ynë, ndaj na fal dhe na mëshiro se Ti je Falës i madh. O Allah, na cakto mëshirën Tënde në këtë botë dhe në tjetrën se me të vërtetë ne pendohemi tek Ti.”* Atëherë tërmeti u ndal dhe Allahu i shpalli Musait: *“O Musa! Me dënim Unë ndëshkoj kë të dua, ndërsa mëshira Ime përfshin çdo gjë. Mëshirën do t’ua jap të devotshmëve që u besojnë shpalljeve të Mia dhe që do të pasojnë Pejgamberin, fe-rrëfyesin, i cili nuk do të dijë të shkruajë dhe as të lexojë. Pejgamberin për të cilin flitet në Teurat e në Inxhil. Ai, i cili do të kërkojë prej tyre që të bëjnë vepra të mira dhe do i ndalojë nga të këqijat, do t’u lejojë ushqimet e mira e do ua ndalojë të këqijat, i cili do t’i lirojë nga ngarkesat dhe vështirësitë që kanë bartur. Ata që do t’i besojnë atij, që do ta përkrahin dhe do ta ndjekin dritën e dërguar përmes tij do jenë të shpëtuar.”*

Tek i fliste Musait, alejhis-selam, Allahu i Lartësuar i shpalli se populli që do mëshirohej nga Lartmadhëria e Tij dhe do të shpëtonin nga dënimi në ahiret do jenë Profeti Muhamed, Profeti analfabet dhe pasuesit e tij. Thuhet se pasi ka dëgjuar këto fjalë Musai i ka lënë pllakat dhe është lutur: *“O Allah! O Zoti im, bëj që edhe unë të jem nga pasuesit e tij!”*

Pas kësaj, një mjegull e dendur ra rreth e përçark dhe e mbështolli Tur-in. Musai eci përpara dhe hyri në brendësi të saj. Kështu vepruan edhe burrat që ishin me të. Tek ngritej



mbi kodër fytyra e Pejgamberit filloi të vezullonte *nur* sikur të ishte diell. Kur hipi në vendin e caktuar i Dërguari filloi t'i lutej të Lartmadhërishmit që t'i falte dhe t'ua pranonte pendimin pasardhësve të Jakubit. Kur ja, përgjigjja i erdhi në çast. Allahu i Lartësuar filloi t'i fliste Musait, alejhis-selam, ndërkohë të pranishmit dëgjonin të mrekulluar të folurën e Zotit të qiejve dhe tokës. Ata dëgjonin me kërshëri se si bisedonte Zoti me të Dërguarin e Tij, se si e urdhëronte dhe e ndalonte. Bëje këtë e këtë dhe mos e bëj këtë e këtë. Por kushti që t'u pranohej pendimi ishte i rëndë dhe vështirë.

## Pendimi

Tek ktheheshin nga Turi Pejgamberi u printe grupit të përgjedhur. Ndërkohë që së bashku i afroheshin gjithnjë e më shumë luginës, benu israilët mezi pritnin të merrnin lajmin. A u ishte pranuar pendimi apo jo? Kur mbërritën, në fytyrat e të përgjedhurve vërehej qartë pikëllimi. Ç'kish ndodhur? A thua vallë nuk u pranua pendimi?

Pejgamberi me pllakat e Teuratit në dorë çau turmën e njerëzve që e prisnin me padurim dhe iu drejtua israilitëve duke i thënë: *"O populli im! Ju i bëtë padrejtësi vetes tuaj kur adhuroat viçin, ndaj kthehuni me pendim tek Krijuesi i juaj dhe mbytni fajtorët në mesin tuaj. Kjo është më mirë për ju, në mënyrë që Krijuesi t'ua falë gjynahun e madh! Ai e pranon pendimin dhe është Mëshirues."* Me të vërtetë lajmi ishte më i hidhur se helmi. E si mund të vritet babai, nëna, vëllai apo kushëriri? Gjithsesi, urdhri ishte i prerë: secili prej atyre që nuk kishin adhuroar viçin duhej të zhvishte shpatën dhe të vriste idhujtarët nga fisi i tij, qofshin ata edhe baballarët apo fëmijët e tyre. Thuhet se me këtë rast, Allahu i Lartësuar zbriti në luginën ku qëndronin benu israilët një mjegull të dendur në mënyrë që mos ta dallonte kushëriri - kushërin apo vëllai - vëllanë.

Në këtë mënyrë besimdrejtët zhveshën shpatat dhe i vranë të gjithë ata që kishin adhuruar vëçin. Vërtetë kushti për pranimin e pendimit ishte i rëndë dhe vështirë, por si pasojë e bindjes që treguan Allahu ua fali edhe vrasësve edhe të vranëve.

## Lopa

Në mesin e israilitëve jetonte një pasanik që nuk kish fëmijë ta trashëgonin, por shumë nipa. Ndërkohë që pasaniku i ndihmonte dhe i përkrahte, ata shpresonin vdekjen e tij që të trashëgonin stolitë e margaritarët. Një natë, kur ra terri, ndërsa njerëzit flinin, njëri nga nipat e tij u përvodh fshehurazi dhe me dinakëri e vrau xhaxhain e pasur. Jo vetëm kaq! Trupin e pajetë e tërhoqi zvarrë dhe e la sa gjërë e gjatë përpara vendbanimit të një israiliti tjetër.

Sapo zbardhi drita dhe rifilloi jeta, një grup burrash rrethuan vendbanimin para të cilit gjendej trupi pa jetë i pasanikut. Filluan grindjet mes fiseve. U bë rrëmujë e gjullurdi e madhe. Sikur të mos ishte fjala e një të mençuri, do të plaste lufta e të derdhej gjaku. Erdhi i mençuri e u tha: *"Pse grindeni kot? Shkoni tek i Dërguari i Allahut... S'ka dyshim se ai do ua zgjidhë çështjen për të cilën grindeni mes vete."* Sapo i erdhi lajmi Musait alejhis-selam, u ngrit në mesin e benu israilëve dhe u tha: *"E lus për hir të Allahut, secilin që di ndonjë lajm për vrasjen, të na e tregojë!"*

Mirëpo, askush nuk dinte gjë, me përjashtim të nipit, i cili vajtonte mbi trupin e të vranit. Për këtë arsye israilitët i kërkuan Musait alejhis-selam që në lidhje me vrasjen ta pyeste Zotin e tij. Kështu veproi i Dërguari dhe Allahu urdhëroi të thernin një lopë dhe me një copë nga mishi i saj ta preknin të vdekurin. Musai, alejhis-selam, u tha: *"Allahu ju urdhëron të therni një lopë."* *"A po tallesh me ne, apo si?"* - ia kthyen. *"Allahu më*

ruajt", tha Pejgamberi, "nuk i takon Pejgamberit të tallet. Unë e pyeta për atë që më kërkua dhe Ai kështu m'u përgjigj." Sikur menjëherë ta zbatonin urdhrin e Allahut, do t'u ishte e mjaftueshme, por siç e kishin zakon, ata e vështirësuan çështjen. "Lute Zotin tënd, në emrin tonë," thanë ata, "të na tregojë çfarë moshe do të jetë ajo."

Musai, alejhis-selam, u tha: "Ai thotë, se lopa duhet të jetë e moshës së mesme, as e moçme e as e re, ndaj zbatoni atë që ju urdhërohet!" "Lute Zotin tënd, në emrin tonë," thanë ata, "çfarë ngjyre duhet të ketë ajo?" Musai alejhis-selam u tha: "Ai thotë se lopa duhet të jetë me ngjyrë të verdhë, të ndezur që të kënaq syrin." Për së treti i thanë: "Lute Zotin tënd për ne. Të na e sqarojë edhe një herë çështjen, se lopët na janë përzier." Musai, alejhis-selam, u tha: "Ai thotë se lopa nuk duhet të jetë e lodhur nga lërimi i tokës apo ujitja e të mbjellave por e shëndetshme e pa kurrëfarë shenjash." "Eeeh, tani na e përshkrove siç duhet."- i thanë. Ama edhe atëherë mezi iu bindën urdhërit. Thuhet se një lopë të tillë e kishte një djalë, i njohur për sjelljen e mirë ndaj babait të tij. Kur ia kërkuan, ai nuk pranoi t'ua jepte. Edhe pasi i ofruan një çmim të majmë, djaloshi nuk pranoi. "Do të të japim flori, sa pësja e saj."- i thanë. Por përsëri i riu nuk pranoi. Vetëm kur i ofruan flori sa dhjetë herë pësja e lopës, pranoi t'ua shiste. Kur e blenë, Musai, alejhis-selam, i urdhëroi ta prisnin dhe me një pjesë të saj ta preknin të vvarin. Sapo e prekën të vvarin me mishin e prerë, Allahu i Lartmadhërishtëm e ngjalli të vdekurin. Papritmas ai u ngrit sikur të kish qenë në gjumë, ndërkohë gjaku vazhdonte t'i rridhte nga damari i qafës. Të gjithë të pranishmit vështronin të mrekulluar. Të hutuar fërkonin sytë nga habija. Vrasësi shtangu në vend. Fshiu lotët me të shpejtë dhe me frikë në shtat priste se ç'do ndodhte. Sakaq, Musai, alejhis-selam, iu afrua pasanikut dhe i tha: "Kush të vrau, o njeri?" "Më vrau nipi im", tha burri, e pasi u përgjigj ra i vdekur përdhe.

## Kodra

Biri im! Dije se udhëzimi me të cilin kanë ardhur Pejgamberët i përngjan dritës së diellit. Sado mirë të shohësh me sytë e ballit, nëse mungon drita, do humbasësh në errësi njëllor si i verbri.. Sa e sa njerëz “të njohur për mendjemprehtësi”, humbën në errësira kur ia kthyen shpinën udhëzimit të Pejgamberëve?! Sa e sa të tillë adhurojnë lopën?! Sa e sa u luten statujave që i mbajnë me vete në çantë nga frika se mos u thyhen?! A quhet kjo “mendjemprehtësi”?! Ato që nuk e pasojnë udhëzimin e Pejgamberëve u përngajnë drurëve të shkretëtirës, të shtrembër dhe me ferra. A nuk ke dëgjuar se si njerëz të këtillë luajnë me pasurinë dhe gjakun e të tjerëve?! A nuk ke dëgjuar se si vrasin e presin, robërojnë e nënçmojnë më të dobëtit?! A nuk i sheh se si i këpusin lidhjet farefisnore dhe i braktisin prindërit e tyre?! Ndërkohë, Pejgamberi u mëson njerëzve më të mirën. U mëson se si ta adhurojnë Krijuesin Bujar, si të sillen mes veti, u mëson edukatën, moralin e mirë dhe virtytet e larta. Me të vërtetë, Pejgamberi i përgjan prindit të butë e të mëshirshëm që u mëson edukatën fëmijëve të mitur. Megjithatë, kur benu israilëve u erdhi Musai, alejhis-selam, me udhëzimin hyjnor, ata u mbajtën me të madh.

Kur Musai, alejhis-selam, i solli pllakat me Teuratin dhe i urdhëroi t'i përmbahen rregullave të Tij, ata i thanë: “Së pari na i trego rregullat e Tij, nëse janë të lehta do t'i pranojmë e nëse jo, nuk i pranojmë ato.” Musai alejhis-selam u tha i vendosur: “Edhe një herë po u them: Pranoni udhëzimin e Zotit dhe kapuni fort pas Libri të tij.” Por ata sërish i kthyen shpinën. Atëherë Allahu i Lartmadhërishëm urdhëroi melekët e kodrave që ta shkulin kodrën afër luginës e ta ngrenin lart në qiell. Toka filloi të dridhej si në tërmet... Sipërfaqja e saj filloi të shqyhej, kur ja: kodra filloi të lëkundej sa andej këndej, sikur donte të shkëputej nga toka mëmë. Israilitët, të frikësuar nga dridhja e tokës, vraponin të shastisur, ama ku të fshiheshin. Sikur të mos

mjaftonte kjo, kodra prej guri filloi të ngritej lart në qiell tamam si re e zymtë. Teksa ngritej lart, të gjithë mbetën si të ngrirë, ndërsa shikimet u shtangën. Në këtë moment Lartmadhëria e Tij urdhëroi melekët që ta ulnin kodrën krejt afër kokave të tyre. Nga lart, në vend të shiut, mbi koka u pikonte rërë, guralecë e dhé e shkrifët. Kur e panë se si u afrohej kodra gjithnjë e më shumë dhe kur u humbi qielli nga sytë, të tmerruar ranë në sexhde. *“Nëse nuk i pranoni pllakat dhe ato që shkruhen në to”,* iu tha, *“kjo kodër do rrëzohet mbi ju.”* Atëherë pranuan nga frika dhe premtuan se do t’i zbatonin urdhrat e Teuratin, por përsëri e thyen betimin. Sikur të mos ishte mirësia e Allahut ndaj tyre dhe mëshira e Tij, me të vërtetë do ta pësonin keq. Por Allahu vazhdoi t’u dërgonte Pejgamberë njëri pas tjetrit që të përudheshin në rrugën e drejtë.

## Edhe më shumë

Biri im, siç të rrëfeva, israilitët ishin popull mosmirënjohës, ziliqarë dhe mendjemëdhenj. Megjithë ndihmën dhe përkrahjen e Allahut të Lartësuar, sapo ngadhënjyen ndaj firaonit dhe ushtrisë së tij, i kërkuan Pejgamberit t’u bënte një idhull që ta adhuronin. Sikur të mos mjaftonte kjo, e lanë në baltë të Dërguarin e Zotit kur u kërkoj të luftonin përkrah tij. Adhuruan vëçin, u orvatën të mbytnin Harunin, ia kthyen shpinën Teuratit derisa u ngrit kodra mbi ta sikurse reja...

Në fakt e tepruan edhe më shumë se kaq, kur edhe pas gjithë mrekullive që dëshmuuan, me mendjemadhësi i thanë Musait, alejhis-selam: *“O Musa, ne nuk të besojmë ty, derisa ta shohim Allahun haptazi.”* E ç’mund të kërkonin më shumë sa kaq?! Kur dëgjoj fjalën e tyre, Musai u trondit si kurrë më parë. Edhe pas të gjithë mrekullive që i kishin parë nuk besonin? Edhe pas gjithë asaj që kishin kaluar tregoheshin mosmirënjohës? Në atë çast shpërtheu një rrufe nga qielli dhe i goditi

njëherësh të gjithë. Mirëpo Allahu i Lartmadhërishëm u dha edhe një mundësi. I ringjalli njëri pas tjetrit që me sytë e ballit të shihnin se si e ringjall Allahu të vdekurin, e kështu të bëheshin dëshmitarë të fuqisë së pakufishme të Zotit, të besonin pa u lëkundur e të ishin mirënjohës... Por ... a u treguan të tillë?

## Në kërkim të diturisë

Një ditë Musai, alejhis-selam, u ngrit në mesin e benu israilëve për t'i këshilluar dhe për t'ua tërhequr vërejtjen. Aq të vlera e të vyera ishin porositë e tij, saqë zemrat e të pranishmëve u përmalluan dhe sytë iu mbushën me lot. Pas këshillës Musai, alejhis-selam, nisi të largohej nga sheshi, por një burrë iu vu pas. *"O i Dërguari i Allahut!"*, e pyeti burri i mahnitur nga ligjërimi i Musait, *"A thua ka në Tokë njeri më të ditur se ti?"* *"Jo, nuk ka."* - u përgjigj i Dërguari. Allahu i Lartësuar, kur e dëgjoji fjalën e Musait, e qortoi pse nuk ia mveshi diturinë Zotit të tij. *"Gjendet një rob i Imi,"* i shpalli Allahu, *"që është më i ditur se ti."* *"E ku mund ta gjej, o Zoti im?"* - pyeti Musai alejhis-selam. *"Në vendtakimin e dy deteve."* - iu përgjigj Allahu. *"O Allah, më jep një shenjë, me anë të së cilës mund ta njoh atë!"* - tha përsëri Musai. *"Merr një peshk të ngordhur në trastën e ushqimeve e nisu për udhëtim. Do të të duhet të ecësh shumë, por mos harro se aty ku do t'i kthehet shpirti peshkut e të fillojë të përpëlitet, do ta gjesh njeriun që dëshiron."*

Menjëherë i Dërguari i Allahut filloi përgatitjet, siç bën udhëtari kur nisat rrugëve të gjata. Për udhëtimin e tij e lajmëroi edhe Jusha bin Nun-in, besimdrejtin që e kish mbështetur dhe ndihmuar të Dërguarin kurdoherë. I kërkoi shokut me butësi ta shoqëronte në udhëtim, por ia bëri me dije se udhëtimi mund të ishte i gjatë dhe i mundimshëm. Jusha e pranoi ftesën e të Dërguarit, lajmëroi familjen e tij, përgatiti gjithçka duhej për rrugë dhe u nis në ditën e caktuar. Para se të niseshin, Mu-

sai, alejhis-selam, e këshilloi djaloshin e ndër të tjera, i la një porosi. *"O shoku i udhëtimit, në trastën time kam një peshk të ngordhur."*, i tha Musai, *"Të kesh kujdes e të më lajmërosh nëse papritur i kthehet shpirti dhe fillon e lëvizë!"* *"Rri i qetë,"* iu përgjigj Jusha, *"do të të lajmëroj patjetër."* Kështu filluan udhëtimin tok: i Dërguari i Allahut, kryetari i benu israilëve me djaloshin besnik. Hodhën krahaqafe krahoshin me bukë dhe morën rrugën e kërkimit të diturisë. Kush e di se sa e sa shtigje kaluan, sa e sa kodra kapërcyen, sa e sa vështirësi shijuan në rrugëtim.

Bir i dashur! Musai, alejhis-selam, si udhëheqës i israilitëve, si kryetar familjeje, si kumtues i shpalljes hyjnore madje edhe si plak i thyer në moshë, ishte gati të flijonte shëndetin dhe kohën në kërkimin e diturisë, megjithëse kishte mbi shpatulla detyra nga më të rëndat. Ndërsa ti, megjithëse nuk ke kurrfarë përgjegjësie madhore mbi supe dhe as nuk ke nevojë të udhëtosh rrugëve të largëta, tregohesh përtac dhe nuk e shfrytëzon aq sa duhet kohën tënde në leximin dhe mësimin e njohurive... A nuk ka ardhur koha t'i përveshësh mëngët e t'i jepesh librit dhe diturisë?

Mirëpo ç'ndodhi një ditë?! Pasi kapërcyen shtigjet e panjohura, Musai, alejhis-selam, u shtri të flinte nën hijen e një shkëmbi. Lodhja e rrugës ia fërkoj dhe ja magjepsi qepallat, e ky ra në gjumë të thellë. Thuhet se nën këtë shkëmb gjarpëronte burimi *Hajeet*. Çfarëdo që prekte uji i bekuar i këtij burimi, ngjallej e merrte jetë. E kështu ngjau edhe me peshkun e Musait, alejhis-selam. I Dërguari i Allahut e kish lënë trastën e tij afër shkëmbit mbi rërën e lagur. Ndërkohë që trasta shtrihej gjërë e gjatë u lag dhe u bë qull nga uji i burimit. Si në ëndërr, sapo uji preku luspat e peshkut, ky mori jetë, filloi të përpëlitej, me të shpejtë doli nga trasta dhe rrëshqiti në det. Jusha i rrinte mbi kokë të Dërguarit dhe bënte roje. Sakaq, u mahnit kur e pa peshkun e ngordhur tek përpëlitej sikur të



ishte zgjuar nga gjumi i gjatë. Peshku jo vetëm që përpëlitej, por sillu e përdridhu doli nga trasta, iu drejtua bregut të detit që e kish fare pranë dhe u zhyt në të. Si për çudi, Allahu i ndali valët e detit, që të vëreheshin qartë gjurmët e lëna nga peshku. Jusha nuk u besonte syve nga ajo që pa, mirëpo nuk e zgjoi të Dërguarin. Ndoshta i dhimbsej ndërsa e shikonte të shtrirë tek dremiste. *“Nuk do ta zgjoj tani.”* tha me vete. *“Le të qetësohet edhe pak, e kur të zgjohet, do e lajmëroj për peshkun.”* Mirëpo Musai, alejhis-selam, fjeti gjatë dhe kur u zgjua shërbëtori besnik harroi ta lajmëronte.

Kështu udhëtuan gjatë pjesës së mbetur të ditës dhe gjatë natës. Tek po agonte, Musai, alejhis-selam, i tha shërbyesit: *“Na e sill pak ushqim, se udhëtimi na lodhi.”* *“Shiko!”*, iu përgjigj Jusha, *“Kur pushuam tek shkëmbi, peshku, si për çudi, u ngjall dhe u fut në det, por unë harrova të të lajmëroj. Ehhh! Shejtani më bëri të harroj e mos të ta përmendi.”* Sapo dëgjoji fjalët e shërbëtorit, fytyra e Musait shkëlqeu nga gëzimi. As nuk e qortoi shokun e tij dhe as që i mbajti qëndrim, megjithëse shumë ishte lodhur nga rruga. *“Kjo është ajo që po kërkojmë!”*- kumboi zëri i të Dërguarit. Së bashku me shokun e tij duke përcjellur gjurmët e veta u rikthyen edhe një herë tek shkëmbi.

Kur ja! Afër shkëmbit një burrë hijerëndë, me kokën e mbuluar me rrobën e gjatë tek qëndron mendueshëm. Sikur priste dikë nga larg. A thua ishte vallë ky, njeriu i ditur që po kërkonin?! I Dërguari i Allahut iu afrua dhe e përshëndeti me *selam*. Burri e zbuloi kokën dhe iu drejtua Musait, alejhis-selam: *“Prej nga je ti që më përshëndet me selam?”* *“Unë jam Musai, i biri i Imranit.”*- ia ktheu i Dërguari. *“Vallë ti je, Musai, stërnipi i Jakubit?”*- pyeti burri i çuditur. *“Po, po, ai jam”,* ia ktheu i Dërguari, *“dhe kam ardhur të më mësosh diç nga dituria e vlerë që të është dhuruar.”* Burri i urtë ia hodhi shikimin të Dërguarit dhe i tha: *“O Musa! Unë jam Hidri. Allahu i Gjithëdi-*

tur më ka mësuar diç nga dituria që s'ta ka mësuar ty, ashtu sikurse edhe ty të ka mësuar diç që unë nuk e di. Mirëpo, ti nuk mund të bësh durim me mua. Është e vështirë të durosh përballë asaj që s'ke njohuri." "Ke për ta parë se në dashtë Allahu, do jem i durueshëm", i tha Musai, alejhis-selam, "dhe se në asgjë nuk do të të kundërshtoj." "Mirë, atëherë", tha burri i urtë, "nëse dëshiron të më shoqërosh, mos më pyet për asgjë, derisa unë i pari të të tregoj."

### Me burrin e urtë

Pa humbur kohë dy burrat, Musai dhe Hidri, u nisën. Udhëtonin pa e ndalur hapin bregut të detit. Pranë tyre erdhi një varkë e vogël që vozitej nga disa të varfër. Kur e prekën bregun, Hidri i kërkoi që ta merrnin në varkë së bashku me shokun e tij. Të varfërit kur e panë se kush ishte, jo vetëm që i morën, por edhe nuk u kërkuan kurrfarë shpërblimi. Hidri ishte i njohur për urtësinë dhe bamirësinë e tij ndaj të varfërve, ndaj të gjithë e donin dhe kishin mendim të mirë për të. Ama për çudi, ai, sapo hipi në varkë, shkuli me forcë një dërrasë të saj derisa e hapi një vrimë. Pronarët e varkës nuk folën as edhe një gjysmë fjale, ndërkohë Musai, alejhis-selam, i trazuar nga ajo që pa, iu drejtua Hidrit: "Këto lundërtarë fisnikë na morën pa pagesë ndërkohë ti ia dëmton varkën! Me të vërtetë, bëre diçka shumë të madhe." "Ehhh...", psherëtiu Hidri, "A nuk të thashë se nuk do të mund të durosh me mua?" Menjëherë Musai, alejhis-selam, u kthjellua. "O njeri i urtë! Mos më qorto, pasi harrova. E mos ma vështirëso udhëtimin me ty!" Vazhduan lundrimin. Ndërsa valët përkundnin varkën që bënte përpara, një zog zbriti në skajin e varkës dhe zhyti sqepin në det. Tek shihnin zogun, Hidri iu drejtua Musait, alejhis-selam: "O biri i Imranit! Mos harro se dituria e ime dhe e jotja bashkë, përballë diturisë së Allahut, është si pika e ujit që mori ky zog

*shtegtar, përballë këtij deti të pafund.*" Ndërkohë varka çante valët dhe për pak kohë dy burrat mbërritën aty ku dëshironin. U përshëndetën me varkëtarët dhe zbritën në breg. Me të zbritur ja nisën edhe një herë udhëtimit. Ndërkohë që vazhdonin rrugën bregut të detit, panë një djalosh që po luante. Për çudi, Hidri e ndali hapin, iu afrua djalit dhe e mbyti. Musai u tërbua, nga skena që pa. *"Përse e mbyte?"* - i thirri me të madhe Hidrit. *"Si u mbytkë fëmija i pafajshëm! Me të vërtetë ke bërë diçka shumë të shëmtuar!"* *"A nuk të thashë"*, ia ktheu Hidri, alejhis-selam, *"se ti, vërtetë, nuk mund të durosh me mua?"* Kësaj here qortimi ishte më i ashpër se i pari, ndaj Musai tha: *"Nëse edhe pas kësaj, të trazoj për çfarëdo qoftë, atëherë më kurrë mos më shoqëro. Tashmë je i arsyetuar!"* *"Mirë, mirë, vazhdojmë atëherë, ashtu siç e lamë."* - ia ktheu Hidri, alejhis-selam. Përsëri ia morën rrugës. Tek ecnin, mbërritën tek një qytet i çuditshëm. Të lodhur nga udhëtimi u kërkuan vendasve pak ujë për të shuar etjen dhe pak ushqim për të vazhduar rrugën. Mirëpo, banorët e qytetit, që njiheshin për ligësi dhe koprraci, nuk iu përgjigjën as me një grusht uji. Kështu vazhduan të endeshin lagjeve të qytetit, derisa mbërritën pranë një shtëpie, avllia e së cilës ishte shtrembëruar aq shumë, saqë gati po rrëzohej. Kur e pa, Hidri, alejhis-selam, iu afrua dhe megjithë lodhjen që bartte mbi supe iu përvesh punës për ta drejtuar. Tek e shihte si punonte, Musai, alejhis-selam, i tha me habi: *"Ti u drejton muret banorëve të një qyteti që as ujë për të shuar etjen s'na dhanë! Të paktën t'u merrje shpërblim për punën që po u bën."* *"Epooo, tani erdhi koha të ndahemi."* - ia ktheu Hidri. *"Përsëri e theve marrëveshjen, por sidoqoftë do t'i shpjegoj gjithçka pe, e s'munde të durosh."*

## Zbulimi i fshehtësisë

*"Tani, dëgjo me vëmendje."* - iu drejtua Hidri, alejhis-selam, Musait. *"Përsa i përket varkës së të varfërve: unë e dëmtova*

*qëllimisht, sepse mora vesh se sundimtari i asaj krahine rrëmbente me forcë çdo varkë pa të meta. Ndaj edhe e prisha, në mënyrë që kur të kalonte pranë saj, ta linte si të dëmtuar. Ama, kur të kalojë njëfarë kohe, pronarët e saj do ta ndreqin dhe do të punojnë si mos më mirë.”*

*“Përsa i përket djaloshit: Prindërit i kish besimtarë, e ky nuk ishte i tillë. Unë e mbyta pasi dashuria e madhe që kishin ndaj tij, në të ardhmen do t'i shtynte në mosbesim, e si mohues do të digjeshin në Zjarr. Unë dëshirova të mirën për ta, për më tepër; në të ardhmen, në këmbim të tij, Allahu do t'u dhurojë një fëmijë më të mirë, besimdrejtë e më të mëshirshëm me ta.”*

*“Ndërsa muri ishte i dy jetimëve. Në themelet e murit ishte e fshehur pasuri e madhe për ta. I gjithë ky nder, për shkak të babës së tyre. Ai ishte besimtar dhe njeri i mirë, ndaj Allahu dëshiron t'ja ruajë fëmijët dhe pasurinë edhe pas vdekjes së tij, që të përfitojnë prej saj kur të rriten. Paramendo sikur banorët e qytetit, koprracët që as një grusht uji nuk na e dhanë ta gjenin thesarin e dy jetimëve! A e kuptove tani, apo jo? O biri i Imranit, tërë këtë, nuk e kam bërë sipas mendjes sime, por me udhëzimin e Zotit... Ja pra, ky është shpjegimi i gjithë asaj ndaj të cilës s'munde të durosh.”*

Biri im i dashur! Si mendon ti? A thua Musai, biri i Imranit, udhëtoi kaq gjatë dhe u lodh kaq shumë vetëm për të mësuar se si priset një varkë, si vritet një njeri apo se si ndërtohet një mur prej guri? Sigurisht që jo... I gjithë ky udhëtim ishte si e si të rrënjoset në zemrën e Musait, alejhis-selam, dhe në zemrën e çdokujt që lexon për udhëtimin e tij, bindja se caktimi i Allahut është përplot urtësi dhe prej Allahut nuk buron veçse e mira sado të na duken të habitshme ngjarjet apo historitë... Megjithëse sot nuk kemi Hidrin të na e zbulojë atë çka fshihet pas ngjarjeve që i dëgjojmë apo marrim pjesë në to, kemi “kohën” që pa u ndjerë na shpalos shumëçka nga urtësitë e

caktimeve hyjnore... Ndaj bëj durim dhe ki mendim të mirë për Allahun e Lartmadhërishëm! Ai është burimi i mirësive. Ai është i Urtë dhe i Gjithëditur... Asgjë nuk ndodh rastësisht, as në qiej dhe as në Tokë.

## Vdekja e Musait

Biri im! Meleku i vdekjes u vinte njerëzve haptazi një kohë e një mot. Në këtë mënyrë iu shfaq edhe Musait, alejhis-selam, por ai nuk e njohu. Kur iu afrua papritmas që t'ia merrte shpirtin, i tha: *"Përgjigju Zotit tënd!"*. Musai e goditi me sa forcë që pati dhe ia nxori syrin. Atëherë meleku u kthye tek Allahu dhe i tha: *"O Zoti im! Më ke dërguar tek një njeri i cili nuk dëshiron të vdesë. O Zoti im! Sikur të mos ishte në mesin e të përzgjedhurve të Tu, do ta shqyeja."* Allahu ia ktheu syrin përsëri melekut dhe i tha: *"Kthehu edhe një herë tek Musai dhe thuaj atij që ta vërë dorën mbi shpinën e kaut dhe për çdo qime që të prekë dora e tij le të jetojë edhe një vit!"* Kur iu shfaq meleku për herë të dytë, Musai e njohu. Sapo dëgjoi fjalët e melekut, e pyeti atë: *"E pas këtyre viteve, çfarë do bëhet me mua?"* *"Përsëri vdekja."*- ia ktheu meleku. Atëherë Musai alejhis-selam iu drejtua Allahut me lutje: *"O Allah! O Zoti im! Më afro afër Tokës së Shenjtë, afër Palestinës aq sa të mund të gjuaj një gur."* Sapo iu plotësua dëshira, përsëri iu drejtua Allahut dhe i tha: *"Atëherë, le të vdes tani, o Zot, menjëherë!"* Pas kësaj fjale, meleku ia mori shpirtin e kështu ndërroi jetë Pejgamberi më në zë i benu israilëve, Musai, i biri i Imranit, burri të cilin Allahu e nderoi duke i folur drejtpërdrejt. Paqja dhe mëshira e Allahut qoftë kurdoherë mbi shpirtin e tij fisnik!

## Jusha Bin Nun

Ky fisnik ishte djali i Nunit, birit të Efraimit e ky i fundit bir i Jusufit... Me pak fjalë në venat e tij rridhte gjak Pejgamberi... Qëkur ishte Musai gjallë, Jusha, alejhis-selam, bënte shenjë në mesin e pasardhësve të Jakubit për trimërinë, urtësinë dhe besimin e patundur. Besoj se e kujton se si e ndihmoi Musain, alejhis-selam, në udhëtimin për kërkimin e diturisë dhe se si e përkrahu të Dërguarin e Allahut kur të gjithë ia kthyen shpinën... E mban mend besoj guximin e tij tek nxiti benu israilët për çlirimin e Palestinës nga zgjedha e idhujtarëve?!

Thuhet: para se të ndërronte jetë, Allahu e ka urdhëruar Musain, alejhis-selam, që secilit fis israilit t'i caktojë komandantin, në mënyrë që pas 40 viteve të përgatiteshin edhe një herë për luftë. Allahu i shpalli Musait, alejhis-selam: *"Unë jam me ju! Nëse populli yt do e fali namazin, do e japin zekatin, do besojë pejgamberët e Mi dhe do i ndihmojnë ata, atëherë Unë do ua mbuloj veprat e shëmtuara në këtë botë, ndërsa vendbanim në Ahiret do të kenë Xhennetet ku rrjedhin lumenjtë të kulluar. E kushdo që edhe pas kësaj nuk do besojë, ai do të jetë përherë i devijuar."* Allahu i Lartësuar e urdhëroi Musain, alejhis-selam, që t'i shënonte në një regjistër të madh emrat e të gjithë israilitëve të aftë për luftë dhe e udhëzoi që Jushain ta bënte komandant të fisit të tij. E ndërkohë që Musai, alejhis-selam, përgatitej për xhihad, Allahu urdhëroi melekun e vdekjes për t'ia marrë shpirtin, gjë që edhe e bëri. Megjithëse Musai e priste me padurim çlirimin e Palestinës, Lartmadhëria e Tij

kish caktuar që toka e shenjtë të çlirohej nga dora e Jusha bin Nun, alejhis-selam.

## Çlirimi i Palestinës

Pas vdekjes së Musait, alejhis-selam, Allahu ia zbriti shpalljen birit të Nun-it dhe e nderoi me pejgamberi. Ai pasoi rrugën e Musait duke u bërë prijës i popullit dhe kryekomandant i ushtrisë. Gjatë tërë jetës së tij është përpjekur t'a udhëzojë popullin e tij për nga e mbara. Megjithatë, sa herë që përmendet emri i tij, të vjen ndër mend çlirimi i Palestinës... Para se të nisej në luftë, u ngrit në mesin e popullit dhe tha: *"Të bëhen gati trimat për luftë! Ama, mos t'i bashkëngjitet ushtrisë asnjë i sapo-martuar, asnjë burrë që është duke mbuluar shtëpinë dhe as ai që ka blerë bagëti apo deve e pret lindjen e tyre!"* Pasi u mblodhën burrat, u ngrit Jusha e shaloi gjokun, ngjeshi armët, u la shëndenë të afërmve dhe u nis në ballë të ushtrisë. Kuajt iknin si shigjetat e linin prapa një re pluhuri që ngrihej në udhë. Jusha nxitonte të arrinte sa më shpejt në fushë të mejdanit. Zembrën e kishte trime dhe syrin zjarr. Edhe me armikun luftoi si burrë, kush e di se sa shtriu përdhe e sa plagosi. Megjithse lufta që e gjatë dhe e vështirë, benu israilët arritën të çajnë radhët e armikut dhe të rrethojnë qytetin ditën e xhuma. Ama, duke qenë se ditën e shtunë nuk u lejohej lufta (edhe sot e kësaj dite ditën e shtunë e konsiderojnë të shenjtë) Jusha, alejhis-selam, iu drejtua diellit që ishte duke perënduar: *"O diell, ti je i urdhëruar, por edhe unë jam i urdhëruar ta çliroj këtë Tokë."* Pastaj iu lut Allahut të Lartmadhërishëm me këto fjalë: *"O Allah! O Zoti im, ndalma pak diellin!"* Allahu ia pranoi duanë, e ndali diellin në perëndim dhe e urdhëroi hënën që të priste në lindje, derisa përfundoi çlirimi...



## Plaça e luftës

Biri im! Ishte e njohur tek popujt që pasonin Pejgamberët përpara nesh se, sa herë që korrnin fitore dhe mblidhnin plaçkën e luftës, Allahu dërgonte një zjarr nga qielli që i përpinte të gjithë. Kjo dukuri ishte shenjë se xihadi u ish pranuar dhe se shpërblimin në Ahiret e kishin të sigurtë... Mirëpo, kur Jusha e mbodhi plaçkën e luftës, zjarri me të vërtetë zbriti nga qielli, por nuk e dogji dot. Atëherë Pejgamberi tha: *"Dikush nga ju ka vjedhur diçka nga preja e luftës, ndaj le të më betohet dhe të më besatohet kryetari i secilit fis se nuk e ka bërë diç të tillë!"* Ndërkohë që betoheshin dhe i shtrëngonin dorën Pejgamberit, dora e kryetarit të njërit prej fiseve iu ngjit pas dorës së tij. Atëherë Jusha, alejhis-selam, tha: *"Dikush nga fisi i jot ka vjedhur, ndaj le të më betohet dhe të më besatohet secili luftëtar i fisit tënd!"* Tek filluan të besatoheshin, duart e dy apo tre luftëtarëve iu ngjitën dorës së Jusha-it. Pejgamberi i pa shtrembër dhe u tha: *"Ju keni vjedhur, ndaj menjëherë ta sillni ganimetin e marrë!"* Të turpëruar, ata ia sollën një stoli floriri me madhësinë e një kokë lope. Me ta bashkuar me plaçkat e tjera, zbriti edhe një herë zjarri dhe shkrumboi çdo gjë.

O bir! Mos harro se Allahu sheh çdo gjë që veprojnë robërit e Tij, ndaj mos bëj hile e mos mashtro se koritësh në dynja dhe në Ahiret! Ki frikë Allahun kudo të jesh, në mesin e njerëzve a në vetmi! Të jesh i bindur se për çdo vepër sado e vogël qoftë, e mirë apo e keqe, do të llogaritësh!

## Në portat e qytetit

Biri im! Allahu i Lartësuar ua fali gabimet israilitëve dhe ua pranoi xihadin, mirëpo ata përsëri u treguan mosmirënjohës dhe të pacipë. Me rastin e fitores madhështore që korrën me ndihmën e Allahut, israilitët qenë të urdhëruar që,

në shenjë falënderimi ndaj Zotit, të hynin në portat e qytetit kokulur dhe të thonin: *"Hittatun!"* (Na e fal gabimin që kemi bërë kur më parë nuk i jemi bindur Musait për të luftuar.) Në vend që t'i bindeshin urdhrin, shumica prej tyre hynë në qytet me shpinë e me kokën lart. Dhe duke u tallur, në vend të fjalës *"Hittatun"* (Na fal) ata thonin *"Hintatun"* (kokrra). E thyen urdhrin dhe i shtrembëruan fjalët, ndaj Allahu i Lartmadhërishëm u lëshoi murtajën, sëmundjen vdekjeprurëse të panjohur deri atëherë. Murtaja bëri kërdrinë dhe nuk i kurseu të padrejtët prej tyre, megjithatë qyteti u çlirua dhe Jusha qeverisi për shumë kohë me drejtësi në mesin e israilitëve. Ai gjykoj me librin e Allahut, Teuratin, dhe udhëhoqi popullin e tij deri në moshën 127 vjeçare, kur Allahu e ngriti lart shpirtin e tij.

## Kibla

Kur Jusha bin Nun, alejhis-selam, hyri si ngadhënjimtar në Jeruzalem, me vete kish marrë edhe shenjtoren e vlerë prej dërrase. Po ç'ishte kjo shenjtoe? Kush e kish ndërtuar? E ç'vlerë kishte për benu israilët mund të thuash ti?

Thuhet se, Allahu i Lartësuar e kish urdhëruar Musain të ndërtonte një shenjtoe prej dërrase. Përbrenda e kish urdhëruar ta stoliste me mëndafsh, me flori dhe argjend. Shenjtorja duhej të kishte katër dyer dhe në brendësi pllaka flori dhe sermi të pastër. Gjithashtu e kish urdhëruar të gdhendej një sënduk prej druri, dy bërryla e gjysëm të gjatë, dy bërryla të gjerë dhe një bërryl e gjysëm të lartë. Të vishej përjashta e përbrenda me flori të pastër. Në katër cepa t'i vihej nga një hallkë që të mund të bartej.

Biri im, thuhet se kjo shenjtoe i përngjante Qabes. Benu israilët faleshin rreth saj, bënin adhurim përreth dhe ktheheshin

në drejtimin e shenjtores sa herë që bënin dua. Thuhet se kur kërkonin nga Musai të gjykonte për ndonjë çështje, ai hynte në shenjtoje, qëndronte afër sendukut dhe priste shpalljen, që do ishte zgjidhje për çështjen në fjalë. Kuptohet se benu israilëve u qe lejuar zbukurimi i faltoreve me ar e mëndafsh, por ne e kemi të ndaluar diç të tillë, në mënyrë që të mos shpërqendrohet besimtari.

Thuhet se Jusha, alejhis-selam, urdhëroi që shenjtorja të vendosej mbi shkëmbin ku para shumë motesh edhe Jakubi kish ngritur faltoren e tij (nëse e mban mend)... mbi shkëmbin ku në të ardhmen do të ndërtohej Mesxhidu-l Aksa-ja... Por me kalimin e viteve shenjtorja u dëmtua dhe u larguan nga shkëmbi, megjithatë benu israilët vazhduan të faleshin e të luteshin në drejtim të shkëmbit. Thuhet se ky shkëmb ka qenë kible e të gjithë peygamberëve pas Musait, alejhis-selam, deri në kohën e vulës së peygamberëve Muhamedit, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të. Madje edhe vetë Profeti Muhamed, për afërsisht katërmëdhjetë vite është falur në drejtim të shkëmbit. Por pasi bëri hixhretin drejt Medines së Ndrishme, kibla e re për të dhe për të gjithë umetin e tij do të ishte Mesxhidu-l Haram-i, faltorja e parë e ndërtuar për adhurimin e Allahut nga babai i peygamberëve, Ibrahim, paqja e Allahut qoftë mbi të.

## Shemuli

Një ndër disfatat më famëkëqe për israilitët ishte ajo me banorët e Gaza-s dhe Askalan-it. Jo vetëm që humbën betejën dhe u poshtëruan, por humbën edhe sëndukun e shenjtë prej druri, sëndukun ku ruheshin pjesë nga urtësitë dhe diç nga ajo që lanë pas Musai dhe Haruni. Falë bereqetit që Allahu i kish dhuruar këtij sënduku, israilitët përgjatë kohe thyenin sulmet armike, mirëpo kur e humbën, e kuptuan se ditë të vështira priteshin. Madje thuhet se kur e lajmëruan sundimtarin e israilitëve për humbjen e tij, ai u trondit kaq shumë saqë edhe vdiq nga pikëllimi...

Kështu benu israilët mbetën si dhentë pa bari... Sundimtari u vdiq, ndërsa Pejgamber nuk kishte më në mesin e tyre prej motesh. Thuhet se pikërisht në këto kohë trazirash një grua e devotshme, pasardhëse e Harunit alejhis-selam, mbeti shtatzënë dhe e luti Allahun e Lartësuar t'ia dhuronte një djalë... Në kohën e caktuar, gruaja lindi një foshnje ashtu siç e kish kërkuar. Thuhet se e quajti Shemul. Nëna e rriti me dashuri e përkushtim dhe kur foshnja u rrit, ajo e dërgoi në faltore. Djalin ia dorëzoi një dijetari që shërbente në faltore që ta edukonte dhe t'ia mësonte fenë. Kështu pra, ditët u bënë javë, javët u bënë muaj e muajt u bënë vite dhe kaluan shpejt. Shemuli u rrit dhe u bë "nishani" i faltores në dituri, urtësi dhe devotshmërinë ndaj të Madhit Zot. Thuhet se një natë teksa flinte, një zë e zgjoi nga gjumi. I frikësuar iu afrua vendit ku flinte mësuesi i tij. "Mësues i nderuar, a më thirrret ju qëparë?"- iu drejtua Shemuli. "Fli,

fli e mos u merakos!"- ia ktheu me butësi dijetari. Mirëpo, sa herë që i mbylleshin sytë nga gjumi, e dëgjonte zërin. Kush të ishte vallë? Pas pak kohe Shemuli do ta kuptonte se zëri që i thërriste ishte i Xhebrailit Besnik, melekut të nderuar që do t'i zbriste djaloshit shpalljen hyjnore dhe do ta lajmëronte se Allahu e ka përzgjedhur për Pejgamber.

## Sundimtari

Pasi i zbriti shpallja, Shemuli e mori përsipër misionin e pejgamberit dhe u bë bariu i deleve të përhumura të Izraelit. Lodhja, vështirësitë dhe morali i prishur i popullit nuk e ndali Pejgamberin në përhapjen e porosive hyjnore. Me mish e me shpirt e thirri popullin e tij për nga e mbara... Nuk ndalej fisniku... Natë e ditë i thirri israilitët, haptazi e fshehurazi, vetëm për vetëm e grupe-grupe derisa shumica prej tyre iu bindën dhe e pranuan si ferrëfytes. Ato kohë israilitët, të lodhur e të rraskapitur nga disfatat e njëpasnjëshme, kërkuan nga Pejgamberi që t'ua caktonte një mbret në mënyrë që të organizonte ushtrinë e t'i thyente sulmet armike. "Na e cakto një sundimtar që të na udhëheqë e të luftojmë pas tij në rrugën e Allahut!"- i thanë. Pejgamberi, që e njihte mirë tabiatin e popullit të tij, i tha: "Po sikur të mos luftoni nëse u caktohet lufta?" "E pse të mos luftojmë në rrugën e Allahut", thanë ata, "ndërkohë që na kanë plaçkitur tokat e na kanë robëruar bijtë tanë?" Megjithatë, kur iu caktua lufta, shumica prej tyre ia kthyen shpinën dhe nuk e mbajtën fjalën...

"Allahu më shpall se do caktojë si mbretin tuaj Talutin!"- u tha Pejgamberi. "E si mund të bëhet Taluti sundues kur ne jemi më lart se ai?!"- ia kthyen me mendjemadhësi. "Për më tepër, Taluti nuk ka as pasuri sa ne." "Vendimi i takon Allahut", u tha Shemuli, "Ai i ka dhuruar dituri të gjerë dhe fuqi të madhe. Allahu i jep pushtet kujt të dojë. Ai është Mirëbërës dhe

*i Gjithëditur: "Shenjë e kësaj që po u them dhe argument se po flas të vërtetën është sënduku që do t'u kthehet juve," u tha Pejgamberi, "sënduku që do jetë prehje për ju, dhuratë nga Zoti i juaj. Në brendësi të tij do të jenë edhe disa copa nga pllakat e Musait si dhe teprica të ushqimit që u zbriste të parëve tanë nga qielli tek endeshin nëpër shkretëtirë. Atë do ta bartin melekët... Me të vërtetë kjo është një shenjë e qartë për ju, nëse jeni besimtarë."*

Nuk kaloi shumë dhe fjala e Pejgamberit u bë realitet. Një grup melekësh e sollën sëndukun e shenjtë, si shenjë bindëse dhe mrekulli nga ana e të Lartmadhërishmit. Kur u bindën në vërtetësinë e lajmeve që u solli Shemuli, të gjithë u pajtuan që si sundues të vendosnin Talutin, i cili ishte ndër pasardhësit e Ben'jaminut. Në shenjë nderimi, Pejgamberi u lut për sunduesin e ri dhe e leu me vaj të bekuar sipas zakonit.

## *Lufta*

Nisma e parë që ndërmoi Taluti kur u caktua si mbret ishte stërvitja dhe organizimi i ushtrisë. Qëllimi i tij ishte të triumfonte mbi armikun, i cili për gjatë kohë e kishte thyer ushtrinë israilite, u kish robëruar djemtë dhe u kish zaptuar tokat. Kur u përgatitën luftëtarët dhe u bënë gati për marshim, Taluti u doli burrave në ballë dhe u thirri me të madhe: *"Ooo muxhahidë! Pas shumë motesh poshtrimi sot po dalim për luftë. Bëhuni të durueshëm dhe tregoni vendosmëri në përballje me armikun. E dini: Allahu do ju vërë në provë afër lumit, kush pi ujë prej tij, nuk është i denjë për luftë, e kush nuk pi prej tij, veçse një grusht, ai është me mua."* Nga qyteti dolën me mijëra, por nuk i qëndruan besnik mbretit veçse pak prej tyre. Të gjithë pinë nga uji i lumit Jordan gjersa u ngopën, me përjashtim të një pakice. Thuhet se numri i muxhahidëve që kaluan lumin, ishte

i njëjtë me numrin e trimave që morën pjesë në betejën e Bedrit... diç më shumë se 300 burra. Kur mbërritën në fushë-betejë, toka filloi t'u dridhej nën këmbë nga numri i stërmadh i armiqve. Teksa panë ushtritë armike duke vërshuar nga çdo bregore si lumi, disa nga luftëtarët e Talutit e humbën shpresën. *"Ne sot nuk mund të ngadhnjëjmë mbi Xhalutin dhe ushtrinë e tij!"*- thanë të topitur. Mirëpo ata që besonin bindshëm se do të dalin një ditë përpara Allahut qëndruan të patundur si malet... Të vendosur ta falnin jetën për hir të Zotit i jepnin zemër njëri tjetrit, megjithëse ishin shumë pak përballë armikut. *"Mos u frikësoni o burra!",* thirrën me të madhe, *"Sa e sa çeta të vogla, me ndihmën e Allahut, kanë ngadhnjyer mbi ushtritë e mëdha! Allahu është me durimtarët."*

Në kampin armik, në krye të ushtrisë marshonte Xhaluti, trimi legjendar i fisit të amalikasve. Askush nuk kish ngadhnjyer ndaj tij... Sa e sa burra kishin lënë nënat me lot në sy dhe gratë e veja pas përballjes me të. Trupin e kishte të gjatë si lisi, shikimin e luanit dhe muskujt të kalitur nga dyluftimet e lufrat e panumërta. Në kokë mbante një përkrenare prej hekuri të zbukuruar me argjend, prej së cilës i dalloheshin vetëm sytë e mëdhenj, pak nga balli i dalë, hunda dhe goja përmes së cilës ushtonte zëri i tmerrshëm tek ftonte kundërshtarët për dyluftim. Teksa shihnin ushtrinë amalikase që kishte pushtuar horizontet dhe dëgjonin zërin frikëndjellës të Xhalutit tek afrohej dhe kërkonte dyluftim, besimtarët ngritën sytë e duart nga qielli duke e lutur të Lartmadhërishmin t'ia përforconte zemrat me iman e trimëri: *"O Allah, o Zoti jonë! Na bëj të qëndrueshëm, na forco këmbët dhe na ndihmo ndaj jobesimtarëve!"* Teksa Xhaluti marshonte drejt israilitëve, mbreti Talut i nxiste ushtarët e tij për luftë. *"Oooo ushtarët e mi! Oooo trima!",* thirri me të madhe mbreti, *"Kush e vret Xhalutin sot, i premtaj pozitë të lartë si dhe dorën e vajzës sime!"*



Askush nuk bënte përpara, derisa, si për çudi, nga mesi i besimdrejtëve doli një djalosh rreth të trembëdhjetave. Davud i thonin. I shkurtër ishte, me sy si qielli, me flokë të rralla, por me zemër të pastër. Ishte i trembëdhjeti djalë i një familjeje të njohur për trimëri dhe përkushtimin ndaj Zotit. Djaloshi kishte nam të madh në mesin e popullit për devotshmërinë e tij dhe për gjuajtjen me hobe. *"Unë do e mbys Xhalutin!"* - tha djaloshi prerazi dhe bëri përpara. Ushtarët nuk u besonin syve tek e shihnin të marshonte duke shtrënguar në grusht lidhëset prej lëkure që i zgjateshin deri afër shputës së këmbës. E si mund të fitonte djaloshi përballë Xhalutit të armatosur gjer në dhëmbë, me shpatë të mprehtë dhe mburojë të pathyeshme çeliku? Tek ecte sypatrembur drejt armikut, Davudi dëgjoji një zë tek e thërriste: *"Merrmë mua! Merrmë mua se do ta mby-sësh Xhalutin!"* Uli kokën andej nga vinte zëri, kur ja! Për çudi, një gur po i thërriste. E mori gurin me të shpejtë dhe vazhdoi përpara. Por edhe dy gurë të tjerë e thirrën Davudin dhe ky i mori dhe i vendoi njëri mbi tjetrin në trastën e hobes. Kur u afruan krejt pranë njëri-tjetrit, djaloshi rrotulloi me sa fuqi që kishte lidhëset prej lëkure dhe në momentin e përshtatshëm i lëshoi në drejt armikut. *"Bismil-lah!"* - thirri Davudi. Kur ja! Si me porosi të tre gurët, me lejen e Allahut e goditën Xhalutin në shteg të ballit, të vetmen pjesë që e kish të zbuluar. Sikur të ish goditur nga rrufeja, Xhaluti shtangu në vend... As nuk bënte para dhe as prapa...

Ndërkohë që gjaku i rridhte rrëke nga balli, këmbët muskuloze filluan t'i dridhen... Si ishte e mundur? A thua mposhtet Xhaluti me gurë? Jo, jo, veçsa është trulllosur, po do ta marrë veten shpejt? Ndërkohë që mendime të tilla u silleshin ndër mend israilitëve, armiku i pamposhtur u rrëzua njëcopë mbi dhé, siç rrëzohen lisat, duke ngritur rreth trupit pa jetë një re pluhuri. Trimat e Talutit brohoritën nga gëzimi, ndërsa ushtarët amalikas u tmerruan dhe e lanë fushën e betejës. Të frikësuar

ia mbathën me të katra... Nëse një djalosh trembëdhjet vjeçar arriti të mposhte Xhalutin legjendar, ç'mund të bënin burrat e stërvitur për luftë në mesin e tyre, menduan...

Kështu pra, u bë i famshëm Davudi në mesin e israilitëve. Të gjithë e donin dhe e nderonin trimin e paepur. Taluti e përmbushi premtimin: e martoi me të bijën dhe i dha pozitë në mesin e fisnikëve. Sikur të mos mjaftonin këto miresi, Allahu i Lartësuar i dhuroi pushtet, urtësi dhe i zbriti shpalljen përmes Xhebrail Emin-it.

## Davudi

Biri im, besoj e kuptove se heroi i radhës do jetë pikërisht trimi trembëdhjetë vjeçar që vrau luftëtarin legjendar... Ky, pra, është Davudi, alejhis-selam, i biri i Uvejdit, robi dhe i Dërguari i Allahut, sundimtari i Jeruzalemit, stërnip i Jakubit, Is'hakut dhe Ibrahimit.

Davudi, alejhis-selam, njihet në mesin e Pejgamberëve si farkëtar. Me të vërtetë, Allahu i kish dhuruar duarve të këtij Pejgamberi një cilësi të jashtëzakonshme: sapo e prekte metalin e fortë të hekurit, ai zbutej e shkrifohej si të ishte baltë. Me pak fjalë, Davudi, alejhis-selam, përpunonte armë lufte dhe mburoja të hekurta pa pasur nevojë për zjarr, a për çekan. Thuhet se ai ishte i pari që punoi parzmoret prej hekuri dhe prej tij e mësuan këtë zanat kovaçët anembanë... Ai ishte punëtor i palodhur... Çdo ditë, deri në pleqërinë e thellë, punonte. Përherë krah përveshur. Jo vetëm kaq; përditë dilte në pazar dhe shiste armë dhe parzmore. Megjithëse u bë mbret, bukën e gojës e fitonte me djersën e ballit. A nuk është furnizimi më i mirë për njeriun ai që e fiton me duart e veta?! Davudi, alejhis-selam, njihet edhe si asket dhe adhurues i madh. Ai e kishte zakon të flinte gjysmën e natës, të adhuronte Allahun me namaz në një të tretën e saj dhe të flinte në pjesën e mbetur. Mos fol për agjërimin e tij: një ditë po e një jo. E ç'të them për trimërinë e Davudit alejhis-selam: asnjëherë nuk zbrapseej nga ballafaqimi me armikun, por luftonte si luan e dilte, me ndihmën e Allahut, kurdoherë fitimtar... Ky pra është burri të

cilit i Lartmadhërishmi i zbriti Zeburin, librin e shenjtë përplot urtësi. Ky është Pejgamberi, të cilit Allahu ia nënshtroi malet, kafshët e shpendët që së bashku me të ta lavdëronin dhe t'i bënë tesbih Lartmadhërisë së Tij. Sa herë që përlëvdonte Allahun e Lartësuar, krijesat përreth tij e shoqëronin dhe zërrat e tyre jehonin mrekullueshëm: një ngazëllim për zemrën e kujtudo që i binte në vesh. Kur njerëzit dëgjonin jehonën mahnitëse, përkujtonin dhe përlëvdonin Allahun Fuqiptotë. Nuk ka dyshim se kjo ishte mirësi e madhe për Pejgamberin. Ai shpërblehej me sevape të shumta për adhurimin e tij dhe për tesbihun e të gjitha krijesave që e shoqëronin. Thuhet se kaq të ëmbël e kish zërin tek këndonte Librin saqë kushdo që e dëgjonte: xhinët, njerëzit, kafshët dhe shpezët tuboheshin rreth tij të mrekulluar derisa përfundonte. Për shkak të zërit të tij thuhet se edhe lumenjtë e ndalnin rrjedhën dhe të sëmurëve u lehtësohej dhembja ...

## *Për një dele*

Allahu i Lartësuar e caktoi Davudin, alejhis-selam, mbret të benu israilëve, e forcoi mbretërinë e tij, i dhuroi urtësi të madhe dhe aftësinë e gjykimit. Me kthjelltësi gjykonte në mesin e popullit dhe me lejen e Allahut ia qëllonte të vërtetës, ndaj israilitët e çmomin dhe e nderonin mbretin e tyre. Mirëpo, kushdo mund të gabojë, kushdo veç Allahut të Lartësuar, të Urtit, të Gjithëditurit. Allahu asnjëherë nuk gabon, kurrë nuk u bën padrejtësi robërve të Tij, përkundrazi, caktimi i Tij është përplot urtësi e maturi, sado i çuditshëm të na duket neve. A të kujtohet historia e Hidrit? Gjithsesi... t'i kthehemi tregimit tonë. Davudi, alejhis-selam, si mbret, angazhohej pjesën më të madhe të ditës me hallet dhe problemet e popullit. Megjithatë një pjesë të kohës e kish ndarë për adhurim, për t'i thurur lavde Zotit dhe për t'u veçuar me Të. Ibadeti ishte ushqim shpirtëror

për Davudin, sepse i jepte forcë dhe çiltërsi për të gjitha punët e tjera. Mirëpo ç'ndodhi një ditë?

Teksa i Dërguari adhuronte Allahun në mihrabin e tij në brendësi të faltores, dy burra u ngjitën mbi murin e mihrabit. Sapo e panë Pejgamberin duke u falur kërcyen nga lart-poshtë në brendësi të qoshkut ku vetmohej Davudi, alejhis-selam. Veç në këtë kohë mund ta gjeje të Dërguarin pa njerëz rreth e rrotull. Ishte i njohur fakti se në vend-adhurimin e tij nuk e shqetësonte askush, ndaj dy burrat shfrytëzuan rastin... Po kush të ishin vallë se? Mos kishin ndonjë qëllim të keq? Israilitët ishin të njohur për ligësinë ndaj Pejgamberëve... Kur u hodhën papritmas në brendësi të mihrabit, Davudi, alejhis-selam, u frikësua prej tyre. Mirëpo, kur e vunë re trishtimin në fytyrën e tij, dy burrat iu drejtuan me mirësjellje dhe i thanë: *"Mos ki frikë o Pejgamber! Ne jemi dy burra që kemi ardhur për gjykim tek ti, pasi njëri i ka bërë padrejtësi tjetrit. Gjyko, pra, mes nesh me drejtësi dhe na udhëzo në rrugën e drejtë!"* Kur dëgjoji fjalët e tyre dhe e kuptoi pse kishin kapërcyer fshehurazi murin, Davudi, alejhis-selam, u lehtësua disi. Me të vërtetë ai ishte njeri i madh. E përmbajti zemërimin, megjithëse burrat hynë pa leje dhe pa edep në mihrabin e tij. Ai ishte mbret, megjithatë nuk i qortoi dhe as nuk i rëndoi me fjalë. Gjykatës në kuptimin e vërtetë të fjalës: mundohej të gjykonte me drejtësi, i pandikuar nga sjelljet e pahijshme të njerëzve. *"Urdhëro! Fol që ta dëgjoj hallin tënd!"* - iu drejtua Pejgamberi njërit prej tyre. *"Ky burrë është vëllai im",* ia behu njëri, *"ai ka nëntëdhjetë e nëntë dele, ndërsa unë vetëm një... Në vend që të jetë i kënaqur me atë që i ka dhënë Allahu, kërkon me ngulm t'ma marrë edhe timen nën kujdesin e tij."* Davudi, alejhis-selam, duke besuar se vëllezërit nuk gënjejnë ndaj njëri-tjetrit, dha gjykimin e tij pa dëgjuar palën tjetër. *"Ai është treguar i padrejtë me ty, duke të kërkuar delen e vetme që ta bashkojë me kopenë e tij."* - tha Davudi, alejhis-selam. *"Për fat të keq,*

shumica e ortakëve i bëjnë padrejtësi shoqi-shoqit, me përjashtim të atyre që drejt besojnë dhe të mira punojnë. Por sa të pakët janë ata se!” Për çudi, sapo i tha këto fjalë, i Dërguari ra në sexhde. Dy burrat mbetën të habitur: “E ç’pati mbreti?”, mendonin me vete. Davudi, alejhis-selam, e kuptoi se i Lartmadhërishmi e kish sprovuar. Prandaj u përul në sexhde në shenjë pendimi, sepse me të shpejtë dha gjykimin e tij, ende pa e dëgjuar palën tjetër.

Biri im! Dije se Pejgamberët kanë qenë të mbrojtur nga gabimet në kumtimin e shpalljes... Ama edhe Pejgamberët ishin njerëz, e si gjithë të tjerët, edhe ata mund të gabonin. Të gjithë bijtë e Ademit gabojnë, por më i miri i gabimtarëve është ai që më së tepërmi pendohet. Me të vërtetë të Dërguarit mund të gabonin ndonjëherë, por ata ktheheshin menjëherë me pendim, ndaj Allahu ua falte gabimin, ua përmirësonte moralin dhe i dëlirësonte edhe më shumë se ç’ishin para gabimit. Allahu ia pranoi pendimin, ia fali gabimin dhe shpalli: “O Davud! Ne të kemi bërë mëkëmbës në tokë, ndaj gjyko me drejtësi e mos ndiq pasionet tuaja, e të devijosh nga rruga e Allahut. Ata që largohen nga rruga e Allahut i pret dënim i ashpër ngase e kanë harruar Ditën e Llogarisë.”

## Dhuratë e çmuar

O djalosh, Davudi kishte njëqind gra me kurorë. Ama njëra në mesin e tyre shquhej për dituri dhe përkushtimin ndaj të Madhit Zot. Ajo quhej Uria. Nëpërmjet saj Allahu i dhuroi Robit të Tij një ndër dhuratat më të çmuara... Përmes kësaj gruaje Allahu i dhuroi Davudit, alejhis-selam, Sulejmanin, djaloshin që do trashëgonte pejgamberinë, diturinë dhe aftësinë e jashtëzakonshme të të gjykuarit në mesin e njerëzve, mirësi për të cilat do t’i përmendi kur të të rrëfej për historinë e tij. Gjithsesi, Sulejmani ishte një ndër dhuratat më të vyera për

Pejgamberin. Kur të krijosh familjen tënde do ta kuptosh se ç'ndjen prindi tek i sheh evladët e tij të rriten të hajrit. Eh, ç'lumturi për prindin kur evladi pason rrugën e udhëzimit, nderon dhe e mban gjallë emrin e babës në mesin e njerëzve edhe pas vdekjes së tij!

## Vdekja e Davudit

Biri im! Pas një jete plot e për plot me bëma Davudin, alejhis-selam, e kaploi pleqëria. Flokët iu rralluan dhe mjekra iu zbardh, mirëpo në shikimin e tij ende dallohej zjarri i pashuar i trimërisë. I kish mbushur njëqind vite tashmë. Megjithëse mbret, punonte për ditë që të fitonte bukën nga duart e tij. Udhëhiqte israilitët dhe gjykonte me drejtësi në mesin e tyre derisa ia dorëzoi shpirtin Allahut. Po si vdiq ky burrë i shquar? Edhe pse i thyer në moshë mbreti Davud ishte shumë xheloz. Kur dilte nga shtëpia, kyçte dyert në mënyrë që askush të mund të hynte në mesin e familjes së tij, përsa kohë që ai mungonte. Një ditë Davudi, alejhis-selam, u largua duke i lënë dyert e kyçura pas vetes. Por pak para se të kthehej Pejgamberi, një nga bashkëshortet e tij e pa një të panjohur tek qëndronte i heshtur në mesin e dhomës së mbretit. Gruaja nxitoi tek shërbyeset. *"Kush është ai njeri në mes të dhomës mbretërore?"* - pyeti e frikësuar. *"Po si ka hyrë vallë, kur të gjitha dyert janë të mbyllura? Ah, mjerë për ne, do të turpërohem para Davudit!"* Nuk vonoi shumë dhe u dëgjuan kërcitjet e llozëve tek hapeshin. Erdhi mbreti, po ku të hynte se? Sapo hapi derën dhe e vërejt një burrë në mes të sallonit u inatos. *"Kush je ti?"* - iu drejtua rëndë. *"Ai që nuk ia ka frikën sundimtarëve dhe ai për të cilin nuk ka pengesa."* - iu përgjigj me qetësi burri. Kur dëgjoi këto fjalë Davudi, alejhis-selam, sikur u qetësua pak dhe i tha përsëri të panjohurit: *"Atëherë, pasha Allahun, ti je meleku i vdekjes! Urdhëro, pra, unë po i përgjigjem urdhrit të Zotit tim."* Sakaq



meleku ia mori shpirtin dhe Davudi alejhis-selam ra pa jetë në mesin e sallonit mbretëror, në moshën 100 vjeçare. Nuk ka vdekur askush pas Musait dhe Harunit e të ketë qenë më i dashur për israilitët se Davudi, paqja dhe mëshira e Allahut qoftë mbi të. Dita e vdekjes së tij ishte ditë pikëllimi për ta. Populli kishte humbur mbretin e urtë, Pejgamberin fisnik, gjykatësin e drejtë; ushtarët kishin humbur prijësin legjendar ndërsa të afërmit babën shembullor. Thuhet se Davudi ka ndërruar jetë në një ditë të nxehët vere. Me qindra mijëra ishin ata që e përcollën xhenazen e Pejgamberit nën rrezet përvëluese të diellit veror. Kur u lodhën nga vapa, e lutën të birin e të ndjerit, Sulejmanin, që t'i mbronte nga dielli përmes ushtrisë së shpezëve. Ai i thirri shpezët me në krye shqiponjat krahëgjata dhe i urdhëroi të fluturonin lart e lart e t'u bënin hije njerëzve. Me shpejtësi shpezët u mblodhën tufa-tufa nga të gjitha anët fluturimthi dhe u radhitën pranë njëra-tjetrës si të ishin një tendë gjigande mbi kokat e njerëzve. Me të vërtetë diellin e zunë, por zunë edhe anën nga frynte fladi i freskët i veriut. Atëherë të pranishmit iu ankuan edhe një herë Sulejmanit, e ky iu tha shpezëve: "Mbroni njerëzit nga dielli dhe lironi anën nga fryn puhija!" Shpezët iu bindën urdhërit menjëherë. Tashmë njerëzit ecnin nën hije ndërsa fladi ua freskonte trupat. Kjo ishte lamtumira e fundit që i dhanë israilitët Pejgamberin fisnik dhe kjo ishte edhe mrekullia e parë që panë nga pushteti i Sulejmanit, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të dy.

## Sulejmani

Biri im! Pas vdekjes së Davudit, kryetar i israilitëve u vendos djali i tij i dalluar, Sulejmani, alejhis-selam. E kush ishte Sulejmani ?

Sulejmani është Pejgamberi, të cilit i ish dhënë sundimi pa kufi dhe pushteti mbi njerëzit, xhindët, kafshët dhe shpezët. Sulejmani ishte gjykatësi i urtë dhe i matur në fjalët e të cilit Allahu i Lartësuar kish vendosur drejtësinë. Ai pati fatin e madh të rritej në gjirin e një familjeje të bekuar... babë Pejgamber e nënë të dalluar. Prindërit e tij mbollën farën e përkushtimit ndaj të Madhit Zot që në vogëli në zemrën e Sulejmanit. E nxitën të jetë i drejtë dhe syapatrembur. Davudi, alejhis-selam, ishte shembull për të birin. Djaloshi mësoi nga i ati artin udhëheqjes së popullit, mjeshtrinë e dyluftimit dhe aftësinë e gjykimit mes njerëzve. Kaq i mprehtë ishte në të gjykuar sa që shpesh-herë i kuptonte çështjet më mirë se babai i tij... Ja vlen të të permendi dy raste kur u shpalos aftësia e tij e jashtzakonshme e të gjykuarit, ndaj dëgjoji me vëmendje dhe vari "vath" në vesh pasi janë përplot mësimë dhe dobi...

### Ujku

Thuhet se në kohën e sundimit të Davudit, alejhis-selam, dy gra punonin në arë dhe me vete kishin marrë edhe foshnjat e gjirit. Teksa punonin ra ujku si shigjetë dhe në pabesi njëres

prej nënave ia mori foshnjen. Mirëpo, gruaja më e madhe u tregua më dinake se dhelpira dhe në vend që të vajtonte për fatkeqësinë e saj vrapoi me nxitim dhe ia rrëmbeu foshnjen shoqes, jo për ta mbrojtur nga grabitqari, por që ta merrte me vete si fëmijën e vet. Kur mori vesh për ujkun nëna e re vrapoi për tek foshnja, por nuk e gjeti aty... Vrapoi me të shpejtë rreth arës kur ja... shoqja e saj tek nxitonte me foshnje në duar. E arriti me të shpejtë dhe kur e pa foshnjen e saj në duart e shoqes u qetësua zemra e nënës. Iu afrua shoqes, me buzën në gaz e përshëndeti dhe, duke hapur krahët e saj, i bëri me shenjë t'ja jepte foshnjen. Gruaja dinake jo vetëm që nuk ia dha beben, por duke rrudhur vetullat iu drejtua duke i thënë: *"Largohu prej meje! Ky është djali im. Fëmijën tënd e mori ujku."* Vasha e befasur, i tha: *"Çfarë po flet kështu? Ky është djali im. Unë e njoh mirë tim bir, ndaj ma kthe djalin!"* *"Nuk ta kthej."* ia ktheu shoqja-shoqes. *"Ose do ma kthesh ose do të të padis tek mbreti!"* - i tha vasha e trazuar. *"Bëj ç'të duash se foshnjen nuk ta kthej."* - tha gruaja dinake. Në këto kushte nëna e re e ngriti padinë tek Davudi, alejhis-selam. Ai i thirri gratë për gjykim, por akoma pa përfunduar fjalën vasha, shoqja e saj filloi të qante me dënesë. Thuhet se vaji i gruas e preku Davudin. Ai mendoi se vetëm nëna e vërtetë mund të vajtonte kaq shumë ndaj gjykoj se fëmija duhet të ishte i saj. *"Foshnja i takon gruas së moçme!"* - vendosi mbreti. Kur dëgjoi vendimin nëna e re, gati sa nuk vdiq nga pikëllimi. Ama, ajo e mbajti veten dhe menjëherë u nis tek djali i mbretit, Sulejmani, alejhis-selam. Ai kishte nam të madh për kthjelltësi dhe mprehtësi në të gjykuar. Pasi u takua me Sulejmanin dhe ia tregoi historinë e saj, ky urdhëroi që t'ia sillnin shoqen e vashës së bashku me foshnjen e mitur. Gruaja dinake edhe njëherë ia nisi vajit, por Sulejmani nuk u prek nga vaji i saj... A nuk erdhën duke vajtuar edhe vëllezërit e Jusufit tek Jakubi, pasi ia hodhën të birin në pus? Ndërkohë që gruaja dinake qante me dënesë, Sulejmani ia mori foshnjen nga duart dhe urdhëroi t'ia sillnin

një thikë të mprehtë. Me të shpejtë ia sollën e ky pa një pa dy ia vendosi foshnjes tehun e mprehtë në lule të ballit, e tha: *“Çështja është e vështirë për t’u gjykuar, ndaj për të qenë i drejtë po e ndaj foshnjën në dy pjesë, e secila le të marrë gjysmën.”* *“Mos, Allahu të mëshiroftë o princ!”*, tha vasha, *“Mos e bëj se foshnja është i saj!”* Ndërkohë dhelpira i ndali lotët dhe nuk fliste. Atëherë kur mendoi se foshnjën do ta mbante për vete, Sulejmani u ngrit e tha: *“Assesi! Foshnja është i joti! Merre djalin dhe qoftë jetëgjatë e i bekuar!”* Dhelpira u largua me kokën ulur nga turpi dhe nga frika se mos të dënohej nga princi dhe asnjëherë më nuk iu afrua foshnjes.

## Vreshtat dhe delet

Pronari i një are me vreshta u ankua tek mbreti Davud se disa barinj kishin kullotur natën bagëtitë në arën e tij, duke ia shkatërruar të gjithë të mbjellat. Për shkak të dëmit të madh që i kishin shkaktuar pronarit të vreshtave, Davudi, alejhis-selam, gjykoi që të gjithë bagëtitë t’i jepeshin atij si dëmshpërblim. Mirëpo barinjtë nuk u kënaqën me një vendim të tillë ndaj shkuan për gjykim tek Sulejmani. Kur ia shpalosën çështjen princit, ai u tha: *“Si ju ka gjykuar i Dërguari i Allahut?”* Pasi e lajmëruan për gjykimin e të atit, ky u tha: *“Sikur të më jepej mundësia e gjykimin, unë do të gjykoja ndryshe: bagëtinë do ia jepja pronarit të vreshtave, që të marrë prej tyre lesh të butë, qumësht e qengja, derisa barinjtë t’ia lërojnë dhe t’ia kthejnë arën ashtu siç e ka pasur. Pas kësaj bagëtia t’i kthehet barinjtë!”* Ky gjykim i ra në vesh Davudit. I mahnitur nga fjalët e të birit, mbreti e ktheu vendimin e tij dhe u vendos gjykimi i Sulejmanit. Nuk ka dyshim se ky gjykim shpaloste edhe një herë zgjuarsinë dhe mprehtësinë e Sulejmanit, alejhis-selam.

## Kuajt e shpejtë

Allahu i Lartmadhërishëm urdhëron e thotë në Kur'anin Famëlartë: *“Ne i dhuruam Davudit Sulejmanin. Sa rob i mrekullueshëm që ishte, ai pendohej shumë!”*

Pasioni i Sulejmanit, alejhis-selam, ishte lufta dhe kalërimi. Për këtë arsye princi ishte shumë i dhënë pas kuajve. Kush e di se sa kuaj rrace mbante në stallat mbretërore. Me dhjetra shërbëtorë kujdeseshin për ushqimin dhe stërvitjen e tyre. Ditaditës Sulejmanit i ndezej edhe më shumë dashuria për kuajt. Kënaqej kur i shihte tek ngarenin në lëndinë. Vërtetë dukej sikur fluturonin mbi bar. Kaq shpejt vraponin, saqë me një rën këmbë thua nuk e preknin token.

Një ditë, ndërkohë që dielli ish ngjyrosur me të verdhë dhe hija e pemëve në lëndina shrihej mbi bar, Sulejmani kish dalë të shihte kuajt e tij tek stërviten për luftë. Njëri më i bukur se tjetri... trokonin me të shpejtë mbi lëndinë me bishtin përpjetë. Filladi i pasdites ua shpupurishte jelet teksa vraponin përpara si furtuna. Njëri pas tjetrit i afroheshin princit me galop. Sytë u flakëronin, këmbët e para i rrihnin në erë me tërbim e me thundrat e pasme godisnin dheun. Kur hingëllinin me poterë dukej sikur të ftonin për kalërim. Tek mrekullohej me kuajt e shpejtë, koha kalonte pa u ndjerë. Dielli i përflakur tashmë kish filluar të strukej pas kodrave ndërsa princi, i mahnitur, kishte harruar se kohës së ikindisë po i vinte fundi. Në të perënduar kur kodrat e qielli bashkë filluan të digjen, Sulejmani u këndell nga pasioni që i kish pushtuar zemrën. Ama, tashmë ishte vonë. Koha e ikindisë kish kaluar, ndërsa princi i mrekulluar nga kuajt e luftës e kish humbur namazin. *“Ah, i mjeri unë!”*, tha Sulejmani, alejhis-selam, *“Bukuritë e kësaj bote më verbuan dhe më bënë ta harroj namazin!”*

Helm nga mërzia, briti princi me të madhe: “*Mi sillni kuajt! Mi sillni kuajt para meje!*” Sapo ia sollën thuhet se i bëri kurban të gjithë pa përjashtim dhe mishin ua shpërndau fukarejve. Në këtë mënyrë ai e “preu në qafë” pasionin e tij. I penduar për ç’kish humbur iu kthye Zotit të tij me pendim dhe i premtoi, se kurrë më, pas asaj dite nuk do mashtrohej nga kuajt e luftës dhe bukuritë e dynjasë.

I dëlirë nga çdo e metë është Allahu! Atëherë kur Sulejmani alejhis-selam i braktisi kuajt për hir të Zotit, i Lartmadhërishmi i dhuroi *erën*, më të fortë, më të shpejtë dhe më të fuqishme se kuajt. Ajo frynte me furi andej nga dëshironte Sulejmani. Duke zbatuar urdhrat e princit ajo përshkonte rrugë shumë të gjata për një kohë shumë të shkurtër. Për më tepër, *era*, as nuk kish nevojë për ushqim e as për mirëmbajtje...

Bir i dashur! Të jesh i bindur se çfarëdo gjëje të braktisësh për të arritur kënaqësinë e Allahut, Ai do ta këmbëjë me diç më të mirë... Me të vërtetë Zoti yt është i Pasur, Fisnik e Mirëbërës.

## *Sundimi pa kufi*

Pas vdekjes së të atit, Sulejmanin, alejhis-selam, e caktuan mbret të israilitëve. Me të vërtetë ai ishte nishan në mesin e popullit. Që para se t’i zbriste Xhebraili me shpalljen hyjnore e të bëhej Pejgamber, ishte i njohur për devotshmëri, mprehtësi, trimëri dhe kish nam të madh për aftësinë e gjykimit mes njerëzve. Thuhet se Allahu i Lartmadhërishëm në fillimet e sundimit të Sulejmanit, alejhis-selam, e sprovoi robin e Tij me humbjen e fronit mbretëror për disa ditë radhazi, por Sulejmani iu kthye Zotit me lutje e përgjërime, ndaj Hirësia e Tij ia riktheu përsëri pozitën e lartë. Thuhet se në shenjë falënderimi Sulejmani, sapo e rimori pushtetin, urdhëroi të ndërtohej Fal-

torja e famshme e Jeruzalemit mbi themelet që i kish ngritur para qindra vitesh stërgjyshi i tij Israili. Në të ardhmen, ky do ishte Faltorja më e vlerë për israilitët. Pas ndërtimit të Faltores Sulejmani, alejhis-selami, kërkoi nga Allahu pushtet pa kufij... "O Allah, o Zoti im!", iu drejtua me lutje të Plotfuqishmit, "M'i fal gabimet dhe më dhuro pushtet, që s'do e ketë askush pas meje! Ti me të vërtetë je Dhurues i Bekuar!"

Allahu ia pranoi lutjen... Përveç erës, e cila frynte me furi sipas urdhrorit të Sulejmanit duke e bartur drejt viseve të largëta, Allahu i Lartësuar ia nënshtroi xhindët si askujt më parë. Ata punonin të përlulur para tij dhe kur nuk pranonin t'i bindeshin, Sulejmani urdhëronte të lidheshin dy e nga dy me pranga dhe i Plotfuqishmi i ndëshkonte me vuajtjen e zjarrit. Punonin pa pushim atë që dëshironte Sulejmani: tempuj e përmendore, enë të stolisura me forma e madhësi të ndryshme, shatërvane, diga dhe rezervuare ku mblidhej uji i lumenjve. Në mesin e tyre kishte edhe zhytës, detyra e të cilëve ishte të zbulonin e të nxirrnin perla, margaritarë dhe inxhi nga thellësitë e deteve. Për më tepër Allahu i dhuroi Pejgamberit të Tij një burim të çuditshëm, i cili nuk gufonte ujë, porse bakër të shkrirë. Thuhet se ky burim ndodhej në krahinat e Jemenit dhe se bakri që buronte prej tij përdorej për sendërtimin e enëve, statujave, armëve dhe stolive. E të mos flasim për aftësinë e Sulejmanit, alejhis-selam, për komunikimin me kafshë e shpend. Me të vërtetë Sulejmani, alejhis-selam, ishte nga robërit e dalluar të Zotit dhe begatia e Ahiretit për të është shumë herë më mirë.

Transmetohet se Muhamedi, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë përherë mbi të, ka thënë: "Kur Sulejmani e ndërtoi Faltoren e Shenjtë (Bejtu-l-Mukaddes), e luti Allahun t'i jepte tri gjëra. Dy iu dhanë, ndërsa e treta shpresojmë të na jepet ne. Së pari, kërkoi që të gjykonte gjithmonë saktë, drejtë dhe me urtësi. Këtë Allahu ia dha. Pastaj kërkoi pushtet të atillë, që s'do e kishte askush pas tij. Edhe këtë Allahu i Lartësuar



ia dha. Gjëja e tretë që kërkoi ishte që: secili që vjen dhe viziton Faltoren e ndërtuar prej tij për të adhuruar Allahun në brendësi të saj, t'i falen gjynahet dhe të dalë nga Faltorja pa gjynahe si dita kur ka lindur. Ne shpresojmë se Allahu na e ka dhënë neve këtë mirësi." E me të vërtetë, o bir! Profeti na ka lajmëruar se kush udhëton drejt Qabes për haxh dhe e kryen këtë adhurim për hir të të Madhit Zot, kthehet që andej, pa gjynahe, si ditën kur e ka lindur nëna.

## Sulejmani dhe Mbretëresha e Jemenit

Sulejmani, alejhis-selam, trashëgoi nga i ati peygamberinë dhe pushtetin. Atij iu dha çdo gjë që i nevojitej një sundimtari: armatim, ushtri xhindësh, njerëzish, kafshësh e shpëzësh; dituri e madhe dhe aftësi për të dëgjuar e kuptuar gjuhën e çdo gjallesë. Kjo ishte me të vërtetë begati e madhe.

Një herë Sulejmani u nis për ekspeditë me ushtrinë e tij. Xhindët dhe njerëzit marshonin së bashku me të, ndërsa shpezët u fluturonin mbi koka duke i mbrojtur me krahët e tyre nga rrezet e diellit. Secila prej ushtrive kishte komandantin e saj, i cili me kujdes përcillte çdo ushtar nga i pari tek i fundit në mënyrë që askush të mos mbeste pas apo të parakalonte mbretin krenar. Ndërsa ushtria e pafund marshonte, dheu tundej e toka dridhej. Kur po u afroreshin luginës së milingonave, një milingonë erdhi me të shpejtë nga larg. Megjithëse e lodhur nga rruga, e thirri popullin e saj me sa frymë kishte: "O milingona! O milingona, hyni shpejt në banesat tuaja, se po afrohet Sulejmani me ushtrinë e tij dhe ndoshta, ju shkelin pa e vënë re aspak!" Milingona dhe çdo gjallesë tjetër e njihte mirë drejtësinë e Sulejmanit, alejhis-selam, prandaj e justifikoi Sulejmanin duke thënë se mund t'i dëmtonte pa dashje. Mbreti që i printe ushtrisë e dëgjoi fjalën e saj. Atij i pëlqyen shumë fjalët e milingonës dhe kujdesi që tregonte për popullin e vet,

dhe i qeshi buza. Sulejmani asnjëherë nuk qeshte me të madhe, pasi një sjellje e tillë tregon mendjehetësi dhe mungesë edukate... Në shenjë dashamirësie mbreti e urdhëroi ushtrinë të shmangeshin nga trojet e milingonave dhe filloi të lutet: *"O Allah, ma mundëso të jem mirënjohës për dhuntitë që më ke dhuruar mua dhe prindërve të mi! Më ndihmo të bëj vepra të mira që të arrij kënaqësinë Tënde dhe pas vdekjes më bashko me robërit e Tu të çiltër!"*

Bir i dashur! Njeriut nuk i takon të lëvdohet e të mbahet me të madh sado lart të arrijë, por të jetë mirënjohës dhe falënderues, i bindur se të gjitha mirësitë janë dhuratë e të Madhit Zot. Të ndjejë nevojën e madhe që ka për Allahun si dhe t'i shfrytëzojë dhuntitë e Tij në mirëbërje ndaj krijesave të Zotit.

Pasi lanë tokën e milingonave Sulejmani, alejhis-selam, hodhi shikimin nga ushtria e shpezëve, kur ja... pupëza mungonte. Mbreti tregonte kujdes të madh në çështjen e kontrollit të ushtrisë dhe përkushtimit të ushtarëve, ndaj mungesa e pupëzës e trazoi atë. *"Përse nuk po e shoh pupëzën?"*, thirri Sulejmani, *"A mos është larguar dhe e ka braktisur detyrën që ka marrë mbi shpinë? Nëse nuk arsyetohet për largimin e saj do ta dënaj rëndë ose do t'ia pres kokën!"* Megjithëse ishte i prerë, Sulejmani nuk nxitohej të ndëshkonte askënd që thyente urdhrin e tij, pa i dhënë mundësi të arsyetohej...

Pikërisht kështu veproi edhe me shpendin që ish larguar pa leje. Mungesa e pupëzës nuk zgjati shumë dhe ja... fluturimthi erdhi nga larg dhe u përul përpara mbretit. *"O madhëri!"*, iu drejtua Sulejmanit, *"Të kam ardhur me lajme të vërteta nga tokat e Sebe-s. Atje pashë një mbretëreshë që kish gjithçka i nevojitej një sundimtareje. Pashë një mbretëreshë mbi një fron madhështor prej floriri, të stolisur e të zbukuruar me inxhi e margaritarë. Pashë se si ajo dhe populli i saj i përuleshin diellit. Shejtani ua kish hijeshuar idhujtarinë dhe i kish devijuar nga*

rruga e shpëtimit, si e si të mos adhuronin Allahun, i Cili nxjerr sheshit gjithçka fshehet në Qiej e në Tokë. S'ka të adhuruar me të drejtë veç Tij... Ai është Zoti i Arshit madhështor." "Do ta shohim", i tha Sulejmani, alejhis-selam, "se po tregon të vërtetën apo jo!" Pas kësaj fjale mbreti urdhëroi t'i sillej një pergamenë, një penë dhe bojë shkrimi. Me t'ia sjellë u ul dhe po shkruan: "Bismil-lahi Rrahmeni-Rrahim!" Mbasi e shkroi, e palosi dhe vulosi, iu drejtua pupëzës: "Merre këtë pergamenë dhe nis fluturim drejt Sebe-s. Me të mbërritur atje përvidhu në pallatin mbretëror dhe shkresën që ta dhashë t'ia hedhësh mbretëreshës. Mandej fshihu me të shpejtë dhe përgjo se ç'do të thotë!" Pupëza e shtrëngoi letrën dhe u nis fluturimthi... Thuhet se kjo është hera e parë që njerëzit kanë përdorur shpezët si letërshpërndarës...

Thuhet se pupëza u përvodh në dhomën e mbretëreshës, e la pergamenën diku që të dallohej qartë dhe u struk duke pritur përgjigjen. Nuk kaloi shumë dhe u kthye mbretëresha... Belkiza i thonin. Me të hyrë në dhomë, i ra në sy pergamena. E çuditur e mori në duar dhe e shpalosi që të lexonte brendinë e saj. E lexoi me një frymë shkresën dhe menjëherë i thirri këshilltarët e oborrit. Me sa duket, përmbajtja e pergamenës kishte rëndësi të veçantë për mbretërinë. Kur u mblodhën të gjithë rreth saj, Belkiza iu drejtohet e i thotë: "O këshilltarë të nderuar! Më është dërguar një letër, që meriton respekt. Është nga një mbret që quhet Sulejman dhe fillon me Bismil-lahi Rrahmeni Rrahim. Ndër të tjera shkruhet që të mos mbahemi me të madh, por t'i nënshtrohemi hirësisë së tij."

Kur dëgjuan çfarë dëgjuan, në dhomën e mbretëreshës ra heshtja. Të gjithë mbanin kokat ulur të zhytur në mendime... Atëherë Belkiza e theu heshtjen e u thotë të pranishmëve: "O këshilltarë të nderuar! Më këshilloni pra, ç'duhet të bëj mbasi pa ju nuk do marr kurrfarë vendimi!" "Ushtria e jonë është e fortë dhe e guximshme. Ne nuk e kemi frikë mejdanin e bu-

rrave”, thanë njëzëri, “por kjo çështje ju takon ju, o madhëri, ndaj vendosni ju se ç’është më e mira për ne!”

Belkiza e kuptoi se, nëse ishin të vërteta ato që shkruhe-shin, mbretit Sulejman, alejhis-selam, nuk mund t’i kundërvihet askush dhe ushtrinë e tij s’mund ta ndalte asgjë, ndaj edhe një herë iu drejtua parisë duke folur me urti. “O këshilltarë fisnik!”, u tha, “Dijeni se kur mbretërit pushtojnë ndonjë krahinë, pasi e shkretojnë vendin, të parët që poshtërojnë janë fisnikët e sundimtarët... Ja, kështu veprojnë ata! Nëse janë të vërteta fjalët që shkruan mbreti, ushtrisë së tij nuk mund t’i bëjmë ballë.” Përsëri ra heshtja. “Unë mendoj t’i dërgoj Sulejmanit një dhuratë të çmuar që t’ja fitoj zemrën e t’i venitet zemërimi. E po shoh me ç’lajme do na kthehen emisarët.”

U bë gati karvani me emisarë nga Jemeni, me deve e kuaj ngarkuar me ar dhe gjë shumë. Pas më se tetë javë udhëtimi delegatët e Sebe-s mbërritën në oborrin mbretëror të Sulejmanit, të ngarkuar me stoli dhe dhuratat plot. Të dërguarit e mbretëreshës u pritën me nderim dhe respekt. Ata diskutuan kokë më kokë me mbretin, por, sapo e lajmëruan për dhuratat, fytyra e Sulejmanit u vrenjt. “A mos doni t’më bëni për vete me pasuri?”, u tha Sulejmani, “Ajo që më ka dhënë Allahu është shumë më e mirë se dhuratat tuaja. Kthehuni tek mbretëresha e bëjeni me dije se do t’u dërgoj një ushtri të papërballueshme dhe do t’ju përzë nga qyteti të përlulur e të poshtëruar!” Mbreti u zemërua pa masë, pasi ata nuk i ishin përgjigjur ftesës së tij. Emisarët u frikësuan nga fjalët e Sulejmanit dhe me kokën ulur u larguan bashkë me dhuratat andej nga kishin ardhur.

Biri im! Besimtari nuk mashtrohet me lajka dhe me stolitë e kësaj bote, ngase është i bindur se ata s’janë asgjë në krahasim me dhuratat që i Madhi Zot ka përgatitur për të në botën e përjetësisë.

Me të mbërritur në Sebe e lajmëruan mbretëreshën se çdo gjë që shkruhej në pergamenë ishte e vërtetë. E lajmëruan Belkizën për ushtrinë e panumërt të Sulejmanit dhe për vendimin e prerë se do të luftohen derisa të pranojnë islamin e t'i përuhlen Allahut Fuqiptotë... Kur mori vesh për ushtrinë e pamposhtur dhe për përgjigjen e të Dërguarit të Allahut, asaj nuk i mbeti tjetër veç të nënshtrohej ndaj sundimit të tij. Tuboi fisnikët dhe së bashku me ta u nisën nxitimthi, të takojnë Sulejmanin...

Më të marrë vesh se po vinte delegacioni me në krye mbretëreshën, i Dërguari u tha xhindëve të përuhur rreth tij: *"O prijës! Cili prej jush mund të ma sjellë fronin e Belkizës para se të vijë delegacioni për t'u nënshtuar?" "Unë do ta sjell!",* tha njëri nga xhindët, *"Madje, para se të ngrihesh nga vendi! Unë jam i fortë dhe besnik."* Me të dëgjuar këto fjalë u ngrit e foli njëri nga komandantët që kish njohuri të thellë nga Libri. *"Unë ta sjell sa hap e mbyll sytë, o madhëri!"* E me të vërtetë, pas një përpëllitjeje të qepallave froni madhështor iu bart nga Jemeni në Jeruzalem. Sulejmani mbeti i mrekulluar. *"Kjo është dhunti nga Zoti im..."*, tha i Dërguari i Allahut, *"Ai po më sprovon mua se a do jem mirënjohës apo mendjemadh. E kush falënderon, për vete e ka... E kush tregohet mendjemadh, për vete e ka... Allahu është i Pasur e s'ka nevojë për askënd."*

Bir i dashur! Sulejmani, alejhis-selam, nuk u mashtrua nga pushteti dhe forca absolute siç bëjnë sundimtarët sot, por e kuptoi se ishte në sprovë, ndaj frikësohej se a do t'ia jepte hakun mirënjohjes ndaj të Madhit Zot. Mbreti ishte i bindur se mirënjohja ndaj Allahut sjell shumimin e të mirave.

Para se të mbërrinte Belkiza dhe shpura e saj, Sulejmani urdhëroi që froni i saj të ndryshohet. Fjala e mbretit ishte urdhër, ndaj një grup mjeshtrash iu dhanë punës me të shpejtë. I ndërruan margaritarët dhe inxhitë me perla e rubinë, e stolisën me diamante vezullues dhe e përpunuan me finesë. Kur mbërriti

delegacioni nga larg, u pritën me nderime ashtu siç u takon mbretërve. Nën shoqërinë e shërbyesve të oborrit, mbretëresha dhe shpura e saj vizituan pallatin mbretëror. Vizitorët mbetën të mahnitur nga gjithçka panë. Belkiza mendonte se perandoria e saj kishte arritur majat e zhvillimit, por kur pa atë që pa nga arritjet e muslimanëve e kuptoi se atyre u ish dhënë dituri e madhe dhe përparimi i tyre nuk kish të krahasuar.

Mandej delegatët u takuan me mbretin Sulejman, alejhis-selam, i cili i priti fisnikërisht. I dëgjoji me vëmendje fjalët e tyre dhe filloi t'u flasë mbi fenë e drejtë. Me urtësi ua shpalosi dinin islam. Aq bukur u foli, sa fjalët e mbretit goditën zemrat dhe shumë prej tyre e pranuan islamin. Pas bisedës me mbretin, të pranishmit me në krye madhërinë e tij, u nisën drejt sallës me zymrydë të lëmuar. Rrugës për atje, Belkizës i mbetën sytë tek një fron madhështor që i kujtonte arshin e saj. Sulejmani e vuri re habinë e mbretëreshës, ndaj me buzën në gaz e pyeti: *"Pse po habiteni mbretëreshë? Mos ju duket si froni i juaj?"* *"Mu bë sikur të ishte ai, o mbret!"* - ia priti ajo.

Përgjigjia e kujdesshme e mbretëreshës i pëlqeu Sulejmanit. Ajo nuk tha se ishte ai, pasi e kishin ndryshuar, por as nuk tha se nuk ishte ai, mbasi e njihte mirë fronin e saj. Fjala e saj tregonte qartë mprehtësinë dhe urtësinë e Belkizës... Mbretëresha ishte një grua mjaft e zgjuar dhe e matur, e aftë të dallonte të mirën nga e keqja, urtinë nga e kota, por bestytnitë ia kishin verbuar zemrën, derisa i erdhi drita e udhëzimit. Vazhduan rrugën dhe ja... mbërritën tek salla e famshme. Dyert gjigande u hapën e ç'të shihje! Mure të larta prej zymrydi, kollona kallkan prej mermeri të kulluar, dysheme me pllaka të tejdukshme xhami, poshtë së cilës rridhnin burime të kthjellët ku lëvrinin pa pushim tufa me peshq me lloj-lloj ngjyrash. Në fund të sallës gjigande ngrihej një fron përrallor. Kur iu dha leje të hynin, Belkiza e mrekulluar përvoli petkat që të mos i lageshin nga burimi që gurgullonte pa pushim, por rojet e sallës

e lajmëruan se dyshemeja ishte e shtruar me pllaka xhami të lëmuar dhe uji nuk kish se si të prekë petkat e as këmbët e saj. Megjithatë ajo nuk refuzoi të bënte përpara, mbasi ishte e bindur se ky mbret fisnik e kish ftuar për ta nderuar dhe se asgjë e keqe s'do t'i ndodhte. Pas gjithë mrekullive që pa me sytë e saj, ajo e kuptoi se muslimanët kishin arritur majat e zhvillimit dhe se dituria e madhe që u ish dhënë besimdrejtëve ishte me të vërtetë pafund. *"O Zoti im!",* tha mbretëresha, *"Unë i kam bërë padrejtësi vetvetes, tash e pranova besimin e drejtë dhe së bashku me Sulejmanin i nënshtrohem Allahut, Zotit të botëve!"*

Eh mor bir, për sa kohë që muslimanët e njihnin dhe e pasonin me përpikmëri islamin, arritën majat e zhvillimit. Ama, kur e braktisën fenë, u venit fama dhe dituria e tyre.

Thuhet se, pasi e pranoi Islamin dhe u bë muslimane, Sulejmani, alejhis-selam, u martua me mbretëreshën e Sebe-s, të cilën e bëri mëkëmbëse të Jemenit. Për shumë kohë Belkiza udhëhoqi me drejtësi dhe maturi vendasit, që e donin dhe e nderonin sunduesen e tyre. Thuhet se Sulejmani e vizitonte çdo muaj, qëndronte tek ajo tre ditë, mandej kthehej në Jeruzalem brenda dite mbi qilimin e tij që e barte era.

## *Vdekja e Sulejmanit*

Në kohën e Sulejmanit, alejhis-selam, shejtanët i kishin mashtruar njerëzit dhe u kishin thënë se ata shihnin të ardhmen dhe çdo gjë që do të ndodhte. Këto fjalë u përhapën me të shpejtë dhe morën dhenë derisa i ranë në vesh mbretit. Kur dëgjoi për shpifjet e tyre, Sulejmani, që asokohe kish arritur pleqërinë, ngriti duart kah qielli dhe u lut: *"O Allah! O Zoti im, fshihja vdekjen time shejtanëve, në mënyrë që njerëzit ta marrin vesh se shejtanët nuk e njohin gajbin (të fshehtën)!"*



Thuhet se, pak para se të vdiste, Sulejmani duke ecur rrugëve të Jeruzalemit pa një fidan të veçantë. Iu afrua dhe e pyeti: *"O fidan, si quhesh?"* *"Harub, Harub quhem, o mbret fisnik."* - ia ktheu fidani. *"E përse je krijuar?"* - e pyeti sërish Sulejmani. *"Kam mbirë që ta rrënoj Faltoren e Jeruzalemit."* - tha fidani. Kur dëgjoi fjalën e tij, Sulejmani, alejhis-selam, u krodh në mendime... *"Allahu më ka premtuar se nuk do ta rrënojë Faltoren dhe as mbretërinë time për sa të jem gjallë. Si duket, ky fidan po më lajmëron se vdekja më është afruar dhe se Faltorja do të rrënohet shpejt pas vdekjes sime."* - tha me vete mbreti. Atëherë Sulejmani e shkuli fidanin, e latoi, e la të thahej dhe e përdori si bastun. Ky bastun iu bë shok i pandarë mbretit. Në shoqërinë e tij ecte, përkrah tij falej dhe mbi të mbështetej tek qëndronte mbi arshin mbretëror.

Asokohe shejtanët vazhdonin të punonin për Sulejmanin, alejhis-selam, duke përmbushur më përpikmëri çdo urdhër të tij... Mirëpo nuk kaloi shumë kohë dhe mbreti fisnik, i ulur mbi arsh, dha frymën e fundit. Allahu e pranoi lutjen e Pejgamberit. Sulejmani famëmadh ndërroi jetë i mbështetur mbi bastun, në mënyrë që njerëzit ta zbulonin gënjeshtren e shejtanëve.

O bir, dije se Allahu ka caktuar që trupat e pejgamberëve të mos prishen dhe as të tjetërsohen pas vdekjes, madje, edhe nëse varrosen, dheu e ka të ndaluar të prishë trupat e tyre. Kjo ndodhi edhe me Sulejmanin, megjithse i vdekur tashmë, trupi i tij dukej si i gjallë. Kështu, sa herë kalonin pranë sunduesit dhe e shihnin të mbështetur mbi bastun, shejtanët mendonin se ishte ende gjallë dhe e kishin frikë.

Mirëpo, kush ua zbuloi atyre vdekjen e mbretit? Askush tjetër pos një krimbi, i cili ditë pas dite hante brendinë e bastunit ku mbështetej Sulejmani. Thuhet se një vit pas vdekjes së mbretit, shkopi u thye dhe trupi pa jetë u rrëzua. Atë ditë shejtanët u çliruan nga prangat dhe u përhapën të lirë.

Gjithsesi, e vërteta doli në shesh dhe njerëzit e kuptuan se shejtanët nuk e njihnin gajbin (të ardhmen). Sikur ta dinin gajbin, atëherë do të dinin edhe për vdekjen e Sulejmanit që e pritnin me padurim, që të shpëtonin nga vuajtjet dhe mundimet.

Biri im! Askush në qiej dhe as në Tokë nuk e di të fshehtë, përveç Allahut dhe as nuk e dinë se kur do të ringjallen. Vetëm Allahu zotëron çelësat e fshehtësive. Ai ka njohuri për gjithë çfarë ka në qiej e në Tokë, për gjithë çfarë ka midis tyre dhe për gjithë çfarë fshihet nën dhe. As edhe një gjethë nuk bie pa dijeninë e Tij. Vetëm Allahu e di kur do të bëhet Kijameti dhe kur do zbresë shiu. Ai e di se ç'bartin mitrat e nënave. Askush nuk e di se ç'do t'i ndodhë nesër dhe as se në ç'vend do vdesë. Allahu është i Gjithdituri që di mirë çdo fshehtësi. Si i tillë, Ai është i Vetmi që meriton të adhurohet me të drejtë... I lartësuar pra, qoftë Zoti jonë, Zoti i plotfuqishëm! Ai është i dëlirë nga çfarë e përshkruajnë ata. Paqja dhe çdo mirësi qoftë mbi të Dërguarit e Tij. Dhe të gjitha lavdërimet qofshin për Allahun, Zotin e Gjithësisë!

## Sha'j-i dhe Hizekiu

Biri im! Kam lexuar në librat e historisë se pas vdekjes së mbretit Sulejman, alejhis-selam, djali i tij, Ruhbuami, ka sunduar për shtatëmbëdhjetë vjet mbretërinë e Izraelit. Me vdekjen e tij, sundimin e morën burra të shquar një pas një, por ia vlen të përmendet emri i Hizekiu. E kush ishte Hizekiu mund të pyesësh me të drejtë? Hizekiu nuk ishte Pejgamber, por njeri i drejtë dhe besimtar i devotshëm. Asokohe Allahu i Lartësuar i kish zbritur shpalljen Sha'j-it, të birit të Emsi-t, e ky ishte këshilltar besnik i mbretit. Ama edhe mbreti e donte Pejgamberin, ndërsa fjalën e tij e kish fort të vyer. Hizekiu e kish krahu të djathtë Pejgamberin dhe i nënshtrohej çdo urdhri a ndalese që i jepte Sha'j-i. Mirëpo me kalimin e viteve mbreti u sëmur rëndë dhe, kur shëndeti i tij u përkeqësua, kah Jeruzalemi nisi marshimin ushtria e Babilonisë me në krye mbretin Senharib.

Sapo u erdhi lajmi i kobshëm, israilitët u tmerruan, ndërsa mbreti e pyeti Pejgamberin: *“Çfarë të ka shpallur Allahu për Senharibin e ushtrinë e tij, o i Dërguar fisnik?”* *“Për të asgjë nuk më është shpallur, o mbret i drejtë, ama për ty po... dije se të është afruar vdekja, ndaj bën mirë të caktosh trashëgimtarin e mbretërisë.”* - ia ktheu Pejgamberi. Kur dëgjoi fjalën e tij, mbreti u kthye kah kibla, u fal dhe u lut me sy të përplotur e zemër të penduar për falje e mëshirë. Thuhet se Allahu ia pranoi lutjen e tij, e mëshiroi dhe i shpalli Sha'j-it ta përgëzonte se Zoti ia ka shtyrë vdekjen edhe për pesëmbëdhjetë vite dhe

se do ta shpëtonte nga armiku. Kur e lajmëroi Pejgamberi për këtë, Hizekiu-t iu venit dhembja, iu zhduk lodhja dhe pikëllimi, ndaj sërish ra në sexhde falënderimi: *"O Allah, Ti i jep pushtet kujt të duash dhe ia merr atë kujt të duash. Ti lartëson kë të duash dhe poshtëron kë të duash. Ti e di të tashmen dhe të ardhmen. Ti je i Pari pa fillim dhe i Mbrami pa mbarim... Ti je Ai, i cili i përgjigjesh dhe e ndihmon nevojtarin."*

Pas kësaj Allahu zbriti vdekjen mbi ushtrinë e Babilonisë që ish afruar krejt pranë trojeve të Palestinës. Vdekja e zezë i gllabëroi të gjithë, përveç Senharibit dhe pesë burrave në mesi e të cilëve ishte Nabukodonosori, trimi që do bëhej në të ardhmen kryekomandant i ushtrisë babilonase. Pasi ushtrinë babilonase e përpiu e zeza, mbreti dhe pesë burrat me të u zunë rob nga israilitët. Hizekiu urdhëroi t'i tërhiqnin të prangosur anembanë qytetit e pastaj të burgoseshin të poshtëruar dhe ashtu u bë. Por jo shumë kohë pas burgosjes së tyre, Allahu i shpalli Sha'j-it që ta urdhëronte mbretin që t'i lironte e të ktheheshin andej nga kishin ardhur në mënyrë që të zinin mend babilonasit.

Thuhet se kur u kthyen, Senharibi tuboi këshilltarët e oborrit dhe i njoftoi për vdekjen e zezë që kish përpirë trupat e ushtarëve. Atëherë dijetarët e pallatit u ngritën e thanë: *"A nuk të kemi folur për Zotin e tyre?! A nuk të thamë se Zoti i tyre është i Plotfuqishëm, ndaj askush s'mund t'i dëmtojë israilitët?! Por ti s'na dëgjove, ndaj edhe ndodhi me ju ajo që ndodhi!"* Në këtë mënyrë frika u hyri deri në palcë babilonasve dhe për vite me rradhë as që kaluan rrugëve që të çonin në Palestinë...

Mirëpo 15 vitet fluturuan dhe Hizekiu ndërroi jetë. Pas vdekjes së tij, në mesin e israilitëve u përhap shthurja dhe paturpësia. Asokohe Allahu i shpalli Sha'j-it, dhe ai doli në mesin e popullit dhe filloi t'i këshillonte e t'i frikësonte me dënimin e Allahut nëse nuk i ktheheshin të mbarës dhe nuk i zbatonin ligjet e Zotit. Mirëpo ata nuk ia vunë veshin paralajmërimit dhe thuhet se e vranë Pejgamberin...

## Rrënimimi i Izraelit

Biri im! Kur benu israilët u dhanë pas gjynaheve, Allahu i Lartësuar i dërgoi shpalljen njërit nga më të devotshmit në mesin e tyre. Eremij quhej... Eremij, i biri i Halkiut. Asokohe israilitët kishin kaluar çdo kufi: sundimtarët nuk i frikësoheshin më Ahiretit dhe as që pyesnin më për Pejgamberët, dijetarët shtrembëronin porositë e Teuratit në këmbim të argjendit e floririt, të devotshmit i braktisën tempujt dhe sinagogat. Ndëkohë populli i thjeshtë u zhyt në errësitat e devijimit dhe dëshirave të liga. Në këto kushte u ngrit Pejgamberi dhe po i thërret israilitët në rrugën e mbarë, duke ua tërhequr vërejtjen, mirëpo askush nuk ia vuri veshin ... madje u tallën me të. Megjithatë Pejgamberi fisnik nuk u tërhoq dhe as u ligështua, por përsëri ua tërhoqi vërejtjen. *"Nëse nuk i ktheheni rrugës së të parëve tuaj", u tha Eremiu, "Allahu do t'u dërgojë një pushtues të pamëshirshëm me ushtri të panumërt sikurse retë e zeza. Ushtria e tij do të vërsulet mbi ju si shpend grabitqar, duke bartur flamuj që valëviten si krahët e shqiponjës. Ata do t'i rrënojnë tempujt deri në themel dhe do shfarosin të gjitha vendbanimet. Mjerë për Jeruzalemin dhe banorët e tij nëse nuk heqin dorë nga e liga dhe harami!"*

Kur e dëgjuan mesazhin që ua përcolli i Dërguari, u ngritën kundër tij, e kërcënuan, e përgënjeshtroan dhe e akuzuan duke i thënë: *"Me të vërtetë ti po gënjen, po trillon për Allahun atë që s'e ka thënë askush para teje. Ne jemi të përzgjedhurit e Allahut. Ne jemi pasardhës Pejgamberësh. Në duart tona ndodhet Teurati, libri i Allahut. Pastaj kush mund ta adhurojë Allahun nëse shkatërrohen tempujt dhe digjet libri? Me të vërtetë ti po shpif një gënjeshtër të madhe!"* Pas kësaj, e rrëmbyen Eremiun, e lidhën këmbë e duar me pranga dhe e burgosën.

## Nabukodonosori

Bir im! Nese njerëzit nuk përmirësohen, atëherë Allahu zemërohet dhe kur zemërohet, Ai dënon ashpër dhe asgjë nuk mund ta ndalë dënimin e Tij! Dëgjo se ç'ngjau me benu israilët!

Kur e tepruan në të keqe dhe e burgosën të Dërguarin e Allahut, i Lartmadhërishmi u lëshoi tmerrin... Kundër tyre u lëshua Nabukodonosori. Për javë të tëra ai dhe ushtria e tij rrethuan Jeruzalemin. Pasi e patën të pamundur t'i bënin ballë rrethimit, israilitët e tmerruar u detyruan t'ua hapnin portat e qytetit me shpresën se do të mëshiroheshin... Por komandanti babilonas u soll ndaj tyre si bishë e egër. U vërsul me kalorësit e tij dhe bëri kërدينë: Faltoren e shenjtë e rrënoi, luftëtarët i mbyti pa mëshirë, të rinjtë i skllavëroi, ndërsa të rejat mori robina; tokën e shkretoi, shtëpiat i prishi dhe librin e shenjtë e dogji. Kështu pra: këngët u lanë vendin klithmave, kandilat luksoz u lanë vendin tymit të zi, mirëqënia u shndërrua në skllavëri dhe siguria në frikë e tmerr. Nabukodonosori hyri në Jeruzalem, shkretoi Shamin dhe shfarosi më shumë se një të tretën e izrailitëve...

Mirëpo para se të largohej, i qe thënë se në mesin e tyre ishte një burrë, i cili ua kishte tërhequr vëmendjen popullit për ardhjen e babilonasve, ua kishte tërhequr vëmendjen për të zezën që i pret, por ata e kishin përgënjështuar dhe e patën burgosur. Thuhet se kur i dëgjoji këto fjalë, Nabukodonosori urdhëroi që Eremiu të nxirrej nga burgu dhe të sillej para tij. Me ta sjellë, komandanti e pyeti: *"A është e vërtetë se ti e ke paralajmëruar popullin tënd për ardhjen time?"* "Po." - u përgjigj Pejgamberi. *"E nga e dije ti?"* - e pyeti përsëri komandanti. Eremiu u përgjigj: *"Allahu, Zoti im më ka lajmëruar, por ata më quajtën gënjeshtar."* Në bisedë e sipër Allahu i Lartësuar ia zbuti zemrën Nabukodonosorit e ky përsëri iu drejtua Pej-

gamberit me dashamirësi: *“Nëse ke dëshirë, rri pranë meje dhe do jesh i nderuar, e nëse do, kthehu në atdheun tënd e unë të premtoj siguri të plotë.”* Eremiu përzgjodhi kthimin në atdhe dhe u nis drejt Jeruzalemit. Në periferi të qytetit, rreth tij, u tubuan israilitët, të cilët e njohën mirë të Dërguarin e Allahut. *“O i Dërguar!”*, i thanë, *“Ne me të vërtetë e kemi tepruar në të zeza dhe padrejtësi, ama jemi penduar, jemi penduar, ndaj lute Allahun të na falë dhe të na mëshirojë!”* *“Nëse thonë të vërtetën”,* i shpalli Allahu Eremiut, *“le të qëndrojnë me ty dhe mos ta braktisin qytetin!”* Kur iu kumtoi shpalljen, ata ia kthyen: *“E si mund të qëndrojmë në një qytet të rrënuar në themel, ku nuk ka kurrëfarë mirësie?!”* Kështu e refuzuan përsëri Eremiun dhe grupe-grupe u shpërndanë nëpër botë... disa u vendosën në Hixhaz, disa në Medine, disa në Egjipt, disa u shpërngulën në lindje e disa në perëndim duke e braktisur urdhrin e Pej-gamberit dhe tokën e shenjtë të Jeruzalemit.

## Pas 100 vitesh

Thuhet se Allahu Fuqplotë i pat shpallur Eremiut: *“Unë do ta rindërtoj Jeruzalemin, ndaj shko dhe vendosu atje!”* I Dërguari iu bind urdhrin por, me të mbërritur në qytetin e shenjtë, nuk u besonte syve. Qyteti famëm madh i rrënuar gjer në themel... Tek ecte sokakëve të shkreta pyeste veten: *“Lavdëruar qoftë Allahu! Më urdhëroi të vij në këtë qytet dhe më tha se do ta rindërtojë... e si mund të arrihet diç e tillë?”* Ai nuk dyshonte në Fuqinë e Allahut, porse nga habia i vinin vërdallë lloj-lloj mendimesh...

I zhytur në mendime e kaploi gjumi... E çfarë gjumi sel! Gjumë 100 vjeçar.. as më shumë e as më pak... Kush e di sa ujëra rrodhën e sa ngjarjet ndodhën gjatë këtyre viteve... Vdiq Nabukodonosori dhe mbreti i madh i Babilonisë. Mbretërinë e trashëgoi Beshtasibi, i cili, kur mori vesh se në Sham kish



pllakosur vdekja e shkatërrimi, shpalli lajmin se tashmë israilitët mund të ktheheshin edhe një herë në Palestinë dhe se askush nuk do t'i trazonte më. Thuhet se, kur morën vesh për kumtesën e mbretit, filluan të ktheheshin grupe-grupe në tokën e shenjtë. U popullua edhe një herë toka Palestinës. Sundimtar u vendos njëri nga pasardhësit e Davudit alejhis-selam. Beshtasibi e urdhëroi sundimtarin e Palestinës ta rindëronte Faltoren e Sulejmanit, alejhis-selam, dhe të fillonte rimëkëmbjen e qytetit. Ndërkohë që rifilluan ndërtimet, Allahu i Lartësuar e zgjoi nga gjumi shekullor Eremiun. Kur u zgjua dhe pa qytetin e shkretë tashmë të rindërtuar e përplot njerëz, ngriti sytë kah qielli i mrekulluar duke thënë: *"Unë e di se Allahu ka mundësi të bëjë çdo gjë!"*

## Familja e Imranit

Biri im, Allahu i Lartësuar e përzgjedhi Ademin, Nuhun, familjen e Ibrahimit dhe familjen e Imranit mbi njerëzimin mbarë, të gjithë pasardhës të njëri-tjetrit. Allahu dëgjon çdo gjë dhe di çdo gjë. Kohë më parë të kam rrëfyer për historinë e Nuhut e po ashtu për Ibrahimin e pasardhësit e tij. Tashmë radhën e ka familja e bekuar e Imranit... Dëgjo bir! Imrani ishte një nga pasardhësit e Davudit alejhis-selam. Njeri i devotshëm, fjalë-pak dhe urtak, imam në Faltoren e israilitëve. Bashkëshorte kishte Hana bint Fakud-in, e dalluar në mesin e bijave të israilit për moralin e mirë dhe virtytet e larta. Burrë e grua kalonin jetë të thjeshtë, por të lumtur. Megjithatë vitet kalonin e fëmijë nuk kishin... Thuhet se një ditë gruaja e Imranit pa një zog duke ushqyer të vegjlit e vet. Tek e vështronte zogun nënë me ëndje, iu ndez dëshira për fëmijë, ndaj e luti Allahun e Lartmadhërishëm me përgjërime dhe u betua se fëmijën e saj do e dërgonte si shërbëtor në Faltoren e Jeruzalemit... Allahu e pranoi lutjen. Mundim pas mundimi Hana e barti barrën për nëntë muaj dhe në ditën e caktuar e lindi foshnjën e shumëpritur. Por, kur e lindi, u shtang në vend... *"O Zoti im",* tha Hana, *"unë linda vajzë, e vajzat nuk shërbejnë në Faltore!"* Pastaj duke e shtrënguar foshnjën me dashuri ngriti sytë nga qielli dhe u lut: *"O Allah! Sidoqoftë, vajzën time do ta quaj Merjem dhe po të lutem ta mbrosh atë dhe pasardhësit e saj nga shejtani i mallkuar!"*

## Në faltore

Kur u rrit pak dhe e mori veten, Hana e dërgoi vajzën e vogël në Faltore, për të përmbushur betimin e saj. Atje ua be-soi dijetarëve të Faltores, të cilët garonin se kush do e merrte në kujdes vajzën e Imranit. Asokohe, Pejgamber i israilitëve ishte Zekerija alejhis-selam, një urtak i thinjur nga pleqëria. Ai shfaqti dëshirën që të kujdesen për Merjemen meqë ishte burri i tezes së saj, mirëpo dijetarët nuk pranuan. Atëherë hodhën short disa herë, por shorti i binte gjithmonë Zekerijas. E si të ishte ndryshe kur ai ishte më i afërti për vajzën?! I Dërguari i Allahut i caktoi në Faltore një vend të veçantë, ku s'mund të hynte askush pos saj. Kështu pra u rrit vajza e Imranit. Ditën e kalonte mbi libra, ndërsa natën në ibadet. Gjatë gjithë kohës ishte nën mbikqyrjen e Zekerijas. Pejgamberi kujdesej për të sikur të ishte e bija... i mësonte Librat e Shenjtë, sjelljen e mirë dhe virtytet e larta. Për pak kohë Merjemja arriti të zinte dituri të madhe e mos fol për adhurimin e saj. Ajo u bë shembull i mirë në mesin e izrailitëve, aq sa thuhet se ia besuan asaj ruajtjen e çelësave të Faltores dhe hapjen e mbylljen e saj. Me të vërtetë Allahu e kish përzgjedhur në mesin e grave të mbarë botës, ndaj edhe e mëshiroi vashën duke e furnizuar prej nga nuk e priste. Sa herë që kthehej në mihrabin e saj, gjente ushqim të shijshëm, pije të freskëta dhe fruta me bollëk. Kurdo që e vizitonte Zekerija alejhis-selam, shihte në mihrabin e saj fruta të lloj-llojshme. Ama një ditë u befasua si kurrë më parë tek shihte pranë vashës fruta pranverore, ndërkohë që sapo kish hyrë vjeshta. I mahnitur e pyeti Vashën: "Prej nga të erdhën këto fruta, o Merjem?" "Prej Allahut.", u përgjigj vasha, "Me të vërtetë Allahu furnizon pa masë, kë të dojë Ai." Fjalët e vashës ngjallën në zemrën e plakut një dëshirë që e fshihte prej motesh. E ç'mbante të fshehtë vallë?

## Zekerija

Me t'u larguar nga vasha e bekuar, Zekerija, alejhis-selam, shpejtoi për në mihrabin e tij. *"Meqë Allahu e nderon Merjemen me fruta pranvere në kohë vjeshte"*, mendonte plaku, *"ashtu mund t'më nderojë edhe mua me pasardhës në kohë pleqërie."* I fshehur nga sytë e njerëzve, ngriti duart kah qielli e po lutet me zë të ulët: *"O Zoti im! Koka më ndriçon nga thinjat dhe eshtrat më janë dobësuar, por gjithmonë kur të jam lutur, o Zoti im, më ke nderuar. O Allah! Unë friksohem se pas vdekjes sime israilitët do ia kthejnë shpinën fesë dhe do i largohen së mbarës, ndaj ma dhuro një djalë që të trashëgojë pejgamberinë nga unë, megjithëse tashmë jam plak dhe gruan e kam shterpë!"* Teksa lutej, melekët e thirrën: *"Përgëzohu, o Pejgamber! Lajme të mira po të sjellim nga Mbreti i Qiejve e i Tokës: Një djalë i bekuar do të të dhurohet, emrin Jahja do ta ketë, emër të bekuar që askush s'e ka mbajtur para tij! Dituri e gjerë do i dhurohet, njeri i dëlirë do jetë, fe-rrëfyes dhe imam i mirëpunuesve."* *"O Allah!"*, tha plaku i mahnitur, *"Si mund të kem një djalë, ndërkohë që gruaja ime nuk lind, ndërsa mua më ka mundur pleqëria!"* *"Kështu është caktuar, pra."*, ia kthyen melekët, *"Zoti yt ka thënë se kjo punë është e lehtë për Të. A nuk të ka krijuar ty më parë, ndërkohë që s'ishe fare?!"* Me fytyrën që i shkëlqente nur nga gëzimi tha plaku: *"O Zot, ma jep një shenjë që të bindem!"* *"Shenja jote"*, iu tha, *"do jetë se duke qenë shëndosh e mirë, nuk do të mund t'u flasësh njerëzve tre net e tre ditë."* Pas pak gjuha sikur iu mpi edhe pse nuk ishte i sëmurë. E çuditshme ishte se, sa herë dëshironte të lavdëronte Allahun apo të lexonte Librin e Shenjtë, ngërçi i lirohej. Kur e ndjeu shenjën e kërkuar, doli shend e verë nga mihrabi duke u bërë me shenjë benu israilëve të adhuronin Allahun mëngjes e mbrëmje.

## Jahja

Allahu i Lartësuar iu përgjigj lutjes së të Dërguarit të Tij: ia shëroi gruan e cila pas nëntë muajsh nxori në jetë djalin e shumëpritur. Zoti i Madhërishëm i dhuroi djaloshit mençuri dhe urtësi. Jahja u rrit në prehrin e Zekerijas, alejhis-selam, nën hijen e këshillave dhe porosive të babës... i sjellshëm ndaj prindërve, i butë, i dëlirë dhe bujar. Zekerija, alejhis-selam, që punonte asokohe marangoz, e mbante djalin afër. Babai mbolli në zemrën e të birit farën e diturisë, trimërisë e fisnikërisë; rregullin se muslimani punon edhe në moshë të thyer; muslimani e fiton bukën e gojës me djersën e ballit dhe nuk ia shtrin dorën askujt. Që në vogëli Jahja, alejhis-selam, dallonte nga fëmijët e moshës së tij. Thuhet se një ditë prej ditësh fëmijët e benu israilëve i kanë thënë: *"Eja me ne, o Jahja! Eja të luajmë e të dëfrehemi!"* *"Nuk jemi krijuar për lojë."* - iu kthye djaloshi dhe vazhdoi rrugën e tij. E ç'mund të presësh tjetër nga një familje e bekuar?! Ata nuk kalonin kohën me lojëra e dëfrim, por përpiqeshin të bënin sa më shumë të mira dhe i luteshin Allahut, me shpresë e frikë, të nënshtruar ndaj Tij. Bir i dashur! Ndoshta për Jahjan ia vlen të përmendim edhe diç më shumë por, meqë filluam të hedhim dritë mbi historinë e Merjemes, po e përfundojmë rrëfimin e saj një herë.

## Sihariqi

Një ditë, ndërsa Merjemja adhuronte Allahun në qoshkun e saj, dëgjoi zërin e melekëve: *"O Merjeme! Allahu të ka për-zqjedhur ty mbi të gjitha gratë e kohës tënde, ndaj bëhu e bindur ndaj Zotit. Përkulu në sexhde dhe në ruku me ata që bëjnë sexhde dhe ruku."* *"O Merjem!",* i thanë përsëri, *"Allahu të përgëzon ty me një lajm të mirë, me një djalë me emrin Mesih, Isa, biri i Merjemes, i nderuar në këtë botë dhe i afërt*

*i Allahut në tjetrën. Do t'u flasë njerëzve që në djep, por edhe kur të rritet, do jetë mirëpunues. Allahu do t'ia mësojë atij Teuratin dhe do ia zbresë Inxhilin, e pastaj do ta dërgojë Pejgamber tek bijtë e Israilit."* Merjemja e habitur nga ajo që dëgjoi tha: *"O Zot, si mund të kem fëmijë kur asnjë burrë nuk më ka prekur?"* "Ja pra, kështu!", iu tha, *"Allahu krijon ç'të dojë Vetë. Kur vendos diçka, Ai vetëm i thotë "bëhu" dhe menjëherë bëhet."* Megjithëse e çuditur nga lajmi i melekëve, Merjemi u pajtua me caktimin e Allahut duke mos i shkuar në mend se sa shumë do ta lëndonin dhe përgojonin për djalin e saj.

## Xhibrili

Merjemja ishte vashë e dëlirë dhe e devotshme. Gjithë kohën e kalonte brenda Faltores, në lexim dhe adhurim. Nuk dilte nga Faltorja veçse për nevojat e saja dhe për të marrë pak ujë dhe ushqim. Një ditë, teksa doli për nevojat e saja, u tërhoq në lindje të qytetit. Teksa mundohej të gjente një skutë që t'u fshihej syve të njerëzve, pa një burrë me pamje fisnike që i afrohej gjithnjë e më shumë... *"Kërkoj mbrojtje nga Mëshiruesi prej teje, nëse ia ke frikën Zotit!"*- thirri Merjemi. *"Mos ki frikë!"*- ia ktheu fisniku. *"Unë jam i Dërguar nga Zoti yt"*, i tha përsëri, *"që të ta dhuroj një djalë të dëlirë."* *"E si mund të kem unë një djalë"*, tha e friksuar vasha, *"kur nuk më ka prekur askush dhe nuk jam e pandershme?"* *"Kështu do ndodh, pra"*, tha i Dërguari, *"Zoti yt ka thënë se kjo për mua është e lehtë... Ky djalë do jetë mrekulli për njerëzit dhe shenjë e mëshirës Sonë. Kështu ka pasë qenë caktuar që më parë!"* Atëherë i Dërguari fisnik fryu për kah vasha. Fryma e tejkaloi hixhabin e vashës, hyri në trupin e saj dhe ja... Nuk kaloi veçse një moment kur për çudi e mbërthyen dhimbjet e forta të lindjes.

## Lindja e mesihut

Tek largohej nga vend-takimi me melekun, dhimbjet e shtënguan edhe më shumë. Këmbët gati sa nuk iu mpinë, ndaj duke i tërhequr me mundim, u struk nën trungun e një palme. *"Ah, sikur të isha e vdekur tashmë dhe e harruar fare!"*- psherëtiu fisnikja. Vdekjen dëshironte vasha nga frika e turpirt dhe e poshtërimit të familjes së saj. Mirëpo, mbas vështirësisë vijtë lehtësimet... Mundim pas mundimi, Merjemja e nxori në dritë foshnjën e saj.

Bir i dashur! Profeti Muhamed, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin kurdoherë mbi të, na ka lajmëruar se çdo foshnje të sapolindur, shejtani e godet në ije. Vetëm Merjemen dhe birin e saj nuk ka mundur t'i godasë. A nuk ke dëgjuar se si çirren foshnjat kur dalin nga trupi i ngrohtë i nënës? Kështu pra lindi Mesihu, nur i bukur dhe i bekuar, në një ditë të kthjellët vere, nën hijen e palmave. Megjithëse e mori veten shpejt, brenga e përbaljes me popullin e saj ja helmonte zemrën vashës. Mirëpo, mu aty mes vuajtjes trupore dhe ngushtimit shpirtëror, u përfshi nga mëshira e Allahut. Ai e frymëzoi foshnjën e porsalindur dhe si në ëndrra ajo filloi të flasë. Tek e shihte Merjemen të lodhur, e të pikëlluar e thirri dhe i tha: *"Mos u dëshpëro se Zoti yt ka bërë që poshtë teje të rrjedhi një përrua i freskët!"* Vasha nuk u besonte syve... Foshnja e porsalindur të flasë si e rritur... Kjo nuk ish parë dhe as dëgjuar ndonjëherë! Sikur të mos mjaftonte kjo, papritmas krejt pranë saj, nga thellësia e tokës, filloi të gurgullonte një përrua me ujë të kulluar. Befas foshnja edhe një herë iu drejtua vashës fisnike: *"Mos u dëshpëro se përkrah ke një pemë të bekuar. Shkunde trungun e saj, e mbi ty do të bijnë hurma të freskët! Ha prej tyre, shuaje etje me ujë të freskët dhe përgëzohu! Nëse sheh ndokënd, t'i thuash: "Për hir të Zotit tim, jam zotuar se do të hesht dhe me askënd nuk do të flas sot."* Kush e di se sa u mrekullua Merjemja teksa



e dëgjoi të birin duke folur, duke e mbështetur e duke i dhënë kurajo. Atëherë nëna e dëlirë, pasi u çmall me foshnjën, pasi e pastroi dhe e mbështolli, e shtrëngoi fort në gjoks dhe së bashku me të u nis drejt qytetit. Sapo hyri në qytet dhe u nis për nga shtëpia e babës, israilitët e panë dhe iu vunë pas. Kush e shtyu, kush e shau e kush e talli, por fisnikja bënte përpara e nuk u përgjigjej. *“O Merjeme!”*, i bërtitën disa, *“ke bërë diçka të turpshme! O motra e Harunit, prej nga dole ti e tillë! Babai yt s’ka qenë njeri i keq, as nëna jote s’ka qenë e përdalë.”* Kështu e thumbonin me fjalë fisniken dhe ia pengonin rrugën. Në çastin kur situata u acarua sa më s’ka, Merjemja u bëri me shenjë për kah foshnja pasi e dinte mirë se i biri fliste... Mirëpo turma gati sa nuk plasi nga marazi. *“O e pacipë!”*, i thanë me nënçmim, *“A mos po tallesh me ne? E si t’i flasim foshnjës së djepit që akoma s’i është ndarë gjirit?”* Lavdia i qoftë Allahu! Aty për aty, si për inat të ziliqarëve, foshnja filloi të flasë përsëri. *“Unë jam robi i Allahut”,* tha ai, *“Ai do të më zbresë Librin dhe do të më bëjë Pejgamber. Allahu më ka bërë të dobishëm kudo të jem dhe më ka porositur me namaz dhe zekat për sa të jem gjallë! Më ka bërë të sjellshëm ndaj nënës sime, e nuk më ka bërë kryelartë dhe të padëgjueshëm! Selami është me mua ditën kur u linda, ditën kur të vdes dhe ditën kur të ringjallem!”* Veç sikur t’i shihje fytyrat e inatçorëve! Të lemeritur nga gjithçka panë e dëgjuan, zbrapseshin duke shtyrë turmën. Me sy të zgurdulluar hidhnin vështrimet nga njëri tjetri. Goditnin fytyrat me shuplaka dhe vikatnin si të ishin gra të frikësuar. Si është e mundur të flasë foshnja e sapolindur?! Kjo nuk është parë dhe as dëgjuar ndonjëherë! Të afërmve të vashës dhe besimdrejtëve fjalët e foshnjës ia shtuan besimin dhe i gëzuan sa më s’ka... Ndërsa zemërligëve fjalët e foshnjës ia shtuan edhe më shumë dyshimin dhe inatin. Kjo pra është e vërteta rreth Isait, birit të Merjemes në të cilin ata hedhin dyshime. Nuk i takon dhe as nuk ka nevojë Allahu të ketë fëmijë. Qoftë i Lavdëruar! Isai asnjëherë nuk tha se është se është bir

i Zotit, përkundrazi që në djep u foli njerëzve dhe u tha: “Unë jam rob i Allahut.”

## Vitet e para

Bir i dashur! Ti as nuk mund ta imagjinosh se sa e vështirë ish jeta asokohe. Israilitët kishin rënë pre e kësaj bote dhe kishin hedhur pas shpine fenë e baballarëve të tyre: Is’hakut, Jakubit, Jusufit e Musait. Me shekuj ishin të skllavëruar e të shtypur: në fillim nga babilonasit, më pas nga persianët, më pas nga grekët e pas tyre nga romakët. Robërimi i gjatë ua kish zvetënuar zemrat dhe kish mbjellur farën e dyfytërsisë, tradhtisë dhe dinakërisë; të fortëve u nënshtroheshin, ndërsa të varfërit i nënçmonin.

Kur fuqizoheshin bëheshin ujqër, e kur e humbnin fuqinë, qengja të butë. Nga njëra anë mbaheshin me të madh për prejardhjen e tyre, nga ana tjetër kundërshtonin Pejgamberët. Shenjtëronin pasurinë dhe pozitën e lartë, ndërsa mësimet e fesë i konsideronin të kota e pavlerë. Me paturpësi vunë dorë edhe mbi Librin e Shenjtë, mbi Teuratin: e rishkruan Librin e Zotit duke lënë veçse ligjet që u shkonin për shtat. Këdo që i këshillonte për mbarë e shihnin si armik dhe e luftonin, ndërsa armikut të vërtetë ia bënë temenanë. Për shkak të bashkëjetesës me popuj idhujtarë, e përziën besimin e tyre me lloj-lloj bestytnish. Aq larg shkuan saqë e quanin Uzejrin: bir i Zotit. U përhap me të madhe kamata dhe humbi mëshira për të dobëtit dhe të varfërit. Megjithse mynxyrat u përhapën në mesin e tyre, Allahu nuk i dënoi, por u dërgoi një Pejgamber të bekuar, të birin e Merjemes që do i këshillonte për mirë dhe do i thërriste nga e mbara... Isai u rrit në prehrin e një nëne besimtare e të tërhequr nga bota. U rrit me mund e vështirësi, larg krenarisë e pasurisë. Ama, që në vogëli dallonte për zgjuarsin e urtësinë. Thuhet se në moshën shtatëvjeçare, nëna e

tij e dërgoi të merrte mësimet e para në Faltore, mirëpo për çudi fëmija dinte më shumë se mësuesit dhe rabinët... Megjithëse shpejt mori nam të madh dhe u bë nishan i Faltores, shumë nga ziliqarët vazhdonin të shpifnin për të dhe nënën e tij. Mirëpo djaloshi bënte përpara në rrugën e diturisë dhe nuk ua vinte veshin shpifjeve dhe gënjeshtreve... Hajde ditë e shko ditë fëmija u rrit e lëshoi shtat. Të gëzohej syri tek e shihje të hynte në Faltore: me trup mesatar, por shpatullgjerë, ecte me qetësi përmes dijetarëve dhe rabinëve. Krelat e ndritshme i derdheshin supeve, ndërsa fytyra i shkëlqente nur nga bukuria. I buzëqeshur me mësuesit, i mëshirshëm me të dobëtit. E shihje se si shoqërohej me njerëzit e thjeshtë duke mos bërë kurrëfarë dallimi mes tyre dhe pasanikëve. Qysh në djalëri fitoi famë dhe respekt të madh në mesin e të varfërve, ndaj kur u rrit filluan ta përcillnin dhe të dëgjonin me vëmendje mësimet e tij. Fjalën e kishte melhem për plagë. *“O beni israilë!”,* u thërriste, *“adhuroni Allahun, që është Zoti im dhe Zoti i juaj! Atij që adhuron tjetërkënd veç Allahut, Allahu do t’ia bëjë të ndaluar Xhenetin dhe vendstrehim do të ketë zjarrin. Për keqbërësit nuk ka ndihmëtarë.”*

Biri im! Gjatë gjithë jetës së tij deri në vdekje Isai kurrë nuk ka thënë se është Zot apo bir i Tij. Përkundrazi, kurdoherë i thirri israilitët të adhuronin Allahun e Vetëm e të Pashoq, Zotin e tij dhe të tyrin, Krijuesin e Gjithësisë, Mirëbërësin që nuk ka të ngjashëm.

## Mrekullitë

Bir i dashur! Allahu Fuqiptotë secilin Pejgamber e ka nderuar me mrekulli në varësi të kohës kur jetonte. Kështu për shembull mrekullitë e Musait, alejhis-selam, ishin në frymën e kohës kur mbizotëronte magjia dhe sihërbazët. Madje sihërbazët ishin të parët që e pranuan Islamin, pasi ata e dallonin me

lehtësi magjinë nga mrekullia e vërtetë. Ndërsa Isait, alejhis-selam, Allahu i Lartësuar ia zbriti Librin dhe peygamberinë në një kohë kur mjekësia kish arritur majat e zhvillimit. Mrekullitë me të cilat u nderua ai ishin sfidë për mjekët dhe shenja për vërtetësinë e peygamberisë së tij. Po cilat ishin disa nga mrekullitë që iu dhanë Isait, alejhis-selam, mund të thuash ti?

Së pari, shërimi i të verbërve dhe i lebrozëve. Sapo ua fërkonte sytë, me lejen e Allahut, u kthehej shikimi; sapo ua prekte lëkurat, u zhdukej gërbula. Madje thuhet se llagapin "Mesih" e mori me rastin e shërimit të sëmundjeve. Pas këtyre mrekullive njerëzit filluan ta thërrasin "Mesih" - Fërkonjë, Fërkonjësi i bekuar... Këto mrekulli i lanë të shushatur mjekët e kohës së tij, por edhe këto të sotmit. Edhe sot e kësaj dite nuk është zbuluar ilaç për verbimin apo lebrën... Madje edhe nëse një ditë mund ta zbulojnë, asnjëherë nuk mund ta shërojnë të verbrin e as lebrozin me një prekje. Shërimi i të sëmurëve me një fërkim të vetëm, megjithëse nuk e njihte mjekësinë, ishte dëshmi se Isai është i Dërguar i Allahu, pasi vetëm me lejen e Tij mund të arrihej diçka e tillë.

Së dyti, ngjallja e të vdekurve. Biri im, mos harro se Allahu i ngjallte të vdekurit, mirëpo këtë e bënte përmes duarve të Isait që të shërbente si dëshmi për peygamberinë e tij. Kur Isai, alejhis-selam, ishte pranë ndonjë varri, e luste Allahun t'a ngjallte trupin që prehej nën dhé. Allahu i Lartësuar ia pranonte lutjen: dheu dridhej, varri hapej dhe i ndjeri ngrihej duke shkundur pluhurin nga koka sikur të ish zgjuar nga gjumi. Të tregova më parë se asokohe israilitët dyshonin në ringjalljen e Ditës së Gjykimit... nëse nuk e shprehnin me gojë, nga punët e tyre kuptohej një gjë e tillë. Prandaj, ngjallja e të vdekurve ishte dëshmi e jashtëzakonshme që ndizte dritën e besimit në gjokse. Megjithatë shumë prej tyre tregoheshin kryeneçë dhe mohues të mrekullive.

Së treti, krijimi i shpendëve nga balta. Me duart e tij të bekuara Isai, alejhis-selam, i jepte baltës formë shpendi, e linte paksa të thahej, pastaj i frynte dhe menjëherë balta shndërrohej në zog të gjallë e të vërtetë, me lejen e Allahut të Lartmadhëruar. A nuk ishte kjo mrekulli e mrekullive?!

Së katërti: njohja e fshehtësive. Tregohet se, ndërkohë që disa israilitë u venduan e po hanin, Isai nga cepi tjetër i qytetit u tregonte me përpikmëri pasuesve të tij llojet e ushqimeve të shtruara në sofrën e të afërmeve të tyre, sikur të ishte i ulur me ta e t'i kishte para syve. Madje jo vetëm kaq, i lajmëroi edhe llojet e ushqimeve që mbanin të fshehura në banesa... Pas bisedës me Mesihun, të pranishmit nxituan nga njëri cep i qytetit në tjetrin për të provuar vërtetësinë e fjalëve të tij. E kur të afërmit e tyre i rrëfyn se ç'kishin ngrënë e çfarë fshihnin në banesa, israilitët mbetën të mahnitur. Dituria e fshehtësive ishte dëshmi e qartë se Isai është i Dërguar i Allahut, pasi veç Tij askush nuk mund t'ia shpaloste diç të tillë.

Së pesti: memorizimi i Teuratit, Zeburit dhe shpallja e Inxhilit. Bir i dashur! Në kohën kur u dërgua Isai, alejhis-selam, si Pejgamber, librat e shenjtë me në krye Teuratin dhe Zeburin, ishin shtrembëruar nga duart e liga të rabinëve... Çfarë u vyente, e kishin lënë dhe çfarë nuk u vinte për shtat, e kishin zhdukur. Kështu pra, e përzienin të vërtetën me gënjeshtren me qëllim. Prandaj, kur u erdhi Mesihu dhe ua shpalosi Teuratin dhe Zeburin ashtu siç kish zbritur, rabinët gati sa nuk e përpinë me shikimet e tyre dhe thanë: "Ai është vërtetë i marrë!" Sa herë që ua përkujtonte ligjet e Teuratit, mbusheshin me maraz dhe gati sa nuk i vërsuleshin. E mos fol për Inxhilin dhe mësimet me të cilat u erdhi biri i Merjemes.

## Hauarijunët

Biri im! Edhe Isain e goditi gjithë ajo që i pat goditur Pejgamberët para tij: pasanikët i largoheshin pasi ai ndalonte

kamatën që e kishin burim fitimi; fisnikët e nënçmonin pasi ai thirrte për mëshirë ndaj të varfërve e kështu mund të humbnin zotnillëkun, ndërsa rabinët e fyenin sa herë që u jepej mundësia dhe trillonin për nënën e tij lloj-lloj gënjeshttrash pasi Isai i thirri në besimin e vërtetë, në fenë e Musait, Davudit e Sulejmanit... Nuk e pasuan të Dërguarin e Allahut veçse njerëzit e thjeshtë, shpirtmirët, të varfrit, peshkatarët, punëtorët, farkëtarët... ata që nuk mbaheshin me të madh dhe as që kërkonin madhështim në tokë, ata që fitonin bukën e gojës me djersën e ballit. Kur Isai alejhis-selam vuri re mosbesimin e parisë israilite, u bëri thirrje njerëzve të thjeshtë: *"Kush do t'më ndihmojë në përcjelljen e fesë së Allahut?"* Një grup nga pasuesit e tij ia shtrinë dorën për besa-besë. Këta u quajtën *hauarijunë* ndihmëtarët e Pejgamberit. *"Ne do të të përkrahim, o i Dërguar i Allahut. Ne besojmë Allahun, ndaj ti dëshmo se jemi muslimanë të nënshtruar ndaj Tij."* Pastaj ngritën sytë kah qielli dhe thanë: *"O Zoti jonë! Ne besojmë në shpalljen Tënde dhe po e pasojmë të Dërguarin Tënd, ndaj na bashko me të mirët!"* Megjithëse dallgët e egra të vështirësive u përplasën fort mbi shpinat e tyre, hauarijunët duruan dhe e mbajtën premtimin; i zunë mësimet e Pejgamberit dhe u munduan me mish e me shpirt t'i praktikonin dhe t'i përhapnin në mesin e njerëzve edhe pas ngritjes së Isait, alejhis-selam, në qiej. Allahu i Lartësuar mbolli në zemrat e tyre mëshirë dhe butësi, ndaj një grup nga benu israilët i nderuan dhe e pasuan udhëzimin e tyre... Megjithatë shumica e tyre u treguan kryeneçë dhe mohues.

## Murgëria

Biri im! Sa për murgërinë, hauarijunët e sajuan vetë me qëllim që të zhvesheshin nga çdo dëshirë e ulët e dynjasë e t'i përkushtoheshin adhurimit, megjithëse i Lartësuari nuk ua kish caktuar diçka të tillë. Kështu vendosën të bënin jetë të

thjeshtë: larg luksit e salltaneteve, larg ushqimit të lloj-llojshëm e pijeve të këndëshme. E lanë pas dore dëfrimin dhe e braktisën martesën. Mirëpo, me kalimin e moteve priftërinjtë nuk arritën t'u bënë ballë dëshirave, për këtë e shndërruan murgërinë në disa rite shterpë, sa për sy e faqe të botës. Filluan të veçohen nga njerëzit e të vetmohen në manastire, derisa shejtani i shtyu ta braktisin fenë e vërtetë e t'u shkojnë pas dëshirave dhe adhurimit të rrejshëm. Ama, kurrë mos harro, mor bir: i Madhi Zot nuk i vlerëson njerëzit nga pamja e jashtme as nga veshjet e thjeshta, por nga njetet që fshihen thellë në zemrat e tyre. Allahu i njeh mirë fshehtësitë dhe çfarë pëshpërisin zemrat e robërve të Tij.

## Ahmedi

Isai, biri i Merjemes u mundua me sa fuqi pati t'i udhëzonte israilitët për nga e mbara, por ata u mbajtën me të madh, ndaj e merituan mallkimin. Përkujto kur Isai, biri i Merjemes, u drejtohej turmës së israilitëve duke i thënë: *"O bijtë e Israilit, unë jam i Dërguar i Allahut te ju, për të vërtetuar Teuratin e shpallur Musait dhe për t'ju sjellë lajmin e gëzuar për një të Dërguar që do vijë pas meje, me emrin Ahmed."* Ua përshekroi këtë të dërguar sikur ta kishte para syve dhe i thirri ta pasonin udhëzimin e tij... Bamirësinë do të kishte shenjë dalluese, nënshtrimin ndaj Zotit si qëllim dhe të vërtetën do ta kishte të vulosur në gjuhën e tij. Në fakt, që prej kohësh, israilitët ishin lajmëruar për ardhjen e Ahmedit... edhe Musai i kish lajmëruar për ardhjen e tij (nëse të kujtohet). Kjo është edhe arsyeja pse shumë israilitë emigruan drejt Gadishullit Arabik. Rabinët dhe ata që kishin njohuri mbi Teuratin e Zeburin e dinin mirë se Pejgamberi i fundit do dërgohej në trojet arabe. Mirëpo, ata e prisnin këtë të dërguar nga mesi i tyre, nga pasardhësit e Is'hakut. Kur i Dërguari u zgjodh nga mesi i arabëve, pasardhës



i Ismailit, nga zilia e mohuan dhe në asnjë mënyrë nuk e pranuan thirrjen e tij. Sikur të mos mjaftonte kjo, i nxitën mbarë idhujtarët arab kundër tij, u përpoqën ta helmonin, mirëpo Allahu e ruajti nga kurthet e tyre, e ndihmoi dhe e bëri Dinin e tij ngadhënjyes mbi besimet e kota. Besoj se e kuptove se për kë bëhet fjalë apo jo? Bëhet fjalë për Profetin Muhamed, emrin dhe cilësitë e të cilit i kanë të përmendura në Teurat, Zebur dhe Inxhil. Mirëpo, siç e kishin zakon, ata e mbajtën të fshehur këtë lajm derisa e fshinë krejtësisht emrin e tij nga librat e tyre. Bir i dashur, Teurati dhe Inxhili na lajmërojnë jo vetëm për Profetin Muhamed, por edhe për shokët e tij të ndershëm. *“Muhamedi është i Dërguari i Allahut. Shokët e tij janë të ashpër me jobesimtarët dhe të mëshirshëm mes vedi. I sheh ata se si bëjnë ruku e sexhde, në kërkim të mirësisë dhe kënaqësisë së Allahut. Në fytyra u dallohen gjurmët e sexhdes. Kështu përshkruhen në Teurat. Ndërsa në Inxhil, shembulli i tyre përshkruhet si një farë e mbjellë që lëshon filizin e ngrihet pastaj e forcon kërcellin e vet, duke i gëzuar mbjellësit...”*

## Sofra

Kështu pra, Isai së bashku me hauarijunët filluan rrugëtimin e gjatë në përhapjen e fesë. Nga nuk shkonin! Kë nuk takonin! I ftonin njerëzit në rrugën e shpëtimit që të arrinin kënaqësinë e të Madhit Zot, e jo për famë a pasuri. Mirëpo pas ditë udhëtimi e lodhjeje, bark e shpinë u ishin bërë një nga uria, ndaj iu drejtuan të Dërguarit duke i thënë: *“O Isa, o biri i Merjemes, a mund të na e zbresë Zoti yt një sofër me ushqim nga qielli?”* *“Kini frikë Allahun! Ç’është kjo kërkesë?”*- u tha Isai, alejhis-salam. Në fakt ata nuk dyshonin në fuqinë e pakufishme të Zotit, por thjesht po u fikeshin shpirtrat në trupa nga uria. *“Kemi nevojë të hamë, o i Dërguar.”*, thanë njëzëri, *“të na shtohet besimi, të na shtohet bindja se ke ardhur me*

të vërtetën dhe të jemi dëshmitar në mesin e njerëzve kur të largohesh ti." Pasi dëgjoi fjalët e hauarijunëve dhe e kuptoi se nuk e kishin me qëllim të keq, biri i Merjemes filloi të lutej. "O Allah, o Zoti jonë!", tha Isai, alejhis-selam, "Zbritna një sofër me ushqim nga qielli që të jetë festë për të parin e të mbramin prej nesh, të jetë mrekulli dhe mirësi nga ana Jote, se Ti je Dhuruesi më i mirë!" Allahu i shpalli Isait: "Unë do t'ju zbres sofrën, por kushdo që nuk beson pas kësaj mrekullie do ta dënoj si askënd tjetër në këtë botë." Një përgjigje e tillë erdhi në mënyrë që të mos bëheshin mrekullitë e jashtëzakonshme lojë e dëfrim, siç qenë për sojin e tyre dhe të mos shpëtojnë pa u ndëshkuar ata që i kthejnë shpinën mrekullive, siç u ndëshkuan popujt e mëhershëm. Si për mrekulli, ndërmjet dy reve pupëlbardha u duk një sofër që mbahej nga melekët, e për pak u zbriti krejt afër tyre. Hauarijunët mezi u besonin syve. Të mahnitur mezi prisnin të zgjasnin duart drejt sofrës... Mos pyet për ushqimet e shijshme e të bekuara mbi të! Mos pyet për pijet e lloj-llojshme! Lum për mysafirët e nderuar! Uria u shua, imani u shtua, Pejgamberi u nderua dhe historia e sofrës mbeti e kurrë nuk u harrua.

## Kurthi

Dashuria e popullit për të Dërguarin e Allahut e ndezi edhe më shumë zjarrin e armiqësisë mes parisë israilite dhe Isait, alejhis-selam. Rabinët dhe të pasurit ranë në një mendje të thurnin një plan për vrasjen e tij, ashtu siç kishin bërë me shumë të Dërguar. Po si mund ta hiqnin qafe pa rënë në sy të popullit se? Pas disa takimesh e thurën planin e zi. Meqë prej vitesh Jeruzalemi ishte nën pushtetin e perandorisë romake, dinakët çështjen e Mesihut e ngritën tek gjykatësi romak. Kokat e tyre u takuan me gjykatësin dhe e frikësuan duke i thënë: "Shkëlqësia e juaj! Siç të kemi lajmëruar edhe më parë, Mesihu

na e prishi fenë e baballarëve dhe na i magjepsi fëmijët. Ai është kryengritës dhe ngatërrestar.” Mirëpo fjalët e tyre nuk ndikuan edhe aq tek gjykatësi... Kur e vunë re këtë, çështjen e Mesihut e përzien me politikë. “Dijeni pra, shkëlqësi”, i thanë dinakët, “se ai nuk i nënshtrohet ligjeve tuaja dhe nuk do t’ia di për rregullat e perandorisë. Ai është njeri i rrezikshëm për shtetin. Nëse nuk e pengoni, e keqja e tij do përhapet edhe më shumë, pasi atë e përkrahin njerëzit e thjeshtë.” Me dhelperi dhe me lajka, siç e kishin zakon, arritën ta bindnin gjykatësin që të urdhëronte kapjen dhe vrasjen e birit të Merjemes. Kështu në pasditën e xhumasë një grup ushtarësh romakë, me në krye dhelprat israilite, ia mësynë shtëpisë ku rrinte i Dërguari me shokët e tij. Ndërkohë që ushtarët ishin rrugës, Xhebraili besnik e vuri në dijeni Isain, alejhis-selam, për kurthin e parisë israilite, por ai nuk u frikësua dhe as nuk u brengos. Ishte i bindur se Allahu i Lartmadhërishëm do ta mbronte nga kurthet e tyre.

## Lartësimi

Allahu i Lartësuar i shpalli të Dërguarit të Tij se romakët nuk do të mund ta kapin dhe as ta lëndojnë. E lajmëroi se njëri prej hauarijunëve do të merrte pamjen e tij, kurse Allahu do ta ngrente Mesihun lart në qiej. Atëherë Isai, alejhis-selam, i tregoi shokëve të tij për planin e lig, i lajmëroi se ushtarët romakë me në krye një grup israilitësh ishin nisur drejt shtëpisë ku po qëndronte. Para se të afroreshin e të rrethonin shtëpinë të pabesët, Pejgamberi la porositë e fundit, pastaj u ngrit e tha: “Cili prej jush pranon të marrë pamjen time, të vritet në vendin tim e të jetë shoqëruesi im në Xhenet?” “Unë, o i Dërguar.”- tha një djalosh në mesin e hauarijunëve. “Ulu!”- i tha Isai alejhis-selam. Të Dërguarit iu dhimbs djalo-shi sepse ishte më i riu në mesin e shokëve ndaj e përsëriti

pyetjen tre herë. Ama sa herë që i pyeti nuk përgjigjej askush pos tij. Atëherë Isai i tha: *"Atëherë ti qenke dëshmori për të cilin më ka lajmëruar Allahu."* Sapo i tha këto fjalë djaloshi, me lejen e Allahut Fuqiptotë, u bë shëmbëlltyra e Isait. Në ato çaste u dëgjuan hapat e ushtarëve që së bashku me israilitët i afroheshin gjithnjë e më shumë shtëpisë. Ndërsa ushtarët mundoheshin të thyenin derën me forcë, në çatinë e vjetër të shtëpisë u hap një vrimë me urdhrin e të Madhit Zot. Isain, alejhis-selam, e mbuloi mëshira e Allahut dhe e kaploi një gjumë i lehtë. I Plotfuqishmi e ngriti të Dërguarin në qiej përmes vrimës në çati. Kur e panë të dashurin e tyre tek ngritej lart, zemrat e hauarijunëve u qetësuan, megjithëse armiku tashmë kishte thyer derën e ishte futur brenda.

## Kryqëzimi

Me të hyrë në dhomën ku rrinin, romakët nxorën shpatat për t'i frikësuar hauarijunët dhe me bisht të syrit prisnin që israilitët t'u bënin me shenjë nga Mesihu. *"Ja ku e keni!"* - bërtitën nga marazi. *"Ja, ai që struket në mesin e tyre është!"*, thanë njëzëri duke bërë me shenjë. Ushtarët e kapën me force djaloshin që kish marrë pamjen e Mesihut, mirëpo ky nuk foli asnjë fjalë dhe u përgatit të bjerë dëshmor. Thuhet se e turturuan fisnikun, por me ndihmën e Allahut ai duroi si shkëmbi. Thuhet se shpinën ia fshikulluan me kamzhik dhe ballin ia shpuan me një kurorë gjembash e më pas e gozhduan mbi një kryq druri. Thuhet se kryqin e vendosën në një shesh ku dënoheshin kriminelët dhe kryengritësit në mënyrë që të frikësonin pasuesit e tij. Turma e njerëzve që ishin mbledhur në shesh shikonin shëmbëllimin e Isait dhe as që u shkonte ndër mend se dëshmori i kryqëzuar ishte njëri nga shokët e tij.

Ata nuk kishin njohuri për mrekullinë e Allahut të Lartësuar. Shkonin grupe-grupe pranë kryqit: inatçorët i silleshin rreth

e rrotull me gëzim në sy, sikur të ishin gjarpërinj, ndërkohë besimtarët e shihnin me sy të përlotur e shpirt të helmuar. Vdiq trimoshi në kryq. Ama, të vërtetën përveç hauarijunëve nuk e dinte askush. Ndërkohë që shpirti i djaloshit besimtar largohej nga kjo botë, Mesihu ngritej me trup e shpirt në mbretërinë e Qiejve. Pasi mbuloi nata, e zbritën trupin e pajetë të dëshmorit, e lanë, e qefinosën dhe e varrosën siç ishte zakoni. Israilitët shpirtlig, shpallën me kryelartësi: *“Ne e vramë Isain, birin e Merjemes, të Dërguarin e Allahut!”*

## *Pas kryqëzimit*

Shumë nga pasuesit e Mesihut, meqë nuk dinin asgjë për lartësimin e tij në sferat qiellore, u besuan fjalëve dashakeqe. Thuhet se pas kryqëzimit ushtarët romakë me në krye israilitët u vërsulën kundër çdokujt që besonte në mesazhin e Isait. Disa i vranë, disa i kryqëzuan e shumë të tjerë u detyruan të braktisnin vendlindjen për të shpëtuar kokën, duke mos pasur mundësi të takoheshin me hauarijunët e të mësonin të vërtetën. Kur u përçanë njerëzit në çështjen e Mesihut, vërshoi dallga e shirkut dhe e besimeve të kota në mesin e tyre. Vetëm një grup i vogël e njohu të vërtetën dhe u mundua me mish e me shpirt ta përhapte në lindje e në perëndim. Por, ky grup u luf-tua dhe e vërteta u mbajt e fshehur me shekuj deri kur Allahu i Lartmadhërishëm i zbriti Profetit Muhamed, alejhis-selam, Kur'anin Famëmadh si shpjegues të çdo gjëje, udhërrëfytes dhe mëshirë për besimdrejtët.

## *Shtrembërimi i fesë*

Biri im! Dije se mësimet e Isait, alejhis-selam, mbetën të kthjellëta e të paprekura derisa u paraqit Pali, një njeri i pri-

shur që pranoi krishtërimin. Ai shtrembëroi mësimet e fesë dhe u dha formë idhujtarie. Për fat të keq, pas tij u mashtruan shumica e të krishterëve. Në kohën e tij u shuan mësimet e pejgamberisë dhe u përçudnua feja e vërtetë. Pali e mohoi synetinë dhe e lejoi mishin e thiut, trilloi historinë e kryqëzimit dhe faljes së gjynaheve, madje mund të themi se feja e krishterë që njohim sot është krishtërimi i Palit dhe jo i Mesihut. Sikur mos të mjaftonte kjo, me pranimin e krishtërimin nga perandori bizantin Kostandini u fetarizua edhe më shumë idhujtaria greke dhe romake me krishtërimin. Aq sa në vitin 325 Kongresi i Nikeas mori vendimin për shpalljen e Mesihut zot... Megjithëse një grup i vogël me në krye pastorin Arius e kundërshtuan këtë vendim me të madhe, fjalët e tyre ranë në vesh të shurdhër. Madje në vitin 431 u mbajt Kongresi i Efesit i cili shpalli vendimi, se zoti na qënka tre: Ati, Biri dhe Shpirti i Shenjtë... Edhe asokohe nxënësit e Ariusit u munduan ta kundërshtonin me çdo kusht këtë gënjeshtër të madhe, mirëpo ky grup u luftua dhe e vërteta u mbajt e fshehur me shekuj, deri kur Allahu i Lartmadhërishëm i zbriti Profetit Muhamed Kur'anin Famëmadh si shpjegues të çdo gjëje, udhërrëfyes dhe mëshirë për besimdrejtët... Pasi u zbrit Kur'ani Fisnik, filloi beteja e paepur mes të vërtetës dhe të pavërtetës, dritës dhe errësirës, islamit dhe besimeve të kota, betejë që nuk do të ndalet deri në Ditën e Kijametit...

## *Thertorja e madhe*

Biri im! Dije se, për sa të ketë jetë në tokë, do të ketë përplasje mes të mirës dhe të keqes, të drejtës dhe zullumit, të vërtetës dhe gënjeshtres, mes dritës dhe errësirës. Kështu qenka kurdisur dynjaja. Asnjëherë nuk do të shuhet zjarri i luftës mes besimdrejtëve dhe të humburve derisa të zbresë biri i Merjemes. Po kur do të zbresë Isai mund të pyesësh ti? Veç

të Madhit Zot, askush nuk ka njohuri për vitin e zbritjes së tij, mirëpo Profeti Muhamed, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin përherë mbi të, na ka shpalosur disa shenja që lajmërojnë për ardhjen e tij.

Na ka lajmëruar Profeti jonë, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin përherë mbi të, se pak para se të zbresë Isai, biri i Merjemes, pas shumë e shumë betejash, muslimanët do lidhin besën për paqe me të krishterët romakë. Por, ata nuk do ta mbajnë besën, do të tradhëtojnë dhe do t'i sulmojnë muslimanët me një ushtri të stërmadhe me 80 bajrakë. Nën çdo bajrak që valëvitet lart, do të ketë 12 000 ushtarë të armatosur gjer në dhëmbë. Do të zbresë armiku tok, duke dridhur tokë e gur. Të shumtë si rëra e detit dhe të egër si ujku. Kur të mbërrijnë në Dabik, një krahinë ndërmjet Halebit dhe Antakias në veri të Sirisë, do të dalë nga qyteti i Medines një ushtri trimash të paepur për t'u përballur me ta.

Profeti Muhamed, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin përherë mbi të, na ka lajmëruar se këto do jenë muslimanët më të mirë të asaj kohe. Lum për ata që e mbërrijnë këtë kohë dhe i bashkëngjiten kësaj ushtrie. Nisen pa e ndalur hapin derisa mbërrijnë në afërsi të Dabik-ut. Romakëve do u shkojë haber se muslimanët janë në rrugë e sipër, ndaj fillojnë e përgatiten për luftë. Tek veshin parzmoret dhe mbrehin shpatat, në lindje ngrihet një re pluhuri. Ushtria e besimdrejtëve është afër. Kur qielli nis të përskuqet nga agu i ditës, horizonti nxihet nga ushtria muslimane. Drejtohen safet e ushtrive. Romakët e vërejnë se janë më shumë dhe më të armatosur, ndaj u thërrasin muslimanëve me kapadaillëk: *"Nxirrini nga mesi i juaj dhe na dorëzoni të krishterët që kanë pranuar islamin nëse dëshironi të shpëtoni kokat tuaja!"* Mirëpo, muslimanët i përgjigjen njëzëri: *"Jo pasha Allahun, ne nuk i braktisim vëllezërit tanë përpara se të pritemi me shpatë në shesh të luftës. Nuk ua kemi frikën se për luftë kemi dalë!"*



Biri im, para Kijametit njerëzit do të luftojnë me armët e mesjetës. Ky arsenal i madh armësh do të zhduket. Pak para perëndimit të kësaj bote njerëzit do t'u kthehen edhe një herë mjeteve primitive, kuajve, armëve të ftohta, shigjetave dhe do të zhvillohen luftrat si dikur. Ashtu siç lind dielli i dobët, mandej bëhet flakë e dritë në zenit e përsëri dobësohet tek ikën mbas malit, ashtu edhe dynjaja: dikur primitive e sot moderne, tek perëndon do e humbë shkëlqimin.

Do të vërshojnë romakët si të ishin dallgë të egra deti. Lënë të vrrarë prapa, largohen tutje, kthehen sërish. Lëshohen muslimanët si luanët e stepave dhe ndezet lufta prush. Një grup nga trimat muslimanë betohen se nuk do kthehen, veçse ngadhënjyes ose dëshmorë. U prijnë gjokëve dhe përplasen fort me dallgët armike. Shpatat vringëllojnë, jataganët ngulen thellë në mish e çajnë eshtrat, ushtat ua pushtojnë gjokset ushtarëve dhe gjaku ua ngjyros parzmoret e çelikut. Shigjetat zbresin breshër, gjokët hingëllijnë e thundrat u xixëllojnë tek godasin pa ndalë gurët, trimat bërtasin me të madhe, u japin kurajo shokëve dhe çajnë rreshtat e armikut...

Lufta pëlçet tym e ndizet flakë. Gjaku derdhet lumë, koka burrash rrokullisën në fushë të mejdanit, trupa trimash përplasen pa jetë për tokë, të plagosurit rënkojnë nga dhimbja që s'durohet. Vdekje e tmerr kudo. Kacafytja s'ndalet deri në perëndim të diellit, por një e treta e ushtrisë muslimane e lë fushën e mejdanit e ia mbath nga frika. Këtyre njerëzve, tregon Profeti, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin përherë mbi të, Allahu nuk ua pranon pendimin kurrë. Kthehen trimat nëpër kazerma, por askush s'ka fituar. Ata që ishin zotuar për të ngadhënjyer ose për shehidllëk, vriten të gjithë. Ata do jenë shehidët më të mirë të asaj kohe...

Të nesërmen zotohet përsëri një grup nga muslimanët: "O ngadhënjyes, o dëshmorë!". Përplasen përsëri ushtritë në agim. Shpatat vringëllojnë, jataganët ngulen thellë në mish e

çaj në eshtrat, ushtat ua pushtojnë gjokset dhe gjaku ua ngjyros parzmoret ushtarëve. Shigjetat zbresin breshër, gjokët hingëllijnë e thundrat u xixëllojnë tek godasin pa ndalë gurët, trimat bërtasin me të madhe, u japin kurajo shokëve dhe çaj në dallgët e armikut... Lufta pëlçet tym e ndizet flakë. Gjaku derdhet lumë, koka burrash rrokullisën në fushë t'mejdanit, trupa trimash përplasen pa jetë për tokë, t'plagosurit rënkojnë nga dhimbja që s'durohet. Vdekje e tmerr kudo... Luftojnë deri natën, por nuk ka ngadhënjimtarë. Ata që ishin zotuar për ngadhënjim a shehidllëk, vriten të gjithë. Kështu edhe dita e tretë: luftë e tmerrshme prej sabahut gjer në aksham.

Në agim të ditës së katërt një ushtri e madhe vjen nga larg. Një kryetrim u prin mbi gjok. Ah sa gëzohen besimdrejtët kur shohin bajrakun "La ilahe ila Allah" tek valvitet në ballë të ushtrisë. Janë trimat muslimanë. Kanë ardhur nga çdo anë t'i bëhen krah vëllezërve të tyre në fushë të mejdanit. Bashkohen ushtritë muslimane e u vërsulen armikut si tufë luanësh. Zhvillohet aso lufte që s'është parë e as s'është dëgjuar. Gjaku derdhet lumë, koka burrash rrokullisen në fushë t'mejdanit, trupa trimash përplasen pa jetë për tokë, t'plagosurit rënkojnë nga dhimbja që s'durohet. Toka vaditet me gjak. Vdekje e tmerr kudo... Njëqind kushërinj sulmojnë armikun në agim, por nuk e mbërrin muzgun veçse një prej tyre... Aq e tmerrshme do jetë beteja, sa çdo zog që kalon mbi fushë të mejdanit, bie i ngordhur nga kundërmimi i padurueshëm i kufomave.

Besimdrejtët do të ngadhënjejnë, megjithatë askush s'gëzon. Nuk ndahet trashëgimia dhe nuk ngazëlleen burrat me ganimetin e luftës. E si të gëzohen tek shohin trupat pa jetë të vëllezërve e kushërinjve të larë me gjak e të nxirë nga tymi?! Si të gëzohen kur nga njëqind burra të një fisi ka mbetur veç një?! Megjithatë e bëjnë zemrën gur dhe bashkohen edhe një herë tok. Ulen e kuvendojnë. Përkujtojnë trimërinë e ushtarëve

dhe u thurin lavde dëshmorëve. Mundohen të pushojnë pak e të ripërtërijnë forcat për betejën e rradhës...

*"Drejt mureve të Kostandinopojës!"*- buçet zëri i komandantit në të zbardhur. Niset kryetrimi dhe pas i shkon ushtria. Ata janë kalorësit më të mirë të asaj kohe. Zemrat e tyre nuk qetësohen derisa të vërejnë flamurin islam tek valvitet lart. Zemrat e tyre i kanë të lidhura me suksesin e kësaj feje. Nuk e ndalin trokun derisa mbërrijnë pranë mureve të qytetit. Kostandinopoja atëbotë do jetë kryeqendra e krishtëritimit. Do jetë e fortifikuar me mure të lartë e të pakapërcyeshëm e me bedena të panumërt rreth e përçark.

Kur morën vesh për humbjen e madhe në Dabik, romakëve frika ua pushtoi zemrat, e mos fol kur i vërenë trimat muslimanë tek u afrohen mureve duke brohoritur me të madhe. Sytë iu errësuan nga frika, shikimet u shtangën dhe zemrat u erdhën në fyt. Fillojnë e dridhen nga frika si gjethet e plepit kur fryn era. *"Ndaj muslimanëve nuk mund të ngadhënjëjmë. Jo, jo është e pamundur të përballësh me to! A nuk e morët vesh se si përfunduan ushtritë tona në Dabik?!"*- i pëshpërisnin ushtarët shoqi-shoqit. Shigjetarët mbi bedena s'mund të ngrejnjë harqet dhe duart u dridhen tek tërheqin shigjetat. Shpatarët hedhin shpatat nga frika e përballjes me trimat e paepur. Komandantët mendojnë veç për kokat e tyre. Ndërkohë nga jashtë muslimanët thërrasin njëzëri: *"Allahu Ekber! Allahu Ekber! La ilahe ila llah!"* Nuk luftojnë me shpata dhe as që hedhin shigjeta, por vazhdojnë të brohorasin e të këndojnë tekbiere. La ilahe ile llah, Allahu ekber... dhe ja: çlirohet pjesa e detit. Pastaj brohorasin edhe një herë së bashku: La ilahe ila llah, Allahu Ekber... dhe çlirohet pjesa e tokës. Pastaj për të tretën herë: La ilahe ila llah, Allahu Ekber... dhe romakët të tmerruar hapin portat kryesore të kështjellës duke kërkuar mëshirë.

## Mesihu Dexhal

Ndërkohë që kanë çliruar Kostandinopojën, muslimanët fillojnë të ndajnë ganimetin e luftës. Tek shikojnë shoqi-shoqin me gëzim, dikush thërret me të madhe: *"Mesihu Dexhaaaal! Mesihu Dexhaaaal! Mesihu Dexhal ka dalë në Sham, ndaj nisuni t'u ndihmoni muslimanëve."* Komandanti i besimdrejtëve dërgon dhjetë kalorës për në Sham që t'ju sjellin haber, ndërkohë ushtria mobilizohet. Kur shkelin në truallin e bekuar të Shamit, kalorësit marrin vesh se lajmi kish qenë i rremë, por pak para se të kthehen e t'i bashkohen ushtrisë u vjen haber nga larg se Dexhali ka dalë në Hurasan, në Asbahan në një lagje të vjetër çifutësh të ardhur që në kohën e Nabukodonosorit. Po kush është Mesihu Dexhal mund të pyesësh me të drejtë?

Biri im! Profeti jonë, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin përherë mbi të, na e ka përshkruar deri në imtësi Mesihun Dexhal, që ta njohim mirë e të mos bijmë pre e mashtrimeve të tija. Dëgjo me vëmendje se ç'na ka lajmëruar për të: *"O njerëz! Prej kur Allahu i Lartësuar krijoi pasardhësit e Ademit, nuk ka pasur sprovë më të madhe mbi tokë sesa sprovë e Dexhalit. Çdo Pejgamber i ka tërhequr vërejtjen umetit të tij për Mesihun Dexhal. Unë jam Pejgamberi i fundit, ndërsa ju jeni umeti i fundit, ndaj ai patjetër do të shfaqet në kohën tuaj. Nëse shfaqet duke qenë unë në mesin tuaj, atëherë unë do të jem mbrojtës për çdo musliman. Por, nëse del pas meje, atëherë Allahu do jetë kujdestar i muslimanëve."*

Biri im! Tre vite para se të dalë Dexhali, do ketë skamje dhe fukarallëk të madh. Në vitin e parë qielli do të ndalë një të tretën e shiut, ndërsa toka një të tretën e bimësisë. Në vitin e dytë do të ndalin dy të tretat e furnizimit, ndërsa vitin e tretë do ndalet shiu krejtësisht dhe në tokë s'do mbijë asgjë prej gjëje e do shuhet bagëtija. Do shterojnë kroje e puse e do mbesë bota pa pikë uji. Ushqimi i njerëzve në atë kohë do jetë: tehlili, tekbi, tesbiu dhe tahmidi.

Biri im! Dexhali do të dalë në një kohë kur nëpër minbere lihet në harresë dhe nuk përmendet më emri i tij. Do të silltet nëpër tokë 40 ditë. Dita e parë zgjat sa një vit, e dyta sa një muaj, e treta sa një javë, dhe të tjerat si ditët e zakonshme.

Dexhal, o bir, do të thotë mashtrues. Me të vërtetë ai ua mbulon njerëzve të vërtetën me gënjeshtëri. Mesih-ngaqë syrin e majtë, e ka të rrafshuar me ballin dhe nuk shikon. Mbi syrin e djathtë, ka një cipë e cila ia vështirëson të pamurin. Syrin e ka të dalë si të ishte kokërr rrushi. Ai i shkëlqen si yll i ndritshëm në natën e errët dhe ka ngjyrë të gjelbër si smeraldi. Ndërmjet dy syve të tij ka të shkruar *kafir*, por diç të tillë nuk do të mund ta dallojë veçse besimtari, qoftë edhe analfabet. Ka flokë kaçurrelë shumë të dendur si të ishte afrikan, por lëkurën e ka të bardhë në të kuqe. Është i shkurtër dhe kërcinjtë i ka të shtrembër. Siç të tregova, ai do dalë nga lindja nga një zonë e quajtur Hurasan në Iranin e sotëm. Do të vazhdojë të ecë në një shteg të gjatë mes Shomit dhe Irakut duke përhapë shkatërrim majtas dhe djathtas. Fillimisht do të pretendojë peygamberinë e më pas do të thotë se është Zot. Ai ka xhenet dhe zjarr, por xheneti i tij është zjarr dhe zjarri është xhenet. Bart me vete kodra prej buke të shijshme dhe mishi të pjekur në një kohë kur pllakos uria. Ka dy lumenj në një kohë kur pllakos thatësira. Njëri duket i bardhë dhe i kulluar, ndërsa tjetri i përflakur zjarr. Kush e arrin atë ditë dhe ka nevojë të shuajë etjen, le t'i mbyllë sytë, të ulë kokën dhe të pijë prej lumit të përflakur sepse është ujë i pijshëm - na mëson Profeti, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin përherë mbi të. Në këtë mënyrë do të shuajë etjen, do t'i bien gjynahet siç bien gjethet në vjeshtë dhe do të shpërblehet me kodra sevapësh.

Tek shkel trojeve të shkreta, Dexhali do t'i thotë bedunit të paditur: "Nëse ta ngjalli babën dhe nënën, a dëshmon se jam zoti yt." "Po" - do t'i thotë beduini. Atëherë i shfaqen bedunit dy shejtanë me pamjen e prindërve duke i thënë: "O biri jonë, pasoje se ky është zoti yt."

Mesihu Dexhal do kalojë në një mëhallë dhe do thërrasë ta besojnë si zot, por ata s'do ta pranojnë dhe do ta përgënjeshtrojnë. Atëherë ai do largohet dhe mëhallën e pllakos thatësira. Qielli e mban ujin. Thahet bimësia dhe shuhen bagëtia. Më pas do të kalojë nga një lagje tjetër ku do ta besojnë. Atëherë ai do t'i japë urdhër qiellit të lëshojë shiun. Do urdhërojë tokën të nxjerrë bimë dhe shkretëtira përnjëherësh bëhet kullotë e gjelbër. Bagëtitë do të majmen dhe gjinjtë do t'u varen nga qumështi.

Dexhali do të kalojë pranë një qyteze të rrënuar dhe do të thërrasë: *"O qytet, nxirri thesaret!"* Menjëherë do të dalin stollitë e arit dhe argjendit prej rrënojave dhe do i shkojnë pas si të ishin tufa bletësh. Dexhali do të shkelë në çdo pjesë të tokës me përjashtim të katër vendeve: Mesxhidu el Haram në Mekë, Mesxhidu Rrasul në Medine, Mesxhidu Aksa ne Palestinë dhe në Kodrën e bekuar Tur.

Dexhali do përpiqet të hyjë në Medine nga shtigje të ndryshme, mirëpo ngado që kalon do ta pengojnë melekë me shpata të zhveshura. Pasi e humb shpresën të hyjë në Medine, do të ndalet në afërsi të kodrës së Uhudit me ushtrinë e vet. Do të tronditet Medineja tre herë dhe të gjithë munafikët do të largohen prej këtij qyteti si të ishin insekte. Shumica prej tyre do t'i shkojnë pas e do i bëhen krah Dexhalit.

Atëherë një djalë i ri nga trimat e Medines do shkojë drejt Dexhalit që t'ia çjerrë maskën e mashtrimit. Profeti Muhamed, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin përherë mbi të, na tregon se do ta zënë rojet e Dexhalit dhe do e pyesin: *"A i beson zotit tonë, u çunak?"* *"Zoti jonë është Allahu."* - thotë trimoshi. *"Atëherë ta vrasim"*, thonë disa, *"se ky nuk beson në zotin tonë."* *"Pritni, pritni!"* - thonë të tjerët. *"A nuk ua ka ndaluar zoti juaj të vrisni ndokënd pa marrë leje nga ai."* E tërheqin djalosin deri tek Mesihu, por kur mbërrijnë, trimi thërret me të madhe: *"O njerëz, dëshmoj se ky është Dexhali për të cilin na ka para-*

*Iajmëruar Pejgamberi Muhamed, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin përherë mbi të!*

Kur dëgjon fjalët e trimit Dexhali inatoset dhe urdhëron ushtarët që ta rrahin... dhe e ashtu bëjnë. Pastaj Dexhali i drejtohet turmës e u thotë: *"O robërit e mi! Nëse unë e vras dhe pastaj e ringjall këtë çunak, a dyshoni tek unë?"* Dexhali urdhëron që trupi i djaloshit të ndahet dysh . E sharrojnë trimin dhe gjaku shkon rrëke. Me mendjemadhësi Dexhali i kalon sipër kufomës së copëtuar dhe i thotë: *"Ngrihu!"*. Përnjëherësh eshtrat takohen, mishi bashkohet, gjaku thahet dhe djaloshi ngrihet në këmbë duke buzëqeshur. Dexhali i thotë: *"A më beson tani, o çunak?"* *"Tash jam edhe më i bindur se ti je Dexhali."* - ia kthen trimi. Pastaj i drejtohet turmës: *"O njerëz, ky nuk ka mundësi ta bëjë këtë që bëri me askënd tjetër pas meje, ndaj mos u mashtroni me të!"* Dexhali pëlçet nga marazi. Përpiqet ta therë djaloshin, por me lejen e Allahut fyti i shndërrohet në bakër. Pastaj e shtrëngon për duarsh dhe këmbësh dhe e hedh në lumin e përflakur, i cili bëhet i ftohtë dhe i paqtë për të, krejt si zjarri për Ibrahimin, alejhis-selam.

## Zbritja e Isait

Pasi nuk ka lënë vend pa shkelur Dexhali ia mësyn edhe një herë Shamit. Ecën me shpejtësi të madhe deri sa mbërrin tek kodra Ilija, në kështjellën e së cilës strehohet ushtria muslimane. Prijësi i muslimanëve në atë kohë do jetë imam el Mehdi, një burrë i mirë me prejardhje kurejshite, prej pasardhësve të Fatimes, bijës së Muhamedit, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin përherë mbi të. Emri i tij është si ai i Profetit, po ashtu edhe emri i babait të tij është i njëjtë me emrin e babait të Profetit, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin përherë mbi të. Muhamed bin Abdilah i thonë. Ballin e ka të gjerë, ndërsa balluket i ka të rralla. Hundën e ka të ngritur dhe fytyrën nur



të bukur. Allahu do ta përmirësojë në një natë duke i dhuruar dituri dhe aftësinë për të udhëhequr. Muslimanët do ta duan dhe do pajtohen me urdhrat e tij. Tokën do ta mbulojë me drejtësi dhe do udhëheqë për shtatë vite.

Kur Dexhali me ushtri rrethojnë kështjellën e besimdrejtëve, komandantët e muslimanëve në kodër do u thonë ushtarëve: *"Përgatituni për luftë, burra. O vdekje, o fitore! Të falim saba-hun e të hapim portat e kështjellës!"* Teksa faleshin yjet dhe lindte dita trimat rreshtohen në safe për namaz. Papritmas nga qielli fillon e zbret biri i Merjemes në një vend të ngritur e të bardhë në lindje të Damaskut, ashtu siç kish lajmëruar Profeti Muhamed, alejhis-selam. Të veshur do ketë dy rroba të ngjyrosura me të verdhë shafiran. Me duar mbahet fort tek supet e dy melekëve. Kur e lëviz kokën, bulëza uji sikur perla i rrëshqasin nga flokët edhe pse nuk i ka të lagët. Lëkurën do e ketë të bardhë që anon nga e kuqja.

Kur e vëren se po zbret isai, alejhis-selam, Mehdiu bën të kthehet prapa, në shenjë respekti për të birin e Merjemes. Mirëpo Isai, që tashmë ka zbritur krejt afër, ia vendos dorën midis dy shpatullave në shenjë nderimi dhe i thotë: *"Dil dhe na prij në namaz!"* Pasi falin namazin, muslimanët presin lindjen e diellit që t'i turren dushmanit. Mbas portave të kështjellës është afruar Dexhali me 70 mijë çifutë me shpata të zbukuruara në duar e të mbështjellë me tajelis (shall i njohur në mesin e jehudive). Isai urdhëron të hapet porta dhe ja: biri i Merjemes dhe Dexhali ballë për ballë. Kur Dexhali e sheh Isain fillon e dridhet si fleta e plepit. Fillon e shkrin sikur kripa në ujë. Sikur ta linte do të trettej i tëri, por Isai nuk e lë. Ndërkohë Dexhali ia mbath vrapit nga frika. Biri i Merjemes i qepet nga pas dhe nuk i ndahet. Profeti, alejhis-selam, na ka lajmëruar se Isai e zë në një qytezë afër Palestinës të quajtur Bebu Lud dhe e vret me kamën e tij. Pastaj kamën e përgjakur do ua paraqesë njerëzve që ta marrin vesh mirë se Dexhali nuk ishte Zot... Zoti s'vritet

dhe as nuk ka gjak. Atëherë muslimanët do t'u turren çifutëve dhe do i shpartallojnë që të gjithë pa përjashtim. Shumë prej tyre do mundohen të fshihen pas shkëmbinjve, mureve dhe pemëve, por më kot...

Allahu do ua mundësojë këtyre krijesave të ngurta t'u flasin muslimanëve. Sa herë që pas tyre fshihet ndonjë çifut, do u thërrasin muslimanëve: *"O rob i Allahut, një çifut është fshehur pas meje, ndaj eja dhe vrite"* Me përjashtim të pemës Garkad, e cila është e kultivuar nga çifutët. Dexhalin e vrasin dhe dushmanin e shkatërrojnë. Duke bërë dhikër dhe duke thurur lavde për trimërinë muslimanët nisen për çlirimin e trojeve të tjera në lindje e në perëndim.

## Je'xhuxhët dhe Me'xhuxhët

Biri im! Teksa muslimanët së bashku me Isain marshojnë drejt viseve të largëta, Allahu i shpall birit të Merjemes: *"O Isa! Së bashku me muslimanët të shpejtoni drejt kështjellës mbi Turi-Sinal! Kanë vërsuar Je'xhuxhët dhe Me'xhuxhët, dy popuj të fuqishëm e të panumërt, përballë të cilëve askush nuk ka takat."* Isai i bindet urdhrit dhe së bashku me besimdrejtët ia mësyjnë kodrës së bekuar... Mirëpo, kush janë Je'xhuxhët dhe Me'xhuxhët?

Ta dish o bir, se ata nuk janë përbindësia me pamje të përçudnuar siç përmenden në përralla, porse pasardhës të Ademit alejhis-selam. Ama, janë njerëz të pamëshirshëm, janë popuj shkatërrimtarë, vrasin e presin këdo që u del përpara. Kur u thahet buza, i përpijnë me fund ujërat e liqeneve dhe të lumenjve. Të fuqishëm sa më s'ka... as Isai alejhis-selam dhe ushtria e tij nuk mund t'i bëjnë ballë. Mos fol për armët e tyre... shpata, jataganët, ushta, shigjeta dhe mburoja prej hekuri e druri. Profeti, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin përherë mbi

të, na ka lajmëruar se me armatimin e tyre mund të ndezin zjarr e mund të ngrohen njerëzia për shtatë vite.

Dëgjo, bir! Qindra vite përpara nesh sundonte një mbret besimdrejtë. Dhul-Karnejn (dy brirësh) e kish llagapin, ngase mbretëria e tij shtrihej nga briri i lindjes së diellit deri tek ai i perëndimit. Allahu i Lartësuar i pat dhënë forcë të madhe dhe mundësi të arrinte çdo send. Ky mbret përshkoi rrugë të gjata nga lindja e nga perëndimi në përhapjen e dritës islame dhe drejtësisë. Kur mbërriti në një qafë mali, u përball me një popull që vështirë të kuptonte ndonjë gjuhë tjetër veç të vetës. Të parët e fisit e pritën me nderime Dhul-Karnejnin dhe, tek bisedonin me përkthyesit e mbretit, iu ankuan për Je'xhuxhët dhe Me'xhuxhët. *"O mbret", i thanë, "Je'xhuxhët dhe Me'xhuxhët po bëjnë kërdinë: na plaçkitën pasurinë dhe na vrasin rininë. A mund të ndërtosh një digë ndërmjet nesh, që të shpëtojmë një herë e mirë prej tyre? Kërko sa të duash e do të ta japim!"* Dhul-Karnejni u tha: *"Shpërblimi i Zotit tim është shumë më i mirë se i juaji! Do ju ndihmoj për hir të të Madhit Zot, po ju më ndihmoni me fuqi punëtore se ushtria ime nuk ia del e vetme." "Më sillni copa të mëdha hekuri!"* - u tha mbreti. Pasi u grumbullua hekuri Dhul-Karnejni urdhëroi të vendoset me mjeshhtëri metali i hekurit ndërmjet dy maleve prej nga vërshonin Je'xhuxhët dhe Me'xhuxhët. Mandej dha urdhër që të ndizej një zjarr i llahtarshëm që të shkrihej hekuri dhe të ngjiteshin copat e metalit njëra me tjetrën. *"Më sillni bakër të shkrirë t'ia hedh murit prej hekuri që të bëhet i lëmuar!"* - urdhëroi përsëri mbreti dhe ashtu u bë. Për pak kohë Dhul-Karnejni ndërtoi një digë kaq të fuqishme saqë asnjë forcë njerëzore, asnjë armë dhe asnjë ushtri s'do mund ta shkatërronte, as ta kapërcente dhe as ta shponte. Kur i pa njerëzit të mrekulluar përballë digës, mbreti besimdrejtë iu drejtua dhe i tha: *"Kjo është mirësia e Zotit tim."* Thuhet se më pas ra në sexhde në shenjë falënderimi, meqë Allahu Fuqiplotë ia mundësoi të

shpëtonte njerëzinë nga ligësia e Je'xhuxh Me'xhuxhëve. Pasi u ngrit tha: *"E kur të vijë urdhri i Zotit tim, diga do shkatërrohet... Me të vërtetë caktimi i Zotit tim është i sigurt."*

Biri im! Transmetohet se Profeti, paqja dhe bekimet e Allahut qofshin përherë mbi të, u zgjua një pasdite dhe i trazuar tha: *"Nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë veç Allahut. Mjerë për arabët nga një e keqe që i është afruar! Nga diga e Je'xhuxh Me'xhuxhëve është hapur një vrimë e vogël."* dhe bashkoi gishtin e madh dhe atë tregues në formë unaze. Në fakt ata çdo ditë gërmojnë nga pak dhe sa herë që gati sa nuk e shpojnë tejprtej, prijësi i tyre u thotë: *"Kthehuni se do e gërmojmë nesër dhe do dalim."* Mirëpo kur kthehen nesër, e gjejnë më të fortifikuar se ditën e parë dhe kështu vazhdojnë çdo ditë deri kur të vijë caktimi për të dalë. Një natë para se të dalin, prijësi u thotë: *"Kthehuni, se nesër do e shpërthejmë in she Allah."* Kur kthehen në mëngjes e gjejnë vrimën të hapur... e zgjerojnë edhe më shumë dhe fillojnë e vërshojnë mbi njëri tjetrin si insektet. Me të shpejtë marshojnë në tokë, bëjnë shkatërrime dhe derdhin gjak deri sa mbërrijnë para liqenit Taberije ndërmjet Palestinës dhe Jordanisë. Grupi i parë që mbërrin buzë liqenit, të etur e të lodhur nga rruga, do ta përpijë ujin e tij deri në pikën e fundit. Ndërkohë që grupi tjetër mbërrin pranë shtratit të lumit, i drejtohen shoqi-shoqit me habi: *"A nuk ka pasur dikur ujë ky vend?!"* Mendo numrin e madh dhe pangopsinë e tyre, o bir?!

Je'xhuxh Me'xhuxhët vërshojnë nëpër tokë si dallgët e detit të trazuar derisa mbërrijnë pranë kodrës Turi-Sina, rreth kështjellës ku fshihen biri i Merjemes me besimdrejtët. Thuhet se gjendja e muslimanëve do jetë shumë e vështirë. Je'xhuxh Me'xhuxhët do u thërrasin përtej mureve, por Isa do u bëjë me shenjë besimdrejtëve që të mos përgjigjen. Kur e shohin se nuk ka përgjigje, drejtojnë shigjetat nga qielli dhe me krenari thonë: *"I shfárosëm banorët e tokës! Tash radhën e kanë"*

*banorët e qiellit.” Mirëpo kush prek shenjtërinë e qiellit, e ka të sigurt shkatërrimin. Ja se ç’ndodh me ta!*

Gjuajnë me shigjeta në qiell dhe shigjetat u kthehen me gjak që t’u shtohet kufri dhe kryelartësia edhe më shumë. Ndërkohë Isai dhe shokët e tij do jenë në ngushticë të madhe. Barku u bëhet një me shpinën nga uria. Kokën e kaut janë gati ta këmbajnë me 1000 dinarë, por ku ta gjenë se! Kur gjendja vështirësohet sa më s’ka, Isai dhe besimdrejtët do t’i luten Allahut t’i shkatërrojë Je’xhuxh Me’xhuxhët. Lartmadhëria e Tij e dëgjon dhe i përgjigjet lutjes së tyre. Mbreti i qiejve u lëshon një ushtri me *negaf*. E ç’është *negafi*? Ai është një krimb që jeton në brendësi të vrimave të hundës së deveve. Është kaq i vogël saqë që mezi shihet. Këto krimba bien si shiu dhe ua brejnë qafat gjithsecilit prej tyre. Sa hap e mbyll sytë vdesin të gjithë përnjëherësh si të ishin një trup i vetëm...

Nga vështirësia dhe uria e madhe njëri nga besimtarët del nga portat e fshehta të kalasë: ose të vëflijohet ose të marrë vesh se ç’bëhet jashtë. Kur del dhe i sheh të gjithë të vdekur, u thërret shokëve me të madhe. Dalin besimdrejtët me Isain të gëzuar: toka është mbushur me kufomat, gjakun, djersët dhe ndyrësinë e Je’xhuxhëve dhe Me’xhuxhëve. Duke mos pasur takat ta pastrojnë sipërfaqen e saj i luten përsëri Allahut dhe Ai dërgon shpendë të mëdhenj sa qafat e deveve. I marrin me kthetra kufomat e qelbura dhe i hedhin andej nga urdhëron Allahu i Lartësuar. Pastaj Allahu dërgon shi, i cili do të depërtojë në çadrat prej lëkure dhe ndërtesat prej qerpiçi dhe do pastrohet toka e do bëhet e lëmuar si pasqyra.

## *Vdekja e Isait*

Bir i dashur! Pas shkatërrimit të Je’xhuxh Me’xhuxhëve toka do mbushet me paqe siç mbushet ena me ujë. Do zbatohet

sheriati e do adhurohet Allahu i Vetëm. Isai do bëhet gjykatës dhe udhëheqës i muslimanëve. Do ta thyejë kryqin, do ta therë thiun dhe nuk do të pranojë xhizje dhe as lëmoshë. Do të zhduken të gjitha fetë e tjera veç islamit. Do të venitet inati dhe urrejtja. Do t'i thuhet tokës: *"Ktheji frutat dhe bereqetin si dikur!"* Një grup njerëzish do të ngopen me një shegë. Qumështi i një deveje do u mjaftojë një ushtrie të tërë, qumështi i lopës do t'i mjaftojë një fisi. Aq bereqet do të ketë saqë, po ta hedhësh farën mbi një gurë apo rrasë shkëmbi të lëmuar, do të mbijë. Do ketë siguri, nuk do të ketë armiqësi, as urrejtje dhe as smirë. Do u tretet helmi gjarpërinjve. Devetë do kullosin afër luanëve dhe lopët afër leopardit. Ujku do luajë me bagëtitë sikur të ishte qen stani. Fëmijët do luajnë me gjarpërinjtë dhe do i vihen pas luanit si ta kishin maçok. Toka do mbushet me bar të njomë. Një dem do të shitet shumë shtrenjtë, ndërsa kali vetëm pak dirhemë, pasi demin do e përdorin për të lëvruar tokën, ndërsa kali nuk shalohet më për luftë. Ngado të hedhësh shikimin: bereqet, prona e pasuri e madhe...

Isai, alejhis-selam, do të qendrojë në tokë 40 vite: 33 vite nga lindja e derisa ngritet në qiej dhe 7 të tjera kur zbret edhe një herë. Nuk do ndërrojë jetë biri i Merjemes para se të bëjë haxhin dhe umran. Kur vdes, muslimanët ia falin namazin e xhenazes dhe e varrosin në tokë... Pas largimit të Isait nga kjo botë, Kijameti është afër dhe tek Allahu do të kthehemi...

## Përmbajtja

<b>Parathënie</b> .....	<b>5</b>
<b>Njeriu i parë</b> .....	<b>9</b>
Havaja .....	12
Selami .....	13
Kurthi .....	14
Pendimi .....	16
Toka .....	18
<b>Idrisi</b> .....	<b>19</b>
<b>Dhjetë breza pas Ademit</b> .....	<b>21</b>
Pejgamberi fisnik .....	22
Populli i Nuhut .....	24
Lutja .....	26
Anija .....	28
Shpëtimi .....	29
Fund .....	31
<b>Pas Nuhut</b> .....	<b>32</b>
Pejgamberi .....	33
Fisi Ad .....	34
Stuhia .....	37
<b>Krahina Hixhr</b> .....	<b>40</b>
Salihu .....	41



Rrëfimet më të mira

Fisi Themud . . . . .	43
Deveja . . . . .	44
Krimi . . . . .	45
Dënimi . . . . .	46
Shpëtimi . . . . .	48
<b>Në Babiloni . . . . .</b>	<b>49</b>
Familja e Azerit . . . . .	50
Ibrahimi . . . . .	50
Me prindin . . . . .	51
Dielli, hëna dhe yjet . . . . .	53
Nemrudi . . . . .	55
Idhujt . . . . .	56
Hixhreti . . . . .	60
Në Egjipt . . . . .	61
Toka e Ken'anëve . . . . .	63
Ismaili . . . . .	64
Për në Mekë . . . . .	65
Safa dhe Merva . . . . .	67
Burimi Zem-Zem . . . . .	67
Fisi Xhurhum . . . . .	68
Ëndërra . . . . .	70
Pragu i derës . . . . .	72
Qabja . . . . .	74
<b>Shuajbi . . . . .</b>	<b>79</b>
Qyteti Medjen . . . . .	79
Shuajbi . . . . .	80
Populli Medjenit . . . . .	83
Dënimi . . . . .	86
Shpëtimi . . . . .	87
<b>Luti . . . . .</b>	<b>88</b>
Sodoma . . . . .	89
Pejgamberi . . . . .	90

Rrëfimet më të mira

Gruaja e Lutit .....	92
Lutja .....	92
Mysafirët e panjohur .....	93
Takimi me Lutin .....	95
Në shtëpinë e pejgamberit .....	96
Melekët .....	97
Dënimi .....	100
Shpëtimi .....	101
<b>Ismaili .....</b>	<b>103</b>
<b>Fisniku – i biri i fisnikut .....</b>	<b>108</b>
Një fe e vetme .....	109
<b>Jakubi .....</b>	<b>112</b>
Në dorëshkrimet e hershme .....	112
Ndër historitë më të bukura .....	114
Ëndrra .....	115
Zilia .....	117
Pusi .....	118
Tek Jakubi .....	119
Karvani .....	121
Në Misir .....	121
Në pallatin mbretëror .....	122
Gruaja e ministrit .....	123
Gostia .....	126
Burgu .....	129
Këshilla e Jusuffit .....	131
Jusufi .....	133
Ëndrra e mbretit .....	134
I burgosuri bëhet princ .....	135
Pas shumë vitesh .....	138
Biseda me Jakubin .....	141
Vëllai i vogël .....	143
Tek Jakubi .....	145

Përballë vezirit të panjohur .....	147
Myzhde .....	149
Ëndrra bëhet realitet .....	150
Takimi i fundit .....	152
Lutja e peygamberit .....	153
<b>Ejubi .....</b>	<b>155</b>
Bashkëshortja fisnike .....	155
Lutja .....	157
Përkujtim .....	157
<b>Junusi .....</b>	<b>159</b>
Shorti .....	159
Lutja në errësi .....	160
Në breg .....	161
<b>Musai .....</b>	<b>163</b>
Pas Jusufit .....	163
Firaoni .....	164
Lindja e ngadhënjimtarit .....	166
Në pallatin mbretëror .....	168
Tek nëna .....	169
Përsëri në pallat .....	171
Goditja vdekjeprurëse .....	172
Në Medjen .....	175
Shpërblimi i merituar .....	177
Princi bëhet çoban .....	178
Kthimi në egjipt .....	181
Me Harunin .....	185
Tek firaoni .....	187
Mrekullitë e Musait .....	189
Në shesh .....	191
Musai dhe magjistarët .....	192
Perëndimi i magjistarëve .....	194
Besimtari nga familja e firaonit .....	196

Rrëfimet më të mira

Karuni .....	199
Gruaja e firaonit .....	202
Gjashtë shenjat .....	205
Shpëtimi .....	210
Në bregun e tjetër .....	214
Në shkretëtirë .....	216
Biseda me Allahun .....	218
Viçi i praruar .....	219
Pas katërdhjetë ditësh .....	221
Në "Tur" .....	222
Pendimi .....	224
Lopa .....	225
Kodra .....	227
Edhe më shumë .....	228
Në kërkim të diturisë .....	229
Me burrin e urtë .....	232
Zbulimi i fshehtësisë .....	233
Vdekja e Musait .....	235
<b>Jusha Bin Nun .....</b>	<b>236</b>
Çlirimi i Palestinës .....	237
Plaçka e luftës .....	238
Në portat e qytetit .....	238
Kibla .....	239
<b>Shemuli .....</b>	<b>241</b>
Sundimtari .....	242
Lufta .....	243
<b>Davudi .....</b>	<b>247</b>
Për një dele .....	248
Dhuratë e çmuar .....	250
Vdekja e Davudit .....	251
<b>Sulejmani .....</b>	<b>253</b>

Ujku .....	253
Vreshtat dhe delet .....	255
Kuajt e shpejtë .....	256
Sundimi pa kufi .....	257
Sulejmani dhe Mbretëresha e Jemenit .....	259
Vdekja e Sulejmanit .....	265
<b>Sha'j-i dhe Hizekiu .....</b>	<b>268</b>
Rrënimi i Izraelit .....	270
Nabukodonosori .....	271
Pas 100 vitesh .....	272
<b>Familja e Imranit .....</b>	<b>274</b>
Në faltore .....	275
Zekerija .....	276
Jahja .....	277
Sihariqi .....	277
Xhibrili .....	278
Lindja e mesihut .....	279
Vitet e para .....	281
Mrekullitë .....	282
Hauarijunët .....	284
Murgëria .....	285
Ahmedi .....	286
Sofra .....	287
Kurthi .....	288
Lartësimi .....	289
Kryqëzimi .....	290
Pas kryqëzimit .....	291
Shtrembërimi i fesë .....	291
Thertorja e madhe .....	292
Mesihu Dexhal .....	297
Zbritja e Isait .....	300
Je'xhuxhët dhe Me'xhuxhët .....	302
Vdekja e Isait .....	305